المؤسسة الإسلامية للشباب

Fondacioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth

Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
☎ + 41 (0) 43 300 16 70

www.islamischen.ch
✉ Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَٰنِ الرَّحِيمِ

N ë emër të A ll-llahut, të Gjithëmëshirshmit, M ëshiruesit!

KUR'ANI

PËRPJEKJE PËR TË KUPTUARIT BASHKËKOHOR

Dr. Mustafa Mahmud

Botuar nga: Botues Privat

Të gjitha të drejtat e këtij libri i takojnë përkthyesit Muhamed I. Dolaku

STRUKTURA E KUR´ANIT 4
DETERMINIZMI DHE INDETERMINIZMI 17
HISTORIA E KRIJIMIT 40
XHENNETI DHE XHEHENNEMI 74
HALLALLI DHE HARAMI 97
TEORIA DHE PRAKTIKA 109
EMRAT E ZOTIT 118
NJË ZOT DHE NJË RELIGJION 134
BOTA E PADUKSHME 148
DITA E GJYKIMIT 164
RINGJALLJA PAS VDEKJES 175
ISLAMI NUK NJEH NDËRMJETËSIMIN 188
NUK KA ZOT TJETËR PËRVEÇ ALL-LLAHUT 197
MU´XHIZJA E KUR´ANIT, Ç´ËSHTË KJO? 211
PASTHËNIE 228
KOMENTIMET TRADICIONALE 230
KOMENTIMET RACIONALE 236
1. - KOMENTIMET E PRANUARA RACIONALE 237
2. - KOMENTIMET E QORTUARA RACIONALE 241
KOMENTIMET SHKENCORE 245

STRUKTURA E KUR'ANIT

Takimi im me Kur'anin ishte kur ende si fëmijë, në moshën katërvjeçare, rrija ulur në njërin prej shumë rreshtave në mejtepin e Shejh Mahmudit, duke shikuar gojëhapur në tabelë dhe në treguesin që e mbante në dorë, me të cilin i përcillte fjalët e shkruara me shkumës në tabelë, derisa i shqiptonte: "Ve-d-duha ve-l-lejli idha sexha!" *(Pasha mëngjesin dhe natën kur qetësohet)*, duke përsëritur mekanikisht pas tij: "Pasha mëngjesin dhe natën kur qetësohet!", duke mos kuptuar asnjë shkronjë dhe duke mos ditur se ç'është ai mëngjes e as se si nata qetësohet, por, megjithatë, mekanikisht i përsëritnim rrokjet dhe i shqiptonim fjalët.

Atëbotë mendja ime ishte tërësisht e pastër. Në të nuk kishte kurrfarë gjurmësh e as ndopak ndikimesh. Jam i edukuar në një familje ku çdo anëtar i saj ishte i dhënë pas vetës së vetë. E dëshironte atë që i pëlqente, ndërsa e përbuzte atë që nuk i pëlqente. Luante gjersa nuk u ngopte me lojë. Më kujtohet se klasën e parë e kam përsëritur tri herë pa kurrfarë qortimi. Njëshi i shkruar me laps të kuq e stoliste çdo faqe të fletores sime dhe gjithnjë nxiste vetëm gaz. Kur më pyetnin se çfarë note kam marrë sot iu thosha shkurt: si zakonisht, (duke iu shmangur në këtë mënyrë që të shpjegojë njëshin tim të përditshëm, i cili në raport me mua ishte bërë i mërzitshëm), e ata vetëm qeshnin.

Kështu rridhnin gjërat në shtëpinë tonë. Nuk kishte kurrfarë detyrimi për të mësuar e as shtrëngim në devotshmëri. Çdonjëri e kishte jetën e vet të cilën e ndiqte.

Nuk e kam pasur të njohur as të ashtuquajturit shpërlarja e trurit, të cilin e njihnin fëmijët e tjerë në shumë familje, që me kamxhik e shkop detyroheshin në shkencë dhe devotshmëri.

Fjalët e para nga Kur'ani i kam mësuar, pra, me mendje plotësisht të pastër, pa kurrfarë ndikimesh të mëparshme, siç ka ndodhur edhe me matematikën, gjeografinë dhe hartimin e lirë.

Dhe, siç kam qenë i mahnitur me rrëfimin mbi trajtën sferike të Tokës, e cila lëviz, kontinentet dhe ujdhesat, të cilat notojnë mbi të dhe rrëfimin mbi Hënën, e cila rrotullohet rreth Tokës, e Toka rreth Diellit, kurse të gjitha së bashku janë në lidhje të ngushtë njëri me tjetrin, po ashtu kam qenë i mahnitur edhe me Kur'anin. Jam hutuar gjatë përshkrimit të ndjenjave me të cilat për të parën herë e kam pranuar fjalën e parë të Kur'anit.

Nuk kam fjalë me të cilat do ta shpjegoja gjendjen time të atëhershme shpirtërore. Fjalët nga vetvetiu ktheheshin dhe pushtonin dëgjimin tim dhe memorien time, kurse unë në vetmi i përsërisja ato në vete... "Pasha mëngjesin dhe natën kur qetësohet."

Shprehja kur'anore ka depërtuar në qetësinë e fëmijërisë sime. Në natën e errët më kujtohet diksioni i Shejhut tim i cili shqiptonte: "Ve xhae min aksa-l-medineti rexhulun jes'a" (Dhe nga skaji i qytetit ngutshëm erdhi një njeri).

Shprehjet lëviznin në imagjinatën time sikur të ishin krijesa të gjalla, të lira, të cilat e kanë jetën e vet të veçantë.

Është e sigurt se nuk kam ditur as ç'është ai mëngjes, as se si qetësohet nata, as që kam ditur se kush është ai njeri i cili ngutshëm ka ardhur nga skaji i qytetit.

Ndoshta rrokjet, ehoja e të cilave ka arritur gjer tek dëgjimi im, të ngjashme me shkallën muzikore... (sol, la, si, do, re, mi, fa), kanë qenë vetëm shkronja pa domethënie që nuk kishin kurrfarë efekti tjetër, pos atij muzikor, vetëm ton dhe ritëm që ngazëllen ndjenjat.

Po, që në fëmijërinë time të hershme, edhe pse nuk kam qenë i vetëdijshëm për këtë, kam zbuluar muzikën e brendshme të shprehjes kur'anore.

Kjo është njëra nga fshehtësitë më të mëdha të strukturës së Kur'anit. Ai nuk është poezi, as prozë, e as poezi në prozë. Kjo është strukturë e posaçme e fjalëve të radhitura në mënyrë e cila në to zbulon muzikën e brendshme.

Ekziston dallimi i madh ndërmjet muzikës së brendshme dhe asaj të jashtme.

Si shembull të marrim vargun e poetit Umer b. Ebi Rabiut, të njohur përkah muzika në poezinë e vet..., ku thotë:

"Më tha shoku për t'kuptua se ç'është me mua. A e do vrasësin e sate motër, Rebab?"

Ti dëgjon, mallëngjehesh dhe dridhesh... por kjo muzikë është e jashtme. Këtë e ka përpiluar poeti me rimë të dyfishtë dhe me mbylljen e çdo gjysmëvargu me shkronjën e gjatë b.

Muzika arrinë të dëgjohet nga jashtë, e jo nga brenda, nga mbyllja e gjysmëvargut (rimës)... nga metrika poetike. Por kur e shqipton:

"Pasha mëngjesin dhe natën kur qetësohet!" Ti gjendesh para një rimimi..., që është i zhveshur nga mbyllja, metrikës poetike dhe rimimi i dyfishtë i pjesëve... Por, edhe përkundër kësaj, muzika gufon prej çdo shkronje. Prej nga? Në ç'mënyrë?

Kjo është muzikë e brendshme. Njëra nga fshehtësitë e strukturës kur'anore e cila nuk ka asgjë të përbashkët me strukturën letrare. Gjithashtu kur thua: "Bamirësi i Gjithmbarshëm që qëndron mbi Arshin." (Ta Ha: 5). Apo kur i lexon fjalët e Zekerijas alejhis-selam me të cilat i drejtohet All-llahut xhel-le shanuhu: "Tha: "Zoti im! Eshtrat më janë dobësuar e koka më është thinjur, por kur Të jam drejtuar me lutje Ty, asnjëherë, o Zot im, nuk kam mbetur i pafat." (Merjem: 4). Apo fjalët e Zotit xhel-le shanuhu të drejtuara Musait alejhis-selam: "Çasti i ringjalljes do të arrijë me siguri - nga çdokush e fshehi atë - kur secili sipas angazhimit të vetë i shpërblyer apo i ndëshkuar do të jetë." (Ta Ha: 15). Apo fjalët e Zotit xhel-le shanuhu me të cilat ua tërheq vërejtjen njerëzve: "Atë që para Zotit të vet del si jobesimtarë, atë e pret Xhehennemi, në të as nuk do të vdes, as nuk do të jeton." (Ta Ha: 74).

Çdo shprehje vetëm për vete paraqet vepër muzikore, prej së cilës shpërthen muzika nga brenda, nga vetë fjalët, ndërmjet fjalëve, pas fjalëve, në mënyrë habitëse, kështu që fare nuk e din se si mbaroi kjo.

Dhe kur Kur'ani rrëfen tregimin e Musait alejhis-selam me stilin mallëngjyes simfonik: "Dhe Ne i patëm kumtuar Musait: "Transferoi natën robërit e Mi dhe nisu me ta rrugës së thatë nëpër det, pa u frikësuar se do të të arrijnë ata dhe se do të fundosesh. E, faraoni - me ushtrinë e tij, i ndoqi pas, por deti i mbuloi ata: faraoni e çoi popullin e vet në humbje, e nuk e udhëzoi në rrugë të drejtë." (Ta Ha: 77-79), fjalët arrijnë kulminacionin e butësisë, si psh. "së thatë", ose pa u frikësuar se ata do të të "arrijnë" - derkun me domethënie idrakun.

Fjalët shkrihen në flakën e Krijuesit të tyre, renditen dhe radhiten në vepër unike të jashtëzakonshme muzikore me të cilën nuk mund të krahasohet asgjë midis të gjitha atyre që janë shkruar në gjuhën arabe në të kaluarën, e as në kohën e sotme.

Nuk ekziston kurrfarë ngjashmërie midis kësaj dhe poezisë paraislamike, midis kësaj dhe poezisë e prozës së krijuar në shekujt e mëvonshëm, e as që ekziston ndonjë pretendim për tu imituar Kur'ani gjatë tërë historisë edhe pse shumë njerëz kanë qenë armiqësisht të disponuar ndaj tij.

Në tërë këtë thurje, shprehja Kur'anore veçohet si shprehje unike me të gjitha karakteristikat e veta... sikur kjo të ishte dukuri që nuk e ka arsyen e vet, e as komentimin e vet, përveç ndonjë burim tjetër, për ne të panjohur.

Dëgjoje këtë ritëm të bukur intonues: "Ai është i pozitës më të lartë, pronar i Arshit, dërgon Shpalljen, Fjalën e Vet - kujt të dojë nga robërit e Vet, që t'u tërheq vërejtjen në Ditën e takimit (Kiametit)." (El-Mu'min: 15).

"...Ai bënë që kokrra dhe bërthama të mugullojë. Ai nga jo e gjalla nxjerr të gjallën, e nga e gjalla jo të gjallën." (El-En'am: 95).

"Ai bënë që mëngjesi të agojë. Ai natën e bëri për pushim, e Diellin dhe Hënën për të llogaritur kohën." (El-En'am: 96).

"Ai di për shikimet e përvjedhur të syrit, dhe atë ç'fshehin kraharorët." (El-Mu'min: 19).

"Shikimet nuk mund ta përfshijnë Atë, e Ai i përfshinë shikimet e të gjithëve..." (El-En'am: 103).

"...Zoti ynë me dijeninë e Tij përfshinë të gjitha..." (El-A'raf: 89).

Pastaj këtë shprehje të re në trajtën e vet... në thellësinë e domethënies së vet dhe në të treguarit e saj për paaftësinë e njeriut që ta kuptojë esencën e Krijuesit:

"Ai e di botën e dukshme dhe të padukshme. Ai është i Madhërishmi dhe i Lartësuari." (Er-Ra'd: 9).

"...Ata përsëri polemizojnë për All-llahun, e Ai është i ashpër në ndëshkime." (Er-Ra'd: 13)

Pastaj ky digresion në përshkrimin e fuqisë së Zotit:

"Tek Ai gjenden çelësat e të gjitha fshehtësive, dhe vetëm Ai i di ato. Ai i Vetmi e di ç'ka në tokë dhe ç'ka në det, asnjë gjeth nuk bie, pa e ditur Ai, dhe nuk ekziston asnjë kokërr në thellësitë e Tokës, as diçka e freskët e as e thatë, e të mos jetë shënuar në Librin e qartë (Lehvi Mahfudh)." (El-En'am: 59).

Por, muzika e brendshme nuk është gjithë ajo me çka shquhet shprehja kur'anore. Së bashku me muzikën paraqitet edhe një veçori tjetër - madhësia.

Në një shprehje të thjeshtë e të thukët, në të cilën All-llahu xhel-le shanuhu flet për përmbytjen dhe me përfundimin e saj, mund ta ndiesh këtë madhësi në vet fjalët:

"Dhe qe thënë: "O Tokë, gëlltite ujin tënd, e ti, o qiell, ndalu!" Dhe uji u tërhoq e urdhëri u përmbush..." (Hud: 44).

Këto kontakte kolosale... çdo fjalë e ka peshën e kodrës dhe goditjen e rrufesë... Lëshohet dhe çdo gjë qetësohet, heshtazi dhe rehatshëm. Natyra frenohet nga pezmi, gjersa rrëfimi është duke

përfunduar: "Dhe qe thanë: "O Tokë, gëlltite ujin tënd, e ti, o qiell, ndalu!" Dhe uji, u tërhoq e urdhëri u përmbush."

Me të vërtetë, në këto fjalë kolosale, të gdhendura nga graniti, ndien diç që nuk është njerëzore, të duket se çdo shkronjë e tyre paraqet shkëmbinj të Alpeve.

Këtu është e pamundur të ndërrohet madje edhe një shkronjë e vetme; ndonjë fjalë të zëvendësohet me tjetrën e që do të kishte tingëllim të njëjtë, pastaj ritmin, gjallërinë, peshën dhe dëshminë e njëjtë. Mundohu dhe sprovo aftësitë tua në këtë thurje të rëndomtë prej dhjetë fjalësh që ta zëvendësosh ndonjë shkronjë apo ndonjë fjalë me tjetrën.

Për këtë shkak, të shprehurit kur'anor tek arabët paraislamikë, të cilët kanë pasur prirje të madhe për retorikë, ka pasur efekt si rrufeja.

Atëherë nuk është për t'u habitur që arabi paraislamik, siç është Velid b. Mugire, i cili ka jetuar dhe ka vdekur si pagan, të jetë i shastisur dhe se nuk ka mund ta fsheh admirimin e vetë ndaj Kur'anit pa marrë parasysh kufrin e tij, kur ka thënë, duke konsideruar se ky është të folurit e Muhammedit alejhis-selam: "Për Zotin, në të folurit e tij me të vërtetë ekziston diç e këndshme dhe e rrjedhshme. Të folurit e tij është i dobishëm, i frytshëm dhe i përsosur. Nuk ekziston diç më të përsosur se ky."

Pas kërkesës së disave që ta ofendojnë Muhammedin alejhis-selam ai ka thënë: "Thuani: "Ai është magjistar, të folurit e tij e ndanë djalin nga babai, vëllain nga i vëllai, burrin nga gruaja dhe njeriun nga familja".

Po, ai është i mrekullueshëm, madje edhe në gjuhën e armikut i cili angazhohet të gjejë fjalë të rënda për ta plagosur.

Nëse sot të shprehurit kur'anor nuk na okupon, shkakun për këtë duhet kërkuar në gjuhën tonë lokale me të cilën jemi mësuar qysh nga ditët e fëmijërisë dhe e cila gjithnjë e më tepër është duke na larguar nga gjuha klasike arabe... Pastaj, në vetë mënyrën e leximit të Kur'anit nga ana e lexuesve profesional, ku nuk dallohet pikëllimi nga gëzimi, kërcënimi nga lajmi i gëzueshëm, lajmi i gëzueshëm nga këshilla, në të theksuarit e nivelizuar ku zhduken domethëniet, kurse shprehjet bëhen sipërfaqësore... sikurse tek disa lexues profesional të cilët Kur'anin e lexojnë në mënyrë të zgjatur, kënduese, pa kurrfarë emocionesh në zemër... mandej në shumë rrethana të tjera, Kur'ani mësohet në mënyrë të përciptë... pastaj jeta moderne me të gjitha preokupimet e saja e cila largon vëmendjen, e brenë shpirtin, ku zemrat janë të ngurosura, kurse individët të kompleksuar.

Pa marrë parasysh të gjitha këto shkaqe, mjafton që njeriu vetëm për një çast të shkëputet nga ky mjedis ngjitës e ta ndiej bukurinë, ëmbëlsinë, shijen dhe ritmin e Kur'anit. Kjo mjafton që përsëri të admirohet, edhe pse kanë kaluar më tepër se 1.400 vjet nga shpallja e tij, duket sikur t'ishte shpallur mu në këtë çast.

Dëgjoje Kur'anin se si përshkruan raportin seksual ndërmjet bashkëshortëve me një stil karakteristik, me fjalë të buta, edukuese, të cilave nuk mund t'i gjesh të barabarta e as që mund ta ndërrosh ndonjërën në cilëndo gjuhë qoftë:

"Dhe kur e mbuloi ai atë, ajo u ngarkua me një barrë të lehtë..." (El-A'raf: 189).

Kjo fjalë "e mbuloi" (akti seksual)... E mbuloi burri i saj. Të bashkohen mashkulli dhe femra sikurse që bashkohen hijet dhe sikurse që nata e mbulon ditën dhe sikurse që ngjyrat treten njëra në tjetrën. Kjo fjalë me të cilën Kur'ani shpreh këtë bashkim të plotë paraqet apogjeun e të shprehurit.

Edhe fjalët e tjera që i lexon në Kur'an lënë në shqisën e dëgjimit jehonë, tingull dhe fotografi. Kur Zoti betohet në natën dhe në ditën, e thotë:

"Dhe natën kur ajo e ngrit velin, dhe agimin kur merr frymë!" (Et-Tekuir: 17-18).

"As'as..." Këto katër shkronja paraqesin natën me gjithë atë që gjendet në të. "Dhe agimin kur merr frymë!" Drita e mëngjesit këtu është e dukshme dhe e dëgjueshme... Vërtet mund të dëgjosh cicërimën e zogjve dhe këndimin e gjelit.

Kur ajetet e Kur'anit paralajmërojnë zemërimin dhe ndëshkimin, atëherë fjalët janë shpërthyese... Struktura Kur'anore është në shenjë oshtime.

Dëgjo se ç'thotë All-llahu për popullin e Adit:

"Ndërsa Adi është shkatërruar me një erë të akullt, të furishme, të cilës Ai ia pat lënë pushtetin mbi ta shtatë netë dhe tetë ditë - parreshtur, e ke mund t'i vërejshe njerëzit e rrokullisur si të ishin trungje hurmash të zgavëruar" (El-Hakka: 6-7).

Në të gjitha këto ajete dëgjon se si fërshëllen era, se si rrëzohen trungjet e hurmave, se si gremiset toka.

Fotografitë kur'anore këtu janë të retushuara, hijet janë të sakta, kurse fjalët posedojnë tonin, zërin dhe fotografinë.

Duke pasur parasysh të gjitha këto, del se Kur'ani është Libër që nuk përkthehet. Ky është Kur'an vetëm në gjuhën arabe... Në gjuhët tjera ai është diç tjetër, e jo Kur'an... "Ne Kur'anin e kemi shpallur në gjuhën arabe". Me këtë, çështja definitivisht është tërhequr nga rendi ditor.

Si është e mundur, p.sh., të përkthehet ajeti: "Er-Rahmanu alel-arshi-steva" (Ta Ha: 5). Ne nuk gjendemi vetëm para domethënies... Por në rend të parë para strukturës...para krijimit muzikor prej të cilit shpërthen muzika nga brendia e vetë fjalëve, prej zemrës, e jo prej margjinave, prej veçantisë së gjuhës arabe, fshehtësirave të saja, fuqisë së saj.

Për këtë shkak ajeti kur'anor veçohet me karakteristika të jashtëzakonshme. Ai nxitë përulësinë e shpirtit posa ta prekë veshin dhe para se mendja ta shqyrtojë domethënien e tij, sepse ai paraqet konstruksion muzikor i cili ndikon në emocione dhe në zemër para se mendja të fillojë të punojë dhe të influencojë.

Kur mendja fillon të shqyrtojë dhe të analizojë, ajo zbulon gjëra të reja dhe atëherë vjen deri te përulësia më e madhe... Kjo është etapa e dytë që mund të ndodhë, por edhe nuk është e domosdoshme të ndodhë... Ngandonjëherë ajeti kur'anor ta zbulon fshehtësinë e vet, e nganjëherë edhe nuk e zbulon atë... Ngandonjëherë fiton prirje vëzhgimi me të cilën ia del ta shkoqitësh ajetin kur'anor, e ngandonjëherë ajo mungon, por, gjithmonë, e ndien një prekje në zemër, sepse Kur'ani të drejtohet së pari si strukturë e jashtëzakonshme..., godinë..., formë..., model që përmbush zemrën..., të cilën e ka kumtuar Ai që e krijoi gjuhën dhe që i di fshehtësitë e saja, e assesi Muhammedi alejhis-selam i cili ishte analfabet dhe i cili dridhej siç dridhesh edhe ti,

kurse shpallja i arrinë me ajetin: "Lexo në emër të Zotit tënd i cili ka krijuar *(të gjitha)*", dridhej dhe djersitej dhe nuk dinte se nga i cili qiell po i vinte ky urdhër... Kërkon strehim te gruaja e vet Hatixheja, i frikësuar nga ajo që kishte dëgjuar, duke u drojtur se mos po çmendet, kurse ajo e qetëson me zërin e saj të ëmbël:

"Për Zotin, Ai kurrë nuk do të poshtrojë... Do të jesh i shpërblyer me përdëllim... Gjithçka do të durosh... Do t'u ndihmosh të humburve... Do ta gostitësh mysafirin dhe do të sjellësh ndryshime rrënjësore."

Pas këtyre fjalëve të para, Shpallja qe ndërprerë dy vjet. Qe lënë në dilemë. Shetiste shkretëtirës përvëluese dhe vetëm që nuk luante mendsh për shkak të zërit të dëgjuar, e që më vonë ishte zhdukur.

Sikurse Muhammedi alejhis-selam të ishte shkrimtar, gjatë këtyre dy viteve do ta shkruante një vepër të tërë.

Ai nuk ka qenë më tepër se një dëgjues fetar. I ka dëgjuar ato fjalë, të cilat kanë më shumë muzikë, siç i dëgjon edhe ti në çastin e sinqeritetit dhe dëlirësisë tënde, andaj ka qenë i habitur siç habitesh edhe ti , ndërsa ndjenjat i ishin të goditura para asaj shprehjeje të veçant.

Pas dy vitesh përsëri dëgjon zërin e njëjtë:

"O ti i mbuluar! Ngrihu dhe tërhiqu vërejtjen!" (El-Muddeththir: 1-2).

Pastaj ajetet kur'anore filluan të zbresin pandërprerë.

Muhammedi alejhis-selam nuk ka qenë prej atyre që i përvetësonin njerëzit me mu'xhize, me mrekullira.

Kur e ka varrosur djalin e vet të vdekur, Ibrahimin, është shfaqur zënia e plotë e Diellit. Disa këtë rast e komentonin si mu'xhize dhe pjesëmarrjen e natyrës në dhembjen e Muhammedit alejhis-selam, i cili me atë rast i ka thënë fjalët e veta të njohura:

"Dielli dhe Hënejanë dy shenja të Zotit, të cilat kurrë nuk janë zënë për shkak të vdekjes së dikujt, e as për shkak të lindjes së dikujt."

Sikur të ishte prej atyre që shërbehen me mrekullira do të shfrytëzonte këtë ngjarje për propagandë personale, por ai ka qenë besimtar i sinqert që nga fillimi i jetës së tij e gjer në vdekje .

Shpallja i arrinë Muhammedit alejhis-selam mbi atë që nuk di asgjë.

"Këto janë lajme të panjohura (sekrete). Ne po t'i shpallim ty (o Muhammed!). Ti nuk ishe i pranishëm kur ata hidhnin short, se kush prej tyre do të bëhet kujdestar i Merjemes. Dhe ti nuk ishe i pranishëm kur ata grindeshin mes veti." (Ali Imran: 44).

"Këto janë lajme të panjohura (sekrete) që po t'i shpallim ty. Nuk i ke ditur as ti, as populli yt para kësaj (shpalljes së Kur'anit). Andaj bëhu i durueshëm, se, në fund, fitorja (e lavdishme) është e besimtarëve." (Hud: 49).

Shpallja i arrinë edhe mbi fshehtësitë e Teuratit dhe Inxhilit... të cilët, në atë kohë të lashtë, nuk kanë qenë të përkthyer në gjuhën arabe (teksti i parë krishter i përkthyer në gjuhën arabe është

dorëshkrim që gjendet në Bibliotekën e Shenjtë në Petrograd, i shkruar rreth vitit 1060.) Këto Libra kanë qenë fshehtësira Hebrenje, për të cilat askush nuk ka ditur gjë, përveç tyre.

Kur'ani kërkon nga hebrenjtë që t'i nxjerrin dorëshkrimet e veta dhe t'i lexojnë ato.

"Thuaj: "Sillne Teuratin dhe lexone atë, nëse e flisni të vërtetën." (Ali Imran: 93).

Pastaj i përmirëson disa detaje në Teurat. Sipas gojëdhënës së Teuratit që ka të bëjë me rrëfimin mbi Jusufin, qëndron se vëllezërit e tij për të udhëtuar nga Palestinenë Egjipt kanë përdorur gomarë, ndërsa Kur'ani thekson se kanë përdorur deve "el'iir".

Gomari nuk është kafshë e beduinëve dhe ai nuk mund të kalojë rrugë aq të gjatë në shkretëtirë për të vajtur nga Palestine në Egjipt... Gojëdhëna që ka të bëjë me "el-iir" është më e saktë dhe më e vërtetë.

A nuk i ka mallkuar Jermiu: "pendët e rrejshme të përshkruesve."

Muhammedit alejhis-selam i mbërrinë Shpallja mbi atë për çka nuk din asgjë, nuk dijnë as shokët e tij, as'habët, as populli i tij, e as përshkruesit e Teuratit dhe ruajtësit e tij..., pastaj fillimi i disa kaptinave të Kur'anit, të cilat më tepër i ngjajnë enigmave dhe shifrave, si p.sh... Kaf-ha-ja-ajn-sad, Ta-sin-mim, Ha-mim, Ajn-sin-kaf, për të cilat Pejgamberi alejhis-selam nuk ka lënë kurrfarë komentimesh.

Sikur të ishte Muhammedi alejhis-selam autor i Kur'anit, atëherë ai në të do të na tregonte për pikëllimin e vet, gjendjen e vet psikike, krizat e veta, dhembjet... Kur'ani është diç krejtësisht i kundërt nga kjo. Ai, që nga fillimi e gjer në fund, është izoluar nga psikika e Muhammedit alejhis-

selam, duke përfshirë këtu edhe preokupimin dhe interesin e tij... madje disa ajete janë shpallur përkundër dëshirës së Muhammedit alejhis-selam

"...Dhe mos shpejto në të lexuarit e Kur'anit para se të përfundojë (shpallja e tij)." (Ta Ha: 114).

E tërë kjo e vendos Kur'anin para nesh si fenomen që është i izoluar tërësisht nga Muhammedi alejhis-selam, i cili na ka lajmëruar mbi këtë... Ai është vetëm ndërlidhës i cili e ka kumtuar atë që e ka dëgjuar.

Për sa i përket Kur'anit, ky edhe me fjalë edhe me domethënie është nga All-llahu xhel-le shanuhu i Cili çdo gjë përfshinë me diturinë e vet.

DETERMINIZMI DHE INDETERMINIZMI

Kur'ani është i veçantë për kah struktura e vet, i pakrahasueshëm për kah mënyra se si janë të sistematizuara fjalët, nga brendia e të cilave gufon muzika, e jo nga margjinat e metrikës poetike dhe mbylljes së gjysmëvargut, por nga brendia e vetë fjalëve, në mënyrë të panjohur dhe tërësisht hutuese, që dëgjuesin e shpien në përkorësi dhe kah kuptimi i zgjidhjes së tij të paqartë. Posa ta dëgjojmë Kur'anin bëhemi robër të tij para se të fillojmë të mendojmë mbi fjalët e tij. Kur fillojmë të mendojmë, t'i shqyrtojmë dhe t'i analizojmë fjalët e tij, atëherë na hapen thesarët e domethënieve, njohurive dhe mendimeve për të cilat nevojiten vëllime të tëra shpjegimesh. Për

këtë shkak, këtu do të ndalemi vetëm tek disa çështje të stërlashta... Si i parashtron Kur'ani ato dhe çka thotë për to?

Së pari: Çështja e lirisë.

Liria është një zbrazësirë e madhe përmes së cilës futet dyshimi dhe përmes së cilës përlirohen diletantët e ndryshëm, të prirur për polemikë. Më së pari që do të thoshte ndonjëri prej tyre është: "Nëse Zoti e ka paracaktuar atë që do të bëj unë, përse atëherë më thërret në përgjegjësi? Nëse çdo gjë në këtë botë rrjedh sipas urdhërit të Zotit, atëherë në çka bazohet mëkati im"?

Parashtrohet pyetja, vërtetë, si problem.

Pejgamberi alejhis-selam i ka porositur shokët e vetë, as'habët, që të mos hyjnë në këso polemikash. U ka thënë: "Nëse përmendet kaderi (përcaktimi i All-llahut), ju përmbahuni!"

Sepse e ka ditur se kjo është një nga çështjet filozofike në të cilën është vështirë të përgjigjet me të arriturat shkencore të asaj kohe. Polemika do t'i shpiente në ato hapësira në të cilat do të humbnin. Për këtë arsye i ka dhënë përparësi besimit me zemër kundruall llomotitjeve racionale sterile.

Ky është testament i cili nuk mund të zbatohet tërësisht në kohën tonë, në kohën kur filozofia studiohet edhe në universitete, dhe pasi që ajo është bërë studim i arritshëm për çdokënd.

Për këtë arsye kjo çështje është bërë aktuale, dhe kërkon përgjigjje si nga filozofia ashtu edhe nga religjioni, siç që është e nevojshme të vëzhgohet edhe në dritën e Kur'anit.

Në esencë bota, duke përfshirë këtu Tokën, qiejt, yjet dhe planetët, prehet në zinxhirin e shkaqeve dhe kauzalitetit (shkaktueshmërisë) ku çdo gjë lëviz sipas sistemit të caktuar me përpikëri. Nëse ke letër dhe laps mundesh saktësisht të llogarisish se në ç'kohë do të lindë dhe do të perëndojë Dielli, sepse ky lëviz në pajtim me ligjin. Dhe çdo gjë në botë lëviz sipas ligjeve të caktuara, përveç njeriut, i cili e ndien se lëviz ashtu si dëshiron vet. Njeriu është i vetmi kryengritës i lirë kundër natyrës dhe gjasave të veta. Ai ballafaqohet me natyrën dhe lufton kundër saj, kurse në asnjë moment nuk mund ta parashikojë kësmetin e vet.

Determinizmin e brendshëm, sipas Frojdit, i cili dukuritë e jetës normale psikike, si dhe dukuritë psikoneurotike i shpjegon me dinamikën e instiktit të nënvetëdijshëm, i cili cakton drejtimin edhe përmbajtjen e përjetimeve të vetëdijshme shoqërore, e ka kontestuar vetë Frojdi kur ka thënë se instinkti është lëndë e papërpunuar me të cilën disponon vullneti me prridhjen, me lirimin apo me ngritjen e saj.

Në këtë mënyrë instinkti është shpier vetëm në kusht të zhveshur me të cilin disponon vullneti, siç disponon dhe dirigjon me kushtet e jashtme.

Kështu vullneti është bërë fakt që gjendet mbi instinktin.

E ngjashme është edhe me determinizmin klasor, të cilin e përfaqësojnë materialistët, të cilët njeriun e trajtojnë si pjesëtar të klasës e cila cakton motivet psikologjike, ndjenjat, vullnetin dhe personalitetin moral. Njeriu, në ujdi me këtë, sillet si aristokrat, si patric, si feudal, apo si proletar, e jo si filan filani. Ai mezi që posedon edhe personalitetin e vetë. Atë që paramendon se është personaliteti i tij i lirë, në realitet është vetëm një grup normash morale që i ka huazuar nga klasa

të cilës i përket. Ky është determinizmi klasor i cili shprehet përmes tij. Ai është vetëm mjet mes të cilit shprehet fuqia shoqërore në luftën e vet.

Kjo teori mendimin materialist dhe psikologjinë klasore e ka hedhur në kontradiktë tejet të madhe. Në ç'mënyrë, psh. do të shpjegojmë sjelljen e njeriut siç ka qenë Tolstoji, patric feudal me trashëgim, i cili, megjithëkëtë, nuk është sjellur si aristokrat e as si feudal, por si avangardist (pararojës) i të varfërve dhe fshatarëve duke rrëzuar kështu atë determinizëm, të cilin e kemi quajtur "psikologjia klasore", ose psh. Bakunjini dhe Kropotkini - avangardistë të anarkizmit, e kanë qenë udhëheqës të spikatur ushtarak. Edhe vetë Marksi, bir i klasës borgjeze, është kthyer kundër borgjezisë.

Çka të themi për punëtorin i cili e lë pas dore pastrimin e barojave në ekonominë bujqësore, apo punëtorin i cili e lë pas dore mirëmbajtjen e automobilit në sektorin shoqëror.

Ky determinizëm, të cilin e përkrahë psikologjia klasore, në realitet, nuk është as shkencor e as i saktë.

Është fakt se vetëm shpirti njerëzor posedon fuqinë e brendshme e cila i mundëson të shmanget nga ...duhet, ...domosdo, ...gjithsesi, ...paracaktuar.

Vullneti njerëzor posedon lirinë e cila mundëson t'i shmanget çfarëdo lidhshmërie. Është e pamundur të parashikohet se çka ndodh në departamentin e vetëdijes e cila faktikisht është e lirë.

Nuk ekziston asgjë që do të mund të qëndrojë si pengesë mes njeriut dhe asaj që gjendet në vetëdijen e tij. Njeriu është e vetmja krijesë që i posedon çelësat e ëndrrave të veta.

Por, kjo liri në brendinë e vetëdijes së njeriut, së shpejti bie në konflikt me botën që e rrethon, tek kontakti i parë me të në çastin e veprimit.

Vullneti ynë mbetet i lirë përderisa është i fshehur në vetëdije dhe në qëllime. Kur fillon realizimi i tij atëherë biem në konflikt me shumë pengesa. Pengesa e parë me të cilën biem në konflikt është trupi ynë me të cilin jemi të mbështjellur si me gjips (allç) dhe i cili na preokupon me nevoja dhe me obligime, kërkon ushqim dhe pije për të jetuar dhe për të ekzistuar. Nuk mund të ikim e të mos i përgjigjemi kërkesave të trupit tonë. Ngarendim për kafshatën e bukës, lodhemi duke kërkuar punë, zhytemi dhe humbasim në luftë për furnizim dhe kështu e humbim edhe një pjesë të lirisë sonë. Një pjesë, e jo tërë lirinë, e kjo është sakrificë e domosdoshme.

Dëshirat tona nuk mund të deklarohen për vetveten pa trupin tonë. Trupi ynë është mjet i lirisë sonë, por njëkohësisht edhe përkufizim i ynë. Jo vetëm trupi ynë, por edhe trupat e të tjerëve, gjithashtu janë mjete tona. Na shërbehemi me atë çka ka prodhuar punëtori, me atë që ka zbuluar shpikësi, me atë që ka shkruar letrari. Të gjitha këto janë fryte të trupave të tjerë dhe i lirive të tyre.

Shoqëria është një mjet shumë i madh që naështë lënë në shërbim me të gjitha ato që gjenden në të: ptt, mjetet e transportit, rryma elektrike, ujësjellësi, industria, shkenca dhe dituria.

Kur dikush prej nesh udhëton me tren, ai udhëton me mjetin e transportit për prodhimin e të cilit kanë punuar me mijëra punëtorë, inxhinierë dhe shpikës, e si kundërvlerë për këtë ai vullnetarisht paguan çmimin për transport.

Shoqëria nuk është e vetmja që e kërkon çmimin e saj, por këtë e kërkon edhe e tërë Gjithësia, gravitacioni i tokës, shtypja ajrore, ujërat e oqeaneve, qielli dhe yjet. Të gjitha këto e rrethojnë njeriun dhe lirinë e tij, dhe kërkojnë nga ai një lloj harmonizimi me ato. Njeriu, përmes kësaj harmonie, është gjithnjë i lirë dhe në fitim e sipër. Duke qenë në harmoni me botën e jashtme njeriu e frenon atë sikur që kalorësi e frenon kalin e vet.

Kur vërenë se druri është më i lehtë se uji dhe e ndërton barkën nga druri, ai, në këtë mënyrë e ka frenuar edhe ujin edhe drurin. Kur e kupton atë që i shërben njerëzve dhe niset në këtë drejtim, ai e përfiton simpatinë dhe ndihmën e tyre.

Njeriu gjatë jetës së vetë hamendet mes dy botëve. Botës së vullnetit të lirë në brendinë e tij dhe botës materiale rreth veti, të farkuar dhe të lidhur me ligje të ndryshme.

Rruga e vetme e njeriut gjer tek veprimi i tij i lirë është njohja e këtyre ligjeve, shfrytëzimi i tyre me shkathtësi, e megjithatë, duke iu përshtatur këtyre. E kjo është gjithnjë e mundur.

Prandaj liria është realitet, që nuk e mohojnë rezistencat dhe kushtet e jashtme. Përkundrazi, këto vetëm e vërtetojnë edhe më. Liria e jonë nuk është në gjendje të zbulojë domethënien e vet të jashtme pa këto pengesa të cilat i mënjanon dhe i përballon. Ajo zbulon domethënien e vet përmes konflikteve. Pa konflikte ajo as që posedon domethënien e vet.

Normat etike dhe ligjet shoqërore nuk e mohojnë lirinë. Ato më tepër i ngjajnë shenjave të komunikacionit të vendosura për rregullimin e qarkullimit dhe për lirinë sa më të madhe të të gjithëve.

Kur i cakton normat e epsheve tuaja, me këtë njëherit e ke arritur edhe lirinë, sepse je bë zotërues i vetvetes, e jo skllav i instinkteve tuaja.

Por liria e bixhozit, e të dehurit, narkomanisë dhe pasionit pas seksit nuk paraqesin liri, por nivele të vetëvrasjes, shkatërrimit të jetës, e me këtë edhe të lirisë.

Çdo zgjedhje e lirë e drejtuar kundër jetës nuk paraqet zgjedhje të lirë.

Çdo zgjedhje e lirë kundër ligjit natyror nuk është zgjedhje e lirë, por, përkundrazi, është shkatërrim i kësaj zgjedhjeje. Të gjithë e dimë se, nëse dëshirojmë të kemi liri sa më të madhe duke notuar, atëherë duhet të notojmë në drejtim të valëve, e jo përkundër tyre.

Duke rezymuar këtë mund të themi se liria e njeriut është realitet pa marrë parasysh atë se ajo është e kufizuar dhe se ka rezistenca. Njeriu është absolutikisht i lirë në departamentin e vetëdijes së vet.

Ai mund të fshehë atë që dëshiron, kurse relativisht është i lirë tek realizimet në lëmenjtë e punës dhe veprimtarisë, varësisht nga kufizimet dhe rezistencat rreth veti.

Pas kësaj mbetet misteri e stërlashtë në marrëdhëniet e njeriut dhe All-llahut xhel-le shanuhu, mbi raportin e lirisë së njeriut me vullnetin absolut të Zotit xhel-le shanuhu

Këtu paraqitet Kur'ani i cili ofron çelësat për zgjidhjen e kësaj çështje të stërlashtë.

Duke pasur parasysh se Kur'ani është Libër religjioz, e jo filozofik, ky kënaqet me isharete, me aludime dhe me simbolikë. Më së pari konstaton se njeriut i është dhënë liria sipas urdhërit, vullnetit dhe dëshirës së Zotit xhel-le shanuhu Ajo çka ndodh me lirinë e njeriut nuk ndodh me

dhunë nga ana e Krijuesit, e as me detyrim nga ana e qenieve të krijuara. Kështu ka gjykuar Përcaktuesi.

Kur'ani thotë qartë: "Sikur të donte Zoti yt, do të besonin të gjithë - që gjenden ne Tokë. E, përse atëherë ti t'i detyrosh njerëzit të bëhen besimtarë!?" (Junus: 99).

All-llahu nuk ka dashur ta detyrojë njeriun të besojë, edhe pse kjo qëndron në fuqinë e Tij. Ai ka dashur që njeriu të jetë i lirë, të zgjedh besimin - imanin, apo mosbesimin - kufrin, ashtu si dëshiron vetë.

"Dhe thuaj: "E vërteta është nga Zoti yt, andaj kush të dojë - le të besojë, e kush të dojë - le të mos besojë." (El-Kehf: 29).

"Në besim nuk ka dhunë - se me të vërtetë rruga e drejtë është dalluar qartë nga lajthitja!" (El-Bekare: 256).

"E, sikur Ne të donim, çdonjërin do ta drejtonim në rrugë të drejtë..."(Es-Sexhde: 13).

"Edhe Themudit Ne ia kemi treguar rrugën e drejtë, por ata e deshtën (e preferuan) verbërimin e jo rrugën e drejtë." (Fussilet: 17).

All-llahu xhel-le shanuhu na lë të lirë edhe nëse kemi zgjedhur verbërinë në vend të rrugës së drejtë. Kësaj zgjedhjeje i ka paraprirë vullneti i Tij.

Madje na ka mundësuar edhe më tepër se kjo. na ka lënë të zgjedhim mes asaj që kemi zgjedhur vet. Na ka ofruar amanetin (lirinë dhe përgjegjësinë) që ta pranojmë apo mos ta pranojmë, ashtu

si të dëshirojmë - amanetin të cilin e kanë refuzuar malet. Njeriu është zotuar për këtë dhe ndaj vetvetes është bërë i padrejtë dhe mendjelehtë.

"Ne u kemi ofruar amanetin qiejve, Tokës dhe maleve, ata ngurruan ta bartin atë dhe u frikësuan prej tij, por njeriu e pranoi. Me të vërtetë, njeriu është zullumqar (për vete) dhe i padijshëm (për fundin - epilogun e amanetit)." (El-Ahzab: 72).

Njeriu nuk i ka ditur pasojat e këtij amaneti, nuk ka ditur për frikën dhe rreziqet me të cilat do të ballafaqohet ai që pranon këtë. Kështu ai i ka bërë padrejtësi vetvetes dhe të tjerëve. All-llahu ka ditur për këto vështirësira të mëdha. E ka ditur se këto njeriun do ta pastrojnë dhe do ta edukojnë.

"E kur Zoti yt u tha engjëjve: "Unë do të caktoj përfaqësuesin në Tokë!" - ata thanë: "A do të jetë përfaqësuesi Yt ai që në të do të bëjë çrregullime e do të derdh gjak? Ndërsa ne Ty të madhërojmë e të lavdërojmë dhe të lartësojmë ashtu si të takon Ty." Ai tha: "Unë di atë që ju nuk dini." (El-Bekare: 30)

Nuk e dimë se si, kur, dhe n'çmënyrë iu është ofruar njeriut të jetë apo të mos jetë i lirë. A ka ndodh kjo në fillim të krijimit të Ademit apo me shpirtra para hyrjes së tyre në mitër të nënës. Kjo është fshehtësi absolute. Kur'ani, në lidhje me këtë, kënaqet vetëm me isharet.

Në bazë të lirisë, të cilën vullnetarisht e ka pranuar, njeriu është përgjegjës dhe do të japë llogari. Kur'ani për këtë tregon në mënyrë të qartë në këto ajete:

"...Çdo njeri është përgjegjës për veprat e veta." (El-Muddeththir: 38).

"...Çdo njeri është përgjegjës për atë që ka punuar." (Et-Tur: 21).

"Çdo njeriu ia kemi varë në qafë punën e tij..." (El-Isra: 13).

"Thuaj: "Ju nuk do të përgjigjeni për mëkatet të cilat i bëjmë Ne, e as që do të përgjigjemi Ne për mëkatet që i bëni ju." (Seb'e': 25).

"....Dhe asnjë mëkatar nuk do t'i bartë mëkatet e tjetrit..." (El-Isra: 15).

Askush nuk mund ta shpëtojë askënd, as që mund t'i mbajë mëkatet e tjetërkujt. Çdo njeri e bartë veprën e vet dhe mëkatin e vet.

Në pajtim me këtë liri All-llahu xhel-le shanuhu i ka dhënë "Njeriut vetëdijen, zgjedhjen dhe ndërgjegjen" të cilat i ka bërë departament të ndaluar dhe shenjtëri të paprekshëm i cili nuk pranon detyrimin dhe determinizmin. Veten e ka obliguar që këtë departament ta bëj të ndaluar ku nuk do të hyj as ushtria e Tij.

Iniciativa e vetëvendosjes është krejtësisht e lirë.

Çdonjëri prej nesh mund të vendos në vetëdijen e vet çka të dojë. Intervenimi i Zotit fillon nga momenti i realizimit të vendimit tonë. Zoti i ofron çdo njeriu lehtësim në harmoni me vendimin, vetëdijen dhe zemrën e tij. Ai është burim i drejtësisë. Ai lejon që njeriu me vepër ta shpreh qëllimin e vet.

"Atij që jep (për bamirësi) dhe ruhet (prej gabimeve) dhe më të bukurën e konsideron për të vërtetë - Ne, atij do t'ia lehtësojmë rrugën e lumturisë (Xhennetit); - kurse atij që është koprrac

dhe pandeh se është i pavarur (nga Zoti) dhe më të bukurën e konsideron për gënjeshtër - Ne, atij do t'ia lehtësojmë rrugën e rëndë (Xhehennemit)." (El-Lejl: 5-10).

Këtu takohemi me një premtim tjetër të All-llahut xhel-le shanuhu, që përbëhet nga lehtësimi i veprës analogjikisht me qëllimin e fshehur të zemrës. Shpirtligu do të gjejë lehtësim tek realizimi i së keqes, kurse mirëbërësi lehtësim tek realizimi i së mirës, e te kush All-llahu sheh të mirën në atë drejtim edhe e udhëzon atë, kurse në të kundërtën ia lë djajve që ta shpiejnë në lajthitje.

"Ai e ka ditur se ç'ka në zemrat e tyre, andaj u ka dhënë atyre qetësi (siguri) dhe së shpejti do t'i shpërblejë me fitore." (El-Fet'h: 18).

Edhe në ajetet tjera thotë:

"Sikur të dinte All-llahu ndonjë të mirë të tyre, do t'i bënte të dëgjojnë." (El-Enfal: 23).

"...E, pasi ata u shmangën (nga e vërteta) - All-llahu u shmangu zemrat e tyre..." (Es-Saff: 5).

Duke qenë se All-llahu xhel-le shanuhu i di të gjitha që më parë, dhe pasi që të gjitha i ka përfshirë me diturinë e Vet, e shohim se si flet në Kur'an:

"...Dhe ndaj atyre është zbatuar fjala (e dënimit)..." (Fussilet: 25).

"E, ata, të cilëve u kemi premtuar shpërblimin e bukur qysh më parë..." (El-Enbija: 101).

"...E disa prej tyre merituan të mbesin në lajthitje..." (En-Nahël: 36).

"...Unë tanimë e kam thënë të vërtetën: "Me të vërtetë, do ta mbush Xhehennemin me xhinnë dhe me njerëz bashkarisht" (Es-Sexhde: 13).

Ai qysh më parë e ka ditur se njeriu në Tokë do të bëj trazira dhe do të nxisë gjakderdhje, dhe se do t'i bëj zullum edhe vetes edhe të tjerëve. Prandaj njeriu meriton ndëshkime të nivelit të ndryshëm.

Të gjitha këto All-llahu xhel-le shanuhu i ka ditur që më parë.

Kjo nuk është determinizëm e as fatalizëm, por, sikurse që ndodh, psh. ti vëren se njëri nga fëmijët e tu ka vullnet për shkencë, - ti i ndihmon dhe ia lehtëson këtë, madje e dërgon edhe në shtetet e jashtme që të specializohet, ndërkaq tek tjetri fëmijë vëren se ai është duke anuar kah përtacia, - ti kënaqesh me atë që do të mund të arrijë në atdheun e vet. Nëse do të veprosh ndryshe, atëherë do të bëhesh i padrejtë, sepse do t'i obligosh fëmijët për atë që është kundër natyrës së tyre.

Në këtë parandjenjë të mëparshme nuk ekziston faktori i detyrimit, por vetëm njohuri e vërtetë paraprake. Ti që më parë e din sipas karakteristikave morale të fëmijës tënd se ai do të jipet pas lojës dhe zbavitjes. Nëse i jipet lojës, e e len pas dore librin, kjo nuk është shtrëngim e as determinizëm. Kjo është natyra e tij, të cilën ti e ke njohur qysh më parë. Praktika e ka zbuluar personalitetin e tij për çka edhe e ka merituar ndëshkimin e drejtë. E më vonë ai e ka kuptuar atë që më parë nuk e ka ditur.

"Çdokush do të di për veprat që ka punuar dhe lëshimet (që ka bërë)." (El-Infitar: 5).

Për këtë arsye kjo botë paraqet fushë eksperimentale për hulumtimin e esencës së shpirtit dhe natyrës së tij.

"Ai i Cili ka krijuar jetën dhe vdekjen, për t'ju provuar se kush prej jush vepron më mirë..." (El-Mulk: 2).

Në këtë mënyrë asnjëri prej jush nuk mund të arsyetohet për shkak të veprave të tij dhe të thotë në çastin e dhënies së llogarisë - këtë e kam bërë kështu dhe kështu nën presionin e adeteve, traditës, rrethit, shoqërisë, edukatës, etj. All-llahu xhel-le shanuhu këtë temë e ka përfunduar me këto fjalë:

"All-llahu nuk ju ndëshkon nëse betoheni pa qëllim, por ju ndëshkon për atë që e bëni me qëllim." (El-Bekare: 225).

Në një ajet tjetër thotë:

"...Nuk është mëkat nëse gaboni diç, por është mëkat nëse këtë e bëni qëllimisht..." (El-Ahzab: 5).

Në ajetin e tretë All-llahu xhel-le shanuhu na flet për ata, të cilët i janë kthyer kufrit, mosbesimit, pas besimit dhe u kërcënohet me ndëshkim të ashpër, pastaj bën përjashtim me fjalët: "...Përpos atij që është i detyruar me forcë (që të mohojë), por që zemra e tij është plot besim *(për të nuk ka mëkat)*." (En-Nahël: 106).

Që do të thotë se kush e mohon besimin nën presion e me zemër mbetet edhe më tutje besimtar për të nuk ka mëkat. Ajo çka mbetet në zemër në radhë të parë është lëndë (çështje) për t'u përgjegjur, e jo çka ndodh në skenë.

"Atë ditë kur do të vëhen në pyetje ndërgjegjet." (Et-Tarik: 9).

Ndërgjegjja është fshehtësi e cila i tejkalon gjasat, shoqërinë, rrethin dhe edukimin, siç thamë edhe më parë.

Ajo është iniciatore absolute.

Është fillim absolut, të cilën All-llahu e ka liruar nga të gjitha prangat.

Ajo është identike me shpirtin tënd.

Ajo e zbulon realitetin tënd, sikur që gjurmët e gishtit zbulojnë identitetin tënd.

Shpirti i yt në ndërgjegjen tënde i takon lirisë së Zotit sepse ai është fryma e Tij: "E kur t'ia jap formën dhe i jap shpirtin (e bëhet i gjallë), ju bëni sexhde atij." (Hixhër: 29).

Duke qenë se në ty gjendet ky plan i Zotit Dhe duke qenë se Ai ty të ka favorizuar me vullnetin e lirë, ti do të japish llogari për këtë liri të dhuruar. Ky është kulminacioni i dhuntisë së Zotit. Kulminacioni i drejtësisë së Tij.

Prej këtu arrihet gjer tek përzierja ndërmjet shpirtit dhe All-llahut në ajetet të cilat kanë domethënie të thellë:

"...Dhe kur gjuajshe nuk gjuajshe ti, por gjuante All-llahu..." (El-Enfal: 17).

Fitorja të vjen njëkohësisht me dorën tënde dhe me dorën e Zotit.

Dora jote në çastin e fitores është dora e Zotit.

Vullneti yt është vullneti i Zotit.

Këtu është e mundur që dikush të kundërshton e të thotë: "Përse edhe qëllimi, gjithashtu mos të jetë i paradestinuar?"

Përgjigjen në këtë pyetje e jep vet Kur'ani: "Zemrat e tyre janë të sëmura, e All-llahu sëmundjen e tyre e rritë edhe më tepër." (El-Bekare: 10)

"...Ja, kështu All-llahu e lë në lajthitje, çdokend që e tepron në vepra të këqija dhe dyshon." (Gafir: 34).

"E ata që janë në rrugë të drejtë Ai edhe më tej do t'i udhëzojë...". (Muhammed: 17).

"...E, pasi ata u shmangën, - All-llahu u shmangu zemrat e tyre..." (Es-Saff: 5).

"Dhe do T'i shmangi prej argumenteve të Mia, ata që madhështohen në Tokë..." (El-A'raf: 146).

Nga kjo shihet qartë se All-llahu xhel-le shanuhu gjithnjë ia lë iniciativën robit të Vet. Pas kësaj vie urdhëri i Tij i cili ta shtonë sëmundjen nëse ke zemër të sëmurë, kurse të udhëzon nëse sinqerisht anon kah rruga e drejtë, respektivisht, të dëbon nga ajo nëse e ke nga kryelartësia.

Fushëveprimi i vetëdijes gjithnjë të është lënë ty, që të veprosh si të duash vetë. Pastaj vie urdhëri i Zotit dhe ndëshkimi. Është e pamundur që Zoti të urdhërojë dhunën apo diç të ligë.

"...Thuaj: "All-llahu nuk urdhëron të punohen vepra të shëmtuara! Përse flisni për All-llahun atë që nuk e dini?" (El-A'raf: 28).

Kjo tregon se ligji i parë i krijimtarisë e konsideron shpirtin si mihrab ku nuk ka vend për detyrime me dhunë. All-llahu nuk e shtrëngon (zoritë) shpirtin. As Ai, as ushtria e Tij, as Pejgamberët e Tij, e as njerëzit e zgjedhur të Tij.

Shpirti është "misterie më e madhe", të cilën e di vetëm All-llahu atë ditë kur ndërgjegjet do të thirren në përgjegjësi. Përkitazi me këtë tregon edhe hadithi që e transmeton Ebu Bekri: *Ebu Bekri nuk ua kalon me namaz e as me agjërim, por me vetëdije të lartë e cila në shpirt lë gjurmë të përhershme."*

All-llahu në Kur'an thotë: "Shumica e ithtarëve të Librit, prej zilisë që kanë në vetë, dëshirojnë t'ju kthejnë nga besimi në mohim, pasi e vërteta u është treguar atyre haptazi..." (El-Bekare: 109).

All-llahu nuk e ka krijuar smirën në zemrat e tyre, e as që i ka dhënë hapësirë asaj në vetëdijen e tyre, prandaj ata ua kanë zilinë me përcaktimin e vet. Këtu shprehja është tërësisht e qartë (nga vetvetiu). Kjo mohon intervencën e Zotit dhe tregon qartas se këtë fushëveprim të brendshëm All-llahu e ka lënë të lirë.

Duke iu drejtuar djallit, All-llahu thotë: "Ti nuk do të kesh kurrfarë pushteti mbi robërit e Mi, përveç mbi ata të cilët do të pasojnë ty, prej atyre të humburve." (El-Hixhër: 42).

Djalli do të hyjë në zemrën tënde vetëm nëse vet ia hapë derën, sipas zgjedhjes tënde dhe nëse je njëri prej atyre që e kanë humbur rrugën. Ai nuk mund të depërtojë me dhunë në zemrën tënde. Zoti i ka garantuar zemrës mbrojtje dhe askujt nuk i ka dhënë pushtet mbi të, qoftë ai i mirë apo i keq, përveç nëse pronari i saj sipas zgjedhjes së vetë e fton, e gostitë dhe e përqafon të mirën apo të ligën. Në këtë mënyrë do të jetë ashtu siç ka dëshiruar vetë.

Me të vërtetë, gjendemi para mihrabit dhe ndalesës më të madhe, të rrethuar me gërmadha ku nuk mund të hyjë as determinizmi as fatalizmi.

Atë që e bëjmë nën presion gjatë jetës sonë të përditshme nuk mund të ndërlidhet me vetëdijen tonë.

Mund të më detyrosh me dhunë që t'i ngris duart apo të gjunjëzohem në emër tënd por kurrë nuk mund të më detyrosh të të dua.

Për këtë shkak religjioni nuk lejon që gjatë dhënies së llogarisë të themi se filan filani më ka detyruar e më ka shtrënguar të bëj diç, duke dëshiruar të arsyetojmë mëkatin tonë dhe atë t'ia m'veshim dikujt tjetër. All-llahu e ka bërë të ndaluar fushëveprimin e vetëdijes dhe ndërgjegjes. Aty nuk mund të hyjë kurrfarë dhunuesi.

Mund ta detyrosh shërbëtorin për ndonjë punë, por nuk mund ta detyrosh që të ketë përgjegjësi për punën e kryer.

Kur'ani të konsideron si njeri të lirë dhe përgjegjës pa marrë parasysh rrethanat në të cilat gjendesh: "...A thua Toka e All-llahut nuk qe e gjerë dhe a thua se nuk keni mundur të shpërnguleni në ndonjë vend tjetër?" (En-Nisa: 97).

Nuk ka arsyetim.

Kur vie momenti i zgjedhjes, ti zgjedh vet për vetën tënde.

"Ne ia tregojmë rrugën e drejtë, kurse e atij është që të jetë mirënjohës ose mosmirënjohës." (El-Insan: 3). Në fjalën "Imma" (ose) është shprehur qartë faktori i indeterminizmit.

"...Pasha shpirtin dhe atë që Ai e krijoi, e ua bëri të kuptueshme rrugën e së mirës dhe së keqes." (Esh-Shems: 7-8).

Domethënë e ka hapur para tij rrugën e së mirës dhe rrugën e së keqes, e pastaj e ka lënë të zgjedh vetë cilën të dojë. Prandaj ka thënë rrugën e së mirës dhe së keqës, e jo "ose rrugën e të

keqes". Që të dy rrugët i ka lënë të hapura ashtu që shpirti të mund të zgjedh njërën prej këtyre pa detyrim. Prandaj në fund ka shtuar edhe këtë: "Dhe do të ketë sukses vetëm ai i cili e pastron shpirtin, e do të jetë i humbur ai i cili e shpien atë në rrugën e tërthortë." (Esh-Shems: 9-10).

Suksesi apo mossuksesi i janë kthyer rrugës së lirë. Në tjetrin ajet çështja është edhe më e qartë: "Edhe të mirën e të keqen ia kemi shpjeguar." (El-Beled: 10), domethënë e kemi drejtuar në udhëkryqin e të dy rrugëve që të zgjedh cilën të dojë.

Qëllimi është i lirë.

Ndërgjegjja është e lirë të heshtë çka të dojë.

Vepra është e lirë dhe njëkohësisht e paracaktuar.

Çdonjëri prej nesh e ka pjesëmarrjen e vetë në veprimtarinë e lirë.

Ai i cili përfaqëson determinizmin do të gjendet në dilemë kur ta pyesin se si do ta dallojë dorën e vet, të cilën e lëviz lirisht dhe shkruan me të çka të dojë nga dora në pranga e cila dridhet nga ethet. Këtu para nesh gjenden dy situata të qarta. Indeterminizmi në situatën e shëndetit dhe determinizmi në situatën e sëmundjes. Sikur determinizmi në fjalë do të ishte i saktë, atëherë nuk do të mund të dalloheshin këto situata, dhe në esencë ato as që do të ekzistonin.

Veprimi i lirë, pra, është realitet. Paracaktimi gjithashtu është realitet. Tani problemi qëndron në kuptimin e kësaj dysie dhe ç'është kjo që njëra e përjashton tjetrën. Ç'është kjo që determinizmi nuk e përjashton indeterminizmin, apo anasjelltas.

Do të përpiqemi që ta shohim këtë përmes ajeteve Kur'anore. Këto tregojnë sheshit, ekspozojnë haptas dhe qartë, që njerëzit mos të jenë në mëdyshje.

All-llahu xhel-le shanuhu thotë në Kur'an: "Sikur të donim Ne, do të zbritnim në ta - nga qielli - një mrekulli, para së cilës, ata do t'i kërrusnin qafat e tyre." (Esh-Shu'ara: 4). Sikur All-llahu xhel-le shanuhu të donte kjo edhe do të ndodhte, por këtë nuk e ka bërë, sepse nuk ka dëshiruar që të na detyrojë në besim, me çka do ta mohonte indeterminizmin, që paraqet esencën e të ekzistuarit tonë, por ka dashur që të jemi të lirë të besojmë apo të mos besojmë.

All-llahu xhel-le shanuhu nuk e ka bërë Iblisin Iblis.

Iblisi e ka zgjedhur vet mendjemadhësinë dhe kryelartësinë kur ka refuzuar t'i përulet Ademit alejhis-selam sikur engjëjt e tjerë, duke thënë: "Unë jam më i mirë se ai. Mua më ke krijuar prej zjarrit, kurse atë prej baltës." (Sad: 76).

Iblisi nga mosdija dhe në mënyrë të padrejtë e ka zgjedhur të mashtruarit. All-llahu e ka zgjedhur që t'i mashtrojë njerëzit dhe i ka dhënë rolin në pajtim me zgjedhjen e tij.

Ngjashëm ka ndodh edhe me Muhammedin alejhis-selam All-llahu e ka ditur pastërtinë e zemrës së tij, andaj e ka zgjedhur për të Dërguar të Udhëzimit të Zotit: "Ata, të cilët bëjnë luftë (përpiqen) për Ne, Ne, me siguri, do t'i drejtojmë rrugëve të cilat shpiejnë tek Ne." (El-Ankebut: 69).

Për shkak mosekzistimit të determinizmit dhe detyrimit, Zoti nuk është treguar në Inxhil dhe në Kur'an, sepse nuk ka dashur të na detyrojë në besim. E ka krijuar Teuratin, Inxhilin dhe Kur'anin, në të cilët mund të besojmë, por edhe mund të dyshojmë.

Për Kur'anin ka thënë: "Me këtë Ai shumëkend i lë në lajthitje, e shumëkujt ia tregon rrugën e drejtë." (El-Bekare: 26).

Ajetet e tij përmbajnë argumente, por kurrë nuk i ka bërë argumente detyruese, të cilat kapin për fyti dhe të cilat e detyrojnë mendjen. Ai, për shkak të respektit të lirisë së njeriut, gjithnjë e lë atë të përcaktohet vet për një gjë, të thotë çka të dojë pa ngurrim, të sqarohet për atë që gjendet në vet brendinë e tij, në vetëdijen e tij, në mënyrë që ta fitojë shpërblimin apo ndëshkimin e merituar.

Ka dashur që njeriu, në një mënyrë, të bëhët mëkëmbës i Tij i vogël në Tokë, i cili do t'i gjykojë vetvetes dhe të tjerëve, në mënyrë që ta soditë, ta provojë dhe ta verifikojë.

Në një ajet Kur'ani shpjegon takimin mes të përcaktimit të Zotit dhe lirisë së njeriut dhe eliminon kontradiktën e hipokritëve, të cilët pandehin se dëshirojnë t'i ndihmojnë Pejgamberit të Zotit, e së këndejmi nuk pranojnë të shkojnë në fushata ushtarake me ta.

"E, sikur ata të donin të shkonin (në luftë), do të përgatisnin pajisjen për të; por All-llahu nuk pëlqeu shkuarjen e tyre në luftë, andaj i pengoi ata me dembeli. Dhe u është thënë: "Rrini me ata që janë ulur (si pleqtë e të sëmurët)!" Sikur t'ishin nisur me ju, do të ishin vetëm në pengesë e sipër dhe së shpejti mes jush do të shtinin ngatërresa, duke ju dëshiruar të keqen. E në mesin tuaj ka të tillë që i dëgjojnë ata me andje. Mirëpo All-llahu i di zullumqarët." (Et-Teube: 46-47).

Këtu flitet për hipokritët, të cilët sipas bindjes së tyre nuk dëshirojnë ta ndihmojnë Pejgamberin alejhis-selam, andaj përcaktimi i Zotit ka qenë në ujdi me bindjen e tyre. Ai ka dëshiruar ashtu siç

kanë dëshiruar edhe ata vetë, andaj i ka penguar dhe e ka përbuzur daljen e tyre, ashtu siç e kanë përbuzur edhe ata vetë.

Kjo ngjashmëri reciproke mes përcaktimit të Zotit dhe ndërgjegjes së njeriut është shprehur në ajetin e sures El-Enfal ku All-llahu i drejtohet Pejgamberit alejhis-selam, e i thotë:

"O Pejgamber! Thuaju robërve që gjenden në duart tuaja: "Nëse All-llahu di se në zemrat tuaja ka çfarëdo të mire, do t'ju japë më të mirë nga ajo që u është marrë juve dhe do t'ju falë..." (El-Enfal: 70).

Kështu shihet se përcaktimi i Zotit është gjithnjë i llojit të njëjtë sikurse edhe vet zgjedhja e njeriut.

Shihet se si vie gjer tek puthitja mes vendimit të Zotit dhe zgjedhjes së njeriut, dhe se si eliminohet kontradikta e cila është rezultat i kuptimit tonë të gabuar.

Tani e kemi lehtë t'i kuptojmë dy ajete me domethënie sipërfaqësore të kundërta:

"Dhe thuaj: "E vërteta është nga Zoti yt, andaj kush të dojë - le të besojë, e kush të dojë - le të mos besojë." (El-Kehf: 29).

"E ju do të dëshironi vetëm atë që dëshiron All-llahu." (El-Insan: 30).

Në ajetin e parë All-llahu e përshkruan vullnetin e lirë të njeriut, ndërsa në të dytin flet për vullnetin e All-llahut, për kaderin.

Kontradiktat në këto dy ajete reduktohen vetëm në domethënien e jashtme. Gjer më tani kuptuam se All-llahu i dëshiron njeriut atë që ai i dëshiron vetës së vet:

"Atë që kundërshton Pejgamberin, ndonëse e ka të njohur rrugën e drejtë, dhe që i drejtohet rrugës që nuk është rrugë e drejtë e besimtarëve, do ta lëmë të bëjë çka të dojë, dhe do ta hedhim në Xhehennem! O, sa vendbanim i tmerrshëm është ai!" (En-Nisa: 115)

Kush zgjedh rrugën e ligështirave, kurse All-llahu në vendimin e tij sheh vendosmëri, Ai nuk e detyron të veprojë mirë, por i ndihmon ta zbatojë atë që e ka zgjedhur vet. Ia përgatitë shkaqet e së keqës që ajo ç'është e fshehur në brendinë e tij të dalë sheshit e atëherë i aplikon sanksionet: "Do ta lëmë të bëjë çka të dojë,dhe do ta hedhim në Xhehennem - o sa vendbanim i tmerrshëm është ai!" Ky është determinizëm dhe ky këtu është njësoj sikurse indeterminizmi. Këtu nuk ka kontradiktë, sepse vullneti i Zotit është vullneti i robit të vet.

Është eliminuar dysia: "Zoti nuk e ndryshon gjendjen e një populli, përderisa ai nuk e ndryshon vetveten" (Er-Ra'd: 11). Zoti nuk dëshiron ta ndryshojë njeriun, përderisa njeriu nuk e ndryshon vetveten. Përputhja reciproke këtu është e qartë.

Edhe njëri edhe tjetri, determinizmi dhe indeterminizmi janë reflektime të vullnetit të Zotit, e njëkohësisht janë pa kontradikta, sepse janë reflektime të zgjedhjes së vetë njeriut: "Thuaj: "Çdo gjë është nga All-llahu."

Njeriu dëshiron por aftësia e tij e kërkesave dhe e zgjedhjeve janë dhunti dhe vullneti më i lartë i Zotit xhel-le shanuhu Liria e njeriut është dhunti e vullnetit të Zotit. Nga këtu ajeti: "E ju do të dëshironi vetëm atë që dëshiron All-llahu" (El-Insan: 30), është konstatim i realitetit e assesi thënie kontradiktore. Ai konstaton lirinë tënde, por liria jote është dhunti , dhuratë dhe vullnet i Atij që jep.

"...All-llahu ka dhënë që të dal sheshit ajo që patët fshehur ju". (El-Bekare: 72).

All-llahu xhel-le shanuhu ka mundësuar të zbulohet qëllimi i juaj, të del sheshit ndërgjegjja e juaj, që gjithsecilit t'ia regjistrojë pretendimin e tij pa kurrfarë shtrëngimi. Ai këtë vetëm e zbulon dhe lejon që pretendimi të dalë sheshit i tillë çfarë është vet, në mënyrë që çdonjëri ta ketë të varur veprën e vet për qafën e tij.

Pastaj pason ajeti Kur'anor me të cilin edhe përfundon kjo temë: "...dhe ta dini se All-llahu ndërhyn mes njeriut dhe zemrës së tij, dhe se të gjithë do të tuboheni para Tij." (El-Enfal: 24).

Kjo do të thotë se All-llahu e lë të lirë zemrën.

Çdonjëri posedon ndërgjegjen e vetë në të cilën është i lirë. Zoti vendos ndikimin e Vet mes njeriut dhe zemrës së tij.

Ai ndërhyn mes njeriut dhe zemrës së tij. Nga mëshira dhe mirësia e Vet, Ai mundëson dhe pengon ashtu që t'i mbrojë të dashurit e Vet nga e keqja, dhe që çdonjërit t'ia lehtësojë në pajtim me vetëdijen, vendimin dhe iniciativën e tij, - t'ia lehtësojë apo t'ia vështirësojë.

"(Kujtoje) kur All-llahu në ëndërr të tregoi se ata (armiqtë) janë pak; e sikur të tregonte që ata janë shumë, ju do të frikësoheshi dhe do të grindeshit rreth kësaj çështjeje, por All-llahu ju shpëtoi - Ai e di mirë se çka keni në zemrat tuaja. (Kujtoje) - kur u ndeshët, e Ai ua dëftoj ata në sytë e juaj pak, - e ju pakësoi juve në sytë e tyre, për ta zbatuar All-llahu atë që kishte caktuar - e te All-llahut kthehet çdo gjë." (El-Enfal: 43-44).

Këtu kemi shembull edhe më të mirë të ndërhyrjes së fshehtë e të pandieshme mes njeriut dhe zemrës së tij. All-llahu dëshiron që t'i inkurajojë myslimanët për luftë në betejën e Bedrit, edhe pse këta ishin numerikisht më pak (treqind myslimanë të armatosur dobët kundër një mijë idhujtarësh të armatosur mirë). Ai dëshiron pa shtrëngim t'i drejtojë në luftë ashtu që zgjedhja të jetë zgjedhje e tyre. Për këtë arsye Pejgamberit alejhis-selam i ka treguar në ëndërr se armiku numerikisht është i vogël, e gjatë luftës armiku shumënumërt në sytë e myslimanëve ka qenë i vogël dhe i parëndësishëm, sikur që e ka bërë të parëndësishme gjendjen e myslimanëve në sytë e idhujtarëve, ashtu që të gjithë ata t'i shpie në luftë, e atëherë ka gjykuar sipas vendimit që më parë të ditur.

Ky është ai lehtësim me të cilin Ai i drejton shkaqet pa shkeljen e ligjit mbi lirinë, të cilin ja ka caktuar çdo njeriu në vetëdijen e tij. All-llahu çdonjërin prej nesh e ka krijuar të lirë në zemër dhe në ndërgjegje dhe ne jemi përgjegjës për këtë liri.

Me këtë Kur'ani e ka dhënë çelësin për zgjedhjen e problemit më të madh në filozofi, problemin e determinizmit dhe indeterminizmit.

HISTORIA E KRIJIMIT

Kur dhe si ka filluar krijimi? Si janë krijuar Toka, HëNe, Dielli dhe yjet...? Çfarë kanë qenë hapat e njeriut të parë në Tokë dhe prej nga ka ardhur ai...?

Mbi të gjitha këto shkenca e ka thënë fjalën e vet. Ajo ka qëndrimin e vet, aspektet dhe argumentet e veta... Biologjia, antropologjia, astronomia, kimia organike, gjeologjia, evolucioni i cili sot është bërë disiplinë e veçantë shkencore, embriologjia dha anatomia. Sa vëllime e vëllime janë shkruar rreth këtyre çështjeve...

Shumëçka është thënë. Ne nuk mund të jemi të izoluar nga kjo kur lexojmë atë se çka thotë Kur'ani mbi historinë e krijimit... Feja kurrë nuk ka qenë e izoluar nga jeta, dhe as që i është kundërvër shkencës ndonjë herë. Ajo gjithnjë i ka ofruar dhe i ka dhënë arritjet skajore mendimit shkencor dhe gjithnjë ka shpie tek faktet pakontestuese. Feja islame ka ardhur të thotë fjalën e fundit. Është e pamundur që përkitazi me këtë të diskutohet nga aspekti religjioz para se të shqyrtohet nga aspekti shkencor. Çështjen e krijimit, pra, duhet ta shqyrtojmë nga aspekti shkencor, religjioz dhe filozofiko-politik.

Rreth kësaj çështjeje kam shkruar që më parë në veprat: "Misteri i vdekjes" dhe "Misteri i jetës". Këtu nuk e kam ndërmend të përsëris atë se çka kam thënë atje, por diç nga ajo është e domosdoshme të thuhet për shkak të kyçjes së lexuesit në këtë çështje.

T'i kthehemi jetës, fillimit dhe vetë babait të evolucionit, Darvinit, që të na shpjegojë vërejtjet e veta mbi rrugën e jetës, mbi teorinë e vet e cila e ka ndërruar tërë mendimin njerëzor.

Gjatë udhëtimit të tij rreth botës në anijen ushtarake "Bigi", Darvini ka filluar të mbledh ekzemplarë nga toka dhe deti, t'i studiojë, të mendojë dhe t'i shënojë të dhënat mbi qeniet e gjalla në rruzullin e Tokës.

Si rezultat i këtij hulumtimi janë këto vërejtje të tija:

- Qeniet e gjalla ndërrohen dhe i adaptohen rrethit ku jetojnë.

- Njeriu i cili jeton në polin e veriut është i trashë dhe me shumë dhjamë sikurse balena në mënyrë që të mbrohet nga ftohtësia e madhe. Ariu polar është i mbuluar me gëzof të trashë.

Në rajonet ekvatoriale, tropike, njeriu është thatanik dhe i zi. Lëkura e tij e zezë paraqet ombrellë dielli e cila e mbronë atë nga rrezet vdekjeprurëse të diellit.

- Hardhucat që jetojnë në shpella janë të verbëta dhe nuk kanë gjymtyrë, gjersa ato që jetojnë në tokë kanë ngjyrë dhe shikim të mprehtë.

- Gojët e disa shtazëve dallojnë përshtatshmërisht me rolin e tyre. Disa janë të furnizuar me dhëmbë, me të cilët rrjepin dhe shqyejnë, sikurse tek tigrat, disa janë me sqep sikurse tek shpesët, kurse disa janë të siguruar me gremç me ndihmën e të cilit kapen sikurse që është rasti me ankilostomën e cila me ndihmën e këtij gremçi mbahet fuqishëm nëpër muret e stomakut. Disa gojë janë të furnizuara me feçkë (turi) me ndihmën e së cilës bëhet thumbimi sikurse tek mushkonjat, disa me aparat për thithje siç është rasti me mizat, e disa me sharrëza për prerje sikurse tek brejtësit.

A thua është e saktë se të gjitha qeniet e gjalla janë krijuar nga një lloj, prej të cilit pastaj ka evoluar në llojet e ngjashme të shumënumërta për shkak të kushteve dhe mjediseve. Tek shtazët që jetojnë në tokë janë zhvilluar këmbët, e tek ato që jetojnë në ujë, në vend të këmbëve janë zhvilluar pendët notuese, gjersa tek ato që fluturojnë, në vend të këmbëve të para janë zhvilluar krahët.

Në qoftë se ky konkludim është i saktë, atëherë ai duhet të na zbulojë ngjashmëritë e konstruksionit të trupit të të gjithëve. Kjo është ajo që me të vërtetë na tregon skalpeli:

- Te gjarpri, i cili nuk ka këmbë, anatomia na zbulon këmbët e fshehura në skelet. Sa shihet me sy na duket se shpesët posedojnë vetëm një palë këmbë, anatomia na zbulon se krahët paraqesin palën tjetër të këmbëve të cilat janë zhvilluar në ujdi me funksionin e ri që iu është dedikuar. Katër pendët notuese tek peshqit nuk janë asgjë tjetër vetëm se dy palë këmbë të shndërruara në rrema.

- Njeriu i ka nga pesë gishtërinj në çdo dorë dhe në çdo këmbë, e gjithashtu edhe majmuni, miu dhe hardhuca. Madje edhe lakuriqi posedon po aq gishtërinj të fshehur.

- Zemra dhe qarkullimi i gjakut funksionojnë në princip të njëjtë sikurse tek baleNe, miu, majmuni, njeriu dhe lakuriqi. Të gjitha këto lloje posedojnë veNe, kurse zemra tek të gjithë është me katër barkushe (ventricoli cardis).

- Sistemi nervor që përbëhet nga truri, palca e kurrizit dhe nervat tek të gjithë është i njëjtë.

- Sistemi muskulor me muskujt, skeletin dhe takëmi skeletor... të gjitha eshtrat, me dallime të vogla dhe të parëndësishme, janë të ngjashme me njëra tjetrën tek të gjitha shtazët.

- Sistemi gjenital, gjithashtu, është i njëjtë tek të gjitha shtazët.

- Shtatzënësia tek gratë zgjatë nëntë muaj, tek balenat dhe tek shumë lloj majmunësh, po ashtu nëntë muaj... Madje edhe periudha e moshës së gjirit tek të gjithë është dy vjet.

Pastaj goditja e dytë... Anatomia zbulon në skeletin e njeriut vertebrat (unazat) e bishtit, që gjenden edhe tek majmuni, janë atrofizuar (rrëgjuar), sepse e kanë humbur funksionin e vet.

Vertebrat e qafës tek njeriu janë shtatë, tek iriqi dhe tek gjirafa gjithashtu shtatë, pa marrë parasysh gjatësinë e qafës së saj.

Goditja e tretë: foshnja në mitrën e nënës zhvillohet sipas etapave... Në etapën e parë foshnja i gjason peshkut - posedon verzat. Në etapën vijuese tek ajo zhvillohet bishti i cili më vonë kalon në gjendje atrofike. Në etapën e tretë foshnja tërësisht është e mbuluar me qime, sikurse majmuni, e pastaj shprehet rënia e qimeve nga trupi, përveç nga sipërfaqja e kokës.

Foshnja e ka zbuluar tërë rrëfimin. Fillin e zhvillimit dhe etapat e zhvillimit.

Skalpeli, i cili luan pas veshit të njeriut, zbulon gjëra të reja. Muskujt që e lëvizin veshin e gomarit, tek njeriu janë atrofizuar, sepse e kanë humbur funksionin origjinar pasi që veshi i njeriut ka fituar formë tjetër të pavarur nga lëvizjet.

Gërmimet në Javë në Transval dhe Pekin kanë zbuluar kafkën e njeriut e cila e ka formën e kafkës së majmunit. Disa nga këto kafka janë zbuluar në shpella ku janë gjetur mbeturinat e drurit të karbonizuar në vatra, që tregon se pronarët e tyre qysh para aq shekujsh kanë zbuluar dhe kanë përdor zjarrin.

Dhe nuk ka mbetur kurrgjë tjetër përveçse Darvini ta shkruan teorinë e vet mbi zanafillën e llojit (sojit), teorinë e cila thotë se të gjitha llojet e kanë gjenezën prej një rrënje, zhvillimi i mëtejshëm i së cilës ka pasur karakter të një druri të degëzuar i cili është ndërruar dhe në mënyrë divergjente është zhvilluar në përshtatje me ndërrimet e rrethanave dhe kushteve.

Darvini nuk ka thënë se njeriu e ka origjinën nga majmuni, e as që origjina e njeriut rrjedh prej shimpanzës dhe orangutanit.

Teoria në esencë nuk thotë se cilido lloj ekzistues rrjedh nga lloji tjetër. Çdo lloj për vete është degë e fundit, e pavarur prej një druri të vetëm. Dega nuk ka rezultuar nga dega tjetër (dega e njeriut nuk ka rezultuar nga dega e majmunit). Edhe njëra edhe tjetra paraqesin bilashnjokë (biskë) të veçantë të trungut dhe, në esencë ata i kthehen të njëjtit burim, qelizës së parë, trungu i së cilës është degëzuar në lloje të cilat i shohim rreth veti. Çdo lloj paraqet kulminacionin e kategorisë së vet. Ai është i pavarur sipas strukturës dhe formës së zhvillimit të vet. Lind vetëm të ngjashëm me të.

Darvini është ndalur tek evolucioni i botës organike duke menduar dhe vëzhguar.

Botëkuptimi i tij mbi përshtatshmërinë e qenieve të gjalla dhe rrethit shpjegon vetëm ndërrimin e konstituimit dhe funksionit ndërmjet qenieve të gjalla, e kurrsesi evoluimin e tyre nga shkalla më e ulët kah shkalla ma e lartë, kah forma më e përsosur.

Ai edhe për këtë ka gjetur zgjidhje kur e ka vërtetuar se evolucioni ka rezultuar nga stimulimi i brendshëm material pa dirigjim nga jashtë.

Lufta për ekzistencë ka qenë filtër.

Ato shtazë të ujit, të cilat kanë mundur t'u adaptohen kushteve jetësore në ujë, e kanë siguruar ekzistencën e tyre, kurse të tjerat, që nuk kanë mund ta bëjnë këtë janë shfarosur.

Në këtë mënyrë kanë vazhduar së jetuari ato të cilat kanë mund të përshtaten, ndërsa të tjerat, që kanë pasur më pak mundësi për përshtatje janë zhdukur. Kështu ka ardhur gjer tek evolucioni në mënyrë spontane, me kushte materiale jetësore.

Furtuna është ngritur kundër Darvinit.

Kanë kaluar shumë vite në hulumtime dhe rishqyrtime... Një pjesë e teorisë së Darvinit jeton edhe më, kurse pjesa tjetër ka vdekur që moti.

Pohimi se të gjitha llojet e kanë gjenezën nga një rrënjë dhe se kanë divergjuar në trungun e familjeve dhe llojeve në pajtim me kushtet e mjedisit dhe rrethanave është supozim më afër të vërtetës dhe është i bazuar në fakte. Rrënja familjare me të vërtetë i lidh të gjitha qeniet e gjalla. Anatomia konfirmon se ato janë të lidhura njëra me tjetrën me lidhje gjaku dhe me farefisni.

Ndërkaq, pohimi se seleksionimi është bërë vetëm me stimulimin jetësor pa drejtim nga jashtë, më nuk është aq bindës. Kjo rrëzohet përmes filtrit të mendimit të sigurtë dhe të saktë.

Përse nga trungu familjar i gomarëve rezulton diçka si kali, kur dihet se gomari është më i qëndrueshëm dhe më i fuqishëm... me çfarë stimulimi nga familja e dhive të egra zhvillohet diç si antilopa e cila është më e dobët, më pak e qëndrueshme dhe më e butë se dhia e egër. E njëjta gjë ndodh edhe me fluturën laroshe e cila është më e dobët se grerëza e vrazhdë dhe zhurmëmadhe... Pëllumbat, pallonjët dhe shumë zogj të tjerë të larmë janë më të dobët se shqiponja, gjeraqiNedhe skifteri.

Krijimi këtyre llojeve nuk është i mundur të shpjegohet me ligjin e ekzistencës të më të fortëve, por me një ligj tjetër, e ky është ligji i ekzistencës të më të bukurve. Më të bukurit në sytë e kujt? Këtë do ta thotë komentuesi.

Më të bukurit në sytë e njëri-tjetrit. Mashkulli zgjedh femrën më të bukur nga mesi i tyre. Kjo është zgjedhje seksuale. Edhe më tutje gjendemi para stimulimeve jetësore dhe materiale.

Përse mashkulli zgjedh femrën më të bukur? Pyetja ende është e hapur. Flatrat laramane nuk janë më të afta për të fluturuar nga flatrat e thjeshta. Këtu s'është në pyetje interesi jetësor, por është në pyetje vlera e lartë estetike e cila vetveten e imponon mbi të gjitha stimulimet e tjera. Këtu ka ardhur në shprehje arsyeja e Artistit - Krijuesit i cili i zbukuron krijesat e Veta. Gjurmët e Tij i hasim në fletën e lisit, në ngjyrën e luleve, në flatrat e fluturës dhe në puplat e pallonjve.

Para kësaj mbetemi të habitur sikurse edhe para drunjve të shkretëtirave, të cilët natyra i ka prirur me farëra fluturuese, të cilat fluturojnë kilometra e kilometra shkretëtirës jopjellore që të bien aty ku ka ujë... apo nëse i soditim vezët e mushkonjave do të zbulojmë se ato posedojnë qesëza ajrore me ndihmën e të cilave notojnë në sipërfaqen e ujit e nuk fundosen. Vetëm kjo mund të shpjegojë arsyen Universale e cila mendon dhe planifikon për krijesat e veta, sepse drunjt e shkretëtirës nuk kanë mendje që farërat e veta t'i furnizojnë me flatra e as që mushkonja din diç për ligjin e Arhimedit mbi fundosjen në mënyrë që vezëzave të veta t'u sigurojë ndonjë mjet për të notuar.

Këto janë gjëra para të cilave teoria e Darvinit është plotësisht e pafuqishme dhe i vetmi që i shpjegon këto është arsyeja Universale, i Gjithmbarshmi, i Cili planifikon, projekton dhe e krijon ekzistencën.

Për të shpjeguar këtë më hollësisht do të marrim një supozim të imagjinuar... Të supozojmë se vuajmë nga një e metë e veçantë të shqisës së të pamurit... Kjo e metë manifestohet në atë që mund të shohim lloj-lloj veglash dhe makinash, por nuk mund ta shohim konstruktorin e tyre...Kështu shohim biçikletën, kaloshinin, karrocën, automobilin, trenin etj. por nuk mund t'i shohim njerëzit që i kanë prodhuar këto. Do të themi se këto mjete kanë evoluar njëra nga tjetra nëpër një seri etapash. Për këtë si argument do ta marrim konstruksionin e tyre. Të gjitha i ngjajnë njëra-tjetrës, sepse janë nga hekuri, druri, dhe lëkura. E kanë trupin dhe rrotat... Do të vërejmë se automobili dhe treni posedojnë motorët, të cilët përbëhen nga cilindrat dhe pistonët, dhe funksionojnë me benzinë, me naftë apo me avull.

Meqenëse nuk e shohim konstruktorin e tyre, do të themi se ato janë zhvilluar nën ndikimin e faktorëve të brendshëm si rezultat i luftës së tyre me rrethin dhe ekzistencën të ma të fortit pas luftës maratonike për ekzistencë.

Nuk do ta përfillim faktorin e jashtëm sepse nuk e shohim atë. Ndërkaq shohim se ato lëvizin me ndihmën e motorit të brendshëm.

Mu ky është gabimi që e ka bërë Darvini në teorinë e vetë mbi evolucionin kur ka thënë se faktorët e zhvillimit janë - faktorët e brendshëm dhe se jeta zhvillohet me stimulimet e brendshme pa dirigjim nga jashtë... Zhvillohet me ndikimin e faktorëve të brendshëm material vetëm për shkak se nuk e sheh Konstruktorin, Krijuesin, i Cili shpik dhe krijon.

Gjendemi, pra, kundruall teorisë e cila ka zbuluar rrënjët familjare të botës organike, por e cila nuk ka mundur të na shpjegojë se si ka ardhur deri te evolucioni ndërmjet tyre.

Nëse tani kalojmë në disiplinat tjera shkencore, që flasin për historinë e krijimit do të ballafaqohemi me mendimin se jeta ka filluar nga uji ku ka ardhur gjer tek krijimi i materies me fuqi të panjohur në formën e parë të jetës... protoplazma... për të cilën askush nuk e din se si ka lindur nga uji e dheu.

Nëse edhe këtë e braktisim e nisemi nga kozmosi... yjet dhe planetët do të gjendemi përsëri para mendimit të astronomit se çdo gjë ka rezultuar nga një re prej pluhuri dhe gazrave.

Kaq në pika më të shkurtëra përkitazi me këtë çështje nga ana shkencore.

Tani të shohim se çka ka thënë Kur'ani në lidhje me këtë qysh para katërmbëdhjetë shekujve.Për çka ka folur Pejgamberi analfabet, i cili nuk ka ditur, sikurse edhe populli dhe koha e tij, se çka do të thotë fjala biologji, kimi organike, embriologji, anatomi dha antropologji.

Kur'ani e ka metodën e vet të ligjërimit, e cila dallon nga të gjitha metodat e tjera. Kur ai shpjegon ndonjë çështje shkencore nuk e parashtron atë sikur që do ta parashtronte Ajnshtajni, e as në atë mënyrë siç do ta bënte ndonjë biolog duke prezentuar çdo gjë, madje edhe detajet më të hollësishme. Kur'ani tregon për çështjen shkencore me isharete (sinjalizime), simbole, metafora, me shkëlqim të rrufeshëm, me shprehje e cila depërton në mendje si reflektim i vetëtimës. Kur'ani ngandonjëherë përdorë ndonjë fjalë të cilën bashkëkohësit e tij nuk janë në gjendje ta kuptojnë, e as ta komentojnë, por Ai e di se historia dhe ardhmëria atë hollësisht do ta shkoqisin dhe shpjegojnë.

"Ne do t'iu ofrojmë argumentet Tona në hapësirat e Gjithësisë, por edhe në veten e tyre, përderisa nuk iu bëhet tërësisht e qartë se Kur'ani është i vërtetë." (Fussilet: 53).

Për të folurit e vet All-llahu thotë: "Vetëm All-llahu e din shpjegimin e tij." (Ali Imran: 7). Kurse për Kur'anin thotë: "E pastaj Ne jemi të obliguar ta shpjegojmë atë." (El-Kijameh: 19). Që do të thotë se All-llahu me të vërtetë do ta shpjegojë Kur'anin në të ardhmen, në kohët dhe epokat të cilat pasojnë.

Çka thotë Kur'ani për historinë e krijimit?

Kur'ani që në fillim të krijimit thotë për Zotin: "Pastaj vendosi (ta bënë) qiellin, përderisa ende ka qenë mjegullinë." (Fussilet: 11).

Në fillim gjithëçka ka qenë në gjendje të gazët nga e cila është krijuar kozmosi me gjithë yjet dhe planetët.

"...Ai e mbështjellë natën në ditë dhe ditën në natë..." (Ez-Zumer: 5).

Ky ajet mund të kuptohet vetëm nëse Toka është në formë sferike, ndërsa nata dhe dita dy gjysmërrethe, të cilat e mbështjellin njëra-tjetrën duke i falënderuar rrotullimit të pandërprerë të Tokës. Edhe vet fjala "tekvir" që është përdorur këtu, është jo e rëndomtë, fjalë e rrallë e cila na imponon këtë komentim: “Edhe Hënës ia kemi caktuar pozitat; ajo gjithnjë kthehet *(duke qenë e plotë)* e bëhet si vishkulli i lakuar i hurmës së vjetër." (Ja Sin: 39).

"Urxhun" në gjuhën arabe do të thotë thupër e lakuar e palmës së vjetër, në të cilën nuk ka gjelbërim, ujë e as jetë. Ky është krahasim i përpikt me Hënën, në të cilin po ashtu nuk ka gjelbërim, ujë e as jetë.

"As Dielli nuk mund ta arrijë Hënën, e as që nata mund ta kalojë ditën. Çdonjëri noton në orbitën e vet me lëvizjen e vet." (Ja Sin: 40).

Duke përshkruar kozmosin Kur'ani konstaton se në të gjenden, udhë, kalime dhe shtigje:

"Pasha qiellin me udhë yjesh." (Edh-Dharijat: 7).

Duke përshkruar Tokën konstaton se ajo ka formën vezake: "E pastaj i dha Tokës formën e vesë." (En-Naziat: 30).

Pastaj paraqet idenë e lëvizjes së imagjinuar pas moslëvizjes së dukshme: "Ti i shikon malet e mendon se janë të palëvizshme, por ato lëvizin si retë." (En-Nemlë: 88).

Krahasimi i maleve me retë i sugjeron mendjes se diç është e formuar nga grimcat e shkapërderdhura, e malet me të vërtetë janë të formuara nga grimcat. Retë e palëvizshme janë vetëm fanitje. Çdo gjë përbëhet nga grimcat, dhe çdo gjë është në lëvizje të pandërprerë. Toka me gjithë malet është në lëvizje të pandërprerë.

Komentuesit e mëhershëm të Kur'anit kanë menduar se ky ajet përshkruan atë që do të ndodhë Ditën e gjykimit, e ky është mendim i gabuar. Dita e gjykimit është fakt pakontestues. Ajo me siguri do të vijë. Nuk ka arsye të dyshohet në këtë, por, për këtë ditë nuk thuhet: "Ti i shikon malet e mendon..."

"Dhe, të pyesin ty (o Muhammed) për malet (çka do të bëhet me to në ditën e gjykimit). Thuaj: "Zoti im ata do t'i bëj në pluhur dhe do t'i shkapërderdh!" (Ta Ha: 105).

Këtu pra flitet për Ditën e gjykimit, ndërsa ajeti i mëparshëm përshkruan gjendjen në këtë botë dhe asgjë tjetër.

Pastaj Kur'ani na flet për qarkullimin e ujit në natyrë: "A nuk po sheh se All-llahu lëshon shiun nga qielli dhe e shpërndanë atë nëpër burime në tokë..." (Ez-Zumer: 21). Kështu e shpjegon Kur,ani këtë qarkullim. Shiu që bie në tokë mblidhet në rezervuarët nëntokësor, pastaj përmes burimeve përsëri del në sipërfaqe të Tokës, avullon dhe kështu qarkullon në natyrë.

Pastaj Kur'ani përmend jetën: "...E nga uji Ne kemi krijuar çdo gjë *(të gjitha gjallesat)..."* (El-Enbija: 30). "All-llahu ka krijuar çdo lloj shtaze prej ujit... (En-Nur: 45). "...A mohon ti Atë, i Cili të ka krijuar prej dheu... (El-Kehf: 37). "Dhe kur Zoti yt u tha engjëjve: : "Unë do ta krijojë njeriun nga deltiNe, nga balta e ndenjur." (El-Hixhër: 28). Kur'ani në një vend përmend se jeta është krijuar nga uji, në tjetrin, nga dheu, pastaj nga deltiNe, nga balta e ndenjur, ose më saktësisht nga uji i fermentuar i përzier me dhe, e kjo përputhet me atë se çka thotë shkenca në kohën më të re.

Në suren *El-A'rafë* Kur'ani flet më gjerësisht rreth kësaj çështjeje: "Ne ju krijuam e pastaj ua dhamë formën; e ju thamë engjëjve: "Përuljuni Ademit!" e të gjithë iu përulën, përveç Iblisit..." (El-A'raf: 11). Në këtë ajet është saktësuar se njeriu është krijuar në etapa kohore. "Ne ju krijuam e pastaj ua dhamë formën; e ju thamë engjëjve: "Përuljuni Ademit!" Koha sipas kuptimit hyjnor është shumë e gjatë. "Vetëm një ditë e Zotit tënd zgjatë sa një mijë vjet, sipas llogaritjes suaj."

Në një vend tjetër thotë": "Tek Ai ngriten engjëjt dhe Xhibrili për një ditë e cila zgjatë pesëdhjetë mijë vjet."

Këto janë, pra, ditët e Zotit... Ato në raport me ne janë diç si periudha shumë të gjata, diçka si pafundësi. Dhe kur All-llahu xhel-le shanuhu thotë Ne ju kemi krijuar dhe ju kemi dhënë formën, dhe këtë proces e kemi plotësuar me krijimin e Ademit, pastaj u kemi thënë engjëjve që t'i përulen Ademit - kjo do të thotë se Ademi është formësuar gjatë etapave të krijimit dhe trajtimit, për çka ka pasur nevojë me miliona vitesh sipas llogaritjes sonë, e vetëm disa ditë sipas kohës hyjnore. "Ai ju ka krijuar suksesivisht dhe në faza", do të thotë se edhe para Ademit kanë ekzistuar krijesa dhe se Ademi ka ardhur si kulminacion i të gjithë atyre.

"A mos i ka kaluar njeriut një pjesë e kohës gjatë së cilës nuk ka pasur rëndësi të përmendet. (El-Insan: 1).

Këtu, pra, tregohet në etapa kohore, gjatë të cilave njeriu nuk ka pasur vlerë të përmendet.

Kur'ani thotë se All-llahu xhel-le shanuhu "Ai i Cili të gjithë atyre që i ka krijuar u ka dhënë atë që u duhet, pastaj e ka frymëzuar se si të shërbehet me to", domethënë Ai e ka frymëzuar këtë zhvillim evolues e që tek Ademi ka arritur kulminacionin e vet:

"Të gjitha kafshët që ecin nëpër tokë dhe të gjitha shpesët që fluturojnë me krahë të vet, janë popuj (bashkësi) sikurse ju..." (El-En'am: 38).

"All-llahu ju krijon juve nga toka (dheu) ashtu si bimët." (Nuh: 17).

Kjo do të thotë lidhshmëri të ngushtë ndërmjet gjinisë njerëzore dhe botës shtazore e shpesore, pastaj lidhje ndërmjet njeriut, shtazëve dhe bimëve.

"Ne e krijojmë njeriun nga substanca e dheut." Qartë tregon se njeriu nuk është krijuar nga dheu, por nga një substancë e veçantë e cila ka rezultuar nga dheu, e kjo është substancë që i ka paraprirë njeriut si lloj të veçant. Kur'ani gjithashtu fletë për etapat e zhvillimit të embrionit dhe thekson se formimi i eshtrave i paraprinë formimit të muskujve:

"Nga mishi (si të përtypur) i formuam eshtrat, e atëherë eshtrave ua veshim mishin (të freskët)." (El-Mu'min: 14).

Nga embriologjia është e njohur se skeleti formohet para muskujve. Për këtë formim Kur'ani thotë:

"Ai ju krijon në barqet e nënave tuaja, krijim pas krijimi, në tri errësira." (Ez-Zumer: 6).

Këtu na zbulon krijimin brenda mitrës së nënës dhe përshkruan se ai kalon nga etapa në etapë, krijim pas krijimi që zhvillohet në tri errësira, e këto janë: peritoneja (cipa e barkut), uterusi (mitra) dhe mbështjellësat e fetusit (shtrraku i pjellës, membraNedhe lëngu amnionik). Këto janë fakte pakontestuese anatomike.

"Dhe se Ai është që krijoi qiftin - mashkullin dhe femrën, nga pika e farës që hidhet." (En-Nexhm: 45-46). Sot e dimë se spermatozoidi e cakton gjininë e foshnjës, a do të jetë foshnja mashkull apo femër, e kurrsesi vezët. Spermatozoidi është i vetmi që përfshin "sex determination factor".

Si ka mundur të vijë Kur'ani me këto fakte, të cilat janë në pajtim me hulumtimet më të reja shkencore! Rastësisht ?!

Nëse e pranojmë një rastësi a do të themi se të gjitha të tjerat janë rastësira.

A thua si i kanë ra ndërmend Pejgamberit analfabet këto çështje dhe këto fakte të cilat nuk kanë qenë të njohura në kohën e tij, e të cilat janë bërë të njohura një mijë e ca vjet pas vdekjes së tij.

Sipas shpjegimeve të disa komentuesve perëndimor në fjalët të cilat i kanë ardhur në gojë Muhammedit alejhis-selam, shohim një trajtë të aktivitetit të brendshëm intelektual e cila tërësisht është hapur ndaj të vërtetës absolute. Nëse e themi këtë atëherë shkencërisht dhe në mënyrë tejet të qytetëruar e pranojmë Shpalljen, sepse e vërteta absolute nuk është asgjë tjetër përveçse All-llahut, kurse të çelurit kah All-llahu dhe kontakti me Të nuk është asgjë tjetër përveçse Shpallja. Por, rrëfimi ende nuk ka mbaruar.

Kur'ani na ofron shumë gjëra, madje edhe më tepër se sa na ofron dhe konfirmon shkenca. na informon edhe për disa fshehtësi që kanë ndodhur në mbretëri në praninë e engjëjve me rastin e krijimit të Ademit, se si All-llahu e ka vendosur atë në Xhennet ku ka mundur të hajë çka të dojë, pos frytit të një peme të caktuar.

Kur'ani na rrëfen se si engjëjt i kanë bërë sexhde Ademit:

"Përpos Iblisit, ai ka qenë njëri nga xhinnët, prandaj nuk respektoi urdhërin e Zotit të vet." (El-Kehf: 50).

Këtë mendjemadhësi dhe refuzimin e zbatimit të urdhërit të Zotit, Iblisi e shpjegon me këto fjalë:

"Unë jam më i mirë se ai, mua më ke krijuar nga zjarri, kurse atë nga deltiNe." (Sad 76).

Ai nuk e ka kuptuar urtësinë e Zotit dhe respektin e Tij që ia ka shprehur Ademit. Vetëm All-llahu e ka ditur se Ademi do të përjetojë mundime të mëdha, sepse është krijuar me trup dhe me shpirt të cilët ndërmjet veti janë në luftë të përhershme. Do të jetë i preokupuar me shumë vështirësi dhe i tendosur mes dëshirave të trupit dhe nevojave të shpirtit.

"Ne njeriun e kemi krijuar (të jetojë) në luftë." (El-Beled: 4). Në luftë të pandërprerë dhe në vështirësi të parreshtura. Ai me këto vështirësi dhe me luftë do te arrijë shkallën më të lartë se xhinnët dhe engjëjt, meritën dhe mëshirën më të madhe se këta. Për këtë arsye Zoti u ka urdhëruar engjëjve që t'i përulen dhe t'i janë në shërbim dhe ndihmë. Mirëpo, Iblisit i ka shpëtuar ky fakt për shkak të madhështisë dhe kryelartësisë së vet. Ai thekson se është i krijuar para Ademit, dhe atë nga zjarri, gjersa Ademi është krijuar nga dheu:

"Kurse xhinnët i kemi krijuar qysh më parë nga zjarri i skuqur." (El-Hixhër: 27).

Iblisi, pra ka refuzuar t'i përkulet Ademit, për çka është i mallkuar dhe i përndjekur nga afërsia e Zotit. Në vend që t'i kthehet Zotit, të pendohet dhe të kërkojë falje, ai ka humbur çdo shpresë në mëshirën e Zotit, e ky është gabimi i dytë që e ka bërë. Pas kësaj është bërë ziliqar, hakmarrës dhe armik ndaj Ademit duke e konsideruar atë si shkaktar kryesor për përzënien e tij. Ky është gabimi i tretë. Ai është shejtan i cili orvatet të shpëtojë nga gabimi me gabim tjetër dhe i cili bie nga humnera në humnerë edhe më të madhe.

Ademit ia ka mbushur mendjen që të hajë frytin e pemës të cilin e ka prezentuar si fryt të përjetësisë, edhe pse e ka ditur se ajo është pemë vdekjeprurëse.

" Dhe kështu Ademi nuk e dëgjoi Zotin e vet dhe devijoi nga rruga." (Ta Ha: 121.)

Zoti e ka bërë Ademin të lirë (i ka dhënë jetë) dhe ia ka mundësuar të zgjedh: Të jetë i dëgjueshëm ndaj Tij sikurse yjet që lëvizin në kozmos në ujdi me ligjin e caktuar të lëvizjes ose të jetë i lirë dhe përgjegjës për amanetin të cilin duhet ta bartë.

"Ne u ofruam amanetin qiejve, Tokës dhe maleve, e ata ngurruan dhe u frikësuan ta bartin atë, por njeriu e mori mbi vete këtë - e ai. me të vërtetë, është i padrejtë dhe mendjelehtë ndaj vetes." (El-Ahzab: 72).

Njeriu për shkak të mosdijes së vet nuk i ka kuptuar rreziqet që do t'i kanosen për shkak të këtij amaneti. Ai këtë e ka pranuar dhe vetes i ka bërë zullum. All-llahu e ka ditur se njeriu e ka rrezikuar veten me pranimin e këtij amaneti, andaj nga mëshira e Vet i ka urdhëruar të bëhet i dëgjueshëm dhe t'i dorëzohej fjalës së Tij. I ka urdhëruar që të mos hajë frute nga pema në mënyrë që sa më gjatë të mbetet në Xhennet (Xhenneti i bindshmërisë dhe dorëzimit ndaj ligjit të Zotit). Mirëpo njeriu e ka zgjedhur lirinë dhe përgjegjësinë. Nuk e ka respektuar urdhërin e Zotit (me mashtrimin e Iblisit) dhe ka ngrënë frytet e pemës së ndaluar. Që nga ky çast njeriu është bërë përgjegjës për veprat e veta në bazë të cilave meriton shpërblim apo ndëshkim. Ndëshkimi ka qenë përzënia nga Xhenneti në botën e mundimeve dhe djersës.

Dallimi ndërmjet Ademit dhe shejtanit qëndron në faktin se Ademi iu ka kthyer Zotit duke u penduar dhe duke kërkuar mëshirën e Tij, ndërsa shejtani ka mbetur i padëgjueshëm, duke humbur çdo shpresë në mëshirën e Zotit.

"Ademi i pranoi disa fjalë nga Zoti i vet, prandaj Ai ia fali (gabimet)." (El-Bekare: 37).

Zoti e ka stërmbushur me mëshirën e Vet, i ka premtuar se pasardhësit e tij do t'i udhëzojë në rrugën e drejtë dhe e ka bërë përfaqësues të Vet në Tokë ku do të mbretërojë sipas dëshirës dhe arsyes së vet.

"Kur Zoti yt u tha engjëjve: "Unë do të caktoj përfaqësuesin në Tokë!" - ata thanë: "A do të jetë përfaqësuesi i Yt ai i cili në te do të bëjë turbullira e gjakderdhje? Kurse ne Ty të madhërojmë dhe të lartësojmë ashtu siç e meriton Ti,." (El-Bekare: 30).

Engjëjt rezonojnë në këtë mënyrë, sepse e kanë parë se Ademi, me zanafillën dhe etapat e krijimit të tij, do të jetë nga ata të cilët do të luftojnë dhe do të derdhin gjak, andaj Zoti edhe u thotë: "Unë di atë që ju nuk e dini." (El-Bekare: 30).

Ai e di se njeriu meriton, me këtë krijim dhe me këtë luftë të natyrshme të trupit dhe shpirtit, pozitë më të lartë nga pozita e engjëjve dhe se ka merita të bëhet përfaqësues i Tij në Tokë. Ai këtë fakt ua zbulon engjëjve me këto fjalë: "All-llahu ia mësoi Ademit emrat e të gjitha sendeve, e pastaj ua paraqiti engjëjve e u tha: "Mi thuani emrat e tyre, nëse flisni të vërtetën!" "Qofsh i lartësuar!" - thanë ata "ne e dimë vetëm atë që na ke mësuar Ti, Ti je i Gjithdijshëm dhe i Urtë." "O Adem!" - tha Ai - "ua trego ti emrat e tyre!" dhe kur ua tregoj emrat e tyre All-llahu tha: "A nuk ju ka thënë se vetëm Unë i di fshehtësitë e qiejve e të Tokës." (El-Bekare: 31-33).

Ky është ai Ademi tokësor. Ai posedon dinjitetin e engjëjve. Nga kjo kuptojmë se All-llahu e ka zgjedhur Ademin Pejgamber të parë në Tokë. Fjalët: "All-llahu ia mësoi Ademit emrat e të gjitha sendeve" shënojnë fillimin e Shpalljes dhe të dhënët mësim nga All-llahu. Nga ky mësim Hyjnor i Ademit alejhis-selam i të gjitha sendeve kuptojmë edhe vetinë tjetër të mendjes së njeriut. Njeriu është i gatshëm t'i mësoj të gjitha emrat e sendeve por jo edhe esencën e tyre. Dituria e njeriut

qarkullon vetëm brenda kufijve, proporcioneve dhe raporteve të jashtme të caktuara. Ai nuk mund të kuptojë esencën e sendeve. Këtë e vërteton edhe filozofia.

All-llahu sipas Kur'anit është "Rabb" me domethënie Edukator, Mbrojtës, Mësues, Udhërrëfyes,i Butë, i Mëshirshëm, i Dashur, i Cili kujdeset për krijesat e Veta dhe i Cili u krijon mundësi të ndryshme dhe u siguron furnizim.

All-llahu i ka premtuar Ademit se pasardhësve të tij do t'u dërgojë Pejgamberë, të cilët do t'i udhëzojnë në rrugë të drejtë.

"Nga Unë do t'u vijë udhëzimi, dhe ata të cilët e pasojnë udhëzimin Tim - nuk do të frikësohen për kurrgjë dhe as që do të pikëllohen." (El-Bekare: 38).

Kur'ani shpjegon se çka do të thotë të pasuarit e udhëzimit të Zotit. Njeriu duhet të kuptojë mëkatin e vet dhe të kthehet në Xhennet të cilin e ka humbur babai i tij, Xhennetin e bindshmërisë dhe devotshmërisë ndaj ligjeve të Zotit. Ky është ai transformim dhe kthim që përsëritet në çdo faqe të Kur'anit. Njeriu duhet të kuptojë se nuk posedon asgjë tjetër, pos vetëdijes së vet (ku është plotësisht i lirë). Duhet t'i dorëzohet Zotit dhe vullnetarisht t'i përulet Atij. Vetëm në këtë mënyrë do të bëhet më i mirë se materia e vdekur dhe nga yjet të cilët lëvizin shtigjeve të tyre dhe të cilët me dhunë i janë dorëzuar ligjeve të Zotit, e jo me dëshirën e vet, përkundër njeriut i cili i dorëzohet Zotit të vet vullnetarisht nga dashuria dhe devotshmëria.

Njeriu e bënë këtë pasi e di se vullneti i Zotit dhe përcaktimi i Tij realizohet me hir e pahir. All-llahu është Krijues dhe Sundues i të gjitha shkaqeve dhe Ai i vetmi posedon udhëzimin, diturinë dhe fuqinë.

Nga ajetet tjera më pak të qarta kuptojmë se ne, pasardhësit e Ademit, kemi jetuar një jetë e cila i ka paraprirë kësaj jete tokësore: "Dhe kur Zoti yt nga kurrizet e bijve të Ademit nxori pasardhësit e tyre dhe kërkoi prej tyre të dëshmojnë kundër vetes: "A nuk jam Unë Zoti juaj?" - ata thanë: "Po, si jo, ne dëshmojmë" - e që të mos thoni në Ditën e gjykimit: "Ne për këtë nuk kemi ditur kurrgjë", ose që të mos thoni: "Të parët tanë përpara nesh All-llahut i kanë bërë shok, kurse ne jemi brezi pas tyre. A do të na dënosh për atë që kanë bërë rrenacakët? Dhe, ja, kështu Ne gjerësisht i shpjegojmë argumentet, ndoshta vijnë në vete." (El-A'raf: 172-174).

All-llahu në këto ajete hollësisht na prezenton ndodhinë interesante nga e cila kuptojmë se kemi qenë në mbretërinë e Zotit para se të gjendemi në mitër. Ndoshta si krijesa të padukshme shpirtërore? Këtë nuk e di askush.Zoti ka kërkuar prej nesh që ta dëshmojmë pushtetin e Tij dhe ka marrë prej nesh kontratën për këtë dëshmim ashtu që të mos i kthehemi mosbesimit e këtë ta arsyetojmë me faktin se kemi qenë therorë të të parëve tanë.

T'i kthehemi kësaj kontrate në ajetet e kaptinës Ali Imran të cilat janë edhe më të paqarta - "Kujtoje (o Muhammed) atë kohë kur All-llahu mori obligimin nga pejgamberët (e ju tha): "Unë ua solla Librin dhe dijeninë e kur t'ju vijë juve Pejgamberi, vërtetues i asaj që e keni ju, padyshim do t'i besoni dhe do ta ndihmoni atë" (All-llahu) u tha atyre: "A e pranuat këtë dhe a morët oblogimin Tim?" Ata u përgjigjën: "E pranuam." - "Atëherë bëhuni dëshmitarë (i njëri-tjetrit)", - tha Ai - "se edhe Unë bashkë me ju jam dëshmitar." (Ali Imran: 81).

Kështu All-llahu i ka tubuar Pejgamberët e Vet dhe prej tyre ka marrë kontratën ,sipas së cilës do ta vërtetojnë njëri-tjetrin. Si është bërë kjo, ku dhe kur?

Këto ajete theksojnë jetën shpirtërore në mbretërinë e Zotit para jetës në mitrat e nënave, që do të thotë se kemi ekzistuar para se të lindemi ashtu siç do të ekzistojmë edhe pas vdekjes.

Në emrat e Zotit qëndron se Ai është "Krijues, Realizator, Shpikës." Krijuesi na ka krijuar në pikëpamje të shpirtit. Realizatori na ka dhënë të drejtën e të ekzistuarit, ngjashëm me mbretin i cili shpërndanë dekorata, e ai që fiton këtë dekoratë fiton të drejtën që ta bartë atë. Shpikës sepse e ka modeluar formën materiale të vendbanimit tonë në barqet e nënave.

Në një hadith Muhammedi alejhis-selam na tregon se ekzistenca shpirtërore i ka parapri lindjes sonë. Ai thotë: *Kam qenë pejgamber gjersa Ademi ende nuk ka qenë krijuar."*

All-llahu në Kur'an i thotë Muhammedit: "Thuaj: "Me të vërtetë, namazi im, edhe adhurimi im, jeta ime, dhe vdekja ime, i përkasin vetëm All-llahut, Zotit të Gjithësisë, i Cili nuk ka bashkërendës; kështu më është urdhëruar dhe unë jam i pari mysliman." (El-En'am: 162, 163).

Me këto fjalë nënkuptohet se Muhammedi alejhis-selam ka ekzistuar para të gjithë pejgamberëve të Zotit. Kur'ani të gjithë pejgamberët i konsideron myslimanë, e Muhammedin mysliman të parë.

Edhe kjo vërteton se të ekzistuarit shpirtëror i ka parapri lindjes dhe se ne kemi qenë në perandorinë e Zotit para se të jemi formuar në barqet e nënave.

Nëse i kthehemi pemës dhe pyetemi se çfarë është kjo pemë... A është kjo simbol apo realitet?

Disa komentues të Kur'anit thonë se ajo është simbol i njohurisë. Ky mendim nuk është i pranueshëm thjesht nga shkaku se All-llahu nuk ia ka ndaluar njeriut të kërkojë njohuri, përkundrazi Ai e ka nxitë njeriun në kërkimin e njohurisë:

"Thuaj: "O Zoti im më shto dituri!" (Ta Ha: 114). "Thuaj: "Udhëtoni nëpër botë dhe shikoni se si ka filluar krijimi." (Ankebut: 20).

Disa komentues këtë fjalë e kanë marrë në kuptimin e saj të vërtetë dhe kanë thënë se ka të bëjë me pemët e ngjashme çfarë i shohim rreth veti. Disa thonë se fjala është për kërcellin e grurit frutin e të cilit Ademi e ka ngrënë andaj e ka ndie nevojën "të del jashtë" për t'i mënjanuar mbeturinat. Në këtë mënyrë e ka zbuluar organin seksual dha ka filluar ta mbulojë me gjethet e Xhennetit, siç shihet edhe nga kuptimi i jashtëm i vet ajetit.

Unë konsideroj se ky është simbol i seksit dhe i vdekjes, që janë të pandashëm në biologji. Kur kanë filluar qeniet e gjalla të shtohen me anë të mbarsjes (fekondimit) seksuale, ata papritmas i kanë caktuar vetes edhe vdekjen. Para kësaj ata nuk kanë vdekur, por janë përtërirë me shartimin personal.

Mbarsja seksuale, në realitet ka qenë pema e ndaluar, burimi i jetës, e cila nga përjetësia është rrokullisur në pavlerësi. E ngjashme ka qenë edhe me martesën e Ademit dhe Havës - dy të përjetshmit në Xhennet. Në martesën çfarë ka qenë kjo nuk ka ekzistuar funksioni bashkëshortor e as mbarsimi seksual. Përjetësia ka qenë fakt ekzistues dhe nuk ka qenë nevoja për pasardhës për tu vazhduar jeta.

Shejtani e ka ditur se pema e pasardhësve është leje për fillimin e vdekjes dhe përzëries nga Xhenneti i amshueshëm. E ka gënjyer Ademin dhe ia ka prezentuar atë si pemë të përjetësisë dhe e ka shpërkëndyer në marrëdhënie seksuale me gruan.

Një argument që flet se kjo pemë është simbol i seksit është edhe rrëfimi i Kur'ani për Ademin dhe Havën i cili na tregon se, pasi e kanë shijuar frutin e pemës, iu është paraqitur lakuriqësia të cilën janë munduar ta mbulojnë me gjethe ngase janë turpëruar. Turpi i cili shfaqet nga organet seksuale arrinë vetëm pasi që shijohet ëmbëlsia me anë të këtyre organeve. Për këtë arsye fëmija nuk turpërohet nga organet e veta seksuale e as që i mbulon ato, kurse i rrituri dhe ai i moshës madhore turpërohen madje edhe kur përmenden emrat e atyre organeve. Kur'ani u drejtohet Ademit dhe Havës, pas shijimit të frytit, me këto fjalë:

"Dilni! Ju jeni armik i njëri-tjetrit." (El-A'raf: 24).

Ndërsa fjalët në ajetet para mëkatit kanë qenë dysorë:

"Kurse ti, o Adem, dhe gruaja jote banoni në Xhennet dhe hani ku të doni, por mos iu afroni kësaj peme." (El-A'raf: 19).

Që do të thotë se përdorimi i frutit të pemës së ndaluar për ngrënie ka sjellur gjer tek shumëzimi.

Edhe më tej trashëgimi seksual është simbol i shkatërrimit shtazarak të dunjallëkut... edhe më tej është objekt i shpërkëndimit (mashtrimit), e jo i ushqimit.

Flitet se shkadhitja (syneti) paraqet shërbimin (kefaretin) e Ademit për mëkatin të cilin e ka bërë, e qysh nga ajo kohë ky synet është akt fetar.

Po ashtu është e mundur se këtu ka të bëjë me pemën, frytet e të cilës pasi hahen, ndikojnë në hormone e këto intensifikojnë dëshirën seksuale e që e ka sjellur Ademin deri te marrëdhënia seksuale me Havën. Në këtë mënyrë ajeti do të ishte komentuar tekstualisht dhe në kuptimin

figurativ. Nuk është e mundur që diç më bindëse të konfirmohet në lidhje me këto çështje, sepse këtë vetëm All-llahu e di. Historia e krijimit edhe më tej është një nga fshehtësitë e Zotit. Kjo është vetëm lëndë e ixhtihadit (logjikim i lirë) dhe kurrgjë tjetër. Ne na është urdhëruar imperativisht që të merremi me ixhtihad.

"Thuaj: "Udhëtoni nëpër botë dhe shikoni se si ka filluar krijimi." (Ankebut: 20). "E përse ata nuk mendojnë devet si janë krijuar." (El-Gashije: 17). "Përse ata nuk mendojnë për Kur'anin, apo në zemra kanë druna." (Muhammed: 24).

Kjo është detyrë dhe obligim... Të shikojmë Kur'anin dhe t'i përdorim të gjitha dituritë e kohës që të kuptojmë fillin e krijimit.

Ata të cilët nuk pajtohen me këtë që thash përkitazi me evolucionin, pyesin: Çka do të thotë dalja nga parajsa sipas këtij mendimi të ri egzegjet dhe çka do të thotë ngjarja kur engjëjt i kanë bërë sexhde Ademit?

Përgjigjemi se dalja (ihbat) është theksuar në Kur'an me domethënie të shpërnguljes prej një vendi në vend tjetër, duke mos e braktisur Tokën. Në Fjalën e Zotit të drejtuar izraelitëve në mënyrë të prerë qëndron: "Shkoni në qytet e do të keni atë që kërkoni".

Po ashtu edhe Xhenneti në Kur'an është përmendur me domethënie bahçe, kopsht në Tokë.

"Me të vërtetë, banorët e Sebes kanë pasur argument të madh në vendbanimin e tyre: dy kopshte (xhenete), në të djathtë dhe në të majtë." (Seb'e': 15).

"Në Tokë ekzistojnë vise të cilat kufizohen njëra me tjetrën dhe ekzistojnë kopshte të mbjellura me hardhia."

Fjala "ihbat" këtu, pra, ka domethënie abstrakte. Zbritja nga vendi i rehatisë në vendin ku nuk ekziston kjo rehati. Kështu është realizuar kalimi i Ademit nga jeta e lehtë dhe e rehatshme, nga kopshtet plotë me furnizim në vendin jopjellor në Tokë. Nuk është fjala, pra, për ndonjë zbritje nga qielli.

Përsa i përket sexhdes të cilën e kanë bërë engjëjt, edhe kjo është bërë në tokë me qëllim nënshtrimi, sikur që All-llahu në Tokë ia ka nënshtruar xhinnët Sulejmanit alejhis-selam, ose me qëllim zbulimi dhe njoftimi me perandorinë, siç e ka njoftuar Muhammedin alejhis-selam dhe ia ka zbuluar perandorinë gjatë kohës së mi'raxhit, e këto janë muxhize me të cilat Zoti i ka nderuar pejgamberët e Vet. E tërë kjo tregon sheshit pozitën e lartë që e ka pasur Ademi alejhis-selam tek All-llahu xhel-le shanuhu. Tërë këto gjëra i janë zbuluar Ademit në Tokë, të cilën ai nuk e ka braktisur.

Kjo është ajo Tokë të cilën Ademi nuk e ka braktisur qysh nga koha kur Zoti e ka dalluar si degë më të zgjedhur në drurin e jetës dhe i cili ka evoluar përderisa nuk e ka arritur kulminacionin si njeri.

Këtë mendim tanë e vërtetojnë shumë ajete Kur'anore:

:Në të do të jetoni, në të do të vdisni dhe prej saj do të ringjalleni." (El-A'raf: 25).

"All-llahu ju krijon nga dheu sikurse edhe bimët, pastaj në të ju kthen dhe nga ajo sigurisht do t'ju nxjerrë"

"Nga ajo (toka) ju kemi krijuar dhe në të do t'ju kthejmë, dhe prapë nga ajo do t'ju nxjerrim edhe një herë." (Ta Ha: 55).

Kjo është Toka të cilën nuk e braktisim kurrë. Dalja është dalje nga Toka në Tokë.

Në kaptinën Es-Sexhde përmes ajeteve 7, 8 dhe 9 parandihet rrëfimi për evolucionin. Në këto ajete lexojmë se All-llahu është Ai "i Cili krijon çdo gjë në mënyrë të përkryer, i Cili njeriun e parë e ka krijuar nga deltine (balta), kurse pasardhësit e tij i krijon nga një pikë lëngu të dobët, pastaj në mënyrë të përkryer ia formëson gjymtyrët dhe ia frymëzon jetën - dhe Ai ju pajis me të dëgjuarit, me të pamurit dhe ju jep mendjen - porse ju fare pak jeni mirënjohës."

Në fillim ka qenë deltinë e mandej si lëng i dobët "spermatozoid" i cili kalon nëpër faza të caktuara, pastaj faza e formësimit të gjymtyrëve dhe në fund frymëzim i jetës. Zoti ia ka frymëzuar njeriut arsyen, respektivisht vetëdijen, gjegjësisht lirinë dhe ai gradualisht është zhvilluar derisa nuk është bërë kështu çfarë e njohim ne, me shqisat e të dëgjuarit, të pamurit dhe me mendje.

Të shpjeguarit në këtë mënyrë dhe në këtë rrjedhë mohon se Ademi është formësuar nga dheu përnjëherit. Kjo kërkon një proces të evolucionit të krijimit. Gjithashtu edhe idenë e zbritjes së Ademit nga qielli e refuzon ky ajet kur'anor: "Ai ju krijon nga dheu dhe ju mundëson të jetoni në të." (Hud: 61).

Përemri "në të" ka të bëjë me Tokën nga e cila ka rezultuar jeta, që do të thotë "se Ademi rezulton nga Toka" dhe se Zoti e ka bërë përfaqësues në Tokë që të mund të jetojë në të. Krijimi nuk ka rezultuar jashtë kësaj Toke në të cilën jemi duke jetuar, e as që ka ndodhur kjo diku në

qiej. Prandaj këtu nuk ekziston kurrfarë zbritje. Nëse zbritja është përmendur në rrëfimin mbi Ademin, atëherë kjo është diç abstrakte.

Pas aventurave të fundit kozmike, flitet shumë për teori të reja mbi fillimin e jetës, sidomos pas zbritjes së njeriut në Hënë. Këto teori konfirmojnë se njeriu ka zbritur në Tokë me fluturake kozmike në kohët e lashta dhe se ai nuk ka kurrfarë lidhje me zhvillimin e botës organike në Tokë pa marrë parasysh se ndërmjet tyre ekzistojnë ngjashmëri të mëdha. Ai është njëri ndër banorët e ndonjë planete tjetër.

Megjithatë këto janë vetëm supozime të cilat janë afër romantizmit shkencor, e të cilat nuk kanë kurrfarë bazash reale.

Rrëfimi mbi historinë e krijimit nuk e ka fundin e vet e as që do ta ketë ndonjëherë.

Mendimi ,të cilit duhet dhënë përparësi, është që e kam ekspozuar në këtë përpjekje për kuptimin e Kur'anit. Dituria i takon vetëm Zotit. Rreth kësaj çështjeje është e pamundur diç të konkludohet. Fillimi i krijimit edhe më është fshehtësi, por megjithëkëtë ne jemi imperativisht të urdhëruar që të mendojmë përkitazi me këtë.

Kur'ani na flet edhe mbi historinë e krijimit të shtatë qiejve:

"All-llahu është Ai, i Cili ka krijuar shtatë qiej dhe po aq tokë." (Et-Talak: 12).

"Ai i Cili i ka krijuar shtatë qiej njërin mbi tjetrin." (El-Mulk: 3).

"Ne përmbi ju i kemi krijuar shtatë qiej." (El Mu'minun: 17).

"Përmbi ju kemi krijuar shtatëshe të fortë." (En-Nebe' 12).

Shtatë qiej është fshehtësi të cilën shkenca ende nuk e ka zbuluar, por në shkencë ekzistojnë gjëra interesante të cilat nxisin në përsiatje. Shkenca zbulon psh. se drita posedon shtatë ngjyra, ngjyrat e spektrit dhe shtatë shkallë të valëve të gjata prej të kuqes deri tek ngjyrë vjollce, pastaj shkalla përsëritet në shtatë nivele të tjera prej infrakuq deri tek ultravjollcë. E ngjashme është edhe me shkallën e muzikës e cila i ka shtatë ndarje, pastaj e teta i kthehet si përgjigje të parës. Në këtë mënyrë nuancat përsëriten shtatë nga shtatë sish.

Nga embriologjia, gjithashtu është e njohur se foshnja vetëm në muajin e shtatë e plotëson evolucionin e vet. Nëse lind para muajit të shtatë ajo do të vdes.

Që nga koha kur kemi mësuar për ditët ato i kemi ndarë shtatë nga shtatë. Kështu kemi fituar javën (shtatëshin) si njësi kohore gjatë llogaritjes. Qysh nga kohët e vjetra njerëzit e të gjitha përkatësive ideologjike dhe ngjyrash janë unanim në këtë. Përse dhe si? Kjo nuk na është e njohur.

Në fund kuptojmë se shkaku i spektrit të ngjyrave gjatë dritës së diellit janë shtatë transmetime të elektroneve, të cilat ngriten në shtatë sfera rreth nukleusit të hidrogjenit. Sa herë që elektroni kërcen (del) jashtë sferës së nukleusit, pason kërkimi i cili reflektohet në paraqitjen e spektrit të ngjyrave. Këto kërcime (dalje) ndodhin brenda Diellit (të cilat përbëhen nga hidrogjeni) për shkak të temperaturës së lartë që arrinë mbi një milion gradë. Elektronet shpërthejnë jashtë atomeve të veta dhe lirojnë rrezet e njohura të Diellit. Nga kjo kuptojmë se elektroni i cili ngritet në shtatë sfera aludon shtatë qiejt. Për të kaluar prej qiellit në qiell duhet të lirohet nga prangat e energjisë me të cilat është i mbërthyer në nukleus. Kjo energji lirohet nga spektri përkatës në trajtë të tufës

së rrezeve të dritës përderisa nuk plotësohen të gjitha të shtatat, e pastaj del i liruar nga atomi i vet. Andaj duket se atomi, i cili është kozmos në miniaturë, paraqet shtatë qiej.

A mos do të thotë kjo se dikur do ta zbulojmë se ekzistenca është e klasifikuar në shtatë shkallë të të gjitha situatave dhe se pandërprerë përsëritet nga shkalla më e ulët gjer tek ajo më e larta. Shtatë qiej dhe shtatë toka. Shtatë rreze të Diellit. Shtatë nota të tingullit. Pastaj numri shtatë që është përmendur në Kur'an (Xhehennemi dhe shtatë dyert e tij, shtatë qiej dhe shtatë toka, shtatë vite të pabereqetshme, shtatë lopë të majme dhe se Zoti ka përfunduar krijimin në ditën e shtatë)... E gjitha kjo aludon në këtë misteri si në një fshehtësi të kozmosit.

S'ka dyshim se këtu Kur'ani, me tërë përqendrimin e vet, tregon për ndonjë çështje shkencore tejet të rëndësishme.

Të marrim edhe një shembull nga Kur'ani:

"Ai, e nxjerr të gjallin prej të vdekurit dhe është nxjerrës i të vdekurit prej të gjallit." (El-En'am: 95).

Komentuesit e mëhershëm të Kur'anit këtë ajet e kanë shpjeguar me çarjen e thelbit të hurmave tek mugullimi i saj me çka palma e përtërinë jetën e vet dhe kështu nga bërthama jo e gjallë rezulton pema e gjallë. A nuk është rastësi ajo çka na zbulon anatomia se qeliza e përtëritë jetën e vet me qarjen e thelbit. Në këtë mënyrë ajo e lind një qelizë të re dhe bashkë me të përbënë dy qeliza. A është e rastësishme ajo që na zbulon shkenca se atomi nuk zbrazet derisa bërthama e tij nuk çahet dhe në këtë mënyrë nga pajetësia nxirret jetësia, (lindja e energjisë atomike nga materia e vdekur).

Këto janë vetëm përsiatje abstrakte...

I njëjti rast është edhe me ajetin nga kaptina Ja Sin: ku qëndron: "Qoftë i lartësuar Ai i Cili ka krijuar çifte nga e tërë që mbin prej toke, edhe nga vetë ata, edhe nga ajo që nuk e dinë!" (Ja Sin: 36).

E dimë se Zoti i ka krijuar bimët në çifte, mashkullore dhe femërore, se ne jemi të krijuar po ashtu në çifte, mashkull dhe femër, e gjithashtu edhe xhinnët.

Atë që nuk e kemi ditur, e që na ka zbuluar shkenca, është edhe kjo se edhe sendet janë krijuar në çifte.

"Dhe çdo gjë e krijojmë në çifte në mënyrë që ju të mendoni."

Elektriciteti posedon dy pole, pozitiv dhe negativ.

Magnetizmi është i polarizuar në dy pole.

Në atom ekziston elektroni dhe pozitroni.

Protoni dhe neutroni.

Në kiminë organike molekula e majtë dhe e djathtë.

Sot dimë për materien dhe antimaterien.

Çdo ditë shkenca na zbulon fshehtësitë e binarizmit në strukturën e materies së gjallë dhe jo të gjallë.

E këto janë pika në detin kur'anor me plotë thesarë dhe fshehtësi të strehuara.

Ndoshta njëra prej fshehtësirave më të mëdha që përmbanë Kur'ani është ajo që ka të bëjë me përshkrimin e Ditës së Kiametit ku qëndron se nga deti do të shpërthejë zjarri i fuqishëm dhe i rrëmbyeshëm.

"Dhe kur detet mbushen me zjarr." (Et-Tekuir: 6).

Në suren El-Infitar, Kur'ani sërish kthehet dhe sinjalizon në këtë:

"Dhe kur detet derdhen në njëri tjetrin, dhe kur varret përmbysen." (El-Infitar: 3-4).

Në suren Et-Tur: Zoti betohet me këtë ndodhi dhe thotë: "Pasha detin e mbushur *(detin e ndezur flakë)*, - ndëshkimi i Zotit tënd patjetër do të ndodhë." (Et-Tur: 6-7).

Ai betohet në det kur në Ditën e Kiametit do të mbushet me zjarr se ndëshkimi me të vërtetë do të plotësohet dhe se kjo është e vërteta.

Kështu me betim tërhiqet vërejtja në rëndësinë dhe madhështinë e ndodhisë. "Detet e mbushura me zjarr".

Kjo për mua ka qenë misteri derisa nuk u furnizova me një hartë ku ishin të shënuara zonat vullkanike dhe tërmetet në Tokë, dhe kur lexova për aktivitetet e vullkaneve dhe fshehtësitë e tyre. Harta ishte fillim i përsiatjes sime të përhershme mbi këto dukuri.

Autori i hartës, gjeologu dr. Po, me skica dhe me të dhënat statistikore ka thënë se prej 500 vullkaneve, për të cilat dimë se ekzistojnë në tokë, më së shumti gjenden në zonën e Oqeanit të Qetë (Pacifik), Detit Mesdhe dhe buzë Oqeanit Atlantik. Edhe më e çuditshme se kjo është se

fundi i Oqeanit të Qetë përbëhet nga bazalti, shkëmbinjve vullkanik. Kjo do të thotë se brendësia e zjarrtë e Tokës është e ngjashme me sipërfaqen e fundit të Oqeanit të Qetë, Detit Mesdhe dhe Oqeanit Atlantik. Këto vende nën ujë paraqesin pika të dobëta të sipërfaqes së Tokës, sepse periodikisht vjen deri tek erupcionet vullkanike, të cilat nga brendësia e Tokës nxjerrin në sipërfaqen e saj lavë, hi etj.

Autori, me tutje i numron disa vullkane të cilat sajojnë zonën e zjarrtë rreth ujit dhe nën ujë siç janë Fuxhijama, Majun, Tal, Orizaba, Kotopaksi, Çimborazo, Mont Lasen, Mont Hud dhe Mont Rejnir. Përveç këtyre vullkaneve në qendër të Oqeanit ekzistojnë edhe ujdhesa vullkanike si psh. Havajet të cilat janë formuar nga shkëmbinjtë vullkanik.

Nga vullkanet më të mëdha të Detit Mesdhe janë Vezuvi te Napoli dhe Etna në Sicili. Në veri të Etnës është vullkani aktiv Stromboli i cili natën ndriçon me një dritë të kuqe për çka marinarët e kanë quajnë fener deti i Detit Mesdhe. Në lindje të Detit Mesdhe gjendet grupi i dytë i vullkaneve prej të cilëve numërojmë Araratin, kurse në Oqeanin Atlantik gjenden ujdhesat vullkanike Azore dhe Kanare.

Statistika thekson faktin tjetër se 80% të tërmeteve gjenden në zonën që e përfshinë Oqeani i Qetë dhe se këto më së shpeshti ndodhin në fund të detit.

Dridhjet e Tokës dhe erupcionet vullkanike ndodhin, pra, rreth ujërave dhe nën to, ku masa e skuqur në brendësinë e Tokës është më afër sipërfaqes së saj, të cilën nga erupcioni mund ta ruajë vetëm baraspesha ndërmjet sipërfaqes së Tokës dhe maleve, të cilat e forcojnë sipërfaqen e Tokës në vendin e tij dhe kështu pengon që zjarri i skuqur nga brendësia të derdhet mbi det.

Përkitazi me këtë dhe përkitazi me malet e palëvizshme Kur'ani thotë:

"...në Tokë ka vendosur male të palëvizshme, për të mos u lëkundur ju, dhe ka shpërndarë në të gjithfarë lloj shtazësh..." (Llukman: 10).

Në një vend tjetër, duke i përshkruar malet, thotë se ato janë shtylla... "A thua Tokën nuk e kemi bërë shtrat dhe malet shtylla."

Kur të vijë Dita e gjykimit, e kur malet të rrepshohen me tokë dhe zjarri të shpërthen nga brendësia në sipërfaqen e saj.

"Kur të dridhet Toka me një të dridhur të fortë dhe kur ta nxjerrë *(nga brendësia)* barrën e vet." (Ez-Zilzal: 1-2) dhe kur zjarri nxiton në detëra dhe oqeane, atëherë "deti do të jetë i mbushur me zjarr" me të cilin është përbetuar Krijuesi i Madhëruar... "dhe Xhehennemi do t'i shfaqet çdonjërit që sheh."

Sot e dimë se temperatura në brendësinë e Tokës është me mijëra gradë. Brendësia e Tokës është furrë e lartë ku kaliten gurët dhe metalet. Ndoshta ky është Xhehennemi për të cilin All-llahu thotë: "Dhe të humburve do t'u dëftohet Xhehennemi." (Esh-Shu'ara: 91). "Dhe Xhehennemi do t'i shfaqet çdonjërit që sheh." (En-Naziat: 36).

Fjala "ibrazun" do të thotë të nxjerrish diç nga brendësia në sipërfaqe.

Ndoshta kjo brendësi e Tokës është ai vend ku do të bien shpirtrat e dhunuesve (tiranëve)... Ky është Xhehennemi lëndë djegëse e të cilit do të jenë gurët.

Këto janë isharete dhe fjalë të pakapshme ku ndeshet stilistika me shkencën.

Kjo ndeshje assesi nuk mund të jetë e rastësishme, e as që kjo puthitje e shkencës dhe fjalëve të Kur'anit mund të jetë ngatërrim i paarsyeshëm gjer tek i cili ka ardhur me përshtatshmëri të rastit.

XHENNETI DHE XHEHENNEMI

Ajo që kisha lexuar në ditët e rinisë në Kur'an për lumenjtë e Xhennetit, mjaltin dhe verën, ishte një nga shkaqet që u pata larguar nga Kur'ani. Unë nuk jam adhurues i mjaltit e as që e dua verën. Atë që thotë Kur'ani përkitazi me këtë e konsideroja si gjë naive. Gjykimi im mbi lumenjtë, mjaltin dhe verën e Xhennetit atëbotë ishte zgjeruar edhe në Kur'an edhe përgjithësisht në religjion.

Sa naiv që kam qenë.

As që jam munduar ta kuptoj tekstin Kur'anor, e as të mbetem në shprehjen e tij sipërfaqësore, e të mos flasë për ndonjë përpjekjet që ta kuptoj domethënien e brendshme të tij. Kam qenë shumë i ngutshëm në gjykimin tim. Qëllimi dhe dëshira ime ka qenë largimi. Kjo dëshirë çdo gjë e kishte vënë nën hije, kështu që edhe vet gjurma e së vërtetës ishte zhdukur nga sytë e mi. Më kishin ikur gjërat të cilat në realitet ishin tejet të qarta.

Çka thotë Kur'ani për Xhennetin?

"Shembulli i Xhennetit që u është premtuar besimtarëve - në të cilin gjenden lumenj me ujë të paprishur, dhe lumenj të qumështit me shije të pandryshuar, dhe lumenj të verës me shije të këndshme për ata që e pinë, dhe lumenj nga mjalti i kulluar..." (Muhammed: 15).

Ajeti fillon me cekjen e shembullit "Shembulli i Xhennetit që u është premtuar besimtarëve", e nuk flet për përshkrimin e përpiktë të tij. Përshkrimi i përpiktë i Xhennetit dhe Xhehennemit është i pamundur, sepse, në raport me ne ato janë fshehtësira të cilat është e pamundur të prezentohen me fjalët e fjalorit tonë.

E ngjashme me këtë është edhe pyetja në lidhje me seks që ta bën fëmija. Gjendesh në telashe se si t'ia shpjegosh këtë, sepse kjo, në raport me fëmijën, është fshehtësi jashta kufijve të eksperiencës së tij. Kur pas të gjitha përpjekjeve nuk ke sukses t'ia sqarosh se ç'është seksi, atëherë e merr një shembull dhe i thua se ky është sikurse sheqeri. Atij i ke zgjedhur diç nga jeta e tij e përditshme. Por, megjithatë, domethënia është shumë larg realitetit. Ka dallim të madh ndërmjet seksit dhe shijes së sheqerit të rëndomtë.

Nga këto pozicione edhe Kur'ani i drejtohet beduinit, dëshira e të cilit ka qenë që, në shkretëtirën e zjarrtë në të cilën ka jetuar, të gjejë burim me ujë të pijshëm dhe të freskët. Krejt ajo çka gjente nga burimet e shkretëtirës ishin burime me ujë të njelmët dhe të ndenjur. Po ashtu është edhe me qumështin i cili në nxehtësinë e shkretëtirës shumë shpejtë fermentohet dhe e ndërron shijen e vet. Kur'ani jep shembull për atë që banori i shkretëtirës më së tepërmi e dëshiron:

"All-llahu nuk ngurron të sjellë si shembull mushkonjën apo diç më të vogël se kjo." (El-Bekare: 26).

Qëllimi i Kur'anit është që të mundëson të kuptuarit sa më të mirë. Gjithë ajo që është thënë për Xhennetin dhe Xhehennemin është e cekur vetëm si shembull, si një lloj afrimi, si simbol.

Në Dhiatën e vjetër Izaiu e përshkruan parajsën me këto fjalë: "*"Dhe Jahve mbi Ushtritë do t'u përgatitë të gjithë popujve në këtë mal gosti prej trashësirave (kafshëve të trasha), gosti prej verës shumë të mirë... Dhe Jahve, Perëndia, do ta fshijë lotin nga çdo fytyrë."* (Izaija, 26, 6-8).

Në Psalmet e Efraimit të shenjtë qëndron: *"Dhe i shikoja banorët e përshpirtshëm... shihja se si nga ata pikonte aroma dhe se si ishin të stolisur me thekë pemësh dhe me bimë aromatike... Dhe çdonjërin që ishte përmbajtur nga makuteria e prisnin gratë e bukura në gjinjtë e pastër."*

Fotografia e parajsës, pra, është e përbashkët tek të gjitha religjionet.

Por Kur'ani nuk na lë nën hijen e shembullit. Ai menjëherë shtonë: "Dhe askush nuk e di se çfarë gëzimesh të fshehta i presin si shpërblim për atë që kanë punuar." (Es-Sexhde: 17).

Ai tërë problemin e hedhë në fushën e të padukshmes, në gajb, në sende për të cilat nuk është e mundur të flitet me gjuhën tonë tokësore.

Këtu është e pamundur që me fjalë të shpjegohet çdo dëshirë e syrit dhe e zemrës. Për sa i përket Xhehennemit, ai është diç e tmerrshme. Ai nuk është as jetë as vdekje.

"...Vdekja do t'u afrohet atyre nga të gjitha anët, por ata nuk do të vdesin, ata do t'i pret vuajtja e rëndë." (Ibrahim: 17).

"...Ruajuni zjarrit, lëndë djegëse e të cilit do të jenë njerëzit dhe gurët." (El-Bekare: 24).

Pastaj këtë e shpjegon edhe më hollësisht: "Përmbi ta dhe përfundi tyre do të ketë shtresa të zjarrit. Me këtë All-llahu i frikëson robërit e Vet. "O robërit e Mi, ruajuni *(dënimit Tim)*!" (Ez-Zumer: 16).

Kur'ani këtu shpjegon një fakt të ri. Ai këto fjalë i cekë si fjalë kërcënuese dhe frikësuese. Por ky frikësim nuk bëhet pa arsye. Kjo bëhet e ngjashme me atë kur ti e frikëson fëmijën tënd duke ia tërhequr vërejtjen për mospastrimin e dhëmbëve të tij dhe i thua: Nëse dhëmbët nuk i pastron me brushë, krimbi do ti hajë ato. Këtë e thua nga dashuria dhe mëshira ndaj tij. Sigurisht se krimbi nuk do t'ia hajë dhëmbët, por këtë do ta bëjnë viruset dhe mikrobet që nuk shifen me sy. Por frikësimi ka qenë i arsyeshëm, sepse ajo që do ti ndodhte fëmijës sikur ta braktiste pastrimin e dhëmbëve do të ishte shumë më e keqe se sa shembulli i përmendur.

Ky është frikësim i Mëshiruesit dhe Fuqiplotit me diç që me të vërtetë do të ndodh dhe që do të jetë më e keqe se tërë ajo çka është thënë dhe çka është shkruar në lidhje me këtë, e që syri kurrë nuk e ka parë e as veshi nuk e ka dëgjuar, e as që ndonjëherë i ka ra ndërmend krijesës së gjallë.

Ndëshkimi është e vërteta... Shpërblimi, gjithashtu, është e vërteta.

Këtu kundërshtari kundërshton.

A nuk është ndëshkimi në kundërshti me mëshirën e Zotit dhe madhështinë e Tij... Kend do ta ndëshkojë? Njeriun e gjorë, i cili nuk është i barabartë as me pjesëzën më të imët të perandorisë së Tij?

Ky kundërshtim ka qenë lëndë e interesimit tim. Gjithnjë kam refuzuar idenë mbi ndëshkimin, e në pajtim me këtë e kam refuzuar Kur'anin dhe religjionin në tërësi.

Çështja kërkon nga ne që më seriozisht të merremi me domethënien e fjalës adhab (ndëshkim).

Zoti në realitet nuk ndëshkon.

Ai vetëm vepron me drejtësi.

Sikur Ai në Ditën e gjykimit do t'i barazonte të shtypurin me shtypësin, të vrarin me vrasësin, sikur Ai këtë do ta bënte me arsyetim mëshire, atëherë kjo do të ishte shumë larg drejtësisë dhe mëshirës, sepse të barazuarit e të pabarabartëve është padrejtësi e rëndë. Zoti është larg asaj që të veprojë kështu.

Pastaj kjo do të ishte anarki nëse në sytë e Zotit e bardha është sikurse edhe e zeza, i verbëti sikurse ai që sheh, i vdekuri sikurse i gjalli, ai që dëgjon sikurse ai që është i shurdhër.

Kozmosi mohon anarkinë.

Përsiatja për pjesët më të imëta të kozmosit na zbulon të ekzistuarit e rendit dhe ligjit ekzakt të cilit nuk mund t'i shpëton as një e njëmijta pjesë e miligramit.

Lëvizja e elektroneve prej orbite në orbitë në brendinë e atomit zhvillohet sipas parallogarisë së caktuar. Ai duhet të lirohet nga energjia e caktuar për të kërcyer jashtë me kërcim të njëjtë. Ai kujdeset për lëvizjen e vet. Atëherë çka të themi për njeriun e arsyeshëm i cili në raport me elektronin është sikurse galaktika e kozmosi në raport me njeriun. Njeriu është diç e madhe sepse All-llahu atë e ka frymëzuar me jetë, e nuk është imtësi sikurse atomi dhe elektroni.

Pastaj çka do të thoshte të vdesin të shtypurit dhe shtypësit e të mos ketë ringjallje në mënyrë që veprat e mira dhe të këqija, dituria dhe arsimi, dhe e tërë ajo që ka arritur njeriu të shkonte huq.

Kjo do të ishte vetëm marrëzi.

"Ekziston vetëm kjo jetë e kësaj bote, jetojmë dhe vdesim, vetëm që koha na shkatërron" - thonë ata. E ata për këtë bash kurrgjë nuk dinë, ata vetëm supozojnë." (El-Xhathije: 24). Ky është mendim i gabuar, sepse sipas kësaj jeta do të ishte vetëm lojë dhe absurditet.

"A mendon njeriu se do të lihet në vullnet të vetin, pa përgjegjësi?" (El-Kijameh: 36). Mendja e cila mendon, kurrë nuk do të thotë kështu. Ajo mendon për krijimin e Gjithësisë dhe për ligjet ekzakte të kozmosit dhe këlthet nga brendia e vet: "O Zoti ynë. Ti këto nuk i ke krijuar më kot, i lavdëruar qofsh Ti." (Ali Imran: 191). Është absurde të jetë kjo e paarsyeshme. Duhet, në një mënyrë të ekzistojë vazhdimi. Mençuria duhet të shfaqet dikur.

Kjo është çështje e drejtësisë dhe e logjikës, e jo çështje e ndëshkimit për vet ndëshkimin.

Ajo se çka do të ndodhë me ne pas ringjalljes është se askush prej nesh nuk do të ndahet nga kategoria dhe shkalla e të arriturit të vet në këtë botë.

"...Ju e keni konsideruar të rrejshëm *(Kur'anin dhe Pejgamberin)* andaj *(ndëshkimi)* dënimi për ju do të jetë i paevitueshëm." (El-Furkan: 77).

Ai i cili ka qenë i shurdhër, ai i cili ka jetuar pa menduar, që nuk ka mundësi ta sheh të vërtetën, atë Zoti do ta ringjallë të verbër. "...Ne në Ditën e Gjykimit do ta ringjallim të verbër. "O Zoti im", - do të thotë ai - "përse më ringjalle të verbër, kur unë, me të vërtetë, kam pasur të pamurit më parë?" "Ja përse", - do të thotë Ai - "Ty të kanë arritur argumentet toNe, por i ke harruar ato, andaj edhe ti sot do të jesh i harruar." (Ta Ha: 124-126).

Ky është atributi yt i cili domosdo do të jetë së bashku me ty "Ndëshkimi do të jetë i obligueshëm."

Zoti nuk e ndëshkon njeriun por njeriu me injorancën e vet e ndëshkon vetveten.

"...Ne nuk u kemi bërë atyre padrejtësi, por ata vetvetes i kanë bërë zullum." (En-Nahël: 118).

Kush e ka kaluar jetën në këtë botë duke u kujdesur vetëm për ushqim, pije dhe fjetje, në botën tjetër do të ketë pozitë të barabartë me këtë, apo edhe më të ulët në raport me ata të cilët kanë jetuar duke menduar.

"Ai i cili në këtë botë ka qenë i verbër do të jetë i verbër edhe në botën tjetër dhe larg çdo kohe."

Në botën tjetër dallimi zmadhohet dhe dyfishohet... Dallimi mes dy vetave do të jetë shumë më i madh edhe nga vet dallimi që ka ekzistuar ndërmjet njeriut dhe shtazës.

"Shiko se si disave u japim përparësi ndaj të tjerëve, kurse në botën tjetër dallimi në shkallëzime dhe përparësira, me të vërtetë do të jetë më i madh." (El-Isra: 21).

"Ata të cilët bëjnë mëkate sigurisht do t'u arrijë nga All-llahu poshtërim." (El-En'am: 24).

Ky poshtërim do të mundojë dhe do të ndezë. Ky do të vajtojë së bashku me pronarin e vet kur do ta shohë vendin e tij dhe vendet e të tjerëve, vlerën e tij dhe vlerën e të tjerëve.

"O Zoti ynë, cilindo që Ti e hedhë në zjarr, Ti e ke poshtëruar atë..." (Ali Imran: 192).

Me këtë ajet All-llahu e konsideron turpin më të dhembshëm se vet zjarrin.

Dhe sikurse që Ungjilli e përshkruan botën tjetër si "Botë të vajtimit dhe cokëllimit të dhëmbëve" ku kundërvajtësi do të kërcëllen dhëmbët duke u penduar për shkak të pozitës së vet të mjerueshme para pozitave të larta tek të cilat kanë arritur të tjerët, Kur'ani i përshkruan banorët e Xhennetit në ato pozita të larta dhe thotë se ata gjenden në aërsi të Zotit, në aërsi të të vërtetës: "Në vendin ku do të jenë të kënaqur, tek Sunduesi i Gjithëfuqishëm." (El-Kamer: 55).

Sipas përshkrimit kur'anor Xhenneti është zonë e paqes ku nuk ekzistojnë konflikte, gënjeshtra, sharje dhe intriga.

Në ajetin 72. të kaptinës Et-Teube: Kur'ani thotë se në Xhennet rrjedhin lumenj, se në të ekzistojnë pallate të bukura në kopshtet e Edenit, dhe përfundon ajetin me këto fjalë: "...Kurse edhe pak dashamirësi e All-llahut është më e madhe se e tërë kjo..." Domethënia e kësaj është plotësisht e qartë. Dashamirësia e All-llahut është më e madhe se të tëra ato kënaqësi materiale.

Kjo domethënie është vërtetuar edhe me ajetin nga kaptina El-Isra: i cili na rekomandon që një pjesë të natës ta kalojmë në ibadet: "Dhe kaloje një pjesë të natës *në lutje. Zoti yt në botën tjetër do të dhuron një vend nderi."* (El-Isra: 79).

Kjo është pra, çështje e vendit. Çdonjëri do të ringjallet në kategorinë e vet dhe do të gjendet në vendin që e meriton.

All-llahu nuk ndëshkon vetëm për të ndëshkuar.

Ndëshkimi dhe pësimi i atyre që gjenden në pozitë më të keqe rezulton nga ndjenja e zilisë, lakmisë, poshtërimit dhe të brejturit e ndërgjegjes. Kjo ndjenjë do t'i ndezë gjoksat ashtu siç i ndez zjarri, madje edhe më tepër se kjo. Ajo do të jetë ndëshkim ekzemplar (shembëllor).

Çdonjëri vetvetes ia përcakton (peshën) ndëshkimin sipas pozitës në të cilën ka qenë dhe në të cilën ka arritur me veprat e veta në këtë botë.

Argument se zjarri për të cilin është fjala në botën tjetër nuk është zjarr që e njohim ne janë edhe këto ajete Kur'anore: "... Kështu ata dëshmojnë kundër vetes se njëmend kanë qenë mosbesimtarë. "Hyni në Xhehennem me popujt, me xhinnët dhe njerëzit - të cilët kanë ekzistuar para jush dhe janë zhdukur." - do të thotë Ai. Dhe kurdo që një popull hyn në zjarr, do ta mallkon atë, të cilin e ka pasuar në mosbesim. E kur të tubohen të gjithë në të, atëherë ata të fundit do t'i thonë atyre të parëve: "O Zoti ynë! Këta na kanë sjellë në lajthitje, andaj jepju këtyre vuajtje të dyfishtë në zjarr! - "Për të gjithë do të jetë e dyfishuar!" - do të thotë Ai "Por ju nuk e dini." (El-A'raf: 37-38).

Ky është dialogu i cili do të bëhet në skëterrë ndërmjet të ndëshkuarëve. Në zjarrin të cilin ne e njohim, nuk mund të ketë dialog mes atyre që digjen në të.

Domethënia e thellë e dytë në ajet është "për të gjithë do të jetë e dyfishuar, por ju nuk e dini."

Para nesh gjenden dy njerëz. Njëri prej tyre vuan dy herë më tepër, edhe pse që të dy janë në të njëjtin vend. Kjo do të thotë se vuajtja është në vetë personin, e jo në diç tjetër. Kjo nuk mohon konfirmimin se vuajtja e përmendur do të jetë trupore. Është e mundur se do të jetë edhe trupore edhe shpirtërore në të njëjtën kohë.

Kjo, gjithashtu, nuk mohon faktin se ky do të jetë zjarr, por jo çfarë e njohim ne.

Kur'ani rrëfen për banorët e Xhennetit, se si ata në të do të kenë femra të pastërta dhe se do t'u përkujtohet, duke ngrënë frute të Xhennetit, se me frute të njëjta kanë qenë të furnizuar gjersa banonin në Tokë (natyrisht me cilësi tjetër).

Ajeti thotë për ta si vijon: "...Çdoherë kur u jepet ndonjë frut prej tyre, ata do të thonë: "Këtë e kemi ngrënë edhe përpara", - e atyre do tu jepen vetëm fruta të ngjashme me to. Në to do të ketë femra të pastërta dhe në to do të jetojnë gjithmonë." (El-Bekare: 25).

Sipas kësaj Xhenneti është gradë dhe vend. Në të ka gjithçka që ka edhe në Tokë, por me dallim të madh nga pikëpamja e cilësisë. Dallim ky i cili tejkalon çdo vlerësim apo paramendim tonë. Diç e ngjashme me dallimin mes kohës dhe parfundësisë. Diç e ngjashme me dallimin mes sheqerit dhe seksit kundruall njeriut në moshën madhore.

Nëse në Xhennet është përmendur mjalti, atëherë ai është vërtetë mjaltë, por jo i tillë siç e njohim ne, ose nëse është përmendur qumështi, atëherë vërtetë ai është qumësht, por jo i tillë siç e njohim ne. Rasti i njëjtë është edhe me femra.

Këto do të jenë gjëra të jashtëzakonshme, të çuditshme, sikurse fshehtësia në raport me atë që thotë se trupi i saj shndritë porsi t'ishte e krijuar nga drita. Këto janë ëndrra, por është e mundur që pas kësaj të ekzistojë e vërteta.

Njësoj është edhe me zjarrin për të cilin na flet Kur'ani. Ky është zjarr, por jo i tillë çfarë e njohim ne. Zjarr nga i cili rritet druri me frute (druri Zekum). Në të gjendet uji i vluar, të cilin do ta pijnë banorët e Xhehennemit. Ata në Xhehennem do të bëjnë dialog. Është e pamundur që trupat e

tyre të kenë përbërje të njëjtë kimike sikurse trupat tonë. Në të kundërtën, shumë shpejt do të avulloheshin. Në situatë të tillë, ata nuk do të mundnin të ndërrojnë fjalë mes veti.

Kjo do të thotë se do të ringjallemi trupërisht, por jo si trup. Ndoshta si ekzistencë, e cila do të ketë formën, por nga materia e cila në raport me ne është fshehtësi. Ai nuk do të jetë trup i sajuar nga elementet tokësore.

Andaj është e mundur që kënaqësitë të jenë të dyfishta, trupore dhe shpirtërore, në mënyrë çfarë ne nuk e kemi të njohur.

Sikurse që nivelet e vuajtjeve do të jenë të dyfishta, trupore dhe shpirtërore, po ashtu edhe njerëzit do të jenë të ndarë në kategori dhe gradë sipas meritave të tyre. Çdo kategori do t'i ketë specifikat e veta të jetesës, të cilat sipas meritave i garantojnë kënaqësi apo fatkeqësi. Konsideroj se kategoria më e vlefshme e njerëzve në Xhennet do të jetë ajo e cila do të ngritet mbi kënaqësitë materiale. Atyre i Gjithëmëshirshmi do t'ua zgjedhë shkallën e jetesës së pastër shpirtërore afër Vetes në *Sidretul-munteha*, ku kënaqësia nuk do të jetë kënaqësi në ushqim, në pije dhe në hyrie, por kënaqësia në shikimin e Qenies së përsosur të All-llahut, kënaqësi në meditimin për të vërtetën, bukurinë dhe mirësinë Absolute.

Kjo është kënaqësia e atij i cili rrinë "në vendin e kënaqësisë, te Sunduesi i Plotfuqishëm." (El-Kamer: 55).

Kjo është kategori e Pejgamberëve dhe atyre që janë në nivel të tyre.

Në këtë mënyrë Xhenneti do t'i përfshijë të gjitha kënaqësitë materiale prej ushqimit dhe pijes duke u ngjitur gjer tek kënaqësia e pastër shpirtërore. Kjo kënaqësi në Xhennet do të jetë e kapshme për çdonjërin, përkitazi me pozitën çfarë do ta ketë në Xhennet.

Këto ajete Kur'anore zbulojnë dhe provojnë se zjarri nuk është zjarr çfarë e njohim ne dhe se Xhenneti nuk është treg i gjelbër dhe se All-llahu nuk është tiran i vrazhdë.

Zoti do te ringjallë secilin në kategorinë, shkallën dhe vendin e vet, sepse kjo është drejtësi, e Ai është i drejtë.

Ndëshkimi do të jetë i caktuar sipas vetë dallimeve në pozita, pastaj do të vlerësohet dhe përgjithmonë do ta përcjellë pronarin sikurse që vurrata (shenja) e përcjellë gishtin e vet.

Ky është me siguri ndëshkimi, ky është me siguri Xhehennemi, të cilin do ta shohim qartë.

“Jo, jo! Mashtroheni, sikur ta dini ju mirë, (nuk do të mbureshit me kotësi). Ju do ta shihni skëterrën! E, (madje) edhe një herë, me të vërtetë, do ta shihni skëterrën konkretisht (qartë). (Et-Tekathur: 5-7).

Duke qenë se All-llahu e di se ky ndëshkim është i tmerrshëm, Ai na ka tërhequr vërejtjen dhe na ka frikësuar me fjalë të cilat jehojnë, na ka dërguar Pejgamber me muxhize dhe me Libra nga mëshira ndaj robërve të Vetë, sepse në një hadith kudsij ka thënë:

"Mëshira ime i ka parapri hidhërimit Tim."

Në suren "El-Fatiha", Veten e ka përshkruar si Mëshirues, Përdëllimtar i Madh, para se të thotë se është Sundues i Ditës së gjykimit, Ditës së llogarive, Ditës së hidhërimit, Ditës kur do të zbatojë ndëshkimin e parevokueshëm.

Meqenëse All-llahu është Mëshirues, Ai gjer e gjatë i ka hapur dyert e pendesës:

"Thuaj: "O robërit e Mi, që i keni bërë keq vetvetes, mos e humbni shpresën në mëshirën e All-llahu! All-llahu, me siguri, i falë të gjitha mëkatet. Ai, me të vërtetë është Falës dhe Përdëllimtar." (Ez-Zumer: 53).

Pastaj këtë e ka kushtëzuar me këto fjalë: "Unë me siguri do t'ia fali atij që pendohet dhe vetëdijësohet *(i kthehet besimit)* e punon vepra të mira, dhe i cili pastaj përqëndrohet *(ngulmon)* në rrugën e drejtë." (Ta Ha: 82)

Ka urdhëruar të kryhen namazet, faljet, e pastaj ka thënë: "Ndërsa përkujtimi në All-llahun është devotshmëria më e madhe."

Të kujtohesh se ekziston fuqia e All-llahut, që kujtesa të mbetet gjithnjë prezente në vetëdijen tënde dhe në punën tënde. Vetëm në këtë mënyrë do të shpëtosh, vetëm kështu do t'i përfitosh konditat e besimtarit të vërtetë i cili me këtë është më i mirë se ai që falet e në zemrën e tij nuk ekziston dhikri.

Vet fjala "dhikër" e cila në Kur'an përmendet në shumë vende, ka domethënie të tillë. Vetë Kur'ani është quajtur me këtë emër, gjersa devotshmëria dhe imani janë vetë dhikër:

"All-llahun e kujtojnë vetëm ata të cilët janë të pajisur me mendje." (Ez-Zumer: 9).

"Dhe kur u drejtohet këshilla, ata nuk kujtohen." (Es-Safat: 13).

"Ne, me të vërtetë, kemi shpallë Kur'anin dhe, Ne, me të vërtetë do ta ruajmë atë (origjinalitetin e tij)" (El-Hixhër: 9).

"Ne Kur'anin e kemi bërë të lehtë për këshillim - e a ka kush që këshillohet (me të)?" (El-Kamer: 17).

"Ti këshillo - se ti je vetëm këshillues. Ti nuk je mbi ta imponues (sundues)." (El-Gashije: 21-22).

"... dhe që të kujtohen (këshillohen) ata të cilët janë pajisur me mend." (Sad: 29).

"Ata që i frikësohen All-llahut, posa i godet ndonjë ngatërresë e djallit, përkujtohen dhe menjëherë vijnë në vete." (El-A'raf: 201).

Këtu duhet të ndalemi dhe të mendojmë pak më gjatë.

Çfarë përkujtimi është ky i cili kërkohet.

Teoritë më të reja psikologjike thonë se shquarja (të kuptuarit) është e grumbulluar dhe e fshehur në brendinë e vet njeriut. Atë e mbulojnë pasionet dhe epshet njerëzore. Për këtë arsye të mësuarit, në realitet paraqet të përkujtuarit me anë të cilës hiqet perdeja e shquarjes (njohurisë). Mësimi assesi nuk mund të bëhet prej kurrgjëje.

Fëmija nuk mëson se dy edhe dy bëjnë katër, por atij vetëm i përkujtohet fakti i brendshëm në shpirtin e vet me të cilin është lindur.

E ngjashme është edhe me ndjenjat për bukurinë dhe për gëzimin. Ky është një lloj përkujtimi i paqartë i botës dhe gjërave që gjenden në të, mbretërisë së Zotit, ku kemi qenë para se të gjendemi në barkun e nënës.

Për këtë arsye psh. bukuria e femrës është bukuri kaluese, bukuri vizituese, e assesi bukuri e përhershme, sepse ajo bukuri nuk është bukuria e saj. Ajo është hije e cila reflektohet në të nga brendësia Hyjnore. Nuk kalon shumë kohë e kjo bukuri e braktisë femrën, atëherë kur mbizotëron ligji i materies, i tokës dhe i pleqërisë.

Para lindjes kemi pasur jetë si shpirtra. Përkitazi me këtë Kur'ani thotë: "Dhe kërkoi prej tyre që të dëshmojnë (për të vërtetën) kundër vetes. (Iu tha atyre) "A nuk jam unë Zoti juaj?" (El-A'raf: 172).

Ajeti flet për atë që ka ndodhur në botën e panjohur para krijimit në këtë botë.

All-llahu ka kërkuar prej krijesave, të cilat i ka krijuar, i krijon tani dhe do t'i krijojë edhe më, të dëshmojnë kundër vetes... "A nuk jam unë Zoti juaj?"... Ata do të përgjigjen: "Po, me të vërtetë, ne dëshmojmë". Në këtë mënyrë All-llahu e merr përgjigjen prej tyre sepse Ai e di se ata këtë tërësisht do të harrojnë dhe se do të bredhin në mohim, pabesim dhe injorancë.

E Ai, nga mëshira e Tij do t'i dërgojë të Dërguarit e Vet që t'i përkujtojnë ata.

Muhammedit alejhis-selam i ka thënë: "E ti pra, këshillo - se ti je vetëm përkujtues. Ti ndaj tyre nuk je imponues (sundues)."

E për iman, besim, thotë se është vetë jeta:

"O besimtarë përgjigjuni All-llahut dhe Pejgamberit kur prej ju kërkon të bëni atë që do t'ua sigurojë jetën." (El-Enfal: 24), sepse lidhmëria e ekzistencës së kësaj bote së bashku me përkujtimin në ekzistencën e parë hyjnore dhe ekzistencës pas vdekjes është depërtimi i njeriut në jetën e vet në tërësi.

All-llahut nuk i duhen lutjet toNe, e as agjërimi ynë. Kjo na duhet ne. Ndoshta në namazin tonë të thellë do të përkujtohemi, ndoshta me lutje dhe orientim të drejt do të piqemi me burimin e ekzistencës sonë prej nga e thithim jetën.

Namazi dhe devotshmëria janë furnizim. Na jemi ata të cilëve na duhet të jetojmë, e jo All-llahu, sepse Ai është ekzistent nga vetvetiu dhe për kurrgjë nuk ka nevojë.

Përsa na përket neve, ne nuk mund të jetojmë pa Atë, pa All-llahun, i Cili jeton nga vetvetiu dhe i Cili është burim i jetës.

Nga kjo kuptojmë se Zoti i ka sjellur ligjet dhe i ka vënë dispozitat për të mirën tonë, e jo për atë që Ai ta ndjejë hyjninë e Vet. Ai mund të ekzistojë edhe pa ne. Ai nuk ka nevojë të na ndëshkojë, as të kërkojë diç prej nesh, e as që të na obligojë.

"Përse t'ju ndëshkojë All-llahu - nëse jeni falënderues dhe besimtarë?" (En Nisa: 147).

All-llahu nuk ka kurrfarë leverdie nga ndëshkimi i krijesave të Veta, e as që ka nevojë për të.

Ai, me të vërtetë, me kurrgjë nuk obligon, e as që kërkon diç prej nesh, madje Ai edhe nuk na ndëshkon. E tërë kjo duket qartë nga kuptimi i jashtëm i ajetit. Sipas kuptimit të brendshëm, më të thellë të Kur'anit, i cili i zbulohet vetëm atij që përpiqet ta kuptojë, All-llahu është Mëshiruesi,

Mëshirues Absolut, i Drejti, drejtësi Absolute, Ai është Ai i Cili jep, dhënie Absolute, nuk merrë asgjë, e as që ka nevojë për diç.

Nëse në këtë botë ekziston ndonjë ndëshkim, atëherë kjo është vetëm mëshira e Tij: "Dhe Ne, do të bëjmë që të shijojnë dënimin më të butë të kësaj jete para dënimit më të madh, për t'u penduar ata." (Es-Sexhde: 21).

Kjo është përpjekje për ta zgjuar arsyen e pakujdesshme. Ndoshta do të përkujtohet, do të vetëdijësohet, e ta shpëtojë veten nga ndëshkimi më i madh, i cili është në rrugë, të pashmangshëm, prej të cilit nuk mund të iket atëherë kur çdonjërit i caktohet pozita dhe shkalla e tij.

Nga Kur'ani kuptojmë se Ligji i Zotit i zgjon të pakujdesshmit në Tokë, dhe i stërmbushë me mynxyra, me sëmundje dhe me ndëshkime, në mënyrë që ta kuptojnë kalueshmërinë e kësaj bote dhe përjetësinë e asaj bote. Ai këtë e bënë nga mëshira e Vet ndaj tyre, sepse Ai e di se çka i pret atëherë kur ndahet drejtësia, atëherë kur Ai nuk do të jetë i Mëshirshëm. Madje edhe kur plotësohen të gjitha mynxyrat e kësaj bote, e ata nuk vetëdijësohen, Zoti do t'ua hapë dyert e thesareve të veta që të kënaqen. Mbi ata do të zbatohet Fjala e Zotit - pësimi në atë botë.

"Ndërsa Pejgamberë u kemi dërguar edhe popujve të tjerë para teje dhe i kemi ndëshkuar ata me skamje dhe sëmundje, për tu bërë të dëgjueshëm. Është dashur të bëhen të dëgjueshëm kur u erdhi ndëshkimi i Jonë! Por zemrat e tyre ishin gurë, e djalli ua zbukuronte ato që bënin ata. Dhe kur i harruan ato me çka ishin të paralajmëruar, Ne iu hapëm të gjitha dyert (të gjitha të mirat); e kur u gëzonin me atë që u dhamë, Ne i dënonim ata befasisht dhe atëherë ata e humbnin çdo shpresë." (El-En'am: 42-44).

Ajo që neve na duket begati, ndoshta në esencë është ndëshkim.

"Le të mos ngazëllejë ty (o Muhammed) pasuria e tyre, e as fëmijët e tyre! Se, All-llahu dëshiron t'i ndëshkojë me to në këtë jetë dhe t'ju dalë shpirti atyre duke qenë mohues." (Et-Teube: 55).

"A mos mendojnë ata - që Ne, duke u ndihmuar me pasuri dhe djem, po nxitojmë kah të mirat e tyre? Kurrsesi, por ata nuk vërejnë." (El-Mu'minun: 55-56).

"...Ne, me të vërtetë ua zgjasim jetën atyre vetëm për t'i shtuar ata mëkatet..." (Ali Imran: 178).

Të mirat dhe begatia në këtë botë nuk janë shenjë për kënaqësinë e Zotit, e as ndëshkimi nuk është shenjë e hidhërimit të Zotit. Ngandonjëherë ndëshkimi është i mirë, dheanasjelltas. Realitetin e zbulon vetëdija jote. Nëse fatkeqësinë e konsideron si diç që do të të pastrojë, atëherë kjo është dhunti, e nëse dhuntinë e konsideron si tiranizim (shtypje), atëherë kjo është fatkeqësi.

Pastaj Kur'ani flet për banorët e Xhehennemit:

"Ata në të cilët plotësohet Fjala e Zotit tënd (dënimi) vërtetë nuk do të besojnë, madje sikur t'u vijnë të gjitha argumentet, përderisa mos ta përjetojnë ndëshkimin e dhembshëm." (Junus: 96-97).

E kur të ndëshkohen me Xhehennem, ata do të klithin duke u lutur:

Ah! Sikur t'i shohish ata kur të ballafaqohen para zjarrit, duke thënë: "Ah! Sikur të ktheheshim pas, mos t'i përgënjeshtronim argumentet e Zotit tonë dhe të bëheshim besimtarë!" (El-En'am: 27).

"Dhe sikur ata të ktheheshin, përsëri do të vazhdonin të bëjnë ato që u ishin ndaluar, sepse ata me të vërtetë janë gënjeshtarë." (El-En'am: 28).

Zoti e di se, nëse ata do të ktheheshin në këtë botë, përsëri do t'u ktheheshin mendjemadhësive të tyre.

Kjo është injorancë dhe insistim në injorancë. Nuk ekziston kurrgjë me çka do të shërohej kjo. Kjo nuk shërohet me dërgimin e Pejgamberëve të Zotit, e as me mu'xhize e ajete, madje edhe kalimi i tyre në Xhehennem nuk është mjaft i bindshëm që t'u kthehen të vërtetës.

Andaj banimi i tyre në Xhehennem është mëshirë. Për disa njerëz kjo është e vetmja mënyrë për të kuptuar.

Zoti është gjithnjë i mëshirshëm, madje edhe në Xhehennem. Prandaj e ka quajtur veten "Er-Rahman", përkatësisht Mëshirues, Mëshirues Absolut në të gjitha situatat edhe për ata që e kanë merituar, e edhe për ata që nuk e kanë merituar këtë mëshirë. Ndaj atyre të cilët e meritojnë mëshirën e Tij, Ai i mëshiron me Xhennet, e ndaj atyre që nuk e meritojnë këtë, Ai i mëshiron me Xhehennem. Xhehennemi, siç shihet, është të kuptuarit për ata të cilët nuk dijnë dhe të cilëve iu ka dështuar çdo mënyrë e paralajmërimit. Kjo është një lloj mëshire. Andaj All-llahu në një ajet thotë: "...Unë e godas me dënimin tim kë dua, ndërsa mëshira Ime përfshinë çdo gjë." (El-A'raf: 156).

Dënimin e Vet, pra, e ka klasifikuar në mëshirën e Vet, e cila përfshinë çdo gjë, ndërsa për llogari thotë si vijon: "Lexoje librin tënd, sot e ke mjaftë që do të japish llogari."

Si duket këtu është fjala për dhënien e llogarisë për vetveten, për ndëshkimin e merituar të vetvetes dhe ballafaqimin me vetveten.

Secilin do ta përcjellë vepra e vet, sikurse hija nga e cila nuk ka shpëtim. Ajo që është thënë gjithsesi do të plotësohet. Drejtësia origjinare do të zbatohet.

Por, këto domethënie humbin gjatë leximit sipërfaqësor dhe gjatë ndaljes në shkronja dhe në fjalët kumbuese.

Fjalët me të cilat Zoti e ka përshkruar Ditën e gjykimit janë fjalë tmerruese, fjalë të cilat kumbojnë dhe jehojnë. Këto fjalë janë: "Es-Sa'atu (momenti, çasti); el-Vaki'a (ndodhia); el-Kari'a (kataklizma); ez-Zelzeletu (tërmeti); ed-Demdemetu (bubullima, gjëmimi); el-Gashijetu (mynxyrë e madhe); er-Raxhifetu (zëri i parë i trumbetës, borisë); er-Radifetu (zëri i dytë i borisë); ez-Zexhretu (parashenja aksidentale); es-Sekretu (mynxyrë shumë e madhe); el-Hakkatu (çasti i paevitueshëm); es-Sahhatu (zëri shurdhues).

A ke dëgjuar për fjalën "es-Sahhatu"?!

Kjo fjalë e shponë daullën e veshit (membranën, timpanin). All-llahu e ka ditur se dikush prej nesh në këtë botë do të jetë i okupuar me epshe dhe lakmira dhe se nuk do të mendojë, e as që do të dëgjojë.

Prandaj e ka përdorur këtë fjalë e cila gati e pëlcet shqisën e të dëgjuarit nga vibracioni i hatashëm, a mos vallë ndoshta do të zgjohemi prej gjumi.

"E kur të arrijë zëri i madh shurdhues, - në Ditën kur njeriu ikën nga vëllai i tij dhe nga nëna e babai i tij." (Abese: 33-35).

Këtë e ka bërë nga mëshira, bamirësia dhe dashuria...

Zoti është larg asaj që të na ndëshkojë dhe dëshirës së madhe për ndëshkim.

Ndëshkimi nuk është asgjë tjetër, pos domosdoshmëri, nevojë. Ky është pasqyrim dhe masë e asaj që njeriu fiton.

Ky është sistematizim i njerëzve sipas kategorive dhe shkallës së vërtetë. Kjo është rënie (mbyllje) e perdes mbi këtë botë, në të cilën njerëzit garojnë në përfitimin e asaj që nuk e meritojnë.

Si shembull i llojllojshmërisë së këtyre kategorive mund të na shërbejë shembulli i nivelit të llojllojshëm të jetës sonë private. Me këtë nuk mendoj në të ardhurat toNe, por në diç më të thellë, në nivelin e vet ekzistencës.

Dikush mund të jetojë në suaza të kërkesave të trupit të tij.

I tërë preokupimi i tij është të hajë, të pijë dhe të flejë. Ai mund t'i shuajë këto kërkesa trupore e njëkohësisht t'u ipet pasioneve, të cilat sillen rreth: zilisë, lakmisë, hidhërimit, ligështisë, dëshirës për dominim, për t'u shquar (dalluar), për prestigj, grumbullimit të kapitalit, pasurive të patundshme dhe lakmisë për pozitë. Shumica e njerëzve nuk ngriten mbi këtë nivel, në të cilin edhe përfundon jeta e tyre. Për ata mendja është vetëm mjet për realizimin e këtyre qëllimeve.

Jeta në raport me këta njerëz është vetëm luftë për ekzistencë. Qëllimi është që të gëlltitet çdo gjë që mund të gëlltitet, të shfrytëzohet çdo gjë që mund të shfrytëzohet. Disa prej tyre do t'i shohish se si luhaten ndërmjet dëshirave porsi batoqët në flakë. Lakmia ata ia dorëzon edhe njërës edhe tjetrës dëshirë dhe gjithnjë e më tepër i kaplon zjarri i aspiratave.

Vetëm një numër i vogël njerëzish zbulon falsitetin (pavërtetësinë) e kësaj jete dhe kupton se mënyra e tillë e jetesës paraqet robëri e jo liri. Kjo i shëmbëllen punës së rëndë e të mundimshme dhe burgut të përjetshëm. Të nënshtruarit instinkteve, të cilat nuk mund të ngopen kurrë, dhe lakmisë, e cila nuk ka të ndalur, nuk kanë kurrfarë domethënie e as vlerë. Sepse të gjitha këto janë kaluese.

Ky grup i vogël njerëzish fillon ta qetësojë këtë thirrje dhe t'i lidhë në pranga pasionet e shqetësuara... Zbulon se këto paraqesin perde pas së cilave fshihet e vërteta dhe se çrregullojnë të konceptuarit dhe të kuptuarit e gjërave.

Në këtë mënyrë ky grup njerëzish ngritet dhe jeton sipas një logjike tjetër. Sipas logjikës e cila jep kurdoherë, e kurrë nuk merrë, e cila dashuron, e nuk urrenë. I tërë angazhimi i këtij grupi është i përqëndruar në të kuptuarit e të vërtetës.

Zemrat e këtyre i përfshinë qetësia. Ndonjërit prej tyre i bie ndër mend e kaluara e tij, derisa ishte rob i epsheve të veta dhe tani ndihet sikur të kishte dalur nga skëterra.

Të tillët vdesin të liruar nga epshet e tyre. Ata e kanë arritur pastërtinë e shpirtit dhe bindjen e fuqishme mbi vërtetësinë e personalitetit të vet.

Trupi, si kategori, është sikundër toka, pasioni kundruall zjarrit ndërsa shpirti kundruall dritës. Këto janë fjalë që shërbejnë vetëm për afrim, por ato na zbulojnë se rrëfimi për kategoritë është rrëfim i vërtetë. Çdonjëri do të ringjallet në kategorinë në të cilën ka vdekur. Kjo është me të vërtetë drejtësi. Ndoshta ndëshkimi do të jetë jashtë asaj që përshkruam ne, nëse epshet lirohen nga mbështjellësi i tyre në këtë botë dhe shndërrohen në nevojë të kulluar, në uri të pastër, në

zjarr absolut dhe në luftë të pafund mes pasioneve të këqija..., përkundër shpirtrave të cilët jetojnë në dashuri dhe në përsiatje për të vërtetën e mbretërisë së Zotit.

Gati se jam i sigurt që fjalët e Kur'anit, të cilat kumbojnë dhe jehojnë kur përshkruajnë Xhehennemin, janë paralajmërim i vërtetë për ndëshkimin çfarë mendja nuk mund ta paramendojë, me të cilin ne do ta ndëshkojmë vetën, sinqerisht dhe drejtësisht, sipas pozitës që kemi merituar me punën tonë.

Paksa nuk e kam vënë dorën mbi të vërtetën, në të cilën nuk ka kurrfarë dyshimi.

Zoti është larg asaj që të ketë dëshirë të madhe të na ndëshkojë. ai është Vërtetësia, Drejtësia dhe Urtësia.

Në lajmet që kanë të bëjnë me Davudin alejhis-selam qëndron se All-llahu xhel-le shanuhu i ka thënë:

"O Davud! Kumtoju banorëve të Tokës se Unë jam mik i atij që është miku Im, bashkëbisedues i atij që rrinë në shoqërinë Time, shok i atij që është shoku Im, i zgjedhur për atë që më ka zgjedhur Mua, i dëgjueshëm ndaj atij që Më është bindur, kush Më kërkon sinqerisht do të Më gjejë, e kush kërkon tjetër kend pos Meje, Mua nuk do të Më gjejë."

Sa shpërblyes i madh është All-llahu i Mëshirshëm - i Cili është ngritur lartë dhunës dhe padrejtësisë!

HALLALLI DHE HARAMI

Ajo që është e ndaluar, harami, sipas Kur'anit, nuk është ndaluar vetëm për hir të ndalesës, por është ndaluar për shkak se është gjë e shëmtuar. Gjithashtu, edhe ajo që është e lejuar, hallalli, sipas Kur'anit, është lejuar për shkak se është gjë e mirë:

"Ua lejon atyre gjërat e mira, e ua ndalon ato të këqijat." (El-A'raf: 157).

Zoti ka ndaluar atë që është e keqe dhe e dëmshme, ndërsa ka lejuar atë që është e mirë dhe e dobishme.

Ai nuk ka urdhëruar vetëm për atë që të ketë pushtet mbi njerëzit, që t'i ndëshkojë ata, apo që t'u bëjë presion.

Dispozitat e Sheriatit i ka sjellur vetëm nga dashuria dhe mirësia e Tij.

Nëse nuk e kuptojmë këtë fakt, atëherë do të bredhim në domethënien sipërfaqësore, e cila është e pafund. E në këtë bredhje do të na ikë edhe vetë thelbi (esenca) i Kur'anit.

Si shembull do t'i marrim këto ajete kur'anore:

"Thuaju besimtarëve që t'i ulin shikimet e tyre..." (En-Nur: 30).

"Dhe thuaju besimtareve që t'i ulin shikimet e tyre..." (En-Nur: 31).

Nëse i marrim këto ajete në domethëniet e tyre sipërfaqësore, duke mos u përpiqur të kuptojmë mesazhin e tyre, do të na duket se ato na kufizojnë pa ndonjë arsye... Si është e mundur që All-

llahu xhel-le shanuhu t'i ketë krijuar sytë e së këndejmi të thotë: mos shikoni. Si është e mundur që Ai ta ketë krijuar bukurinë e pastaj të thotë: ulini shikimet tuaja.

Sikur pak më detajisht t'i shqyrtonim këto ajete, do të zbulonim se ky urdhër është mëshira më e madhe e Zotit dhe ndihma e mbrojtja më e madhe e Tij. Ky është shpëtim i njeriut nga skllavëria dhe prangat, e jo kufizim i tij.

Shikimi është rrugë e cila shpie në mvarësi, e mvarësia është burg. Kur syri shikon fytyrën e bukur, ai bëhet i burgosur, e bashkë me të edhe shpirti. All-llahu dëshiron që ne të jemi të lirë, e të lirë do të jemi vetëm nëse e braktisim bukurinë ndijore dhe shikojmë vetëm në Krijuesin e saj. Në këtë mënyrë shikimi na lartëson gjer tek liria absolute dhe shoqërimi me All-llahun xhel-le shanuhu

Zoti e ka krijuar shpërkëndisjen e kësaj bote vetëm për të na sprovuar.

A do të veprojmë sipas natyrës së shëndoshë e ta drejtojmë shijen tonë të shëndoshë kah bukuria më e madhe që ekziston, kah bukuria e All-llahu xhel-le shanuhu, bukuria e Fytyrës së Tij, apo do t'i qepemi bukurisë ndijore, ta mbyllim vetën në të, e në këtë mënyrë të dëshmojmë devijimin e natyrës sonë dhe zvetënimin e shijes sonë.

Problemi nuk qëndron vetëm në shikimin e fytyrës së bukur...

Ky është shikim pas të cilit shumë shpejtë lind dëshira, pastaj pasioni e më në fund plani se si dhe në ç'mënyrë të kënaqet ky epsh, si të posedohet ajo femër, apo ato gjokse.

Epshet errësojnë mendjen, njeriu humb qëllimin e vet, harron drejtimin e vet, humbet dhe kthehet pas gjokseve të lakuriquar.

Njeriu i tillë tanimë e ka humbur lirinë, pavarësinë dhe është bërë skllav i pasioneve të veta. Ai nuk sheh rrugëdalje nga kjo situatë. Arsyeja e tij është vënë në prangat e pasioneve. Ai humbë kontrollin. Harron punën për të cilën ka ardhur. Këmbët i dridhen dhe nuk di se si t'i kontrollojë ato.

Një gjendje e tillë e rënies e shpie pronarin e vet gjer tek procesverbali policor për moralin publik, apo tek rrëfimi i cili fillon me çaste të ëmbla e mbaron me hajni, apo me marrëdhënie seksuale e cila shpie në spitalin për shërimin e sëmundjeve venerike.

Mesazhi i këtyre ajeteve kur'anore është i qartë, për sa i përket këtij lloji të shikimit. Shija e shëndoshë nga vet natyra i largohet shikimit të tillë.

Këtu arrijmë mu në thelb të ndalesës: E ndaluara përherë është e dëmshme.

Zoti i ka sjellur dispozitat e Veta nga dashuria dhe nga mëshira, e jo nga dëshira për dominim.

Prej këtu del se është e domosdoshme të ulet shikimi në mënyrë që të evitohet dëmi dhe pasojat dhe të mbrohet dobësia e ndërlikuar natyrore që gjendet brenda në trupin tonë.

Të ulurit e shikimit nuk është vetëm për shkak lakuriqësisë së trupit, por shikimin, gjithashtu, duhet ulur edhe kur është fjala për pasurinë e tjetërkujt, kur është fjala për mirëqenien e tyre. Turpi dhe dinjiteti nuk i lejojnë njeriut të zbresë në nivel të ziliqarit, smirëziut dhe grykësit.

Ndër mëkatet më të mëdha tek All-llahu xhel-le shanuhu, bënë pjesë egoizmi, dashuria e tepruar ndaj të gjitha atyre gjërave nga të cilat lind diskriminimi, racizmi dhe shovinizmi.

Njeriu me botëkuptime të tilla, e adhuron vetëm veten, vetëm mendimin e vet të kufizuar dhe ai, në përputhshmëri me këtë i takon idhujtarëve.

Qëllimi i fesë është të kapërcesh personalitetin tënd, mos ta trajtosh atë, t'i zaptosh epshet tuaja, të lirohesh nga lakmia dhe gjakimet, xhelozia dhe madhështia. Këto janë pranga. Feja përpiqet të të lirojë nga robëria e këtyre prangave.

Ndër veprat e ndaluara më e urrejtura tek All-llahu xhel-le shanuhu është shirku (t'i përshkruhet shok All-llahut), apo adhurimi i dikujt tjetër pos Tij.

Shirk nuk është vetëm të adhuruarit e idhujve. Ky lloj adhurimi naiv është vjetëruar dhe është zhdukur thuajse tërësisht. Sot idhujt nuk janë Lati, Uzati dhe Hubeli, por diç tjetër.

Idhujt e sotëm janë diç abstrakte. Ata adhurohen në çdo vend. Të adhuruarit e pasioneve, interesave si dhe adhurimi i mendimit personal, janë idhujt e sotëm, të cilëve u përulen shumë njerëz.

"A e ke parë atë, që epshin e vet e ka marrë për zot të vetin..." (El-Xhathije: 23).

Ky është zoti i sotëm të cilit i flijohen kurbaNe.

T'i kthehemi hallallit dhe haramit e të pyesim: e, çka ka të keqe në atë që njeriu adhuron epshin e vet dhe shikon vetëm interesin e vet?

E keqja këtu duket më se e qartë. Jetën e këtij njeriu dhe njerëzve të ngjashëm me të, nuk mund ta quajmë jetë. Ai jetën e vet do ta kalojë në burg të ndërtuar nga pasqyrat. Kurdoherë që shikon në mur, gjithnjë do ta shohë vetëm figurën e vet.

Ai do të gënjejë, do të vjedhë, do të vretë dhe do të shfrytëzojë (eksploatojë). Ankimet dhe vajtimet e të tjerëve nuk do të arrijnë gjer tek veshët e tij, sepse ai e sheh vetëm veten e vet, interesin e vet dhe pasurinë e vet.

Personaliteti i vet atëherë do t'i bëhet pengesë mes tij dhe All-llahut xhel-le shanuhu, mes tij dhe të vërtetës, mes tij dhe drejtësisë.

Për njerëz të tillë Kur'ani thotë:

"Dhe Ne, vumë pendë para tyre dhe prapa tyre dhe në sytë e tyre vumë perde - andaj ata nuk shohin." (Ja Sin: 9).

E kjo pendë (zdatk) para teje dhe prapa teje, kjo bllokadë, nuk është asgjë tjetër pos epshi yt.

Në një ajet tjetër All-llahu xhel-le shanuhu thotë:

"E ai nuk mundi ta kapërcejë këtë pengesë. E, ç'mendon ti, ç'është pengesa? - të lirohet robi nga robëria." (El-Beled: 11-13).

All-llahu të thotë: "E, ç'mendon ti, ç'është pengesa?" në mënyrë që të të nxitë të mendosh për këtë pengesë, e cila për ty është e paqartë. Kjo pengesë është epshi yt. Para teje nuk ekziston kurrfarë pengese, pos epshit tënd, të cilin duhet ta zaptosh në mënyrë që të bësh ndonjë bamirësi, ta lirosh ndonjë person nga shfrytëzimi (eksploatimi) dhe robërimi, e këtë do ta arrish vetëm nëse

ia del ta lirosh veten nga këto pranga... Kurrë nuk do të arrish ta lirosh dike para se ta lirosh vetveten. Pastaj do të shohësh se çfarëdo bamirësie është e mundur... Atëherë do të arrish të dashurosh dhe të ndihmosh.

Prandaj All-llahu xhel-le shanuhu thotë në Kur'an:

"All-llahu, me të vërtetë, ka blerë nga besimtarët e Vet jetën e tyre dhe pasuritë e tyre, për t'iu dhuruar Xhennetin..." (Et-Teube: 111).

"...Dhe mbytni epshet tuaja. Kjo është më mirë për ju tek krijuesi juaj." (El-Bekare: 54).

Në kuptim të: zaptoni epshin tuaj dhe triumfoni mbi të.

Në Inxhil Isai alejhis-selam në kuptim të njëjtë thotë:

"Kush dëshiron ta ruaj jetën e vet, do ta humbë at, e kush e humb jetën e vet për shkak timin, do ta gjejë atë. Çfarë dobie ka njeriu nëse e fiton të tërë botën e e humb jetën e vet." (Ungjilli sipas Matejit-16, 25-26).

E All-llahu xhel-le shanuhu i thotë Davudit alejhis-selam:

"Shkatërroje epshin tënd. Do të jesh i denjë për dashurinë Time vetëm nëse je armik i pasioneve tuaja... Më vë para veti dhe më shiko me shikim të zemrës sate. Dije se çdo rob, i cili u dorëzohet pasioneve të veta, Unë ua lë atyre dhe kështu ato e shkatërrojnë atë."

Davudi e pyet Zotin e vet: "O Zoti im, si të arrijë te Ti?" - "Lëri epshet tuaja dhe eja tek Unë."

Ndërsa Musait alejhis-selam All-llahu xh.sh i thotë:

"Zbathi këpucët tuaja, se ti, me të vërtetë, gjendesh në luginën e shenjtë - të Tuvasë." (Ta Ha: 12)

Në praninë e Zotit është e mundur të jihet vetëm nëse eliminohen epshet dhe trupi, dhe pas eleminimit të preokupimit ndaj epshit dhe trupit - që është kusht për të arritur në praninë e mbretërisë së Zotit.

Për këtë shkak ky shirk i fshehur, të cilin njeriu e zbaton me adhurimin e epsheve të veta, është mëkati më i madh dhe kufiri i çdo gjëje që është e ndaluar, sepse në vete përmbanë çdo mëkat tjetër dhe se paraqet shkatërrim pas të cilit më nuk ka shkatërrim.

Çdo gjë që adhurohet pos All-llahu xhel-le shanuhu është shirk... Nëse je skllav i epsheve tuaja, atëherë je mushrik, idhujtar. Gjithashtu je idhujtar edhe nëse je skllav i pasionit ndaj familjes, fisit, racës apo kombit. Nëse të ka okupuar ndonjë ide, e cila i ka çrregulluar mendimet tuaja dhe për shkak të cilës nuk dëshiron të diskutosh për çfarëdo ideje tjetër, atëherë ti je gjunjëzuar para idhullit pa marrë parasysh se ai është diç abstrakt dhe se është i skalitur nga filozofia, e jo nga materia.

Prandaj Kur'ani e konsideron shirkun si mëkat i cili assesi nuk falet, sepse ai është verbërues si për sy ashtu edhe për zemër. Ai i paralizon të gjitha shqisat, ndërpren zhvillimin e shpirtit dhe i pengon (shpirtit) në rrugën kah burimi i dritës së tij.

"All-llahu, me të vërtetë, nuk e falë atë që i bën shok Atij, por ia falë të tjerat mëkate kujt të dojë, përveç këtij. (En-Nisa: 48).

Shirku vërtet është sikundër fijet e kërthizës, të cilat kur të prehen, ndërpritet lidhja mes foshnjës dhe burimit të jetës së saj. Kështu edhe me shirk ndërprehet lidhja mes njeriut dhe All-llahu xhel-le shanuhu

Çka do të ndodhte për shembull sikur luledielli ta braktiste Diellin, sikur t'ia kthente atij shpinën e t'i drejtohej Hënës? Thjesht, do të vdiste, sepse Dielli është burim i jetës së tij. Luledielli nuk kthehet kah Dielli nga poshtërimi, por për arsye se ai është burim i jetës së tij. Ibadeti (adhurimi) është jeta dhe furnizimi.

Zoti e ka urdhëruar ibadetin sepse e ka ditur se në ibadet është jeta jonë. Ai nuk e ka urdhëruar këtë vetëm për të urdhëruar, e as për atë që të ketë sundim të pakufishëm mbi njerëzit.

E ka ndaluar bixhozin, sepse bixhozi shpie në armiqësi, katastrofë dhe urrejtje.

E ka ndaluar prostitucionin, sepse ky paraqet anarki ku vjenë gjer tek çrregullimi gjenealogjik dhe për atë se në të shpirtrat i nënshtrohen epsheve.

E ka lejuar martesën, sepse martesa është institucion, përgjegjësi dhe qetësim i zemrës.

E ka ndaluar mishin e derrit. Zoti është intelekt universal i gjithmbarshëm, dhe Ai nuk ka sjellur kurrnjë dispozitë pa arsye.

Zoti ka caktuar Sheriatin, ka ndaluar çdo gjë të keqe, ka lejuar çdo gjë të mirë dhe ka urdhëruar ibadetin vetëm nga dashuria dhe mëshira e Vet.

Këtë fakt nuk guxojmë ta harrojmë asnjë çast. Ky është shpirti i Ligjit dhe zemra e Sheriatit.

Për këtë shkak Zoti ka ndaluar hajninë dhe vrasjen.

"...Nëse dikush mbyt dikë, i cili nuk ka mbytur askënd, ose atë që nuk ka bërë çrregullim në Tokë - është sikur t'i mbyste të gjithë njerëzit, e nëse dikush bëhet shkaktar që të shpëtojë jeta e dikujt - është sikur t'ua shpëtonte jetën të gjithë njerëzve." (El-Maide: 32).

Sepse të mbytet njeriu, i cili nuk ka bërë kurrfarë delikti, me të vërtetë paraqet shkelje të të gjitha ligjeve, andaj All-llahu xhel-le shanuhu njeriun e tillë e konsideron si vrasës të të gjithë njerëzve.

E ka ndaluar vetëvrasjen.

"...Mos vritni vetveten (dhe njëri tjetrin)! All-llahu, me të vërtetë është mëshirues për ju. Ai që e bënë këtë me përdhunë dhe padrejtësi, Ne do ta hedhim në zjarr..." (En-Nisa: 29-30), sepse vetëvrasja paraqet mendim tejet të keq mbi Zotin dhe humbje shprese në mëshirën e Tij, zhgënjim ndaj drejtësisë së Tij, shkelje e Ligjit të Tij dhe injorim i botës tjetër. E, kjo është dhunë në raport me shpirtin.

"...që mendojnë keq për All-llahun - e vallja e fatkeqësisë le t'i godet ata! All-llahu është pezmatuar në ta dhe i ka mallkuar ata dhe u ka përgatitur atyre Xhehenemin, e sa vend i shëmtuar që është ai!" (El-Fet'h: 6).

Zoti e ka ndaluar prostitucionin, sepse prostitucioni është i dëmshëm.

Këtu do të njoftohemi me mendimin e lirë dhe modern parizian, i cili në prostitucion nuk sheh kurrfarë dëmi.

Ku qëndron dëmi nëse dy persona edhe nëse nuk janë bashkëshort ndërrojnë dashuri, vullnetarisht, pas derës së mbyllur dhe larg syve të huaj. Atë që bëjnë, e bëjnë nga dashuria. Me sjelljet e veta nuk e ofendojnë askendin. Atëherë ku qëndron këtu ajo e dëmshmja?

Të njëjtën gjë do ta thonin edhe atë të cilët vendosen për homoseksualizëm. Ne e bëjmë këtë nga dashuria dhe nga kënaqësia. Me këtë ne askujt nuk i sjellim dëm, e as që e ofendojmë dikend.

Për të kuptuar dëmin e kësaj, është nevoja që dashuria dhe seksi të kuptohen në suazat natyrale të tyre.

Nëse i marrim parasysh ligjet e Gjithësisë dhe në mënyrë të tërësishme e rrahim çështjen, atëherë del se çoroditja është e njëjtë në të dy rastet. Në të dy rastet kemi shmangien e fuqisë natyrore nga qëllimi i saj. Dallimi është vetëm në shkallën e neverisë... në shkallën e kontrastit me ligjet natyrore të dashuruarëve. Edhe njëri edhe tjetri pohojnë se janë të sinqertë ndaj vetvetes, e në realitet, që të dy janë të pasinqertë ndaj vetvetes.

Sinqeriteti i njeriut ndaj vetvetes arrihet vetëm atëherë kur sinqeriteti është i harmonizuar me natyrën.

Për të qenë i sinqertë ndaj vetvetes, njeriu, me të vërtetë, duhet të jetë i sinqertë edhe me natyrën e vet sikurse edhe me ligjet e Gjithësisë. Në të kundërtën, do të jetë i ndarë, nga një anë në trup, e nga ana tjetër në shpirt.

Ajo që sinqerisht e dashuron njeriun kurrë nuk do të thotë: dua të bie me ty, por do të thotë: dua ta kaloj tërë jetën me ty. Dua të bëhesh baba i fëmijëve të mij, kulm i shtëpisë sime, mburrje i emrit tim dhe shok, bashkudhëtar në rrugën e jetës sime!

Nëse nuk vepron kështu, atëherë ajo e gënjen vetveten... Ajo gabon përkundër asaj që i thotë vetvetes se është Gjulijetë. Bile gabon edhe ajo e cila tërë nderin e shet për një kafshatë goje e këtë e arsyeton me uri, sikundër që gabon edhe ajo e cila keqpërdor atë më të çmueshmen që i ka dhuruar natyra, pa kurrfarë arsye, pos për shkak të epshit dhe kënaqësisë kaluese. Edhe kjo cytje e flaktë, e cila, kohë pas kohe, kërkon ndonjë mjet qetësimi, nën pretekstin e dashurisë, është gënjeshtër, sepse dashuria e vërtetë e femrës kërkon njeriun i cili do të jetë baba i fëmijëve të saj dhe kulm i shtëpisë së saj, e jo ilaç i përkohshëm i cytjes së saj.

Nëse prostitucioni kalon në shprehi dhe bëhet qëllim jetësor, atëherë ai shpie në rrënimin e tërësishëm të natyrës së njeriut dhe personalitetit të tij... Trupi në një anë, zemra në të dytën e shpirti në anën e tretë. Kështu shkatërrohet dhe rrënohet natyra, e ky është dëm shumë i madh. Prandaj edhe lexojmë nëpër statistika se përqindja më e madhe e vetëvrasjeve ndodhin në Suedi, përkundër faktit se atje seksit dhe kënaqësive seksuale u është dhënë liri e plotë. Shkaku i gjendjes së këtillë është shkatërrimi, i cili ndodhë në vet brendinë e shpirtit të njeriut, për çka edhe e humb qetësinë e brendshme përgjithmonë.

Nga e tërë kjo del se dispozitat fetare janë sjellur me plotë arsye, nga dashuria dhe mëshira ndaj njeriut, e jo për shkak të dëshirës së Zotit për dominim.

Feja e ka ndaluar martesën mes vëllezërve e motrave, mes nënës dhe të birit, mes babait dhe të bijes, sepse feja pretendon që në familje të zhvillohen edhe tjera ndjenja... si amësia, atësia etj.

Zoti ia ka bërë njeriut të neveritshme të gjitha ato gjëra që me të vërtetë janë të papëlqyeshme, e të dashura të gjitha ato gjëra që me të vërtetë janë të pëlqyeshme.

Andaj edhe shkurorëzimin e ka bërë të neveritshëm, por edhe të mundshëm nëse jeta nën kurorë bëhet e padurueshme.

Gënjeshtrën e ka bërë mëkat të madh:

"O sa e neveritshme është te All-llahu të thoni atë që nuk e punoni!" (Es-Saff: 3).

Përgënjeshtrimi i All-llahut është mëkati më i madh:

"Kush është më mizor se ai i cili trillon gënjeshtra për All-llahun ose përgënjeshtron argumentet e Tij?" (El-En'am: 21).

Të paraqiturit si pejgamber është gënjeshtër. Modifikimi (ndërrimi) i Librave të shpallura është haram, rreptësisht i ndaluar, sepse është i dëmshëm dhe se njerëzit i shpie në lajthitje.

Ky është Sheriati dhe ky është shpirti i tij. Zoti ka lejuar të mirën, ndërsa ka ndaluar të keqën. Nëse e pastrojmë natyrën tonë, atëherë do t'i dëshirojmë vetit atë që edhe Zoti na dëshiron, pa vështirësi të madhe apo ndonjë mundim.

Në këtë mënyrë në zemrën e besimtarit do të asgjësohet kontrasti mes dispozitave të Zotit dhe asaj që njeriu pretendon me ndjenja dhe me mendje. Ajo që njeriu i dëshiron vetes, bëhet mu ajo që dëshiron All-llahu xhel-le shanuhu Prandaj Ibrahimi alejhis-selam i është lutur Zotit me këto fjalë:

"O Zoti im, bën që unë ta kryej përherë namazin, e edhe ata nga pasardhësit e mi..." (Ibrahim: 40).

Prej Zotit ka kërkuar atë që Zoti kërkon prej tij.

Ky është qëllimi i imanit dhe bindjes, dhe besnikëri e përpiktë ndaj Sheriatit. Në këtë mënyrë Sheriati dhe dëshira e njeriut bëhen një.

Njeriu dëshiron vetëm atë që dëshiron Zoti.

Ky është shtegu i atyre të cilët kanë arritur qëllimin.

Në një hadith kudsij All-llahu xhel-le shanuhu thotë: "O robi im! Bëhu i dëgjueshëm (i bindur) ndaj Meje, e Unë do të bëj ty të hyjnishëm. Dora jote do të jetë dora Ime, gjuha jote do të jetë gjuha Ime, shikimi yt do të jetë shikimi Im, aspirata jote do të jetë aspirata Ime dhe dëshira jote do të jetë dëshira Ime."

Këta janë Pejgamberët e All-llahut, evliatë dhe njerëzit e zgjedhur, të cilëve All-llahu xhel-le shanuhu u ka dhënë më tepër nga dituria e Vet dhe fuqia e Vet.

TEORIA DHE PRAKTIKA

Ikre (lexo, mëso) është fjala e parë që ka zbritur nga Kur'ani. "Lexo në emër të Zotit tënd i Cili ka krijuar të gjitha!" Ky është urdhëri i parë i Zotit që është shpallur në Islam. Me këtë All-llahu xhel-le shanuhu i ka urdhëruar çdo njeriu që të mësojë dhe të lexojë, dhe atë para urdhërit që ka të bëj me namaz, agjërim dhe dispozitave të tjera të Sheriatit. Para të gjitha këtyre All-llahu xhel-le shanuhu ka thënë "Ikre!"

Prej të gjitha Librave të shpallura nga Zoti, Kur'ani dallon me atë që shpallja e tij ka filluar me këtë fjalë dhe me këtë urdhër... Ky është nderimi më i madh për shkencën dhe shkencëtarët, që fjala e parë e një feje të shpallur nga Zoti të jetë urdhëri për të lexuar dhe për të kërkuar dituri... Më tutje ajeti cakton më afërsisht se për çfarë diturie është fjala, e thotë:

"Lexo në emër të Zotit tënd i Cili ka krijuar të gjitha!" (El-Alak: 1).

Kjo është dituri në emër të All-llahu xhel-le shanuhu, dituri e cila do të sjellë dobi e jo dëm.

Pastaj kanë pasuar ajetet tjera, që kanë të bëjnë me diturinë dhe që nxisin në kërkimin e saj:

"...Dhe thuaj: "O Zoti im, shtoma dijeninë mua! (Ta Ha: 114).

"Thuaj: "A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?" (Ez-Zumer:9).

"All-llahu dëshmon se nuk ka zot tjetër pos Tij, - por edhe engjëjt, e të diturit (e dëshmojnë këtë)." (Ali Imran: 18).

Kështu All-llahu xhel-le shanuhu i ka bërë njerëzit e ditur të afërt për Vete, siç janë edhe engjëjt, duke marrë parasysh vlerën e shehadetit (dëshmisë) së tyre. Kjo është gjëja më madhështore që dëshiron ta arrijë njeriu, që emri i tij të përmendet së bashku me All-llahun dhe me engjëjt.

Vetë fjala dituri dhe derivatet e saj janë përmendur në Kur'an mbi 850 vende.

All-llahu xhel-le shanuhu betohet në pendë dhe në atë që shkruajnë ato:

"Nun. Pasha pendën dhe në atë që shkruajnë ato." (El-Kalem: 1)

Duke qenë se urdhëri i parë në Kur'an i përket leximit dhe mësimit, atëherë xhahili i cili nuk lexon, sado që ai falet, agjëron, bën dhikër etj. nuk ka të drejtë të thotë se i përket fesë islame.

Por kjo dituri, të cilën Kur'ani e favorizon, nuk është vetëm shpjegim i hollësishëm, diskutim detaj, por është e lidhur ngusht edhe me praktikë.

"Dhe thuaj: "Punoni *(përpiquni)*! All-llahu do ta shohë punën tuaj, por edhe Pejgamberi i Tij edhe besimtarët." (Et-Teube: 105).

Në çdo vend ku Kur'ani flet për "ata që besojnë", këtë besim e ndërlidhë me praktikë e thotë: "Ata të cilët besojnë dhe bëjnë vepra të mira."

Me dhjeta ajete kur'anore përmendin teorinë dhe praktikën së bashku dhe janë të pandara njëra prej tjetrës.

Qëllimi i kësaj përsëritjeje është që të dëshmohet se nuk ka besim pa praktikë, nuk ka besim pa vepra. Ajo është dëshmi e dëgjueshmërisë së atij që është i dëgjueshëm, i bujarisë së atij që është bujar dhe mirësisë së mirëbërësit.

Sot bota islame, me përtacinë dhe paditurinë e vet, mohon një faktor shumë të rëndësishëm të Islamit. Myslimanët e lindjes nuk lexojnë, nuk mësojnë e as që punojnë. Në vend të punës, shkencës dhe diturisë janë dhënë pas injorancës dhe përtacisë.

Çdonjëri prej tyre mendon se do të shkojë në Xhennet vetëm se e ka emrin Muhammed, se është mysliman sipas trashëgimit familjar dhe se posedon Kur'anin. E, harron se fjala e parë e Kur'anit, të cilin e posedon ai, është "Ikre" (lexo, mëso), e së këndejmi as që lexon e as që mëson.

All-llahu xhel-le shanuhu thotë: "Punoni *(përpiquni)*! All-llahu do ta shohë punën tuaj." E ata nuk punojnë (nuk përpiqen), por kohën e kalojnë nëpër kafene duke hapur gojën (gogësitur).

Bota perëndimore evropiane me punën, shkencën dhe aktivitetet e veta është më afër esencës së Islamit dhe të Kur'anit sesa kjo botë e mjerë lindore arabe, e cila është zhytur në injorancë gjer në vesh.

Ne duhet ta kuptojmë Kur'anin para se të themi se jemi pjesëtar të tij.

Kur ata, të cilët injorancën dhe përtacinë e tyre e veshin me rroba të stolisura të tesavvufit thonë - përderisa simpatizojnë vetminë (veçimin) dhe përsiatjen e zbrazët dhe shterpe - ne jemi mistik, atëherë harrojnë se shpërngulja e mistikëve tek All-llahu xhel-le shanuhu mund të realizohet vetëm me dituri dhe me punë, respektivisht, me teori dhe praktikë. Mistiku së pari duhet të kërkojë dituri, e kur ta realizojë këtë, atëherë duhet edhe të veprojë sipas saj. Kur teorinë e zbaton në praktikë, e realizon në vepër, atëherë kalon nga një gjendje në gjendje tjetër. Nëse në këtë gjendje qëndron një kohë më të gjatë dhe ngulmon në punë, atëherë nga kjo gjendje kalon në gjendje tjetër më të lartë. Këto janë fazat nëpër të cilat kalon mistiku, janë shkallët përmes të cilave i afrohet Zotit. Mistikët e parë kanë qenë ushtarët. Ata kanë bartur armë dhe e kanë mbrojtur atdheun e tyre. Në njërën dorë e kanë pasur Kur'anin e në tjetrën armën.

Afrika Veriore është përplot me varre të dervishëve, të cilët janë vrarë duke luftuar gjer në predhën e fundit për ta mbrojtur atdheun e tyre.

Guximi, energjia, lufta për të vërtetën, për drejtësinë mes njerëzve, lufta kundër eksploatimit, ndihmat ndaj të dobëtve etj., paraqesin thelbin e fesë, madje edhe vetë fenë.

Prandaj, ai i cili me pasivitet sjellet ndaj gjërave të lartpërmendura nuk mund të jetë besimtar i vërtetë. Por, në vend të parë gjithnjë ka qenë dituria.

Lexo, që së pari të mundesh ta dallosh të vërtetën nga e pavërteta, që t'i njohish ligjet e popujve në mjedisin e të cilëve jeton para se të vërtetohesh se je në gjendje t'i reformosh ato.

Kur na fton Kur'ani në lexim dhe në njohuri, atëherë na njofton edhe me metodën se si dhe në ç'mënyrë të arrijmë tek dituria. Kjo metodë sipas Kur'anit përbëhet në "udhëtime dhe vështrime".

"Thuaj: "Udhëtoni nëpër botë dhe shikoni se si ka zënë fillin të krijuarit..." (El-Ankebut: 20).

Ky është metos (metodë) induktiv[1] me të cilin na ka njoftuar Bekoni një mija e ca vjet pasë Kur'anit.

Me këtë metodë, duke iu falënderuar shkencëtarëve perëndimor, është realizuar e tërë ajo që lexojmë dhe që shohim nga fusha shkencore dhe industriale. Sikur të përpiqeshim ta kuptonim Kur'anin dhe t'i ndjeknim udhëzimet e tij, atëherë vërtetë do të ishim paraardhës të shkencëtarëve evropian në këto dituri.

Një numër i vogël i shkencëtarëve arabë në periudhën e parë të Islamit, gjatë punës së tyre, kanë përdorur metodën induktive.

Me punën e tyre hulumtuese ata e kanë pasuruar kulturën perëndimore në kohën kur Perëndimi ka qenë i zhytur në errësirat e shekullit të mesëm (mesjetës).

---

[1] Metoda induktive: mënyra e mendimit me të cilën arrihet, në bazë të soditjes, gjer tek të vërtetat mbi realitetin kohor-hapësinor (sh.p).

Të përmendim vetëm Xhabir Ibni Hajjanin nga lëmi i kimisë, Ibni Sinaain nga lëmi i mjekësisë, Ibni Rushdin nga lëmi i filozofisë, Ibni Arabiun nga lëmi i tesavvufit, Ibni Hejsemin nga lëmi i shkencave matematikore...

Gjithashtu t'i përmendim edhe Andoluzianët dhe krijimtarinë e tyre nga lëmi i muzikës dhe muveshshehut.[2]

Të përmendim astronomët arabë. Shumë yje edhe sot në burimet perëndimore mbajnë emra arabë.

Fjala "Alembik", me të cilën Xhabir Ibni Hajjani e ka quajtur aparatin për destilim, edhe sot është në përdorim e sipër në gjuhën franceze ambique. Folja ambiquer është derivat nga kjo fjalë.

Numrat decimal në matematikë, evropianët i kanë njohur përmes Arabëve. Asokohe, pra, ka qenë e përfaqësuar edhe teoria edhe praktika.

Atje ku ekziston teoria dhe praktika, ekziston edhe kultura. Kur'ani e ka dhënë çelësin e kësaj kulture.

"Ikre" - lexo!

Këtë e ka bërë me shkronjat e para të cilat janë shpallur. Me shpalljen e parë që i ka zbritur Muhammedit alejhis-selam dhe ummetit të tij. Kush nuk lexon e humb të drejtën e përkatësisë të këtij ummeti. Ai nuk mund ta quan veten bartës të Kur'anit dhe të të kuptuarit të tij.

---

[2] Muveshsheh: poezia postklasike strofike arabe me rimë të ndryshme.

Ai i cili posedon dituri teorike e nuk e zbaton atë në praktikë, ai është i privuar nga autoriteti dhe nga feja.

Për Ibrahimin alejhis-selam, kur e ka ndërtuar Ka'ben, Kur'ani thotë:

"*(Dhe kujtoje atë kohë)* kur Ibrahimi dhe Ismaili i ngritnin themelet e Ka'bes, ata luteshin: "O Zoti ynë! Prano prej nesh *(këtë vepër)*! Me të vërtetë Ti je Ai, që i dëgjon të gjitha dhe që të gjitha i di! (El-Bekare: 127).

Mendja projekton, dora ndërton, e zemra pështpërit: "O Zoti ynë! Prano prej nesh *(këtë vepër)*! Me të vërtetë Ti je Ai, që i dëgjon të gjitha dhe që të gjitha i di!

Dituria, puNe, imani dhe ngritja!

Kur'ani për besimtarët punëtorë, flet me fjalë më të bukura:

"E, me të vërtetë, ata që besojnë dhe punojnë vepra të mira - ata janë krijesat më të mira. (El-Bejjineh: 7).

"E, kush flet më bukur se ai që thërret te All-llahu, dhe bënë vepra të mira." (Fussilet: 33).

Dhe vërteton se veprat ruhen dhe shkruhen, dhe se Zoti në Ditën e gjykimit do të na ballafaqojë me veprat toNe.

"...Dhe çfarëdo pune që bëni ju, Ne vigjilojmë mbi ju..." (Junus: 61).

"Atë ditë kur secili njeri e gjenë para vetes se ç'ka ka punuar mirë dhe ç'ka ka bërë keq - do të dëshirojë që ndërmjet tyre dhe atij të ketë distancë të madhe..." (Ali Imran: 30).

"...Ja, kështu All-llahu do t'ua tregojë atyre veprat e tyre të kobshme për ta..." (El-Bekare: 167).

..."Dhe të gjejnë të shënuar atë që kanë punuar. Zoti yt askujt nuk do t'i bëjë padrejtësi." (El-Kehf: 49).

Dhe vërteton se kjo botë është i vetmi rast që të arrihen vepra të mira. Ky është i vetmi provim, pas të cilit më nuk ka provime. Për banorët e Xhehennemit thotë:

"Ata, në të, do të thërrasin (duke bërtitur): "O Zoti ynë, nxirrna (prej zjarrit), do të bëjmë vepra të mira, e jo asosh çfarë kemi bërë." (Fatir: 37). Ata do të flasin kështu, por me vonesë.

"Jo! Jo! Por atyre iu doli ajo, që më parë e fshihnin, sikur ata të ktheheshin, prapë do të bënin ato që u ishin ndaluar. Ata, me të vërtetë, janë gënjeshtarë." (El-En'am: 28).

Tani puna ka mbaruar dhe më nuk ka ndjesë.

Kur'ani vërteton se qëllimi, sado i mirë të jetë ai, i cili nuk shpie në punë nuk është i mjaftueshëm të jetë dëshmitar për besimin e njeriut.

Vetëm dëshira për xhihad nuk është e mjaftueshme, por xhihadi në vepër ku njeriu do të jetë i ballafaquar me vështirësitë, të cilat do t'i përballojë me durim... i ballafaquar me vdekjen, para së cilës do të qëndrojë me vetëmohim:

"A mendoni se do të hyni në Xhennet e All-llahut të mos u tregojë juve për ata që kanë luftuar dhe për ata që kanë duruar." (Ali Imran: 142).

Qëllimi, i cili nuk shndërrohet në vepër, është qëllim të cilit i mungon sinqeriteti.

Ky është më tepër pretendim arbitrar mes njeriut dhe vetëdijes së tij, sesa dëshirë e vërtetë, e cila sikur t'ishte e vërtetë do të nxistte në vepër.

All-llahu xhel-le shanuhu thotë se jetën në këtë botë e ka krijuar vetëm për këtë shkak.

"Ai i Cili ka krijuar jetën dhe vdekjen, për t'ju provuar se kush prej jush do të veprojë më mirë." (El-Mulk: 2).

Jetën e ka bërë provim i cili tregon se kush ka punuar, e kush nuk ka punuar... e ka bërë eksperiment si tregues të vendit dhe vlerës të çdo individi, dhe kur në Ditën e gjykimit do të realizohet (plotësohet) Fjala e Zotit ndaj tyre, ajo do të jetë drejtësi absolute.

Kur'ani thotë: "O besimtarë! Kini frikë All-llahun dhe përpiquni që T'i afroheni Atij me vepra të mira, dhe luftoni në rrugën e Tij për të shpëtuar." (El-Maide: 35).

Të afruarit All-llahut është i mundur vetëm me punë.

Pejgamberi ynë dhe shembëlltyra jonë, Muhammedi alejhis-selam nuk ka qenë vetëm kumtues i Shpalljes së Zotit, vetëm bartës i Kur'anit dhe misionar, por ka qenë edhe punëtor i madh. Ndër të parët është nisur në luftë me shpatë në dorë, si udhëheqës i ushtrisë myslimane. Ka qenë i uritur dhe i etshëm atëherë kur edhe bashkëluftëtarët e tij kanë qenë të uritur dhe të etshëm. Ka qenë i pari kur është dashur të vërsulej në pozitat e armikut. Në një betejë ka qenë i plagosur. Ka marrë pjesë në njëzet e tri beteja, derisa ishte në moshën pesëdhjetë vjeç.

Ai është Pejgamber, kumtues i Shpalljes, luftëtar, udhëheqës ushtarak dhe politikan. Ai është i sinqert dhe besnik. Ai është babë, burrë dhe mik.

Ai është simbol i punës së palodhshme.

Ai është udhëheqës i çdonjërit që dëshiron të arrijë atje ku mund të arrihet vetëm me punë, dhe ku rruga kah Zoti është e mundur vetëm me shkallë punuese.

EMRAT E ZOTIT

Është e pamundur të konceptohet qenia e All-llahu xhel-le shanuhu dhe të hyhet në esencën e Tij... Është e pamundur të shihet All-llahu xhel-le shanuhu me sytë njerëzor, sepse syri i njeriut pranon vetëm atë që është e kufizuar me hapësirë dhe kohë... All-llahu xhel-le shanuhu është mbi hapësirën dhe kohën... Atij kurrgjë nuk i shëmbëllen...

Në ajetet e harmonizuara në mënyrë të mrekullueshme Kur'ani tregon për këtë fakt të stërlashtë:

"Ai i di gjërat e dukshme dhe të padukshme, Ai është i Madhërishmi dhe i Lartësuari." (Er-Ra'd: 9).

"Ata diskutojnë për All-llahun, e Ai mundet çdo gjë." (Er-Ra'd: 13).

"Tek Ai gjenden çelësat e të gjitha fshehtësive, dhe vetëm Ai i di ato. Ai i Vetmi e di ç'ka ka në tokë dhe në det, asnjë gjeth nuk bie, pa e ditur Ai, dhe nuk ekziston asnjë kokërr në thellësitë e Tokës, as diçka e freskët e as e thatë, e të mos jetë shënuar në Librin e qartë (Lehvi Mahfudh)." (El-En'am: 59).

"All-llahut i bëjnë sexhde të gjithë ata që gjenden në qiej dhe në Tokë, dashtë e padashtë..." (Er-Ra'd: 15).

Çdo gjë që ekziston i bënë sexhde All-llahut xhel-le shanuhu.. Kush nuk i nënshtrohet Atij me hir, atëherë i nënshtrohet pa hir, sepse çdo gjë qarkullon sipas ligjeve natyrore, sipas ligjeve që i ka caktuar All-llahu xhel-le shanuhu

Zemra e besimtarit, sikurse edhe e jobesimtarit, i nënshtrohet ligjit fiziologjik, të cilin e ka caktuar All-llahu xhel-le shanuhu Edhe njëra edhe tjetra rrahin duke iu nënshtruar vetëm këtij ligji. Dhe çdo qelizë gjithashtu rrahë në çdo trup. Për këtë edhe Kur'ani thotë:

"A mos kërkojnë ata tjetër, përveç fesë së All-llahut? E, Atij i përulen të gjithë ata që gjenden në qiej dhe në Tokë, me dashje ose padashje, dhe tek Ai do të kthehen të gjithë." (Ali Imran: 83).

Çdo gjë i nënshtrohet ligjeve të Zotit, me ndihmën e të cilëve zhvillohet jeta.

Sot ne i njohim shumicën e këtyre ligjeve si për shembull: Ligji i aksionit dhe reaksionit; Ligji i kohezionit të shtyllës së ujit, baraspeshës së elektricitetit dhe jonit në tretës; Ligji i diferencimit kimik mes hormoneve, kështu që njëri prej tyre bëhet vendimtar në raport me tjetrin, dhe shumë ligje të tjera, sipas të cilëve zhvillohet jeta dhe të cilëve u nënshtrohet çdo gjë që ekziston në qiej dhe në Tokë, me dashje apo pa dashje.

All-llahu me ligjet e Tij mbretëron me çdo gjë prej atomit e gjer në kozmos... Duke i falënderuar Atij dhe ligjeve të Tij ekziston jeta.

Ai është El-Kajjum (Ekzistent nga Vetvetja)

Ai është El-Hajju(I Gjalli, në të Cilin është jeta).

Në këtë mënyrë dhe më këtë lavdithurje Kur'ani na prezenton emrat e All-llahu xhel-le shanuhu, atributet e Tij dhe veprat e Tij.

"Ai është All-llahu - s'ka zot tjetër përveç Tij, Sunduesi, i Shenjti, Ai që është pa të meta, Paqedashësi, Ai që çdokujt i jep siguri , Ai që mbikëqyrë të gjitha, i Plotfuqishmi, i Lartmadhërishmi dhe Krenari..." (El-Hashër: 23).

"Ai është All-llahu, Krijuesi, Ai që prej asgjëje krijon, Ai që çdo gjëje ia jep formën, Ai posedon emrat më të bukur..." (El-Hashër: 24).

All-llahu për vetveten folë në vetën e parë shumës: "...Ne jemi ma afër se damari i tij i qafës." (Kaf: 16).

Damari është arterie nëpër të cilën qarkullon gjaku në qafë. Ai na është më afër se vet gjaku në trupin tonë. E kjo do të thotë afërsi jashtëzakonisht e afërt.

Sufistët thonë se Ai është larg të konceptuarit tonë për shkak se Ai është tejet afër, e i fshehtë për shkak se është tejet i dukshëm. Këtë mendim të vetin ata e shpjegojnë me fjalët se dritën e Diellit e kuptojmë vetëm atëherë kur Dielli perëndon... Ngjyrat e sendeve i kuptojmë me anë të dritës, e jo me vet sendet... Ato janë të kaltra, të kuqe dhe të blerta sepse absorbojnë valë të ndryshme të dritës... Me anë të errësirës e kuptojmë dritën... All-llahu xhel-le shanuhu nuk ka antitezë, në mënyrë që përmes saj ta njohim Atë... Drita e Zotit përherë iluminon dhe Ai nuk ka hije... Andaj themi se All-llahu fshehet prej nesh për shkak iluminitetit të Vet tejet të madh dhe për shkak përhershmërisë së Vet.

Ne edhe lindim nën këtë mbrojtje të Tij, por për këtë atëbotë jemi të pavetëdijshëm. Kur rritemi dhe arrijmë moshën madhore - na okupon epshi, pastaj pasuria, pozita dhe dynjallëku, kurse në vitet më të moçme, kur arrijmë moshën e pjekurisë - jemi të okupuar vetëm me mendime. E gjatë tërë kësaj kohe prezenca e Zotit na është gjë e ditur nga të gjithë, ndërsa fenomenet e Zotit në Tokë, në qiej dhe në brendinë tonë bëhen të rëndomta, të zakonshme. Një poet thotë:

Si ta konceptojmë atë që fshehet me konceptim?

Të kapluarit tanë rreth shkaqeve e fshehë nga ne Shkaktarin... si për shembull ai i cili, kur ia dorëzojnë veprën e ndonjë shkrimtari, angazhohet rreth llojit të shkrimit, të ngjyrës dhe letrës, e harron të folurit dhe domethënien e veprës; apo angazhohet me të folurit dhe domethënien, por harron autorin e saj.

Karakteristikë e përhershmërisë është se ajo e fshehë të vërtetën - lëvizja e përhershme e ashensorit e fshehë nga ne lëvizjen e vet. Vetëm atëherë kur ndalet, ne kuptojmë se ka qenë në lëvizje.

Ngjashëm me këtë edhe përhershmëria e Zotit është e fshehur me prezencën e Tij. Afërsia tejet e madhe e Tij, e largon Atë nga të konceptuarit, ndërsa të shfaqurit tejet i madh i Tij, e fsheh Atë. Ai është më i fshehtë se më të fshehtit, sepse Ai është më i dukshmi se më të dukshmit. Është i fshehur nga ne vetëm me perden e fanitjeve toNe... me perden e pasioneve toNe, me çka i kemi mbuluar sytë tanë.

Ibni Ataullah Es-Sekenderi thotë: "Nëse diçka do Ta strehonte Atë, atëherë edhe do Ta fshihte Atë... Nëse Ai do të kishte mbulesë, atëherë edhe ekzistenca e Tij do t'ishte e kufizuar. Zoti është larg asaj që të ekzistojë diç Ta kufizojë dhe Ta pengojë..."

Gjithashtu askush prej nesh nuk e sheh bebëzën e syrit të vet për shkak se na është tejet afër.

Te sufistët Zoti nuk ka nevojë të argumentohet. Tek ata Bota është lëndë dyshimi dhe atë duhet argumentuar. Ata e argumentojnë me Zotin. Bota ekziston me ndihmën e Tij, e jo Ai me ndihmën e Botës. Ata, të cilët e kërkojnë Zotin me ndihmën e argumenteve - ata janë njerëz me perde që e shohin kozmosin e nuk e shohin Krijuesin e kozmosit.

Ibnu Ataullah Es-Sekenderi i bënë vetit pyetje: "E, kur është zhdukur Ai i Cili duhet të argumentohet? Kur është zhdukur Ai që shkaqet e Botës do të duhej të na shpiejnë tek Ai?"

Dëshira e çdo mistiku është që t'i afrohet Zotit nga dashuria, e jo nga frika prej zjarrit apo nga aspiratat për Xhennet. Ata thonë se përherë gjenden në udhëtim e sipër kah All-llahu... prej kozmosit kah Krijuesi i kozmosit. Ky udhëtim nuk është i tillë çfarë e njohim ne në Tokë, udhëtim prej ndonjë vendi në vendin tjetër. Udhëtimi i kësaj bote tek ata është i ngjashëm me sjelljen e gomarit te mulliri, i cili e braktisë një vend në mënyrë që përsëri të kthehet aty. Udhëtimi i vërtetë është udhëtimi prej kësaj bote në mbretërinë qiellore, prej botës së ndjenjave kah bota kuptimlotë.

Sufistët janë njerëz të situatës. Për disa çështja i kanë mendimet e veta origjinale, të cilat posedojnë thellësi, rëndësi dhe dëshmi. Kështu thonë se ngandonjëherë mosdëgjesa është më e mirë së dëgjesa dhe se ekzistojnë mëkate të cilat shpiejnë kah frikërespekti dhe nënshtrimi ndaj

All-llahu xhel-le shanuhu, sikundër që ekzistojnë edhe dëgjesa të cilat shpiejnë ka kryelartësia dhe mendjemadhësia. Në këtë mënyrë ai i cili është i padëgjueshëm bëhet më i afërt për Zotin, se ai i cili është i dëgjueshëm. Ai që e sheh përvujtninë e vet dhe me këtë krenohet, ai që i sheh veprat e veta të mira dhe në to mbështetet - pikëpamja e tij e tillë është argument se këto nuk janë vepra të mira. Veprat e mira ngriten tek All-llahu xhel-le shanuhu menjëherë pas lindjes së tyre. Fjala e bukur ngritet tek All-llahu xhel-le shanuhu dhe pronari nuk mund ta shoh atë (fjalë). Ai, që me të vërtetë është i mirë dhe bujar, nuk i ndien veprat e veta të mira dhe bujare. Ai përherë ndien frikërespekt ndaj All-llahu xhel-le shanuhu Me këtë koment ata e shpjegojnë ajetin kur'anor:

"...Tek Ai ngriten fjalët e bukura, dhe veprën e mirë Ai e pranon..." (Fatir: 10).

Ata thonë se mirënjohja nuk përbëhet në fjalët "el-hamdulilahi" (falënderim All-llahut) por në vepër. Ndaj të mirës duhet të jesh mirënjohës, ashtu që të mos gabosh ndaj Atij që ta ka dhënë këtë të mirë dhe që të mos e marrish dhuntinë e Tij si mjet me të cilin do të ofendosh edhe veten edhe të tjerët. Mirënjohja është vepër e jo fjalë.

All-llahu xhel-le shanuhu thotë: "... O familje e Davudit! Punoni duke falënderuar All-llahun! E, pak nga robërit e Mi janë falënderues." (Seb'e': 13). Kështu All-llahu xhel-le shanuhu mirënjohjen e ka bërë vepër, aksion e jo vetëm fjalë.

Edhe sufisti edhe murgu, e edhe ai që mirret me jogë - çdonjëri prej tyre, në mënyrë të vet, përpiqet të arrijë tek All-llahu.

Për këta njerëz pasioni, makutëria dhe dashuria ndaj jetës së kësaj bote janë vetëm perde dhe pengesa. Dituria e shkencëtarit kryelartë dhe mendjemadh gjithashtu është një ndër perdet më të

dendura. Po ashtu edhe devotshmëria e mendjemadhit dhe mirësia e mirëbërësit i cili lavdërohet është perde.

Në këtë mënyrë devotshmëria ngandonjëherë bëhet perde për hyjni, shkenca perde për dituri, e vepra e dobishme perde për gjykim të drejtë të bamirësve.

Për ajetin kur'anor i cili flet për Pejgamberin e All-llahu xhel-le shanuhu: "...ç'ka ky pejgamber? Han ushqimin dhe shëtitë nëpër tregje..." (El-Furkan: 7) sufisti thotë se është perde e Zotit me të cilën Ai i ka mbuluar pejgamberizmet me rroba të rëndomta njerëzore... "Njeriu i cili han ushqimin dhe shëtitë nëpër tregje"..., në mënyrë që fshehtësia thjesht të mos përdhoset me publicitet dhe famë.

Myslimani mistik, murgu dhe ai i cili mirret me jogë kërkojnë afërsi dhe lidhje me anë të leximit të emrave, mirënjohjes, përvujtnisë, devotshmërisë, veprave të mira dhe duke thirrur All-llahun xhel-le shanuhu me emra të bukur të Tij.

"All-llahu ka emra ma të bukur, andaj thirreni Atë me ata..." (El-A'raf: 180).

Në Indi ekziston një lloj joge e posaçme për madhërimin dhe përlëvdërimin e Zotit, e quhet mantra-joga, nga fjala hinduse matram, që don të thotë madhërim dhe përlëvdërim.

Në lutjen sankrite[3], ai i cili mirret me jogë, lexon me pendesë "rehim...reham" me mijëra herë. Këto fjalë janë adekuate me fjalët arabe "rrahim...rrahman"... Këto janë emrat e Zotit në gjuhën sanskrite.

Ai që mirret me jogë i vënë rreth qafe tespihët e gjatë prej një mijë kokrrash.

Islami ofron rrugën më të shkurtër dhe më të shëndoshë e cila shpien tek All-llahu xhel-le shanuhu, gjersa Kur'ani është i vetmi Libër i shpallur me përcaktimin e Tij, e që është ruajtur në origjinal.

Sipas imam Gazaliut, All-llahu xhel-le shanuhu nuk madhërohet dhe nuk lavdërohet me anë të tespihëve, e as me gjuhë, por me zemër. Shpirti heshtazi, në qetësi dhe izolim të plotë, krahas rrahjes së zemrës, pa zë pështpëritë emrat e Zotit: "Dhe në vete përmende Zotin tënd, me përulje dhe devotshmëri dhe pa e ngritur zërin lart.." (El-A'raf: 205).

Kjo është shkalla më e lartë e tesavvufit. Këtë mund ta arrijë vetëm ai që e ka zemrën e qetë dhe shpirtin e pastër, që posedon aftësi koncentrimi, që mediton, që ka vullnet të fortë dhe i mbizotëron epshet e veta. Epshet janë perde. Mendja është perde. Konceptimi është perde. Të tërë këto paraqesin mbështjellësin e jashtëm të njeriut, e assesi realitetin e tij. Është e domosdoshme të kapërcehet ky mur në mënyrë që secili që mirret me tesavuf të mund ta shikojë

[3] Sankrit: gjuhë e përsosur klasike e hindusëve apo brahmanëve në Hindustan, me të cilën janë shkruar veprat e tyre religjioze-filozofike dhe poetike; si gjuhë popullore është shuar qysh në shekullin VI para epokës së re, por dijetarët hindus edhe sot flasin dhe shkruajnë me të. (sh.p.)

shpirtin e vet në pastërtinë e tij dhe të qëndrojë në pragun e tij që të sheh atë që syri ende nuk ka parë, të dëgjojë atë që veshi ende nuk ka dëgjuar.

Tesavvufi është të kuptuarit që arrihet me anë të aftësisë së lartë mendore.

Sufisti është gnostik (synon të njohurit, të konceptuarit). Caku i të konceptuarit të tij është Zoti në përsosmërinë e Tij dhe në plotësinë e Tij... Kjo nuk është aspiratë për të kuptuarit e pjesërishëm siç është rasti me fizikën, kiminë, gjeografinë dhe historinë. Gnostiku pretendon të arrinë konceptimin universal me shqisa të ndryshme dhe me mjete, të cilat dallojnë nga mjetet logjike dhe nga instrumentet e njohura shkencore. Epshi paraqet pengesën e parë me të cilën ballafaqohet sufisti. "E ai nuk mundi ta kapërcejë këtë pengesë. Ç'mendon ti, ç'është pengesa." (El-Beled: 11-12).

Në lajmet për Davudin qëndron: "O Zot, ku mund të të gjejë?" Zoti është përgjigjur: "Leri pasionet dhe eja...Shmangju pasioneve dhe do të Më gjesh (konceptosh)."

Në këtë drejtim disa mutesavif e komentojnë ajetin kur'anor me të cilin All-llahu xhel-le shanuhu i drejtohet Musait alejhis-selam: "Zbathi këpucët tuaja, se ti, me të vërtetë, gjendesh në luginën e shenjtë - të Tuvasë." (Ta Ha: 12)

Me nocionin këpucët nënkuptohet pasioni dhe trupi, të prirurit ndaj pasioneve dhe kënaqësive trupore. Nuk ka takim me All-llahu xhel-le shanuhu përderisa njeri nuk i zbathë këto këpucë: pasionin dhe trupin, me vdekje ose me jetë asketike. All-llahu prezenton pasionin dhe trupin sikurse këpucët, sepse pasioni dhe trupi janë këmbë me të cilat shpirti ecë në botën materiale dhe me ndihmën e të cilave ka zbritur nga qiejt në Tokë.

Ndoshta dikush do të protestojë e do të thotë...E, përse është dashur të shmanget domethënia e vërtetë e këtyre fjalëve? Faktet flasin se kjo ka qenë e domosdoshme. Për ardhjen në prezencën e Zotit nuk mjafton vetëm zbathja e këpucëve, por të ndarët me mendje nga joqenësia, që më lehtë të kuptohet ajo kryesorja, e kjo është gjëja më minimale që meriton madhëria e All-llahut xhel-le shanuhu Të abstrahuarit[4] do të përkryhet vetëm atëherë kur hiqet (largohet) preokupimi ndaj pasioneve dhe ndaj trupit. Domethënia është kjo dhe nuk është në kundërthënie me kuptimin e vërtetë të këtyre fjalëve.

Për këtë arsye gjithsecili që mirret me tesavvuf do të nxitojë t'i zbathë këpucët dhe kështu ta bëjë hapin e parë në luginën e shenjtë.

Kur'ani na informon se pas vdekjes dhe pas ringjalljes, ne do ta shohim All-llahun xhel-le shanuhu dhe do të qëndrojmë para Tij:

"...Dhe druajuni All-llahut dhe dijeni se do të takoheni me Të! E ti pra sihariqoji besimtarët." (El-Bekare: 223).

"Dhe, çdonjëri prej tyre, në Ditën e Kiametit, do të vijë fill i vetëm tek Ai." (Merjem: 95).

"Ti, o njeri, që përpiqesh shumë, mundin tënd do ta gjesh te Zoti yt." (El-Inshikak: 6).

"E do të na vini ju veç e veç, ashtu siç ju kemi krijuar herën e parë (lakuriq)..." (El-En'am: 94).

---

[4] Abstrahim: të ndarët nergut në mendime me qëllim që sa më mirë të vërehet dhe të pranohet ajo që në diç është kryesore, e përgjithshme, e domosdoshme dhe e rëndësishme. (sh.p.)

"Dhe kur do të arrijë urdhëri i Zotit tënd, e engjëjt të rreshtohen radhë pas radhe." (El-Fexhër: 22).

"Njerëzit do t'i përulen të Gjallit dhe të Përjetshmit, do të humb çdo shpresë ai që i ka bërë shok Atij." (Ta Ha: 111).

"E sikur t'i shohësh mëkatarët se si para Zotit të tyre kokë-ulur thonë..." (Es-Sexhde: 12).

"E në Ditën kur ata do të qëndrojnë para Tij, Ai do t'i përshëndet me: "Selam!", dhe, Ai, u ka përgatitur atyre shpërblim fisnik." (El-Ahzab: 44).

"Në Ditën kur All-llahu do t'i ngjallë të gjithë, ata do t'i betohen Atij, sikundër që ju janë betuar juve, duke menduar se do të kenë farë dobie, prej kësaj. Po, me të vërtetë, ata janë gënjeshtarë të vërtetë!" (El-Muxhadele: 18).

"A presin ata që t'u vijë ndëshkimi i All-llahut nga qielli i kthjellët, dhe engjëjt, dhe çdo gjë të merr fund?!..." (El-Bekare: 210).

Disa sekte islame mohojnë mundësinë e të pamurit të Zotit në botën tjetër dhe këto ajete i komentojnë si alegori, simbole dhe aluzione, e jo si mundësi të njëmendtë. Ata thonë se ajetet duhet të kuptohen në bazë të domethënies së brendshme të tyre, e jo sipas kuptimit sipërfaqësor.

Si argument të aspektit të këtillë ata theksojnë se syri njerëzor mund të pranojë vetëm atë që është e kufizuar me vend dhe kohë. Zoti është i pakufishëm. Zoti është lart vendit dhe kohës, andaj në përputhje me këtë nuk është e mundur që Ai të shikohet me sy. Argumenti i tyre është i paqëndrueshëm. Ky është kuptim material i kësaj bote. Ata pandehin se shpirti do të shikojë në

botën tjetër me sy material dhe se ai do të ketë bebëz dhe kapakë dhe se edhe më tej do të mbetet në raport të njohur të kësaj bote ndaj vendit dhe kohës. Këtë e mohon vetë Kur'ani, i cili thotë për ringjalljen: "Dhe sërish t'ju krijojmë në figura çfarë ju nuk i njihni", respektivisht, All-llahu xhel-le shanuhu do t'i ringjallë njerëzit në figura të cilat për ata janë tërësisht të panjohura.

Nuk do të jetë asgjë e jorëndomtë nëse shpirti në botën tjetër do të ketë një shqisë të gjithmbarshme të të pamurit, me të cilën do të mund të pranonte edhe atë që është e pakufizueshme.

Kur'ani përmend nëntëdhjetë e nëntë emra të bukur të Zotit. Disa prej këtyre emrave janë veçori vetëm për Zotin, si për shembull All-llah, ndërsa emrat e tjerë, si El-Kerimu (Fisniku), El-Halimu (I butë për të gjithë), El-Rreufu (Mëshirëbërësi), El-Vedudu (Që e don të krijuarën), ia ngjesim veti e themi: Kerim, Halim, Reuf, Vedud etj. Mirëpo askujt nuk i lejohet të thotë se quhet All-llah, sepse ky është emri i vet Qenies së Zotit, ndërsa emrat e tjerë janë atribute të Zotit dhe veprave të Tij. Qenia e Zotit është gajb (fshehtësi) dhe askujt nuk i është lejuar që të hyjë në të. Përsa i përket atributeve dhe veprave të Tij - për këto është e lejuar të përsiatet.

Zoti i përgjigjet atij i cili e thërret me emra të Tij të bukur:

"Më thirrni Mua, Unë do t;ju përgjigjem..." (El-Mu'min: 60).

"Dhe kur të pyesin robërit e Mi për Mua, Unë jam me të vërtetë afër; i përgjigjem lutjes së lutësit kur më lutet..." (El-Bekare: 186).

Ky është fakt. Mirëpo metoda, me ndihmën e së cilës arrihet gjer tek kjo (lutje), nuk është llomotitje e thjeshtë me gjuhë dhe shqiptim i thjeshtë i fjalëve "Ja Rabb!" (O Zot!). Shumica e

njerëzve thonë "Ja Rabb!"..., por me mendje e cila është tërësisht e zbrazët dhe e larguar nga domethënia e vërtetë e fjalës. Thirrja e Zotit është gjë e madhe. Ky është thelbi i tesavvufit. Ky është tesavvufi në esencën e vet. Këtë janë në gjendje ta arrijnë vetëm njerëzit me zemër të madhe, ata të cilët kanë fuqi të madhe perceptimi dhe njerëzit me ideale të lartë.

Kjo nuk do të thotë se duhet të jesh dervish që ta plotësosh kushtin për t'iu drejtuar Zotit me lutje, e Ai të përgjigjet, por kushti është të kesh zemër të pastër dhe ndërgjegje të pastër.

Ai që thotë: "Ja Rabb, më furnizo me njëqind funta", ky është njeri i cili tallet në mënyrë tejet marrëzore. Këto gjëra mund t'i arrish me ndihmën e mjeteve të kësaj bote. Tesavvufi nuk është rrugë për diç të tillë.

Sufisti si përfillë nevojat e kësaj jete dhe ngritet mbi to, sepse ai dëshiron diç më tepër se kjo.

Ai është i sjellshëm. Edhe kur sëmuret ai nuk kërkon ilaç nga Zoti. Ai thotë se si të posedojë vullnetin tim pranë vullnetit të Zotit. Si të lutem për diç që Ai nuk e ka bërë. Unë jam ai që e kam të panjohur së çka është e dobishme për Të e çka është e dëmshme. Si mund t'i bëjë vërejtje ai që nuk di Atij që di. E, kush e di, ndoshta sëmundja ime dhe dhembjet e mia nuk janë shkak i fundit tim.

Kjo tepri nuk është e dëshiruar tek myslimani, sepse All-llahut i pëlqen kur dikush kërkon ndihmë prej Tij.

Por sufisti, nga frika prej All-llahut dhe nga mirësjellja e vet, kërkon prej Tij dhe thotë ashtu siç ka thënë Ibrahimi a.s: "O Zoti im, bën që unë ta kryej përherë namazin...!" (Ibrahim: 40). Ai dëshirën e Zotit e merrë si dëshirë të vet, nga dashuria dhe respekti ndaj Krijuesit. Dashuria është

caku i fundit i çdo sufisti. Ai thotë: "Kësmeti im nuk është i lidhur me Xhennetin dhe Xhehennemin. Dashurinë time me asgjë nuk dëshiroj ta zëvendësojë."

Në çdo gjë që ekziston sufisti e sheh vetëm Zotin. Sipas tij Zotit nuk i duhet lutja jonë. Ajetin kur'anor "Xhinnët dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë" (Edh-Dharijat: 56) ata e marrin me domethënie: xhinnët dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të më njohin.

Ibadeti pa njohjen e Zotit nuk është ibadet. Si është e mundur të adhurosh diç të panjohur? Rob i Zotit do të jesh vetëm atëherë kur e njeh Zotin, e Zotin do ta njohësh vetëm nëse e njeh vetveten, pastaj asgjësohesh dhe i drejtohesh Krijuesit tënd. Zoti e ka krijuar njeriun që së pari ta njohë vetveten e pastaj Zotin, Krijuesin e vet. Me këtë njohje njeriu do ta plotësojë pikëpamjen e vet dhe do të evolulojë përmes luftës e cila zhvillohet mes shpirtit dhe trupit të tij.: "Ne e krijuam njeriun që të luftojë me vështirësi *(për të dy jetërat)*" (El-Beled: 4).

Njeriu është krijuar që të luftojë. All-llahu i ka premtuar njeriut që nëse fiton do t'i trashëgojë Tokën dhe qiejt. Të adhuruarit e Krijuesit është liri e vërtetë para të krijuarit. Nënshtrimi ndaj Krijuesit është fisnikëri e vërtetë para të krijuarit.

Të adhuruarit e All-llahut do të thotë para së gjithash të liruarit e njeriut nga adhurimi i materies, pasioneve, epsheve dhe pozitave. Kush adhuron Zotin, ai nuk adhuron turmën nga dëshira për pozitë dhe vend të lartë tek turma. Do t'i dorëzohesh sinqerisht All-llahut vetëm atëherë kur e liron zemrën nga adhurimi i këtyre hyjnive dhe shlyen çdo gjë që nuk është All-llahu, në mënyrë që në zemrën tënde të mbetet vetëm një vend për Krijuesin tënd. Do ta arrish shkallën më të lartë të ibadetit vetëm nëse ia del t'i ngadhënjesh pasionet dhe dëshirat tua, kështu që ajo që i dëshiron

vetes të bëhet njëkohësisht ajo që All-llahu dëshiron për ty. Pikërisht dëshira jote të bëhet dëshirë absolute e Zotit...Ky është kulminacioni i lirisë dhe i çlirimit nga të gjithë hyjnitë tjerë.

Sufisti është njeri që mediton, është mendjemprehtë dhe me shije të stërholluar. Ai thotë: "Miku yt i sinqert është ai, i cili gjithnjë shoqërohet me ty dhe i cili t'i di vetitë e këqija. Ky nuk mund të jetë askush tjetër pos All-llahut, Krijuesit, i Cili i di fshehtësitë tua dhe është i njoftuar për atë që fshehë dhe për atë që bënë haptazi. Nëse ia refuzon dëgjesën, Ai të mbronë, nëse kërkon ndjesë prej Tij, Ai pranon pendesën tënde."

Sufisti gjithashtu thotë: "Nëse argëtohesh pak, pak edhe do të pikëllohesh. Nëse nuk dëshiron të përmbysesh nga pozita, atëherë as mos prano të jesh në pushtet të përkohshëm. Nëse pohon se je modest, atëherë me të vërtetë je fodull (kryelartë). Nëse për Zotin di vetëm kur je në mirëqenie, atëherë as që e adhuron Atë, por je adhurues vetëm i pasioneve tua. All-llahu ka krijuar botën që të jetë në shërbimin tënd, e ti u bëre shërbëtor i saj. Ka dashur që të jesh sundimtar, e ti u bëre ai i cili është në pronën e sundimtarit."

Sufisti u thotë dijetarëve: "Diturinë e juaj e keni marrë nga i vdekuri, ndërsa ne nga i Gjalli, i Cili kurrë nuk vdes. Thoni se ka thënë filan filani, e të gjithë janë në mesin e të vdekurve. Dhuruesi i vërtetë, Ai i Cili i di fshehtësitë, për ju është më afër se edhe vet delli juaj. Ai është me ju kudo që të gjendeni. Tre vet nuk bisedojnë mes veti, e Ai të mos jetë i katërti. Atëherë si mund ta braktisni All-llahun e të kërkoni njohuri prej tjetërkujt."

Prandaj sufisti thotë mbi njohurinë e vet se kjo është njohuri e dhuruar nga Zoti, e jo tradicionale, e përfituar duke lexuar vepra të ndryshme. Për vete thonë se gjenden në afërsi të Zotit, se merren me sportin shpirtëror, me agjërim dhe me ibadet gjer tek zhytja përfundimtare në Zotin. Rruga e

tyre gjer tek Zoti janë emrat e bukur të Zotit dhe dashuria e pakufishme ndaj Tij, e cila ua përmbush çdo atom të zemrës. Ata janë të preokupuar vetëm me dhikër, dhe në çdo gjë shohin vetëm Zotin.

Ata dinë më tepër fshehtësi se njerëzit e rëndomtë. Ata janë më afër Zotit se çdokush tjetër. Ata janë raritet (rrallësi) i vërtetë. Kur vijnë ndokund, janë të panjohur, e kur shkojnë, nuk humbasin, sepse nuk flasin për veten. Secili prej tyre i fshehë kerametet e veta, sepse kjo është fshehtësi vetëm mes tyre dhe Zotit, është shenjë dashurie, afrie dhe veçantie. Ajo që gjendet mes tyre dhe të Dashurit të tyre, nuk duhet të zbulohet dhe të përdhoset. Ligji i tyre është se ai që flet nuk di, e ai që di nuk flet.

Ata nuk janë dervishë të rëndomtë e as ata që marrin shënime. Ata janë të përmbajtur dhe të devotshëm pa u hetuar. Zoti thotë për ta në një hadith kudsij: *"Të dashurit e Mi janë nën kubben Time dhe vetëm Unë i njoh ata."*

Në një hadith tjetër për këtë veçanti Zoti thotë: *"Për mua nuk është e gjerë as Toka Ime as qiejt e Mi, për Mua është e gjerë zemra e atij që Më beson."*

Në hadithin e tretë qëndron: *"O robi im! Bëhu i dëgjueshëm ndaj Meje, e Unë ty do të bëj hyjnor. Dora jote do të jetë dora Ime, gjuha jote do të jetë gjuha Ime, shikimi yt do të jetë shikimi Im."*

O sa pak ka sot njerëz të tillë!

NJË ZOT DHE NJË RELIGJION

Kur'ani qartë dhe në mënyrë të padyshimtë konfirmon Unitetin absolut të Zotit. Vetëm Ai ekziston, e çdo gjë tjetër përveç Tij është e zbrazët dhe e përkohshme.

"Dijeni se s'ka zot tjetër pos All-llahut! Kërko falje për mëkatet tua..." (Muhammed: 19).

"Çdo gjë, pos Tij, është e destinuar të shkatërrohet!..." (El-Kasas: 88).

Jezusi (Isai alejhis-selam) në Ungjill thotë: *"Askend në Tokë mos e thirrni baba tuajin, sepse e keni vetëm një baba, Atë në qiell!"* (Mateji-23, 9)

"Jezusi (Isai a.s) tha: "Zmbrapsu, o satan, sepse është shkruar: Përkulju Sunduesit, Zotit tënd, dhe shërbeji vetëm Atij!" (Matej-4, 10)

Në Teurat qëndron: *"Sytë nuk janë ngopur së shikuari dhe veshët së dëgjuar... Tërë mundin që e ke bërë nën Diell ia lë trashëgimtarit tënd. Sikur që do të vdes ai që është i mençur, ashtu do të vdes edhe ai që është injorant... Sikur që nuk e di se cila është rruga e erës, e as se si krijohen eshtrat në mitrën e gruas shtatzënë, ashtu nuk i di as veprat e Zotit, i Cili krijoi çdo gjë."*

Teurati e përshkruan Zotin si Një të Vetmin[5], patrupor, të vetëmsuar në tërë përsosmërinë e Vet,i Cili nuk hanë e as që ka ndonjë të metë[6].

---

[5] Bibla në mënyrë të qartë dhe të padyshimtë flet për Unitetin (Njësinë) e Zotit. Ja disa citate nga Dhiata e Vjetër dhe e Re:
"Unë jam i pari dhe unë jam i fundit: pos meje nuk ka Zot." (Izaija, 44, 6).

"Unë, unë ekzistoj, tjetër Zot pos meje nuk ka." (Ligji i përsëritur, 32, 39)
"A nuk jam unë, Jahve?" S'ka Zot tjetër nga unë; Zot të drejtë dhe shpëtimtar, pos meje nuk ka." (Izaija, 45,21).
"Jahve është Zot lartë në qiell dhe këtu në tokë - tjetër nuk ka." (Ligji i përsëritur, 4, 39).
"Jahve është Zoti ynë, Jahve është një." (Ligji i përsëritur, 6, 4).
"Zoti ynë është një" (Letra e parë Timotejit, 2, 5)
"Ekziston vetëm një Zot" (Letra Jaakovit, 2, 19)

6 Zoti, si qenie e domosdoshme posedon cilësi të përsosura. Ai është i pastër nga çdo e metë. Për këto cilësi të përsosmërisë Kur'ani flet qartas, e po ashtu edhe Bibla. Ja disa citate nga Dhiata e Vjetër dhe e Re:
Jeta - Hajat:
"Unë e di mirë: shpëtimtari im jeton." (Job, 19, 25)
"Njerëzit, domethënë, vetë flasin... se si jeni kthyer nga idolet kah Zoti, që vijimisht t'i shërbeni Zotit të gjallë dhe të vërtetë." (Letra e parë Solunjanëve, 10).
"Dhe do t'i përkuleshit atij "i cili jeton" për jetë." (Zbulimi, 4, 10)
Dituria - ilm:
"Kështu flet Zotëriu i cili bënë atë që ka paraparë nga përjetësia." (Veprat apostolike, 15, 18).
"Jahve, më përshkon të tërin dhe më njeh, ti e di se kur ulem dhe kur ngritem, që prej së largu tanimë mendimet e mia i njeh. A jam duke ecur apo i shtrirë, ti të gjitha i sheh, i ke të njohura të gjithë rrugët e mia. Fjala as më ka ardhur gjer tek gjuha e ti, Jahve, tanimë i di të gjitha." (Psalmet, 1, 4).
"O thellësi e pasurisë, urtësisë dhe diturisë së Zotit! Sa të paarritshme janë vendimet e tij, dhe sa të pahulumtueshme rrugët e tij." (Letër romakëve, 11, 33).
Vullneti - iradet:
"Gjithçka që i pëlqen Jahves, atë e bënë në qiell dhe në tokë, në det dhe në humnera." (Psalmet, 135, 6).

Të gjithë Librat e shpallur nga Zoti: Teurati, Zeburi, Inxhili dhe Kur'ani, në trajtën e tyre si janë shpallur, janë Libra monoteistik, dhe si të tillë urdhërojnë vetëm e vetëm monoteizmin.

Kur'ani tërësisht qartë thotë se, ata të cilët kanë pranuar Shpalljen e Zotit para pejgamberizmit të Muhammedit alejhis-selam, hebrenjtë dhe të krishterët, janë në rrugën e drejtë nëse i përmbahen monoteizmit... Ata në botën tjetër do të shpërblehen... Dhe, më tepër se kjo, Kur'ani thotë se madje edhe ata, të cilët iu kanë drejtuar Diellit, duke e konsideruar atë si simbol dhe si njërën nga shenjat e Zotit sabi'inët, siç është Ahnatoni, gjithashtu do të jenë të shpërblyer, sikurse edhe hebrenjtë para ardhjes së Isait a.s dhe të krishterët para ardhjes së Muhammedit alejhis-selam Të gjithë ata kanë të drejtë të jenë të falur dhe të shpërblyer.

"Pasi që jemi të paradestinuar me qëllimin e atij i cili çdo gjë bën sipas vendimit të vullnetit të vetë." (Letra efezhanëve, 1, 11).
Fuqia - kudret:
"Për njerëzit është e pamundshme, por për Zotin gjithçka është e mundshme." (Matej, 19, 26).
"Zoti është i gjithëfuqishmi" (Zanafilla, 48, 3)
Të dëgjuarit - sem' dhe të pamurit - besar:
"Kuptoni, o ju budallenj nga populli: të marrë, kur do të mblidhni mendjen? A mos vallë, Ai që mbolli veshin, të mos dëgjojë? Ai që krijoi syrin, të mos shohë?" (Psalmet, 94, 8-9)
Të folmit - kelam:
Zoti flet. Për këtë janë të njëzëshëm të gjithë Pejgamberët e Zotit. Teurati, Zeburi, Inxhili dhe Kur'ani - Librat e Zotit janë e folmja e Zotit. Shumë ajete kur'anore flasin për këtë, ndërsa lexuesve u preferojmë të shikojnë edhe në Bibël: Krijimi 3:9, 22, pastaj dalja 20, 1.

"Ata që kanë besuar, madje edhe ata që kanë qenë hebrenj, dhe të krishterë, dhe sabi'inë - ata të cilët kanë besuar All-llahun dhe botën tjetër dhe kanë bërë vepra të mira - me të vërtetë, ata i pret shpërblimi nga Zoti i tyre; ata prej kurrgjëje nuk do të frikësohen dhe për asgjë nuk do të pikëllohen!" (El-Bekare: 62).

Antagonizmi mes religjioneve qartazi paraqet mosnjohjen e religjionit: "Hebrenjtë thanë: "Të krishterët nuk janë në rrugë të drejtë!" Kurse të krishterët thanë: "Hebrenjtë nuk janë në rrugën e drejtë!" - e ata lexojnë Librin. Pikërisht kështu thonë për ta edhe ata që nuk dinë. E All-llahu do t'i gjykojë në Ditën e gjykimit për atë në çka kundërshtoheshin." (El-Bekare: 113).

Ata që gjenden në këso marrëdhëniesh antagoniste nuk e kanë kuptuar esencën e religjionit.

Religjioni në esencën e vet është një: "Ai ju urdhëron nga feja atë që ia ka urdhëruar Nuhit, edhe atë që ta shpallim ty, edhe atë që i urdhëruam Ibrahimit, Musait dhe Isait: "Predikoni fenë e drejtë dhe mos u përçani në të!..." (Esh-Shura: 13).

Religjioni është një përsa i përket doktrinës[7]. Ligjet e këtij religjioni unitar janë shpallur në etapa: "...për secilin kemi caktuar një Ligj dhe një drejtim..." (El-Maide: 48).

Isai alejhis-selam thotë: *"Nuk kam ardhur që ta abrogoj Ligjin, por që ta plotësoj."* (Matej-5, 17)

Këto janë etapat. Në çdo etapë ka ardhur Pejgamberi i Zotit me Ligjin, i cili i është përgjigjur zhvillimit të njeriut të asaj kohe.

---

[7] Dallimi që ekziston ndërmjet religjioneve është dallim vetëm në raport me ligjet.

Kurdoherë që njerëzimi ka përparuar dhe e ka tejkaluar fazën përkatëse, Zoti ka dërguar Pejgamber të ri për ta plotësuar Ligjin qiellor, në mënyrë që ai të jetë në harmoni me progresin e ri shpirtëror.

Në kohën e Musait alejhis-selam, gjatë periudhës së faraonit, periudhës së vrazhdësisë, forcës dhe tiranisë, Musait alejhis-selam i është shpallur Ligji i drejtësisë.

Drejtësia përkatëse për këtë periudhë dhe për periudhat e ngjashme me këtë, paraqet kthimin e grushtit me grusht... Syri për sy, dhëmbi për dhëmb.

Kur njeriu është përkryer edhe për një hap përpara, atëherë ka pasuar shpallja e Ligjit të ri, Ligjit të dashurisë... Ka ardhur Jezusi (Isai alejhis-selam) të thotë në Inxhil: "Kemi dëgjuar se është thënë: "Syri për sy, dhëmbi për dhëmb." E unë ju them: "Mos iu kundërvëni keqbërësit! Nëse dikush të godet në faqen e djathtë, ti afroja edhe tjetrën. Nëse të detyron të shkosh me të një milje, ti shko dy! (Matej-5, 38-42).

Këto virtyte të larta etike kanë ardhur në konflikt me tiraninë e tiranëve dhe i ka ndodhur Jezusit (Isait alejhis-selam) ajo që i ka ndodhur... Dashuria jep provim në lëndën më të vështirë... Çdo përdhunues në të sheh dobësi dhe zmbrapsje, andaj këtë e shfrytëzojnë për interesa të veta dhe ngriten kundër secilit që flet në emër të saj.

Ka qenë e domosdoshme të vijë sheriati i Muhammedit alejhis-selam në mënyrë që ta bashkojë Ligjin e drejtësisë dhe Ligjin e dashurisë në një Ligj unitar, Ligjin e përdëllesës.

"Në qoftë se doni të merrni hak për padrejtësi, atëherë bëni atë në masë sa u është bërë juve; po nëse duroheni, vërtetë kjo është më së miri për të durueshmit. Jij i durueshëm! Por, i durueshëm do të jesh vetëm me ndihmën e All-llahut..." (En-Nahël: 126-127).

Derisa përdorimi i forcës gjatë vetëmbrojtjes në Inxhil ka qenë i ndaluar, tani është kanonizuar, por gjatë këtij kanonizimi Zoti i ka dhënë përparësi durueshmërisë dhe tolerimit të torturimit kundrejt hakmarrjes, e pastaj në fund të ajetit ka urdhëruar: "Jij i durueshëm!Por, i durueshëm do të jesh vetëm me ndihmën e All-llahut." Zoti ka premtuar se të durueshmin do ta ndihmojë në durueshmërinë e tij, e edhe më tepër se kjo. Kur'ani ka qenë tërësisht i qartë në favorizimin e dashurisë dhe e kthimit të së keqes me të mirë. Këtë e ka urdhëruar në mënyrë të prerë: "Ti ktheje të keqen me të mirë..." (El-Mu'minun: 96).

All-llahu e ka ditur se pas kësaj nuk do të ketë më përparim shpirtëror. Njeriu do t'i zhvillojë vetëm mjetet për prodhimtari. Ai do të prodhojë automobila, lokomotiva, aeroplanë, raketa, do t'i përsosë shkencat pozitive dhe racionale, e nuk do ta bëjë as një hap të vetmin në drejtim të progresit shpirtëror, andaj edhe e ka përfunduar ciklin e shpalljeve me Muhammedin alejhis-selam

Na ka mbetur të mendojmë për atë se çka është thënë dhe përse është thënë, pastaj të pyetemi përse ka mbaruar cikli i shpalljes?

Religjioni, pra, është një sikur që është edhe Zoti Një.

Ata të cilët janë në divergjencë përkitazi me këtë çështje, atyre nuk u është e qartë esenca e shpalljes së dispozitave të Zotit, porosive dhe ligjeve të cilat janë shpallur në etapa e në përshtatshmëri me zhvillimin shpirtëror të njerëzimit.

Zoti flet në Kur'an tërësisht qartë dhe përpikërisht për Pejgamberët të cilët janë ndërruar si për Pejgamberë të një religjioni dhe ata i quan myslimanë, ndërsa religjionin e tyre të cilin e kanë predikuar e ka quajtur Islam.

Nuhi alejhis-selam, duke iu drejtuar jobesimtarëve thotë: "Unë prej jush nuk kërkoj kurrfarë shpërblimi, mua do të më shpërblejë All-llahu. Mua më është urdhëruar të jem mysliman." (Junus: 72).

Pastaj për Ibrahimin dhe të birin i tij, kur e ndërtonin Ka'ben, thotë: "*(Dhe kujtoje atë kohë)* kur Ibrahimi dhe Ismaili i ngritnin themelet e Ka'bes, ata luteshin: "O Zoti ynë! Prano prej nesh *(këtë veper)*! Me të vërtetë Ti je Ai, që i dëgjon të gjitha dhe që të gjitha i di! O Zoti ynë, bëna ne të dy myslimanë dhe pasardhësit tanë myslimanë, dhe na i trego rregullat e ibadetit *(adhurimit)* dhe falna neve, sepse Ti njëmend pranon pendimet dhe Je mëshirues i madh!" (El-Bekare: 127-128).

Pastaj Musait alejhis-selam: "Dhe Musai tha: "O populli im, nëse besoni All-llahun, mbështetuni tek Ai, nëse jeni myslimanë!" (Junus: 84). Edhe faraoni, në çastin e përmbytjes ka deklaruar: "...Unë besoj se nuk ka zot përveç Atij që i besojnë të bijtë e Izraelit dhe unë jam mysliman." (Junus: 90).

Edhe Jusufi alejhis-selam, kur i ndihmoj Zoti të bashkohet me vëllezërit e tij, ka thënë: "O Zoti im! Ti më ke dhënë një pjesë të pushtetit dhe më ke mësuar komentimin e disa ëndrrave! O Krijues i qiejve dhe i Tokës, Ti je Mbrojtësi im edhe në këtë botë edhe në botën tjetër; bënë që të vdes si mysliman dhe më shoqëro me ata të mirët! (Jusuf: 101).

Po ashtu edhe magjistarët, të cilët i kanë besuar Musait alejhis-selam, thonë: "...O Zoti ynë, na jep fuqi të durojmë dhe bënë që të vdesim si myslimanë!" (El-A'raf: 126).

Ndërsa për Isain alejhis-selam dhe havarijjunët thotë: "E kur Isai u bind se ata nuk dëshirojnë të besojnë, thirri: "Kush do të jenë ndihmësit e mi në rrugë të All-llahun?" - "Ne", - thanë nxënësit, - "ne do të jemi ndihmësit e fesë së All-llahut, ne besojmë All-llahun, e ti bëhu dëshmitar se ne jemi myslimanë." (Ali Imran: 52).

All-llahu xhel-le shanuhu thotë se Isai alejhis-selam është mysliman, havarijjunët janë myslimanë... Musai alejhis-selam është mysliman, magjistarët, të cilët i kanë besuar Musait alejhis-selam janë myslimanë, faraoni, i cili është penduar në çastin e vdekjes, ka pranuar Islamin. Jusufi alejhis-selam është mysliman, e po ashtu edhe Ibrahimi, Ismaili dhe Nuhi, alejhis-selam, janë myslimanë. Të gjithë kanë pranuar Islamin...

Kjo do të thotë se që të gjithë iu kanë dorëzuar Zotit, sepse kanë kuptuar se me të vërtetë asgjë nuk ekziston përveç Tij.

Zgjedhja e një fjale të vetme për të gjithë ka mësimin dhe urtësinë e saj, e kjo reduktohet në atë se nuk ka kurrfarë ndarjesh në religjione.

Pastaj shkon edhe më tej, e e ndalon ndasinë mes Pejgamberëve, respektivisht, të veçuarit e njërit nga tjetri... Për besimtarët në suren El Bekare thotë: "Pejgamberi beson në atë që është duke iu shpallur (Kur'ani) nga Zoti i tij, dhe besimtarët; - të gjithë ata besojnë All-llahun, engjëjt e Tij, Librat e Tij dhe Pejgamberët e Tij: "Ne nuk e dallojmë asnjërin nga Pejgamberët e Tij." (El-Bekare: 285).

Ndasia mes Pejgamberëve nuk ka kurrfarë kuptimi e as që ka ndonjë bazë. Besimtari i mirë do të jetë i dorëzuar Zotit vetëm nëse i beson të gjithë Pejgamberët, Librat e shpallura nga Zoti, Ditën e gjykimit dhe Unitetin (Njësinë) e Zotit.

Religjioni në esencën e vet është një. Ai ka kaluar përmes fazave të caktuara në të cilat janë shpallur ligjet e Zotit në ujdi me natyrën e njeriut dhe zhvillimit të tij.

"Ty aspak nuk të interesojnë ata të cilët e kanë copëtuar fenë e tyre dhe janë darë në fraksione, All-llahu do të përkujdeset për ta." (El-En'am: 159).

"Ata, të cilët mohojnë All-llahun dhe Pejgamberët e Tij dhe ata të cilët dëshirojnë të bëjnë dallim ndërmjet All-llahut dhe Pejgamberëve të Tij në besim e thonë: "Disave u besojmë, disave nuk u besojmë", dhe dëshirojnë që përkitazi me këtë të marrin ndonjë qëndrim, - ata janë, me të vërtetë, pabesimtarë të vërtetë." (En-Nisa: 150-151).

Feja është e pandashme. Nuk mund të jesh mysliman nëse i beson një Libri të shpallur, e tjetrin nuk e përfill. Islam do të thotë të nënshtruarit ndaj fesë së Zotit. Ai është të pranuarit e të gjitha atyre që ka shpallur dhe ka dërguar Zoti. Do të jesh besimtar i vërtetë vetëm nëse i beson Zotit dhe në të gjitha ato që ka shpallur Ai.

Me këtë gjerësi dhe me kësi pikëpamje të gjerë duhet ta kuptojmë morinë e religjioneve në mënyrë që të tejkalojmë anësinë dhe të ndjejmë se të gjitha religjionet, në realitet janë vetëm një religjion, të cilin e ka shpallur vetëm Një Zot.

All-llahu është i mëshirshëm. Ai ia ka lënë të hapuara dyert e mëshirës së Vet çdonjërit që përpjeket të arrijë gjer tek e vërteta.

Nëse jeton në xhungël (pyll i pashkelur) dhe nuk ke pasur mundësi të dëgjosh për Kur'anin dhe për pejgamberizmin e Muhammedit alejhis-selam, e as për Libra të tjerë qiellor, pos Inxhilit në përkthim në gjuhën tënde amnore, me ndihmën e të cilit iu ke afruar Zotit, do të jesh i pranuar te Zoti... Nëse jeton në fund të polit verior, e nuk ke mundur të vijsh në kontakt me asnjë Libër qiellor, por me përsiatjen tënde ke kuptuar Unitetin e Zotit në saje të shenjave të Tij në qiell, yjet dhe planetët, të cilët i ka krijuar Ai dhe me ndihmën e tyre iu ke afruar Zotit (siç kanë bërë seb'ejët, p.sh. Ahnatoni), shpërblimi yt nuk do të mungojë. Çdonjëri që përpiqet dhe përdorë të gjitha mjetet që i ka në disponim për të arritur tek Zoti, do të jetë i shpërblyer. Dyert e Xhennetit janë të hapura për secilin që sinqerisht përpiqet ta konceptojë (njohë) All-llahun. Zoti thotë se të gjithë popujve ua ka dërguar Pejgamberin e Vet...

"Nuk ka pasur popull të cilit nuk i ka ardhur ai që ua ka tërhequr vërejtjen."

Disa prej këtyre Pejgamberëve janë krejtësisht të panjohur. Kur'ani nuk flet asgjë për ta... Për këta Pejgamberë All-llahu xhel-le shanuhu i thotë Muhammedit alejhis-selam: "Për disa prej tyre të kemi treguar, e për disa nuk të kemi treguar." All-llahu ia ka dërguar fjalët e veta çdonjërit në çdo vend në mënyrën çfarë nuk e kemi të njohur. Zoti thotë se edhe shtazët i ka frymëzuar, e jo vetëm njeriun: "Zoti yt e ka frymëzuar bletën: "Ia mbaron vetit shtëpinë në kodra e në dushkaja dhe në atë që mbarojnë njerëzit." Zoti është në kontakt të afërt me çdo gjë që ka krijuar.

Pas Muhammedit alejhis-selam ka pasur raste të paraqiten pejgamberë të rrejshëm. Kohë pas kohe lajmëroheshin disa njerëz, të cilët e quanin veten pejgamber dhe të cilët pohonin se janë bartës të librit qiellor. Shumica prej tyre kanë përfunduar në litar, e librat e tyre janë harruar.

Çdonjëri nga pejgamberët e vetëquajtur është dashur të vijë intuitivisht me koncept të ri mbi botën e padukshme. Atij, të cilin Zoti e dërgon tek ndonjë popull, Ai vetvetiu ia mundëson pushtetin mbi atë popull apo pushtetin mbi ligjet e tyre natyrore. Ata pejgamberizmin e tyre e argumentojnë me fenomene mbinatyrore apo me libër të përsosur e të paarritshëm të cilit i nënshtrohet edhe zemra edhe shqisa e të dëgjuarit, ndërsa mendja mbetet e habitur. Diç të tillë nuk janë në gjendje ta bëjnë ata që për vetveten pohojnë se janë pejgamberë të Zotit.

Andaj të gjithë pejgamberët e vetëquajtur, për të dalur nga ky qorrsokak, orvaten t'i rrënojnë themelet në të cilat mbështetet pejgamberizmi i vërtetë. Ata i mohojnë mu'xhizet dhe botën e padukshme dhe çdo mjet tjetër i cili do të sillte dyshim në pejgamberizmin e tyre.

Çdo pejgamber i rrejshëm zakonisht i pranon të gjithë Pejgamberët, që i kanë paraprirë atij, e me këtë edhe Librat e tyre qiellore. Andaj ka qenë e paevitueshme që ta pranojnë edhe Kur'anin. Mirëpo, shtrohet pyetja si të ndërlidhet pranimi i Kur'anit dhe mohimi i mu'xhizeve dhe botës së padukshme. Në mënyrë që ta harmonizojnë njërën me tjetrën, ata i janë qasur komentimit ezoterik (të brendshëm) të Kur'anit, duke u orvatur që kështu t'i ikin kuptimit të tij të jashtëm dhe të tërë asaj që dispozitat kur'anore kërkojnë prej tyre.

Djalli, i cili përmendet në Kur'an, sipas tyre është simbol i pasionit, e engjëlli simbol i mirësisë. Iblisi, sipas tyre, nuk posedon ekzistencën e vet dhe ai është simbol i së keqes.

Mu'xhizet e Pejgamberëve paraprak të Zotit, për të cilët flet Kur'ani, Ata janë, thonë, simbole, e jo realitet. Shkopi i Musait alejhis-selam nuk është asgjë tjetër veçse sheriat me të cilin ka ardhur për t'i udhëzuar ata që kanë devijuar.

"Ky është shkopi im" - u përgjigj ai - "në të cilin mbështetem dhe me të u shkundi gjethe dhenve të mia, e me të kam edhe dobi të tjera." (Ta Ha: 18). Dhentë, sipas komentimit të tyre ezoterik, janë populli i tij.

Kur e hodhi Musai shkopin e vet, ai u shndërrua në gjarpër, i cili i gëlltiti gjarpinjtë e magjistarëve... Nuk ka ndodhur që nga shkopi të dalë gjarpri siç thotë Kur'ani. Edhe ky është simbolizëm, sheriati dhe argumentet e tij i kanë gëlltitur gjarpinjtë gënjeshtra.

Kur i ka ra Musai detit me shkopin e vet, ai nuk është ndarë. Ndarjen e detit për të cilën flet Kur'ani, ata e komentojnë në mënyrë simbolike. Kjo është ndarja e të vërtetës nga e pavërteta me ndërmjetësimin e sheriatit të Musait dhe dëshmisë së sheriatit (shkopit të tij).

"Dhe fute dorën nën sqetullën tënde, dora do të paraqitet e bardhë, por jo e sëmur." Edhe këtë ajet Kur'anor ata e komentojnë simbolikisht. Dora këtu është simbol i dorës zemërgjerë, të cilën Musai ia ka shtrirë faraonit.

Ringjallja e të vdekurve nga ana e Isait nuk është asgjë tjetër veçse mësimi i tij me të cilin i ka ndriçuar shpirtrat e njerëzve. E ka shpëtuar injorantin nga errësira e injorancës, e nuk e ka ngjallur përnjëmend të vdekurin nga vari.

Ngjashëm me këtë është edhe shërimi i tij i të verbërve. Ky shërim është shërim i verbësisë së zemrës, e jo të syrit. Gostia e tij, të cilën e ka përgatitur, nuk është asgjë tjetër veçse gostia shpirtërore që ia ka ofruar popullit.

Në këtë mënyrë Mirza Husein Ali, i ashtuquajturi "Behaullah", i është qasur komentimit të Kur'anit, duke i abstrahuar mu'xhizet dhe atë që është e padukshme (engjëjt dhe djajtë), vetëm

për t'i ikur kërkesave të popullit që të realizonte mu'xhize me të cilat do ta argumentonte pejgamberizmin e vet. Atje nuk ka asgjë të padukshme dhe as që ekziston mundësia e mu'xhizeve. Asnjëri prej Pejgamberëve të kaluar nuk është shërbyer me mu'xhize (çudira) për argumentimin e pejgamberizmit të tyre. Ne jetojmë në botën të cilës i kanë ardhur Pejgamberët si reformatorë dhe të cilën e kanë mësuar se si të jetohet më mirë dhe më bukur.

Mu'xhizja e tyre është mu kjo reformë shoqërore.

Kjo është leje e hapët për çdonjërin që dëshiron të shpallet si pejgamber i Zotit. Mjafton të thotë se është i dërguar nga Zoti, dhe asgjë tjetër.

Nuk e di përse Mirza Husein Ali të tërë këtë e ka quajtur fe, respektivisht, religjion, që i është shpallur nga Zoti?

Përse këtë nuk e ka quajtur aspekt shoqëror, të lindur nga inspirimi i vet, sikurse të gjithë të tjerët?

Përse i ka lejuar vetes të thotë se ka kontaktuar me Atë, i Cili është jashtë kësaj bote, pasi që nuk i ka besuar asaj bote dhe engjëjve në të?

Vallë, a mos i verbëri duhet ta detyrojë atë që sheh?

Vallë, a ekziston Dielli nëse e mohon ai që nuk mund ta shohë?

Vallë, a duhet të ndjekim shumicën që nuk sheh, vetëm për arsye se ajo paraqet shumicë? Si është e mundur të quhet fe diç që mohon mu'xhizet dhe nuk pranon botën metafizike?

Këto janë vetëm disa pyetje, të cilat e kanë vetëm një përgjigjje.

Këto janë gënjeshtra të atij që ka dashur të hyjë në oborrin pejgamberik pa kualifikime, që është orvatur të hyjë në shoqërinë e atyre të cilët janë të amshueshëm pa provime. Andaj edhe i ka mohuar mu'xhizet dhe botën metafizike në mënyrë që disi t'i ikë atyre që prej tij kërkojnë shkresat akreditive në ambasadën e Zotit, në të cilën disponon të drejtën.

Këto gjëra zbulojnë të gjitha rreziqet që fshihen mbrapa qasjes ezoterike të Kur'anit... Rreziqet të cilat paraqiten për shkak të lënies pas dore qasjes ezoterike, respektivisht, qasjes e cila është e bazuar në kuptimin e jashtëm të vetë fjalëve dhe shprehjeve. A është e mundur që këto qasje të Kur'anit, dhe të ngjashme me këto, ta anulojnë me themel religjionin?

Këtë e kanë praktikuar me të vërtetë harixhinjtë, keramitët dhe shumë grupacione të tjera, të cilët e kanë komentuar Kur'anin në përputhshmëri me të kuptuarit e tyre, e gjatë qërimit të hesapeve ndërmjet veti.

Kjo kërkon prej nesh të marrim qëndrim unik rreth çështjes së egzegjezës të tekstit kur'anor dhe t'i përmbahemi atij, e kjo do të thotë që në mënyrë të prerë të lidhemi për shprehjen dhe kuptimin e jashtëm të ajeteve kur'anore. Kalimi në komentimin ezoterik është i lejuar vetëm atëherë kur në të na sinjalizojnë fjalët e Kur'anit. Kur'ani duhet komentuar me Kur'an përkitazi me kuptimin e tij të brendshëm dhe të jashtëm. Kuptimi i brendshëm i Kur'anit nuk guxon të bie në kundërshtim me kuptimin e jashtëm. Komentimi i brendshëm i Kur'anit është i pranueshëm vetëm atëherë kur është në shërbim të kuptimit të jashtëm dhe kur vjen si verifikim i domethënies së jashtme të fjalëve kur'anore, por megjithatë kjo lejohet vetëm atëherë kur është e domosdoshme. Këta janë kufijtë që i dikton vetë natyra e Kur'anit.

Vetëm në këtë mënyrë mund t'ia ruajmë Kur'anit vendin e tij, i cili edhe i takon, kurse pejgamberizmit të tij - pacenueshmërinë, respektivisht, shenjtërinë. Me Kur'anin, e kjo qëndron edhe në këtë Libër hyjnor, ka përfunduar cikli i shpalljeve.

BOTA E PADUKSHME

Kur'ani veçohet me disa sure më të gjata ku flet për ndodhi që bëjnë pjesë në fshehtësitë e botës së padukshme. Mendja e jonë para këtyre informatave mbetet e habitur dhe e pafuqishme. Ne nuk jemi në gjendje ta kuptojmë e as ta mohojmë atë. Gjendemi para zgjedhjes tejet të vështirë. A ta besojmë atë botë të padukshme, apo ta mohojmë? Këtu para nesh gjenden faktet të cilat nuk kanë shenja konkrete.

Komentimi i këtyre gjërave të padukshme, sipas mendimit tim paraqet provim të madh të imanit tonë. Si dëshmi për këtë mund të na shërbej edhe kjo që Kur'ani thotë për besimtarët:

"Ata, të cilët i druajnë Zotit të tyre edhe atëherë kur nuk i sheh askush, dhe ata brengosen për çastin e Ditës së Kiametit." (El-Enbija: 49).

"Ata, të cilët e besojnë botën e padukshme..." (El-Bekare: 3)

Kjo përsëritet në shumë ajete kur'anore, kurse ka të bëj me ata, të cilët besojnë me zemër, të cilët nuk kërkojnë shenja, të cilët nuk i apostrofojnë argumentet dhe të cilët nuk i jipen polemizimit.

Kur'ani tërheq vërejtjen se polemizimi dhe zënka me fjalë mes veti është një nga veçoritë e qortuara të njeriut: "...por njeriu, më tepër se çdokush tjetër, është polemizues." (El-Kehf: 54).

Besimi është më parë ndjenjë sesa teori, i cili përqafohet në bazë të argumenteve. Ai është gjendje e zemrës para se të jetë filozofi racionale. Si provim të kësaj gjendjeje të zemrës dhe të kësaj pozite të saj, Zoti në Kur'an na prezenton fshehtësitë e botës së padukshme, të cilat nuk mund t'i mohojmë e as t'i pohojmë me argumente. Në këtë mënyrë Ai na zbulon para vetes sonë. Dhe ja! Ne refuzojmë dhe gënjejmë megjithëse pohojmë se posedojmë iman, ndërsa nga imani, në realitet ka mbetur vetëm mbështjellësi, vetëm polemizimi i thatë.

Si shembull për këto fshehtësira përmendim: engjëjt, xhinnët, Ditën e gjykimit, Arshin, Kuraijjin, siratin, berzahin, shpirtin, mizanin, Levhi-Mahfudhin.[8] Sekreti më i madh, pa dyshim është djalli - Iblisi dhe shoqëria e tij. Për të All-llahu xhel-le shanuhu thotë: "...Ai ju sheh, ai dhe shoqëria e tij, prej nga ju nuk i shihni ata. Ne i kemi bërë djajtë ndihmësa të atyre që nuk besojnë." (El-A'raf: 27).

"Kush bëhet i verbër që të mos e madhërojë Mëshiruesin, Ne do t'ia ngarkojmë djallin dhe ai do t'i bëhet shok i pandashëm i tij". (Ez-Zuhruf: 37).

---

[8] Engjëjt: krijesa; xhinnët qenie të padukshme shpirtërore - të mirë ose të këqij; Dita e gjykimit: dita; Arshi: froni i All-llahut xhel-le shanuhu; Kuraijj:; sirat:; berzah:periudha mes vdekjes dhe ringjalljes; mizan:; Levhi-Mahfudh: tabela (libri) e fateve, në të cilën janë shënuar ngjarjet e paracaktuara. (shën. për.)

Tregimi për këtë shoqërim të djallit përmendet në shumë vende në Kur'an. Në Ditën e gjykimit, atëherë kur çdonjërit do t'i zbulohet shoku i vet satanik, do të shohë se ai gjithnjë ka qenë xhinn, dhe se roli i tij gjatë tërë jetës së njeriut ka qenë nxitja në të keqe. Kur t'i zbulohet shoku i tij dhe kur t'a shohë atë, atëherë do të klithë duke u penduar:

"Ah, sikur të ishte fati që largësia mes meje e teje të kishte qenë sa mes lindjes e perëndimit të Diellit. Sa shok i keq paske qenë!" (Ez-Zuhruf: 38).

Ky ajet është delikat dhe i paqartë. ne e dimë se dy pikat më të largëta në Tokë janë Lindja dhe Perëndimi. Por, në këtë ajet qëndron: "Ah, sikur të ishte fati që largësia mes meje dhe teje të kishte qenë sa mes lindjes e perëndimit të diellit!", domethënë largësia skajore.

Kjo është e mundur të komentohet vetëm nëse perëndimi i diellit është njëkohësisht edhe lindja e tij në vend tjetër, e kjo është e mundur vetëm nëse toka ka formë sferike e cila lëvizë, kështu që "largësia nga lindja gjer te perëndimi", me të vërtetë është pika më e largët, diç që është edhe më larg se ajo që gjendet mes lindjes e perëndimit.

Ky ajet tregon sheshazi se sa gjëra sekrete gjenden në Kur'an, kurse kuptimi i tyre kërkon dhe rivendikon përpjekje maksimale. Këto ajete dhe të ngjashme me to, asokohe nuk kanë mundur të komentohen.

Kjo është shenjë se shoqërimi me xhinnin është gjë e padukshme, tani e pakuptueshme, por sigurisht do të sqarohet kur të vijë koha. Ne duhet të besojmë nëse kemi zemër, ndjenja, natyrën dhe shpirtin të cilit i përkujtohet e tërë ajo që i ka ndodhur në mbretërinë qiellore.

Besimi me zemër në xhinnët dhe engjëjt është dëshmi e një kujtese të mjegulluar të botës dhe jetës në mbretërinë qiellore. Ky besim tregon në diç, e kjo assesi nuk mund të jetë nënshtrim i thatë.

Zoti në Kur'an gjithashtu na lajmëron se njeriu nuk është i lënë vetëm xhinnëve, por se ai e ka shokun e vet edhe në mesin e engjëjve, i cili është gjithnjë pranë tij dhe i cili e inspiron të bëj vepra të mira.

Në ditën e gjykimit ky engjëll do të paraqitet për të dëshmuar dhe për të raportuar për pronarin e tij.

"E, shoku i tij do të thotë: "Ky, pranë meje, është i gatshëm." (Kaf: 23)

Pastaj, ekzistojnë engjëjt shkrues dhe engjëjt mbrojtës, të cilët gjenden në shërbim të njeriut, ndërsa njeriu nuk i sheh: "E, mbi ju vigjilojnë rojtarët, që janë të respektuar tek Ne, të cilët e dinë se çka punoni." (El-Infitar: 11-12).

Pastaj engjëjt e Fronit (Arshit): "...e atë ditë, tetë do ta mbajnë mbi ta Arshin e Zotit tënd." (El-Hakka: 17).

Si do ta mbajnë tetë engjëj Fronin e Zotit? A mos janë këtu tetë rreshta, e në çdo rresht gjenden engjëj në numër të pakufizueshëm, apo këtu ka të bëj me tetë ligje fizike apo metafizike? Këtë askush nuk e di. Kur'ani nuk na informon se çka fshihet pas numrit tetë?

Pastaj, çka është Froni? A është ky simbol?

Çka është Karrigeja (Kursija)?

Zoti në ajetin kursij thotë: "Kursija (Karrigeja) e Tij përfshinë qiejt dhe Tokën" (El-Bekare: 255).

Nëse është kaq e madhe Karrigeja e Tij, atëherë sa është i madh Froni i tij dhe si është e munduar ta mbajnë atë krijesat, apo këtu, ndoshta, është fjala për krijesa tërësisht të panjohura për ne. Ndoshta ato jonë ndonjë lloj krijesash elektro-magnetike?

Ndoshta Froni është vetëm metaforë, siç flasim për Ka'ben në kuptimin figurativ "Shtëpia e Zotit", gjithashtu në kuptimin figurativ flasim edhe për Fronin e Zotit.

Përveç të përmendurve aty është edhe Xhibrili - i Dërguari i engjëjve.

Nga Pejgamberi i Zotit transmetohet se e ka parë dy herë në formën dhe fizionominë e tij të vërtetë. Hadithi përmend se njëra prej këtyre pamjeve ka ndodhur në Bekijje në një natë të ndriçuar nga drita e hënës. Engjëlli me madhësinë e vetë e ka mbushur horizontin dhe Pejgamberit alejhis-selam i ka ra të fikët nga frika.

"Ai e ka parë edhe një herë tjetër, tek Sidretul-muntehaja." (En-Nexhm: 13-14)[9]

Fuqia dhe karakteristikat e tjera të Xhibrilit janë përshkruar në suren *Et-Tekvir*: "Me të vërtetë, Kur'ani është thënia e të Dërguarit fisnik, të fuqishëm, të çmuar nga Zoti i Gjithësisë." (El-Tekuir: 19-20).

[9] Sidretul-munteha: të paraqiturit simbolikisht të kufirit më të skajshëm të dijenisë njerëzore. (shën. përk.)

"I Dërguari fisnik" këtu është Xhibrili i fuqishëm, i çmuar nga Sunduesi i Gjithësisë. Pastaj ai është edhe mësues. Kur'ani thotë se ai posedon fuqi të hatashme: "Kjo (që flet ai) është vetëm Shpallja e cila i proklamohet atij, e mëson atë njëri me fuqi të madhe." (En-Nexhm: 4-5)

Nga Kur'ani më tej mund të kuptohet se ai do të zbret edhe në tokë, në çfarëdo forme qoftë dhe të sjellë Shpalljen cilitdo Pejgamber qoftë, në ndonjë shekull, në çfarëdo gjuhe qoftë.

Për engjëjt e tjerë, me pozitë më të ulët, Kur'ani flet me gjuhën e tyre: "Çdonjërit prej nesh i është caktuar vendi.", që do të thotë se çdonjëri prej tyre ka detyrë dhe punë të caktuar. Punët e tyre, degëzueshmëria e tyre dhe mundësia e veprimit tek engjëjt nuk janë aq të shumta sikur tek njeriu. Njeriu ka përparësi më tepër se shumë engjëj. All-llahu ia ka mësuar Ademit "emrat e të gjitha gjërave", e kur i ka pyetur engjëjt për emrat e atyre gjërave, ata janë përgjigjur: "I lavdëruar qofsh Ti! Ne dimë vetëm atë që na ke mësuar Ti."

Emrat këtu janë dituritë e shumta me të cilat Zoti e ka veçuar njeriun mbi të gjitha krijesat e tjera.

Gjithashtu Zoti na informon se engjëjt nuk kanë gjini të caktuar. Ata nuk janë mashkuj, nuk janë as femra dhe nuk shumëzohen. Ata nuk pinë dhe nuk hanë, siç bëjmë ne. Engjëjt janë vetëm krijesa të Zotit. Ata jetojnë në dëgjesë të plotë, nuk kanë të drejtë e as liri që të mos jenë të dëgjueshëm sikurse njeriu.

"...të cilët nuk u kundërshtohen urdhërave të All-llahut dhe do ta kryejnë atë që u urdhërohet." (ET-Tahrim: 6)

Për xhinnët All-llahu thotë se disa prej tyre janë të mirë e disa të këqij. Ata shumëzohen. Ata dëgjojnë se çka ndodhë në botën e njeriut dhe njerëzve u imponojnë mendime të këqija. Disa prej

tyre tentojnë të kuptojnë se çka ndodhë edhe në sferat më të larta, duke u orvatur që në këtë mënyrë të vijnë tek konceptimi edhe i asaj që është e padukshme, por në këtë nuk kanë sukses. Disa prej tyre e sulmojnë njeriun duke u përpjekur që t'i sjellin mynxyra, por ata nuk mund ta bëjnë këtë pa vullnetin e Zotit, sikurse që edhe shërimi nuk do të kryhet pa vullnetin e Zotit. Përpjekja që të fitohet simpatia e xhinnëve me anë të flijimeve për qëllim shërimi është haram. Gjithashtu është haram të thirret xhinni në ndihmë.

"Dhe ka pasur njerëz që kanë kërkuar ndihmë nga xhinnët, e në këtë mënyrë ia kanë rritur atyre çamarrokësinë *(mendjemadhësinë)*." (El-Xhinn: 6).

Me fjalët e vetë xhinnëve Kur'ani na flet për përgjimin e tyre: "Ne jemi përpjekur ta prekim qiellin, por jemi vërtetuar se aty ka shumë roje të forta dhe yje rënëse *(meteorë)*, dhe kemi ndejtur rreth tij, nëpër vende të përshtatshme për të dëgjuar diçka, por ai që përgjon tani, do të hasë në yje rënëse që janë në prita *(pusia)* dhe ne nuk dimë se a i përgatitet diçka e keqe atyre në Tokë, apo Zoti i tyre u dëshiron mirësi, e midis nesh ka të mirë dhe ka që nuk janë të mirë, ka prej nesh kategori *(lloje)* të ndryshme". (El-Xhinn: 8-11).

Kur'ani më tej konfirmon se për xhinnin bota e padukshme është e panjohur. Ai më kot e përgjon atë botë.

"Ata assesi nuk mund të përgjojnë." (Esh-Shu'ara: 212).

Ata janë të vdekshëm sikurse edhe njerëzit. Ata do të ringjallen dhe do të japin llogari për veprat e tyre.

Kur'ani na tregon se çka ka punuar xhinni në kohën e Sulejmanit alejhis-selam dhe si i ka nënshtruar ata këtij Pejgamberi.

"...Dhe, ia nënshtruam Sulejmanit disa nga xhinnët, të cilët punonin para tij me lejen e Zotit të tij. E, kushdo prej tyre që largohej nga urdhëri Ynë, bënim që ai ta shijojë vuajtjen e zjarrit. Ata i punonin atij ç'dëshironte: tempuj dhe përmendore, enë të gjera si saranxhat dhe kazana të mëdhenj - të palëvizshëm *(për shkak të madhësisë)*." (Seb'e': 12-13).

Pastaj na informon për rrëmbimin e fronit të Belkises, e thotë: "Unë do ta sjellë" - tha Ifriti, njëri nga xhinnët - "para se të ngritesh nga kjo ulëse e jote, unë jam i fuqishëm dhe i sigurt." E, unë do ta sjellë" - tha ai i cili kishte mësuar nga Libri - "sa çel e mbyll sytë." Dhe kur Sulejmani pa se tanimë froni është vuar para tij, thërriti: "Kjo është mirësi e Zotit tim i Cili më sprovon se a jam mirënjohës apo jo. E, kush është mirënjohës - është mirënjohës në dobi të vetë, e, kush është jomirënjohës - megjithëkëtë Zoti im është i pavarur dhe fisnik." (En-Nemlë: 39-40).

Nga ajeti kuptojmë se "ai i cili kishte mësuar nga Libri" ka qenë më i fuqishëm se xhinni. Ai ka ardhur me fron sa çel e mbyll sytë. Edhe për të dytën herë Kur'ani tregon për paditurinë e xhinnit në suren *Seb'e'*:

"E, kur ia caktuam vdekjen, në të askush nuk i udhëzoj pos një krimbi. Dhe pasi u rrëzua, xhinnëve u bë e qartë se nuk do të mbeteshin të turpëruar sikur të mundnin ta dinin ardhmërinë. (Seb'e': 14).

Sulejmani ka vdekur duke qëndruar në këmbë i mbështetur në shkopin e tij, duke u lutur në tempull. Një kohë të gjatë qëndroi ashtu. Xhinnët, të cilët punonin atë që u kishte urdhëruar,

edhe më tej punonin duke menduar se ai është gjallë dhe se në tempull po i lutet Zotit. Vetëm atëherë kur krimbi ia brejti shkopin, në të cilin ishte mbështetur Sulejmani alejhis-selam, ai u rrëzua dhe xhinnët kuptuan se ai kishte vdekur, e kjo është shkalla më e lart e mosdijes së tyre.

Kur'ani gjithashtu na informon se All-llahu xhel-le shanuhu ia ka mësuar Sulejmanit alejhis-selam gjuhën e shpesëve dhe gjuhën e thneglave. Në Kur'an qëndron: "Dhe kur arritën në luginën e thneglave, një thnegël tha: "O thnegla, hyni në banesat tuaja që të mos ju shkel Sulejmani dhe ushtria e tij, e këtë as mos ta vëreni." E, ai qeshi zëshëm në fjalët e saj dhe tha: "O Zoti im, ma mundëso të jem mirënjohës në dhuntinë Tënde, që më ke dhënë mua dhe prindërve të mi, dhe që të bëj vepra të mira, me të cilat do të jesh i kënaqur Ti, dhe më shpie, me mëshirën tënde, në mesin e robërve Tu të mirë! (En-Nemlë: 18-19).

Ky rrëfim dhe rrëfimet të tjera ngjashme me këtë përkitazi me gjuhën e thneglave në të kaluarën ka qenë gjë e jashtëzakonshme. Sot shkenca, në bazë të vëzhgimeve, pohon se thneglat kanë gjuhën e tyre, e gjithashtu edhe bletët, si dhe të gjitha llojet e insekteve të cilat përbëjnë një bashkësi. Pa gjuhë si mjet për marrëveshje do të ishte e pamundur që insektet të organizojnë jetën e tyre dhe ta bëjnë ndarjen e punës së tyre.

Andaj edhe kjo për çka na rrëfen ajeti paraprak është e mundur.

Pastaj vijmë tek djalli për të cilin Kur'ani thotë se ai dhe shoqëria e tij i takojnë xhinnëve. Ata janë të mospërfillur dhe do të jetojnë gjer në Ditën e gjykimit. Në Ditën e gjykimit do të vdesin, e pastaj përsëri do të ringjallen, në mënyrë që pas kësaj përgjithmonë të qëndrojnë në Xhehennem.

Djajtë janë ata, të cilët ia kanë mësuar njeriut magjitë (sehiret), dhe si ta ndajnë burrin prej gruas.

Kur'ani na rrëfen se sehiri është paraqitur për të parën herë në Babiloni, ku kanë zbritur dy engjëj në formë të njeriut të quajtur Harut dhe Marut. Zoti ka dashur që me anë të tyre t'i sprovojë dhe t'i riprovojë njerëzit. Në Kur'an gjithnjë përmendet sprovimi i njeriut në të mirë dhe në të keq.

"Çdo krijesë e gjallë do ta shijojë vdekjen! Ne ju vëmë në sprovë me të keqe dhe me të mirë." El-Enbija: 35).

E keqja në ajetin paraprak është përmendur para së mirës si mjet sprovimi.

Rrëfimi mbi Harutin dhe Marutin është shpallur në suren El-Bekare: "...Sulejmani nuk ka qenë mosbesimtar, por djajtë janë mosbesimtarë (patën mohuar), që u mësonin njerëzve magjinë dhe çka u zbriti dy engjëjve, Harutit dhe Marutit, në Babiloni. E këta dy nuk e mësonin askënd para se ti thoshin: "Ne vetëm ju sprovojmë, e ti mos u bënë mosbesimtar!" Dhe njerëzit mësonin prej atyre dyve se si ta ndajnë burrin prej gruas, por me këtë nuk mund t'i bënin dëm askujt pa vullnetin e All-llahut. Dhe mësonin atë që do t'u bën dëm atyre dhe prej çkafit nuk do kenë kurrfarë dobie..." (El-Bekare: 102).

Në këtë mënyrë Zoti vërteton se sehiri, madje edhe ai që është i dëmshëm për njeriun, len gjurmë vetëm me vullnetin e Zotit.

Me këtë, në mënyrë të tërthortë, është i pranuar sehiri dhe është verifikuar mënyra e shpalljes së tij, historiku dhe vendi, por Kur'ani edhe më tej vazhdon t'i shënojë magjitë dhe magjistarët: "...E, magjistari, nuk do të ketë sukses, kudo që të gjendet." (Ta Ha: 69).

"A mos vallë, për të Vërtetën e cila ju ka ardhur thuani se është magji?" - tha Musai - "E , magjistarët kurrë nuk do t'ia dalin!" (Junus: 77).

Ky sehir për të cilin flet Kur'ani dhe i cili është përmendur për të dytën herë në rrëfimin që ka të bëj me Musain alejhis-selam dhe faraonin, kur faraoni i kishte sjellur magjistarët e vet, litarët e të cilëve ishin shndërruar në gjarpinj të gjallë, dhe për të tretën herë në rrëfimin që i përket Samirijjit, i cili, me ndihmën e magjive, ka bërë një viç të artë i cili pëlliste, pastaj rrëfimi që ka të bëj me magjistarët, të cilët frynin në nyje. Ky sehir pra ka qenë dhe është zhdukur, gjersa ai me të cilin ne ballafaqohemi sot është diç krejtësisht tjetër. Nga magjistarët sot kanë mbetur vetëm bastardët, të cilët flasin atë që nuk dijnë dhe konfirmojnë diç që nuk janë në gjendja ta bëjnë. Doreshkrimet e vjetra, në të cilat ka qenë e shënuar kjo dituri, kryesisht janë zhdukur. Kanë mbetur vetëm tregimet, në të cilat shkenca është gërshetuar me përralla. Gjithashtu thirrja e xhinnëve dhe tubimi i tyre është dituri shumë e ligë, bazat e së cilës i njeh vetëm një rreth i ngushtë.

Shkenca nuk din, e arsyeja nuk kupton. Kjo do të ishte shkurtimisht përkitazi me qëndrimin e shkencës dhe arsyes për këto çështje dhe për çështje të tilla.

Disa fenomene, të cilat i përkasin sehirit, siç është për shembull hipnoza, shkenca i pranon megjithëqë kësaj nuk mund t'i gjejë shpjegim.

Shkence edhe sot e kësaj dite nuk e din se si gjumësjellësi mund të arrijë ta mbizotërojë dhe t'ia nënshtrojë vullnetin e njeriut të fjetur vullnetit të vetë. Atë që sheh gjumësjellësi sheh edhe njeriu i fjetur. Në pyetjet që i bën gjumësjellësi njeriu i fjetur i përgjigjet qoftë edhe nëse kërkon prej tij që të fluturojë nëpër ajër.

E tërë ajo që ka bërë shkenca në këtë rast reduktohet vetëm në terminologji dhe asgjë tjetër.

Ngjashëm me këtë janë edhe fenomenet e telepatisë, të zbuluarit (keshfit), parashikimit (luciditetit) etj.

Kjo është ndoshta edhe më e çuditshme se sehiri. Shkenca këtë vetëm e regjistron, kurse nuk e shpjegon.

Ndërsa berzahu është periudha mes vdekjes dhe ringjalljes.

"... E pas tyre është hapësira e cila e ndanë çastin e vdekjes nga dita kur do të ringjallen." (El-Mu'minun: 100).

Kur'ani gjithashtu flet për domethënien e berzahut edhe në këto ajete: "Ai i ka lënë dy detëra njërin pranë tjetrit - njëri është i pijshëm e i ëmbël, e tjetri është i njelmët e i hidhët, ndërsa ndërmjet tyre ka vënë parmakun berzah dhe pendën e padukshme." (El-Furkan: 53).

Kur'ani flet për ujërat e njelmëta të detit dhe të ëmbla të lumenjve. Se si ata bashkohen dhe derdhen njëri në tjetrin dhe se si është eliminuar përzierja e ujit të pijshëm me atë të njelmëtin. Nëpër lumenj edhe më tej gjendet uji i ëmbël, ndërsa në dete - uji i njelmët, sepse Zoti mes tyre ka vënë parmakun. Domethënia e njëjtë përsëritet edhe në suren *Er-Rahman:* "I ka lëshuar dy dete të takohen *(të preken)*, e mes tyre është parmaku dhe ata nuk përzihen." (Er-Rahman: 19-20).

Nga këto ajete shihet qartë se këtu nuk bëhet fjalë për dheun i cili i ndanë. Dheu nuk paraqet pengesë që lumenjtë të mos derdhen nëpër dete e oqeane. Ligjet natyrore kanë bërë që oqeanet të gjenden në ultësirat më të mëdha të Tokës, e në to të derdhen lumenjtë nga lartësirat malore. Në të kundërtën do të vinte gjer tek përzierja e ujit të pijshëm me atë të njelmët. All-llahu xhel-le shanuhu ka bërë që oqeanet të rrisin nivelin e tyre gjatë baticës (ndikimi i fuqisë tërheqëse e

Hënës). Sikur Hëna të ishte më afër Tokës atëherë edhe batica do të ishte më e madhe, kjo ndoshta do të shkaktonte që oqeanet të derdhen në lumenj kështu që ujërat do të përziheshin dhe ndoshta më nuk do të gjendej as një pikë ujë i pijshëm.

Berzah (parmaku, pengesa), hixhrun mahxhurun (penda e padukshme) etj. tregojnë në ligjet e fizikës, të cilët caktojnë vendin dhe kufirin e çdo gjëje.

Kjo mund të mirret si komentim i kësaj që Kur'ani thotë për të vdekurit: "... E pas tyre është hapësira e cila e ndanë çastin e vdekjes nga dita kur do të ringjallen." (El- Mu'minun: 100).

Këtu berzahu nuk do të thotë ndonjë parmak i gjerë, i cila do t'i ndante shpirtrat e të vdekurve nga jeta e dynjallëkut (kësaj bote), por berzahu këtu ka kuptimin e ligjeve, të cilët do ta pengojnë këtë. Shpirtrat pas vdekjes fillojnë një jetë specifike për ta. Andaj është e pamundur që ata të flasin me ne, e as që mundemi ne të flasim me ta, sepse mes nesh gjendet berzahu, parmaku, respektivisht ligjet e kësaj bote të cilët dallojnë nga ligjet sipas të cilëve vijon jeta në botën shpirtrave. Ndoshta shpirtrat gjenden këtu, rreth nesh, por kontaki me ta është i pamundur për shkak të dallimeve në ligje sipas të cilëve ato ekzistojnë nga ligjet sipas të cilëve zhvillohet jeta jonë.

Nga këto ajete gjthashtu kuptojmë se Kur'ani përdorë edhe shifrën kur flet për fshehtësitë dhe botën e padukshme. Ky nuk është libër që flet mbi hidraulikën apo fizikën dhe nuk hynë në detaje shkencore. Ai kënaqet vetëm me një fjalë e cila udhëzon, për shembull berzah, fjalë e cila inspiron, pastaj na lë të mendohemi, a të besojmë apo të mos besojmë.

Për sa i përket kalemit (pendës) dhe Levhit (pllakës), shohim se All-llahu xhel-le shanuhu betohet në pendë dhe në atë që shkruajnë ato:

"Nun. Pasha pendën dhe në atë që shkruajnë ato." (El-Kalem: 1)

Kjo nuk është pendë me të cilën shkruajmë ne. Kjo është pendë e Zotit me të cilën Ai e shkruan kësmetin në lehvi-mahfudhu (pllakën ë famshme), apo ndoshta ka të bëj me pendën, me të cilën shkruajnë engjëjt.

"All-llahu shlyen çka të dojë, e ngulitë (përforcon) çka të dojë. Tek Ai është Libri amë (ummul-kitabi)." (Er-Ra'd: 39).

Kjo e folme habitë. Nga kuptimi i jashtëm i ajetit jipet të kuptohet se Zoti shkruan dhe shlyen sikurse edhe ne. Ky komentim nuk është i saktë. Këtu është fjala për magfiretin (faljen) e Zotit i cili arrinë edhe gjer tek shlyerja e mëkateve. Zoti i shlyen mëkatet toNe, duke na frymëzuar me vepra të mira.

"... Me të vërtetë, veprat e mira i shlyejnë veprat e këqija..." (Hud: 114).

Zoti është i lirë të bëj çka të dojë. Nuk do të pyetet për atë se çka ka bërë. Në këtë mënyrë Zoti u ka dhënë gjasë edhe atyre të cilët pendohen. Ky është argument i lirisë absolute dhe mëshirës së madhe të Zotit.

Këtë liri absolute e kuptojmë edhe në saje të asaj se ç'na thotë Kur'ani përkitazi me ditët e Zotit. Në një ajet All-llahu xhel-le shanuhu thotë: "... Me të vërtetë, vetëm një ditë te Zoti yt është sa një mijë vjet sipas numrimit tuaj *(në këtë jetë)*." (El-Haxhxh: 47).

Ndërsa në një ajet tjetër thotë për engjëjt si vijon: "Engjëjt dhe Xhibrili ngjiten tek Ai për një ditë që zgjatë pesëdhjetë mijë vjet." (El-Mearixh: 4)

Kjo do të thotë se dita e Zotit zgjatë sa të dojë Ai vetë. Njëra zgjatë një mijë vjet, ndërsa tjetra pesëdhjetë mijë vjet. Ai nuk është i varur nga koha siç jemi ne. Ai është mbi kohën.

Të gjitha këto domethënie ndriçojnë, e mendja as që i vëren, përderisa nuk angazhohemi më tepër në këtë drejtim. Mësimi i Kur'anit sipas mendimit tim është xhihad. Kush e mëson Kur'anin ngadal dhe qetas, e pastaj mohon atë që gjendet në të, ai i ka sjellur zullum vetit e jo Kur'anit.

Prej të gjitha gjërave që janë thënë në Kur'an, thellësia më e madhe i përket botës së padukshme. Ndoshta në një fjalë prej dy shkronjash, të cilën e len m'anash, prehet fshehtësia e tërë ekzistencës sate, e ndoshta e lexon ndonjë fakt duke e tundur kokën dhe thua: Si është e mundur kjo? Kjo është përrallë. Kjo nuk është logjike vetëm për shkak se ke lexuar ndonjë vepër në gjuhën angleze, andaj në saje të kësaj konsideron se je njeri i kulturuar.

Përgjigjja më e mirë për ty dhe të ngjashmëve me ty janë fjalët e Isait alejhis-selam: "Nëse punon sipas asaj që di, Zoti do ta zbulon edhe atë që nuk e di."

Nëse e ndjek shtegun e atij i cili sinqerisht kërkon dituri, i cili lexon nga dituria çdo gjë që i vie në dorë, i cili kupton atë se çka gjendet në to, dhe i cili pastaj të gjitha ato i zbaton në praktikë, Zoti do t'ia mësojë edhe atë që nuk ka ditur, e do të kuptojë edhe atë që ka menduar se është e parëndësishme.

Ky është shtegu i mistikëve islamik, të cilët të paqartën e kanë konceptuar me keshf (zbulim) dhe ru'je (të pamurit), e kjo prapë do të thotë mësimi dhe puna sipas Kur'anit, aplikimi i çdo shkronje

të tij, thirrja e përkortë të Zotit me emrat e Tij të bukur, kërkimi i diturisë, përfitimi dhe zgjerimi i dijenisë.

E këtë premton edhe Kur'ani: "E, ata që luftojnë *(përpiqen)* për Ne, Ne me siguri do t'i udhëzojmë rrugëve ToNe..." (El-Ankebut: 69).

E gjithashtu edhe Inxhili: "Kërkoni e do ta gjeni! Trokisni, e do t'ju hapet!" (Mateji, 7,7)

Me kusht që trokitja në derë të jetë me zemër, e sinqertë dhe qëllimmirë. Atëherë do të jesh i stërmbushur me begatitë e Zotit, siç janë me to të stërmbushur edhe të dashurit e Tij dhe njerëzit e mirë.

"Sikur të dinte All-llahu se prej tyre mund të dalë ndonjë vepër e mirë, do t'i bënte të dëgjojnë..." (El-Enfal: 23).

Zoti kurrë nuk e ka thyer premtimin e Vet, ne jemi ata të cilët premtimet tona nuk i realizojmë.

"Edhe Ademit menjëherë në fillim i urdhëruam, por ai harroi dhe nuk u tregua i vendosur." (Ta Ha: 115)

Dhe, ja kështu, erdhëm gjer tek fshehtësia më e madhe, gjer tek kiameti.

Kiametit është fshehtësi, të cilën All-llahu xhel-le shanuhu askujt nuk ia ka zbuluar, madje as të dërguarve të Vetë.

"Të pyesin ty kur do të ndodhë Dita e Kiametit. Thuaju: "Atë e di vetëm Zoti im. Ai do ta zbulojë atë në kohën e tij, e (tmerret e Ditës së Kiametit) do të jenë të rënda për qiejt dhe Tokën,

do t'u vijë krejtësisht papritmas." Të pyesin, thuajse ti di diçka për të. Thuaj: "Këtë e di vetëm All-llahu, por shumica e njerëzve nuk e kuptojnë këtë (të vërtetë)." (El-A'raf: 187)

Se kur do të ndodhë Kiametit vetëm Zoti e di dhe askush tjetër. Kjo do të jetë pamje e tmerrshme.

DITA E GJYKIMIT

Dita e gjykimit është kulminacioni i botës së padukshme. Për të askush nuk din gjë, pos All-llahut xhel-le shanuhu Kjo është veçori vetëm e Zotit, dhe e askujt tjetër. Mirëpo, All-llahu xhel-le shanuhu në Kur'an na informon për disa shenja të kësaj dite. Disa prej këtyre shenjave Ai i ka përshkruar me këto fjalë:

"Andaj ti prite ditën kur do t'iu duket se kah qielli shohin tym të dukshëm, i cili do t'i mbulojë njerëzit. Kjo është vuajtje e padurueshme! "O Zoti ynë, largoje vuajtjen nga ne, ne me siguri do të besojmë!" E, si do të marrin ata mësim, kur tanimë u ka ardhur Pejgamberi i vërtetë, të cilit ia kthejnë shpinën dhe thonë: "I mësuar - i çmendur!" Ne do ta largojmë vuajtjen pak nga pak, e ju me siguri do të ktheheni *(në politeizëm)*, por atë ditë kur do t'i rrëmbejmë me tërë forcën - Ne me të vërtetë do t'i ndëshkojmë." (Ed-Duhan: 10-16).

Edhe Zbulimi i apostolit Ivan gjithashtu tregon në këtë tym: *"Kur ai e hapi grykën - Humnerën, nga gryka "u ngrit tymi i Furrës" gjigante, dhe e "errësoi diellin", ajri prej tymit nga gryka."*

Apostoli Ivan në Zbulimin e vet thotë se ky tym nuk do t'i mbytë njerëzit, por do t'i mundojë ata pesë muaj radhazi: *"Gjatë atyre ditëve njerëzit do të kërkojnë vdekjen, por nuk do ta gjejnë, do të dëshirojnë të vdesin, por vdekja do të ikë prej tyre."* (Zbulimi-9, 2-7).

Kjo është dukuri natyrore. Kur'ani flet për këtë sikurse edhe Zbulimi i apostolit Ivan. Kjo dukuri është tërësisht identike edhe në njërin edhe në tjetrin burim.

Gjendemi para tymit, i cili do ta mbulojë Tokën dhe do ta errësojë Diellin. Kjo është vuajtje për njerëzit gjer në kohën e caktuar, kur Zoti do te largojë këtë vuajtje.

Për shenjat e tjera të Ditës së gjykimit Kur'ani thotë në suren En-Neml: "Dhe, kur të vijë koha që ata të ndëshkohen, Ne do të bëjmë që nga Toka të del një kafshë, e cila do t'u thotë atyre..." (En-Nemlë: 82). "U afrua çasti dhe Hëna u ça!" (El-Kamer: 1). Zoti ia dërgon Pejgamberit një fjalim dhe i thotë që t'ia tërheq vërejtjen çdo dhunuesit për këtë Ditë: "Dhe terhiqjau vërejtjen atyre për Ditën e afërt të gjykimit, kur zemrat do t'u vijnë deri në fyt e të gajasen, kur dhunuesit nuk do të kenë as mik të sinqert, e as ndërmjetës që përfillet." (El-Mu'min: 18).

S'ka dyshim se të gjithë do të besojnë kur do t'i shohin këto shenja, kur Hëna çahet dhe kur nga Toka del kafsha, e cila do të flasë. Atëherë më nuk do të ketë dyshim në zemrat e atij që ka dyshuar, por ky besim nuk do t'i sjellë dobi, sepse ky ka qenë i detyruar të besojë, e Zoti nuk do të pranojë iman të tillë.

"Atë ditë kur të vijnë parashenjat nga Zoti, atëherë askush nuk do të ketë dobi prej asaj që do të besojë, nëse nuk ka besuar më parë, ose nuk ka bërë ndonjë të mirë si besimtar..." (El-En'am: 158)

Zoti gjithnjë pranon besimin e atyre, të cilët besojnë në të padukshmen, pa pasur nevojë për argumente, pa pasur nevojë që ta shohin atë me sytë e tyre.

Të pamurit me zemër, e jo me shqisat e të pamurit. Bota e padukshme është provim. A e sheh vetëdija atë që nuk e sheh syri, e në saje të kësaj të bindet (të besojë) në botën e padukshme!?

Nëse e bën këtë, atëherë kjo është dëshmi se njeriu gjendet në një shkallë të lartë, se ka fushëpamje të gjerë dhe se ka përfituar të drejtën të jetë i shpëtuar. Nëse këtë nuk e bën, atëherë kjo është dëshmi se ai vetëm sheh, dëgjon dhe mendon sikurse edhe krijesat e tjera me shqisat e jashtme. Me këtë vetëm ka dëshmuar se gjendet në një nivel shumë të ulët, respektivisht, se e ka vendin në shkallën më të ulët.

Parashenja e fundit e Ditës së gjykimit janë Jexhuxhi dhe Mexhuxhi (Gogu dhe Magogu).

Ky është rrëfim mjaft enigmatik i cili përmbanë shumë simbole. Kur'ani flet për Dhulkarnejnin dhe udhëtimin e tij nëpër Tokë, e thotë: "Kur arriti mes dy bjeshkëve, gjeti afër tyre një popull, i cili, pothuaj nuk kuptonte asnjë të folme. Ata thanë: "O Dhulkarnejn, Jexhuxhi dhe Mexhuxhi bëjnë çrregullira në Tokë, a don të të japin dhuratë që të ndërtosh një mur mes nesh dhe atyre?" "Më mirë është ajo çka më ka dhënë Zoti im" - tha ai . "Por më ndihmoni ju mua sa të mundeni, e unë do të ndërtoj një mur ndërmjet jush. Më sillni copa të mëdha hekuri! E, kur ai i bashkoi dy anët e bjeshkëve, tha: "Fryni!" Pasi e skuqi si zjarri, tha: "Më sillni tunxh të shkrirë që ta hudhi në të!" Dhe kështu, ata *(Jexhuxhi dhe Mexhuxhi)* nuk kanë mundur ta kapërcejnë as nuk kanë mundur ta zhbirojnë. "Kjo është dhuntia e Zotit tim!" - tha ai. "Dhe kur të plotësohet kërcënimi i Zotit tim, Ai do ta rrepshojë atë me tokë, e kërcënimi i Zotit tim sigurisht do të plotësohet." Dhe Ne

do të bëjmë që disa prej tyre të ndeshen me të tjerët si valët *(e detit)* dhe do t'i fryhet Surit *(bririt)*, e do t'i tubojmë që të gjithë." El-Kehf: 93-99)

Këtu kemi rrëfimin tërësisht enigmatik, rreth të cilit kanë bredhur dhe ende bredhin shumë komentues të Kur'anit.

Disa prej tyre thonë se Jexhuxhi e Mexhuxhi janë pasardhësit e Jafesit, të birit të Nuhit alejhis-selam, racë e verdhë, se kanë jetuar në kohët dhe periudhat e lashta, në të cilat ka mbretëruar injoranca dhe prapambeturia. Popujt që jetonin rreth tyre kishin përjetuar një përparim jashtëzakonisht të shpejt si në shkencë ashtu edhe në industri, por, një ditë edhe ata do ta shqyejnë velin e prapambeturisë së tyre dhe do ti kthehen përparimit dhe shkencës.

Kjo nuk do të thotë se komentimi i këtij ajeti është i saktë. Të gjitha këto janë vetëm supozime. Fshehtësinë e di vetëm All-llahu xhel-le shanuhu e askush tjetër. E tërë ajo që është përmendur përkitazi me rrëfimin mbi Jexhuxhin dhe Mexhuxhin i takon supozimeve dhe hipotezave, kurse sipas mendimit të mistikëve këto janë gjëra të cilat gjenden edhe në komentimet e tyre.

Mirëpo, edhe pranë kësaj, nëse hapim kaptinën e njëzetë të Zbulimit dhe lexojmë atë se çka thotë apostoli Ivan për Gogun dhe Magogun, do të shohim se aty ka të bëj me domethënie të njëjta dhe simbole të njëjta: *"E kur kaluan një mijë vjet, satani do të jetë i liruar nga burgu. Do të dalë që t'i futë në grindje popujt "në katër anët e botës" - "Gogu e Magogu" - t'i tubon për luftë aq të shumënumërt sa rërë në det."* (Zbulimi-20, 7-9)

Cili është ai popull që numri i tyre është sa rëra e detit, që do të ndërmerrë luftë kundër botës kur të mbushen një mijë vjet? Këto janë gjëra, të cilat e trondisin imagjinatën. Këto janë shpallje të

cilat kanë ardhur ta vërtetojnë njëra tjetrën. Ne këtu nuk kemi çka të kërkojmë e as të komentojmë, Në Kur'an qëndron: "...Por, komentimin e tyre e di vetëm All-llahu..." (Ali Imran: 7).

Ai është i Vetmi që i posedon çelësat e këtyre mistereve. Ai është i Vetmi që e di se kur do të ndodhë Dita e gjykimit.

Logjikimi i lirë është i lejuar kur ka të bëj me gjërat e kësaj bote, por të jesh kategorik për gjërat të cilat kanë të bëjnë me të padukshmen është gabimi më i madh të cilin do të mund ta bënte çdonjëri që mirret me komentimin e Kur'anit, e përveç kësaj, kjo as që është në fuqinë tonë.

Kur'ani gjithashtu na informon se Dita e gjykimit do të vijë atëherë kur qytetërimi në botë arrinë kulminacionin e vet, ndërsa njeriu sendërtimin e vet të arritshëm, kur Toka të stoliset dhe të zbukurohet me veshjen e vet, kur njeriu mendon se është zotërues mbi të gjitha..., e kultivon shkretëtirën, qeverisë me shiun, shëron edhe sëmundjet pashëruese, bën transplantacionin (ndrimin) e organeve nga njerëzit e vdekur në ata të gjallët, udhëton nëpër kozmos, zbërthen atomin dhe i bartë malet prej një vendi në vend tjetër. Zoti na kërcënohet dhe na tërheq vërejtjen me fjalët: "...E, kur Toka të vishet dhe zbukurohet, dhe kur banorët e saj mendojnë se ata janë zotërues të saj, *(atëherë)* u vie urdhëri Ynë, natën ose ditën, dhe Ne e bëjmë atë si të ketë qenë e korrur, thuajse përpara nuk kishte ekzistuar asgjë..." (Junus: 24). Ajeti përmbanë një fshehtësi. Zoti thotë se Dita e gjykimit do të ndodhë natën ose ditën, e kjo është e mundur të komentohet vetëm me formën sferike të Tokës e cila rrotullohet, kështu që në njërën gjysmë është natë e në tjetrën ditë. E kur të vijë Dita e gjykimit, e sigurisht do të vijë në një çast: "...Kurse Dita e Kiametit do të vijë sa çel e mbyll sytë, ose edhe më shpejt..." (En-Nahël: 77), gjysma e banorëve

të botës do të jenë në natë e gjysma tjetër në ditë. Lajmi nuk do të ishte i saktë po qe se kishte thënë se Kiameti do të ndodhë ditën, gjegjësisht natën. Zoti kur nuk e ka thye premtimin e Vet, andaj edhe ka thënë se Kiameti do të ndodhë natën ose ditën.

Se sa është kjo e rëndësishme, shihet edhe nga fakti se kjo është përsëritur edhe në një ajet tjetër i cili flet për Ditën e Kiametit: "Thuaj: "Më thuani ju mua: nëse do t'ju godit dënimi i Tij natën ose ditën, atëherë përse e nxitojnë atë politeistët?" (Junus: 50). Për herën e dytë flet se kjo vuajtje e papritur do të ndodhë natën ose ditën... Ky është për ne sinjal që të mendojmë për këtë. Dhe, ja kështu, me Kur'an arrijmë gjer tek shenja e fundit e Ditës së Kiametit, e kjo është zëri i borisë dhe fillimi i Ditës së gjykimit.

Skenat e Ditës së gjykimit do të jenë të tmerrshme. Gjaku do të ngrihet në damarë. Dielli do të errësohet, Hëna gjithashtu, bjeshkët do të rrënohen, yjet do të bien, detet do të mbushen me zjarr, e Tokën do ta godasë një tërmet i madh. Çdo gjallese në Tokë dhe në qiej do t'i bie të fikët, pos atyre të cilat do t'i ruaj Zoti, në mënyrë që t'i shohin skenat e kësaj dite.

E tërë kjo do të ndodhë pas zërit të parë të borisë, kurse pas zërit të dytë çdo gjë do të ringjallet përsëri dhe do të fillojë dhënia e llogarisë.

Në Zbulimin e apostolit Ivan gjejmë fotografinë e njëjtë të Ditës së gjykimit. Në kaptinën e gjashtë qëndron: *"Shikoja edhe më dhe kur u hap vula e gjashtë, u shkaktua tërmet i madh, dielli u bë i zi sikur pëlhura nga kërmendi* (leshi i dhisë)*, e Hëna u bë sikur gjaku. Yjet nga qielli u rrëzuan në tokë, sikur që fiku i flak frutet e veta të papjekura kur e shkundë era e fortë. E qielli u zhduk, sikur libri kur mbështillet. Nga vendi i tyre lëvizën të gjitha bjeshkët dhe ujdhesat."* (Zbulimi-6, 12-15).

Në suren *En-Infitar* Kur'ani thotë për Ditën e gjykimit me sa vijon: "Kur të çahet qielli, dhe kur të rrëzohen yjet, dhe kur të derdhen detet njëri në tjetrin, dhe kur të rrotullohen *(trazohen)* varret..." (El-Infitar: 1-4).

Ndërsa në suren *El-Tekvir* qëndron: "Kur Dielli të humbë shkëlqimin, dhe kur yjet të rrëzohen, dhe kur malet të lëvizin, dhe kur devet mbarse të mbeten pa barinj *(të pakujdes)*, dhe kur shtazët e egra të tubohen, dhe kur detet të mbushen me zjarr." (Et-Tekuir: 1-6).

Në shumë ajete kur'anore, që kanë të bëjnë me Ditën e gjykimit është theksuar se Zoti dhe engjëjt e Tij do të zbulohen.

Dita e gjykimit më duket sikurse fotografia e smadhuar e asaj që ka ndodhur në çastin kur Musai alejhis-selam ka kërkuar ta shohë Zotin e vet. Përkitazi me këtë Kur'ani na tregon hollësisht në suren El-A'rafë:

"...Musai tha: "O Zoti, im dëftomu që të të shoh!" "Nuk mund të më shohësh" - tha - "por shiko në atë mal, e nëse mbetet në vendin e vet, ti do të më shohësh." E kur Zoti i tij iu dëftua atij mali, ai bëri rrepsh me tokë, ndërsa Musai u rrëzua i fikët..." (El-A'raf: 143)

Të njëjtën gjë do ta shohim, por të smadhuar, në çdo skenë të Ditës së gjykimit.

"Dhe, të pyesin ty (o Muhammed) për malet (çka do të bëhet me to në Ditën e Kiametit). Thuaj: "Zoti im ata do t'i bëj në pluhur dhe do t'i shkapërderdh, e vendet ku kanë qenë ata do të bëhen fusha të rrepshta." (Ta Ha: 105-106)

"A mos presin ata që All-llahu t'u vijë nga qielli i kthjellët, e edhe engjëjt, e të merr fund çdo gjë?!..." (El-Bekare: 210).

"Edhe qielli do të çahet - atëherë do të jetë i flashkët - dhe engjëjt do të do të qëndrojnë në skajet e tij..." (El-Hakka: 16-17)

"Por kur Toka u thërrmua copa-copa dhe erdhi Zoti yt, e engjëjt të rreshtohen radhë pas radhe." (El-Fexhër: 21-22).

"Dhe qielli do të hapet dhe do të ketë shumë dyer, dhe malet do të thërrmohen dhe do të bëhen si hije e ajrit (fatamorganë)." (En-Nebe': 19-29).

"Dhe do të fryhet në Sur (bori), dhe do të vdesin ata që gjenden në qiej dhe që gjenden në Tokë, do të mbesin vetëm ata që do All-llahu, pastaj do të fryhet për të dytën herë në Sur dhe ata përnjëherit do të ngjallen e do të presin (se çka do të ndodhë). Dhe Toka do të shndritet me dritën e Zotit të vet dhe Libri do të shtrohet, do të sillen Pejgamberët dhe dëshmitarët, dhe të gjithë do të gjykohen me drejtësi, askujt nuk do t'i bëhet padrejtësi." (Ez-Zumer: 68-69).

Aty gjithnjë do të jetë prezenca e Zotit dhe zbulimi i tij sikurse ai nga i cili Musai ka mbetur i fikët, e mali u rrepshua me tokë, por kësaj radhe të gjithëve do t'u bie të fikët, e të gjitha malet do të rrepshohen me tokë.

Kur'ani për gurët thotë në një vend tjetër:

"...E disa prej tyre me të vertetë nga frika do të rrëzohen para All-llahut..." (El-Bekare: 74). Nuk ekziston asgjë që do të mund ta përballojë prezencën e Zotit, madje edhe gurët do të rrëzohen. Si

duket Dita e gjykimit nuk është asgjë tjetër pos shfaqja e Zotit, të cilën nuk do të mund ta durojë kurrnjë trajtë materiale. Kurrgjë nuk do të mund të ngritet para Fytyrës së Zotit. Malet zhduken nga frikërespekti. Ato avullohen dhe shndërrohen në fanitje. Gjithçkaje të gjallë i bie të fikët. Zoti e ka hequr perden nga fytyra e Tij e lartësuar. "Dhe Toka do të shndritet me dritën e Zotit të vet."

Apostoli Ivan për këtë dritë, në kaptinën njëzet e një të Zbulimit të tij thotë: *"Qytetit nuk i duhet as Dielli as Hëna të ndriçojnë, sepse atë e ka ndriçuar shkëlqimi i Zotit."* (Zbulimi-23, 23).

Në fillim krijesat nuk do të jenë në gjendja ta durojnë këtë drite, andaj do t'u bie të fikët, e pastaj Zoti i tyre do t'i ringjallë në trajtë tjetër që të japin llogari.

"Që t'ju ndryshojmë figurën dhe përsëri t'ju krijojmë në figurën çfarë ju nuk e dini." (El-Vaki'a: 61).

Kjo ringjallje e dytë do të jetë në figurën e cila për ne është e panjohur. Kur'ani gjithnjë flet për takimin e njeriut me Zotin e tij:

"Dhe të gjithë në Ditën e Kiametit do T'i vijë një nga një." (Merjem: 95).

"E do të na vini ju veç e veç, ashtu siç ju kemi krijuar herën e parë..." (El-En'am: 94).

"Ti, o njeri, që përpiqesh shumë, mundin tënd do ta gjesh te Zoti yt." (El-Inshikak: 6).

"Ata që obligimin e vet ndaj All-llahut dhe betimin e vet e shkëmbejnë me diçka që ka vlerë më të vogël - nuk do të kenë kurrfarë të mire në botën tjetër, All-llahu as që do t'ju folë atyre, e as që do

të tregon ndonjë kujdes ndaj tyre në Ditën e gjykimit, e as që do t'i pastrojë ata (nga mëkatet) - ata i pret vuajtje e dhembshme." (Ali Imran: 77).

"Lema mua atë të cilin Unë e kam krijuar." (El-Muddeththir: 11).

"...Dhe druajuni All-llahut dhe dijeni se do të takoheni me Të. E ti (o Muhammed) sihariqojë besimtarët e vërtetë." (El-Bekare: 223)

"...Kush gjakon do të jetë i pranuar mirë nga Zoti i vet, le të punojë vepra të mira, duke iu falur Zotit të vet, dhe le të mos i bëj askë shok Atij! (El-Kehf: 110).

Ky takim nuk do të bëhet derisa njeriu ka formën e kësaj jete. Nëse megjithatë bëhet ky takim, atëherë ajo është Dita e Kiametit, në të cilën të gjitha krijesave të gjalla do t'u bie të fikët, e malet dhe detet do të copëtohen "në ditën kur Toka do të zëvendësohet me tokë tjetër, por edhe qiejt..." (Ibrahim: 48).

Për të gjitha këto apostoli Ivan thotë si vijon:

"Pastaj vërejta qiellin e ri dhe tokën e re, sepse ishin zhdukur qielli i parë dhe toka e parë: detëra më nuk ka." (Zbulimi-21, 1).

Ne të gjithë do të ngritemi para Atij i Cili është ekzistent nga vetvetiu. Prej këtu edhe Dita e gjykimit është quajtur Kiamet.

"Kush do ta ketë pushtetin atë ditë?" - "All-llahu, Një i Vetmi, i Gjithëfuqishmi!" (El-Mu'min: 16).

Ka marrë fund ky hilafet iluzor, në të cilin jemi sjellur sikur të paraqisnim diçka. Këtu pushteti i është kthyer Sunduesit të vërtetë, Krijuesit, i Cili i ka krijuar të gjitha dhe të Cilit i kthehen të gjitha.

Dita e gjykimit shkurtimisht paraqet të shfaqurit e All-llahu xhel-le shanuhu dhe qenies së Vet.

S'ka dyshim se Zoti gjithnjë ekziston në çdo vend dhe në çdo kohë, por ka dallim mes ekzistencës së Tij, të shfaqurit e Tij dhe qenies së Vet.

Me të shfaqurit e qenies së Zotit çdo gjë do t'i nënshtrohet Atij, kurse do të zhduken format materiale. Kurrnjë formë materiale nuk do të mund të ekzistojë para qenies së Zotit, Unitetit të Tij dhe Plotësisë së Tij.

Ky është fundi i përsiatjes mbi ajetet, të cilat i përkasin Ditës së gjykimit.

Për sa i përket teorive shkencore, të cilat këtë ditë e komentojnë me ndeshjen e Tokës me Hënën ose me tkurrjen, gjegjësisht me zgjerimin e gjithësisë apo ndeshjen e materies me antimaterie, këto nuk posedojnë arsyetimin e vet.

Njeriu vdes nga shkaqet apo pa to. Ashtu siç do të vdes njeriu si njësi ashtu do të vdes edhe i tërë populli dhe kultura, do të vdesin të gjitha llojet e botës së gjallë, si dhe yjet në Gjithësi.

Nuk është nevoja të ngarkohemi me shkaqet e fundit dhe përfundimit. Ky është ligj, të cilin e ka vendosur Ai që i ka krijuar të gjitha.

Nëse Ai na thotë se do të vijë Dita e gjykimit, atëherë nuk është nevoja që ketë ta shpjegojmë me teori, t'i gjejmë shkaqet, arsyetimet etj. Arsyetimet për kend? Ai i Cili urdhëron dhe askush tjetër.

Zëri i borisë është simbol i urdhërit.

Urdhëri në Kur'an është i shumëfishtë. Ndonjëherë ky është zëri i borisë, ndonjëherë zëri i bririt, e ndonjëherë tërmeti ose bubullima.

Të gjitha këto janë simbole të imperativit dhe fjalës "bëhu, dhe bëhet".

Ka ardhur urdhri, e kjo është e tëra.

Ky është ligj, që çdo gjëje që ekziston i vie fundi.

Kjo vdekje e jonë paraqet miniaturën e Ditës së gjykimit.

Gjatë kohës së Ditës së Madhe të gjykimit koha tërësisht do të jetë e shkatërruar dhe çdo gjë do t'i kthehet burimit të vet dhe bazës së vet.

Këtu nuk ka vend për dyshim, por duhet të dorëzohemi me zemër dhe pa pyetje e diskutime.

RINGJALLJA PAS VDEKJES

All-llahu xhel-le shanuhu i drejtohet Pejgamberit të vet (Muhammedit alejhis-selam) në Kur'an e thotë: "Ti je i vdekur, e edhe ata janë të vdekur." (Ez-Zumer: 30).

Nuk thotë "Ti do të vdesësh", por thotë "Ti je i vdekur." Ti jeton me ndihmën Time, dëgjon dhe flet me ndihmën Time. Kjo është veçori e çdo njeriu, jeton me ndihmën e All-llahut xhel-le

shanuhu, sheh dhe dëgjon me ndihmën e All-llahu xhel-le shanuhu, sepse në qenien e vet është i vdekur. Njeriu nuk jeton me ndihmën e qenies së vet. Të gjithë në ekzistencën e tyre mbështeten në Njërin dhe të Vetmin, i Cili të tëra i ka krijuar, i Cili në Unitetin e Vet është i pavarur nga çkado qoftë.

Në ajet fjala"Ti je i vdekur" posedon gjerësi e cila zgjon ndjenjat. Ajeti ia tërheq vërejtjen njeriut se në çfarë gjendje gjendet tani, e jo gjendjen çfarë e pret njeriu në të ardhmen.

Çdonjëri prej nesh, me të vërtetë e bartë në supet e veta barrën e trupit të vet. Në çdo pikë të djersës e lë një pjesë të trupit të vdekur sikur që e lë druri për çdo ditë gjethen e vyshkur dhe të vdekur.

Vdekja është prezente në çdo moment dhe e pezulluar (vonuar) në çdo moment. Kurrgjë me të vërtetë nuk është gjallë pos All-llahu xhel-le shanuhu na e kemi huazuar jetën tonë nga Ai, i Cili përherë jeton. Kjo na është dhënë në shfrytëzim për një kohë të caktuar.

Në një hadith-kudsij All-llahu xhel-le shanuhu i thotë Muhammedit alejhis-selam: "Jeto sa të duash, ti je i vdekur...Duaje kend të duash, një ditë duhet ta braktisësh...Kij sa të duash, çdo gjë që posedon i takon tokës... Puno çka të duash, puna jote është i vetmi bashkëudhëtar."

Më kotë dashurojmë... Ne dashurojmë që të ndahemi prej atyre që i dashurojmë. Kjo është dashuri, e cila shpien në zhgënjim, përveç nëse vendosim që ta duam të Amshueshmin dhe të Gjallin, i Cili nuk vdes kurrë. Është e padobishme të posedojmë diçka, sepse atë që posedojmë jemi të detyruar ta braktisim. Me ne do të mbeten vetëm veprat toNe.

Tërheqja e vërejtjes për vdekjen, në Kur'an, është përmendur me dhjeta vende. All-llahu xhel-le shanuhu na tërheq vërejtjen në faktin se jeta jonë është e kufizuar dhe se një ditë sigurisht do të jemi të shkatërruar.

Ky është fakt i qartë, por, me gjithëkëtë, askush nuk i jep rëndësinë e duhur. Të gjithë sillen sikur gjithmonë do të jetojnë në Tokë. Për këtë shkak koprraci koprracon, rrenacaku rrenë, vjedhësi vjedh, vrasësi vret, eksploatatori eksploaton, sepse mendon se është i sigurt dhe i amshueshëm.

Kur'ani thekson se shumicën nuk mund ta ndjekim në çështje ideologjike:

"Shumica pasojnë vetëm supozimet, por supozimet aspak nuk i shërbejnë të vërtetës..." (Junus: 36).

"...Por shumica e njerëzve assesi nuk duan të besojnë." (El-Isra: 89).

"Ne e kemi ditur se shumica prej tyre nuk do t'i mbahen zotimit, dhe e kemi ditur se shumica, me të vërtetë, do të jenë mëkatarë." (El-A'raf: 102)

"Po qe se do t'iu përuleshe shumicës së atyre që jetojnë në Tokë, ata do të të shmangnin nga rruga e All-llahut, ata ndjekin vetëm supozimet..." (El-En'am: 116).

"Ndaj shumicës prej tyre u njëmendësua Fjala - andaj ata nuk duan të besojnë." (Ja Sin: 7).

"...Mirëpo, ai ua sjellë të Vërtetën, por shumica prej tyre e urrejnë të Vërtetën." El-Mu'minun: 70).

Sikur Muhammedi alejhis-selam të fillonte të thërriste në Islam me anë të referendumit... Çka të adhurojnë: Zotin apo idhujt? Shumica e Mekkasve do të ishin për adhurimin e idhujve. Të

kuptuarit e fakteve gjithnjë ka qenë dhe do të jetë çështje e të rriturve. Për çështjet jetësore është e mundur të thirret në mendimin e shumicës, sepse këto janë gjëra që shumica e dinë më së miri.

Në kohët e lashta shumica kanë qenë të një mendimi për likuidimin e Sokratit, djegjen e Brunos dhe burgosjen e Galileut, atëherë kur iu është dhënë rasti ta thotë fjalën e vet për çështjet e filozofisë, ideologjisë dhe shkencës.

Shkencëtari ngandonjëherë sakrifikon edhe jetën e vet duke studiuar krimbin apo anatominë e thneglës, e kjo në raport me arsyen e shumicës është e pakuptueshme. Shumica e njerëzve nuk kuptojnë se një studim i tillë mund të sjellë një sërë punimesh shkencore dhe zbulimin e vakcinës kundër paralizës fëmijërore, lisë apo influencës, e kjo shpien në të mirë dhe është në dobi të të gjithëve. Atyre u intereson vetëm dobia e prekshme momentale. Ata janë robër të pasioneve dhe të stomakëve të tyre. Kjo nuk është urrejtje e shumicës, por të kuptuarit e kufijve dhe rolin e tyre. Ai, i cili i përmbahet mendimit të shumicës për çështjet e magnetit dhe elektromagnetit, bënë padrejtësi ndaj vetvetes, magnetit dhe energjisë elektrike.

Për problemet shkencore dhe ideologjike fjalën vendimtare e kanë ata mendimi i të cilëve është meritor, me kusht që konsultimi mes shkencëtarëve të jetë themel e jo arbitraritet.

"...dhe konsultohu me ta..." (Ali Imran: 159).

"...e këshillohen reciprokisht për punët e tyre..." (Esh-Shura: 38).

"...ti nuk mund t'i detyrosh..." (Kaf: 45).

"Ti këshillo - se ti je vetëm këshillues, Ti nuk je mbi ta imponues (sundues)." (El-Gashije: 21-22).

"...që njëri-tjetrin mos ta konsiderojmë për zot, në vend të All-llahut..." (Ali Imran: 64).

Kur'ani është kundër kultit të personalitetit, kundër arbitraritetit, madje edhe nëse ky arbitraritet vjen nga vet Pejgamberi. Bashkëpunimi dhe konsultimi është themel dhe kriter.

"...Ndihmone njëri-tjetrin në bamirësi dhe shpirtdlirësi, e mos merrni pjesë në mëkate dhe armiqësi." (El-Maide: 2).

"All-llahu ju urdhëron...kur të gjykoni mes njerëzve - gjykoni drejt." (En-Nisa: 58).

Kur'ani konfirmon klasat njerëzore, por jo ato mbështetja e të cilave është kapitali dhe pasuria e patundshme. Ky klasifikim i klasave është i llojit tjetër.

Njerëzit klasifikohen në shkencë, në konceptim (njohuri) dhe në devotshmëri. Shpirtrat janë të ndryshëm edhe pse ky nuk është rast me trupat, të cilët, në raport me drejtësinë dhe përmbushjen e nevojave, janë tërësisht të njëjtë.

"...E All-llahu do t'i lartësojë ata nga mesi i juaj të cilët besojnë dhe të cilëve u është dhënë dituri..." (El-Muxhadele: 11).

"Disa nga ata Pejgamberë i kemi nderuar më tepër se disa të tjerë..." El-Bekare: 253).

"...A mos, vallë, janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?" (Ez-Zumer: 9).

"Më i nderuari tek All-llahu është ai, i cili i druan më së shumti Atij..." (El-Huxhurat: 13).

Pa marrë parasysh këto karakteristika, Kur'ani nuk ka ardhur me ndonjë sistem të caktuar politik, por dyert e ixhtihadit i ka lënë të hapura. Sistemet politike gjatë kohëve janë ndërruar.

Kur'ani është Libër i stërlashtë, i cili në vete përmbanë dituritë e stërlashta dhe faktet gjithnjë të amshueshme. Ai nuk u jep rëndësi gjërave që ndërrohen gjatë kohëve. Këtë ndryshueshmëri kohore të gjërave ai ua lë njerëzve që të gjejnë zgjidhje të pavarura.

Kur'ani është Libër fetar dhe etik, e jo politik. Mirëpo, megjithëkëtë, Kur'ani ofron suazat e një pushteti shembullor dhe ideal (i mbronë të drejtat e çdo individi, më të mirëve ua lë udhëheqjen me vlerat kulturore dhe ideore, ndërsa shumicën e konsulton vetëm për çështjet, të cilat kanë të bëjnë drejtpërdrejtë me jetesën; pushtetin e bazon në marrëveshje - e jo në tiranizëm e shtypje, në drejtësi dhe barazi, e jo në eksploatim e në dhunë). Për sa i përket mënyrës dhe hollësive të tjera, këto janë të hapura për zbulimin e zgjidhjeve të pavarura. Kur'ani nuk thellohet në to.

Kur'ani i drejtohet vetëdijes të individit, dëshiron që ta udhëzojë dhe ta lirojë atë. Orientimi i drejtë i shoqërisë rezulton nga orientimi i drejtë i individit, e jo anasjelltas. Kur'ani nuk troket në dyert e politikës për ta ndërruar shoqërinë, por në dyert e zemrës për ta udhëzuar njeriun. Atë njeri, për të cilin Kur'ani thotë:

"...Nëse dikush mbyt dikë, i cili nuk ka mbytur askënd, ose atë që nuk ka bërë çrregullim në Tokë - është sikur t'i mbyste të gjithë njerëzit, e nëse dikush bëhet shkaktar që të shpëtojë jeta e dikujt - është sikur t'ua shpëtonte jetën të gjithë njerëzve." (El-Maide: 32).

Vrasja e një njeriu nga dhuna dhe armiqësia, madje edhe nëse kjo është në rrugën e sendërtimit material dhe mirëqenies paraqet thyerjen e Ligjit dhe vrasjen e tërë njerëzisë. Gjer tek kjo shkallë arrinë vlera e individit në sheriatin islamik. Individi është ekzistencë absolute nga vetvetiu. Ai posedon shenjtërinë dhe lirinë e vet. Respektimi i kësaj lirie është kushti i parë i të besuarit të sinqert në All-llahun xhel-le shanuhu

Individi trupërisht vdes në këtë botë, ndërsa shpirtërisht absolutikisht ekziston, jeton dhe mbetet i amshueshëm.

Sipas mendimit të disave shpirti i njeriut është shumë (grumbull) e reaksioneve, e rrethanave dhe e gjasave. Ai është në shërbim të trupit dhe varet nga ai. Sipas tyre shpirti është vetëm shtytje e urisë, seksit, frikës dhe ndjenjave të tjera me ndihmën e të cilave trupi kupton se është i etshëm, i uritur etj.

Mirëpo, ngandonjëherë njeriu sakrifikon edhe kafshatën e bukës, shtëpinë dhe shtratin e ngrohtë për qëllime tejet abstrakte, siç është drejtësia, e vërteta dhe liria. Ku janë këtu shtytjet e urisë dhe seksit? Ky është argument i pakontestueshëm se shpirti është fakt i cili është përmbi trup, e jo vetëm nevojë e thatë e trupit e reflektuar nga pasqyra e brendshme. Ky vullnet i madh, i cili ndikon në trup dhe i cili e sakrifikon atë, është fakt i cili është përmbi trup dhe drejton trupin, e nuk është i nënshtruar trupit e as që është shtesë e tij.

Shpirti nuk vdes me trupin. Ai i cili pohon këtë, le të na tregojë se ku gjendet njeriu në çastin e fjetjes? Gjatë fjetjes të gjitha organet fiziologjike edhe më tej funksionojnë, reflekset po ashtu. Zemra rrahë, gjëndrat tajisin, mushkëritë punojnë si dhe organet e tjera. Mirëpo, megjithëkëtë, ne jemi në gjendje,e cila është e ngjashme me natyrën e vdekur. Ku është njeriu?

Përkitazi me këtë flet edhe Kur'ani. Shpirti e braktisë trupin gjatë fjetjes, siç është rasti edhe tek vdekja. Zoti përsëri e kthen shpirtin kur njeriu vjen në gjendjen e zgjuar:

"All-llahu ua merr shpirtrat atyre që u ka ardhur çasti i vdekjes, por edhe atyre që nuk kanë vdekur e janë në gjumë, e Ai ndalë shpirtin e atij që i është caktuar vdekja, e të tjerëve ua kthen deri në kohën e caktuar..." (Ez-Zumer: 42).

Në Kur'an gjenden shumë ajete, të cilët flasin për Ditën e gjykimit dhe për ringjalljen pas vdekjes.

"All-llahu ju krijon nga toka (dheu) ashtu si bimët, pastaj ju kthen tek ajo dhe prej saj sërish do t'ju nxjerrë." (Nuh: 17-18).

"Ne, me të vërtetë, do t'i ringjallim të vdekurit, dhe Ne i kemi shkruar veprat që i kanë punuar dhe gjurmët që i kanë lënë pas veti, të gjitha këto i kemi numëruar në Librin e qartë." (Ja Sin: 12).

"Dhe do të fryhet në bri, e ata do të nxitojnë nga varret kah Zoti i tyre, duke thënë: "Të mjerët ne! Kush na ngjalli nga varret tona? " - "Ja, po realizohet kërcënimi i Mëshiruesit, e Pejgamberët e kanë thënë të vërtetën!" Do të jetë ai vetëm një zë, e ata të gjithë do të mblidhen para Nesh." (Ja Sin: 51-53).

"A keni menduar se më kot ju kemi krijuar dhe se nuk do të ktheheni tek Ne?" (El-Mu'minun: 115).

"Ata do të dalin nga varret me shikim të përulur, si karkalec të shpërndarë. (El-Kamer: 7).

E, në ditën kur i heqim bjeshkët, dhe kur të shohish tokën e zhveshur, - e ata t'i kemi tubuar, askend nuk e kemi lënë anash, para Zotit tënd do të jenë ata të radhitur: "Ne keni ardhur ashtu siç u kemi krijuar herën e parë, kurse ju keni deklaruar se nuk do t'ua caktojmë kohën e ringjalljes." (El-Kehf: 47-48).

"Dhe pasha Zotin tënd, Ne do t'i tubojmë edhe ata edhe djajtë, pastaj do t'i sjellim ata që të gjunjëzohen para Xhehennemit!" (Merjem: 68).

Shpirt është fakt. Ky i takon kategorisë e cila është më e lartë se trupi. Koha atë nuk do ta shkatërrojë. Ai është i amshueshëm. Ai ka zanafillën e vet, jetën e vet dhe takimin e vet me Krijuesin.

Mirëpo, thjeshtësimi dhe hulumtimi për zgjidhje të lehtë, ka sjellur tek botëkuptimi se njeriu është vetëm grumbull nevojash fiziologjike dhe asgjë tjetër. Nuk mund të kuptoj si mund t'i besohet kësaj në botën, në të cilën çdo atom është argument i sistemit ekzakt, bukurisë së përkryer dhe radhës së pandërprerë të kauzalitetit, në të cilën njeriu sakrifikon madje edhe jetën e vet për gjërat që janë tejet abstrakte.

Si është e mundur që njeriu si krijesë më e zgjedhur të shpartallohet më kot. "A keni menduar se më kot ju kemi krijuar dhe se nuk do të ktheheni tek Ne?" (El-Mu'minun: 115).

"Vallë, a mendon njeriu se do të lihet në vullnetin e vet, pa përgjegjësi?" (El-Kijameh: 36).

Një idhujtar ia sjell Muhammedit alejhis-selam një kockë të kalbur, e thërrmon atë dhe e bënë pluhur, e pastaj thotë:

"A mundet Zoti yt ta ngjallë këtë kockë të thërrmuar?"

Me këtë rast Muhammedit alejhis-selam i është shpallur ky ajeti kur'anor nga sureja Jasin:

"Dhe ai na sjellë shembull, dhe harron se si është krijuar, e thotë: "Kush do t'i ngjallë eshtrat duke qenë ato të kalbura (shkapërderdhura)?"Do t'i ngjallë Ai që i krijoi herën e parë..." (Ja Sin: 78-79)

Kur'ani i përgjigjet me argument largpamës dhe bindës. Pyet se si do t'i ngjallë Zoti eshtrat e kalbura, e harron se është krijuar prej asgjësendi, prej një pike uji. Ai që e ka krijuar njeriun herën e parë, është në gjendje edhe ta ringjallë atë.

"Vallë, a nuk ka mundësi Ai që krijoi qiejt dhe Tokën - të krijojë të ngjashëm si ata? Po, me të vërtetë, Ai është Krijues i çdo gjëje dhe Ai është i Gjithdijshëm." (Ja Sin: 81).

"E, vallë, mos jemi lodhur Ne gjatë krijimit të parë? Jo, por ata dyshojnë në krijimin e sërishëm." (Kaf: 15).

A mos jemi lodhur kur ju kemi krijuar për të parën herë, e dyshoni në mundësinë e krijimit Tonë për të dytën herë. "Ashtu siç ju krijuam për të parën herë nga hiçi, po ashtu përsëri do t'ju krijojmë nga hiçi." Kur'ani në këtë mënyrë ofron rrëfimin mbi ringjalljen, shumë të thjeshtë dhe me pesë fjalë.

Pastaj në një ajet na informon se të vdekurit do të ngriten nga varret e tyre pas një kohe të gjatë qëndrimi në to:

"E, atë ditë kur të arrijë çasti i ringjalljes, kriminelët do të betohen se në varre kanë qëndruar vetëm një orë." (Er-Rum: 55).

Koha e kaluar në varre të vdekurve do t'u duket në çastin e ringjalljes si një orë, sikur kanë qenë në një gjumë të lehtë apo fjetjen e pasditës pas drekës së mirë.

Ringjallja do ti duket çdo të vdekuri sikur ka ardhur menjëherë pas vdekjes së tij, sepse ai me vdekjen e vet ka dalur nga koha dhe hapësira e vet. Andaj nuk do ta tejkalojmë të vërtetën nëse themi se gjer te Dita Kiametit ka mbetur edhe shumë pak kohë.

Ndoshta në këtë duhet kërkuar komentimin e ajetit:

"Ti nuk e di, ndoshta Dita e Kiametit është afër."

E ndoshta ky është komentimi i ajetit për ringjalljen:

"Krijimi i të gjithë juve dhe ringjallja e të gjithë juve është sikurse krijimi dhe ringjallja e një njeriu."

Ringjallja e njeriut që ka vdekur para dy mijë vitesh dhe njeriut që ka vdekur dje është e njëjtë sikurse ringjallja e një njeriu, sepse dy mijë vjet, në raport me atë që ka vdekur atëherë, kanë kaluar si një orë. Ata do të jenë të ringjallur në të njëjtën ditë, si të ishin një person.

Shpirti dhe ringjallja janë fakte të konfirmuara, por lexuesi i sotshëm përkitazi me këto çështje kërkojë bindshmëri të bazuar në argumente filozofike. Të tillëve u ofrojmë një argument tjetër në bazë të karakteristikës të vet lëvizjes.

Livizja mund të ngulitet (konstatohet) vetëm nga jashtë. Lëvizja nuk mund të kuptohet nëse lëvizim së bashku me të në kozmos. Duhet të jemi jashtë saj që të mundemi ta fikësojmë. Andaj shpeshherë kur gjendemi në ashensor i cili lëvizë, nuk dimë se është duke lëvizur apo jo, sepse së bashku me ashensorin jemi pjesëmarrës në lëvizje. Këtë lëvizje mund ta kuptojmë vetëm nëse nga dera e ashensorit shikojmë në objekt të palëvizshëm. E njëjta gjë është edhe me trenin. Lëvizjen e

tij, nëse jemi në të, e kuptojmë vetëm atëherë kur shikojmë nga dritarja. Po ashtu edhe banori i Tokës nuk mund ta ndiejë lëvizjen e saj, por, të themi se nga Hëna mund ta fikësojë. Procesi i të vrojturit është argument i pakontestueshëm se aty ekzistojnë dy gjëra në çdo çast. Andaj edhe kohën që rrjedhë nuk do të mund ta kuptonim sikur të mos ishte ajo pjesë brenda në ne e cila është jashtë këtij kalimi të vijueshëm të kohës.

Ne gjendemi para njeriut si para të vërtetës. Njëra pjesë është zhytur në kohë, e rrjedhë bashkë me kohën, rritet dhe përjeton pleqërinë (trupi i njeriut), pjesa tjetër është jashta kësaj kohe, nuk rrjedhë me të, nuk rritet e as që plaket. Kur trupi bëhet dhe, kjo pjesë edhe më tej do të mbetet dhe do të jetojë jetën e vet të posaçme, e cila nuk është e kufizuar me kohën. Kësaj pjese nuk mund ti gjejmë emër më të mirë pos emrit me të cilin e quajnë të gjitha religjionet, e ky është shpirti. Çdonjëri në veten e vet mund ta ndiejë këtë ekzistestent ideor, të kuptojë se ai dallon sipas llojit të vet nga ekzistenca e jashtme e cila pulson dhe e cila është e nënshtruar çdo ndërrimi të mundshëm.

Kur e kuptojmë bukurinë dhe e veçojmë nga ajo që është e shëmtuar, kur e kuptojmë të vërtetën dhe e veçojmë nga e pavërteta, kur e kuptojmë drejtësinë dhe e veçojmë nga mujshia, ne çdo herë peshojmë me kritere të posaçme, të ndarë me vizore nga ngjarja të cilën e masim. Në shpirt tregon edhe vetëdija edhe ndjenja për të bukurën, si dhe ndjenja me të cilën e ndajmë të vërtetën nga e pavërteta, të falsifikuarën nga origjinali etj.

Vallë, a është kjo jashtëkohore për të cilën është fjala e përjetshme? Apo kjo është një tjetër kohë, e cila posedon kalendarin e vet, në të cilin dita zgjatë sa një mijë vjet, siç qëndron në Kur'an "Vetëm një ditë e Zotit tënd zgjatë sa një mijë vjet sipas llogarisë tuaj", ato janë ditë, të cilat nuk i

përgjigjen ditëve toNe. Përkitazi me këto ditë komentuesit janë ndarë në mendime dhe kjo shkoqitje (shpjegim i çështjes në hollësi) nuk është e mundur të përfshihet në tërësi. Në raste të shumta kemi të bëjmë me shenja, simbole, të cilat provojnë, e nuk shpjegojnë, sepse shpirti dhe rrojtja e tij është mbi kuptueshmërinë. Mirëpo, për të ekzistuarit e tij mund të gjykohet. Kjo madje është edhe e nevojshme.

Ndoshta shpirti është mbresë e All-llahut xhel-le shanuhu, të cilën Ai e ka lënë në ne si gjurmë të Vet. Nuk do të largohemi së tepërmi nëse shpirtin në brendinë tonë e përcaktojmë si liri, lirinë tonë të brendshme, në thellësinë e vetëdijes sonë të cilës Zoti ia ka përcaktuar të jetë e shenjtë dhe e ndaluar për të gjithë, pos për pronarin e saj. Ne, në thellësitë e vetëdijes sonë dëshirojmë, zgjedhim dhe posedojmë aftësinë e vlerësimit, vendimit dhe mundësisë së gjykimit. Prandaj Zoti na ka bërë edhe mëkëmbës të Vet në Tokë, mbretër të vegjël, të cilët mbretërojmë. Ky është provim dhe vlerësim pas cilit pasojnë pyetjet, llogaritë dhe kthimi i shkallëzimit në pozita, në të cilat çdonjëri do ta gjejë veten sipas meritave të veta që i takojnë. Departamenti i vetëdijes është departament rishqyrtimi. Në një hadith qëndron: *"Veprat vlerësohen sipas qëllimeve. Çdonjërit i takon ajo që ka pasur ndër mend."* Departamenti i vetëdijes është departament të cilin Zoti e mbikëqyrë dhe në bazë të cilit bënë llogari, sepse ky është regjion i lirisë. Problemet paraqiten atëherë kur përpiqemi ta realizojmë dhe ta zbatojmë në botën materiale atë që kemi menduar, që kemi pasur për qëllim. Atëherë vie tek ndeshja e lirisë me vetveten, me mjedisin dhe me shoqërinë. Atëherë ndërhynë vullneti i Zotit, e kufizon të keqën, i jepë hapësirë të mirës dhe e pakëson dëmin të cilin ia sjellim njëri-tjetrit.

Për shpirtin mund të flasim vetëm në mënyrë indikative, vetëm simbolikisht, sepse gjendemi në hapësirën jashtëkohore, jashtë asaj që është e dukshme dhe e prekshme.

"Të pyesin ty për shpirtin. Thuaj: "Ç'është shpirti - vetëm Zoti im e di, e juve u është dhënë vetëm pak dijeni." (El-Isra: 85).

Pas vdekjes ai shkon kah vendi i vet, dhe nga ne është i ndarë me berzahun gjer tek ringjallja e jonë e sërishme.

Atyre që nuk besojnë u themi atë që ka thënë edhe Kur'ani:

"Dhe thuaju atyre që nuk dojnë të besojnë: "Punoni ju çka të mundeni, edhe Ne do të punojmë, dhe pritni ju (fundin e punës), edhe Ne do të presim!" All-llahu i di fshehtësitë e qiejve e të Tokës dhe Atij i kthehet çdo gjë." (Hud: 121-123).

Shpirti është fshehtësi. Jeta pas vdekjes është fshehtësi. Rreth këtyre gjërave dimë vetëm aq sa i ka zbritur Muhammedit alejhis-selam nga Ai, i Cili i njeh fshehtësitë, i Cili sheh çka nuk shohim ne dhe i Cili dinë çka nuk dimë ne.

ISLAMI NUK NJEH NDËRMJETËSIMIN

Kur'ani është kategorik kur është fjala për ndërprerjen e klerizmave dhe ndërmjetësimit klerik. Këtë e përsëritë shumë herë në shumë ajete. Njeriu kundruall Zotit qëndron në kontakt të drejtpërdrejt. Zoti i mbronë interesat e robërve të Vet pa këshillin drejtues, pa sekretariat dhe çfarëdo ndërmjetësi tjetër:

"Thuaj: "Vetëm All-llahut i takon ndërmjetësimi..." (Ez-Zumer: 44).

"Dhe kur të pyesin robërit e Mi për Mua, Unë jam me të vërtetë afër; i përgjigjem lutjes së lutësit kur Më lutet..." (El-Bekare: 186).

"...Ne nuk të kemi bërë ty rojtar të tyre, e as që je mbikëqyrës i tyre." (El-En'am: 107)

"...Me të vërtetë, Zoti yt i di më së miri ata, që janë shmangur nga rruga e Tij, e Ai i di më së miri (edhe) ata që janë në rrugë të drejtë." (En-Nahël: 125).

"...Ai dënon kë të dojë dhe falë kë të dojë..." (El-Maide: 40).

"Thuaj (o Muhammed): "Thirrni ata, të cilët i konsideroni zotra në vend të All-llahut. Ata nuk kanë kurrgjë, as sa grima, as në qiej as në Tokë..." (El-Seb'e': 22)

Madje All-llahu edhe Pejgamberit të Vet i thotë:

"U lute ti për ta ose nuk u lute, (njësoj është) u lute madje edhe shtatëdhjetë herë, All-llahu nuk do t'ua falë - për shkak se ata nuk e besojnë All-llahun dhe Pejgamberin e Tij..." (Et-Teube: 80).

Është e pamundur madje edhe për Pejgamberin e Zotit të ndërrojë ndonjë përcaktim të Zotit, pa marrë parasysh pozitën e lartë të tij dhe veçorinë me të cilën dallohet nga krijesat e tjera. E çka të themi atëherë për njeriun e rëndomtë, madje edhe nëse ai është imam, jurist i sheriatit ose ndonjë evlia - njësoj është. Vetëm Zotit i takon rekomandimi. Pa vullnetin e Tij askush nuk mund të ndërmjetësojë.

Andaj Islami nuk njeh ndonjë rast të shitjes së dokumentit për faljen e mëkatit, e as që njeh dikë që mundet dikujt t'ia cenon mëshirën e Zotit, duke marrë si argument kufrin apo lajthitjen e tij. Kur'ani thotë se vetëm "Zoti yt i di më së miri ata, që janë shmangur nga rruga e Tij, e Ai i di më

së miri (edhe) ata që janë në rrugën e drejtë." Askush pos Zoti nuk di se çka gjendet në zemrën e robit të Tij. Andaj Islami nuk njeh klerizmin, e as që në Islam ekziston kleri, i cili kujdeset për kësmetin e njeriut.

Edhe ceremonitë fetare sipas Kur'anit janë shumë të thjeshta. Pesë namazet dhe koha e tyre: sabahi, dreka, ikindia, akshami dhe jacia përsëriten vetëm e vetëm që njeriut t'i përkujtohet Zoti i Cili gjithnjë e soditë atë, dhe të pengohet nga veprat e keqija. Guslli, abdesti, rukua dhe sexhdeja janë vetëm për dëbimin e kryelartësisë dhe për t'u përkujtuar vendi dhe pozita e krijesave kundruall Krijuesit. Ky është sport psikologjik, trupor dhe shpirtëror. Në jogë, modë e njeriut të sotëm, ekzistojnë ushtrime edhe shumë më të rënda dhe më të komplikuara, megjithëkëtë njeriu i sotëm me vetëmohim angazhohet në të dhe garon në të.

Pa marrë parasysh të tërë thjeshtësinë e parimeve të caktuara, Kur'ani në rast nevoje ka lejuar thjeshtësimin edhe më të madh të tyre. Të themi për shembull se në vend të abdestit mund të mirret tejemumi, e namazi është i mundur të kryhet ulur, madje edhe shtrirë duke mbyllur njërin sy si simbol të sexhdes. Islami, më tutje, lejon që ajetet në vend se me zë të këndohen në vete. E e tërë kjo vlenë nëse njeriu është i sëmur apo gjendet në ndonjë situate jetësore jonormale. Me këtë thjeshtësim namazi bëhet vetëm përkujtim me zemër, pa rituale. Cilido vend në botë, sipas Islamit është xhami:

"...Kahdo që të ktheheni - atje është ana e All-llahut." (El-Bekare: 114).

Namazi është këpujë mes njeriut dhe Zotit dhe është urdhëruar vetëm për shkak të dobisë së njeriut. Zoti nuk ka nevojë për këtë, por ne kemi nevojë. Namazi është mjeti ynë i furnizimit. Sikur që luledielli kthehet kah Dielli që të furnizohet me jetë, gjithashtu edhe ne duhet t'i

kthehemi burimit tanë nëse dëshirojmë të furnizohemi me jetë, me dritë dhe me inspirim tërëjetësor.

Agjërimi është sport shpirtëror, mposhtje e epsheve trupore dhe i atij elementi animal tek njeriu. Të gjitha sportet hinduse-mistike, sportet budistike apo krishtere kanë caktuar agjërimin, abstenimi i tërë nga ushqimi dhe pija, ose vetëm nga pija, respektivisht përdorimi i ushqimit bimor. Agjërimi islamik është më i thjeshti. Sikur Zoti mos të na e caktonte, ne do t'ia caktonim këtë vetvetes, sepse ky është sport i domosdoshëm shpirtëror, i cili forcon vullnetin - sikur që noti, lundrimi ose gjimnastika i forcojnë muskujt. Zoti megjithatë i ka liruar nga agjërimi ata, të cilën nuk janë në gjendje të agjërojnë. Të sëmurit i ka liruar të hajnë, e si shpengim All-llahu u ka caktuar fidjen.

Pluhuri që ngritet rreth dispozitës që vjedhësit duhet t'i prehet dora, është tendencioz, sepse kjo dispozitë sheriatike është e kushtëzuar. Kush ka vjedhur që ta shuan urinë apo ta përbushë ndonjë nevojë jetësore, ndaj tij kjo dispozitë nuk do të zbatohet. Mbetet vetëm ai që vjedhë pa nevojë, e i cili është ose mentalisht i çrregulluar apo dhunues, i cili si i tillë meriton që ky dënim të zbatohet ndaj tij.

Në ligjet pozitive të shumë shteteve për përvetësimin e pasurisë shoqërore ligji parashikon dënim me vdekje, kurse në Ungjill qëndron: *"Nëse dora jote e djathtë, të shtyen në mëkat - preje atë... Nëse syri yt i djathtë të shtyen në mëkat - shkule atë"*, ndërsa Kur'ani parashikon vetëm prerjen e dorës.

Kritika që orientalistët ia drejtojnë qëndrimit të Kur'anit përkitazi me robërit është kritikë e cila e kundërshton vetveten. Të liruarit e papritur të robërve me anë të ligjit hyjnor në shoqëri, çfarë kanë qenë Arabët para Islamit, do të thoshte ballafaqim me mijëra lypësarë pa kurrfarë burimesh

për jetë. Kjo do t'ishte katastrofë e jo zgjidhje. Zgjidhja më e mirë është ajo me të cilën ka ardhur Kur'ani. Burimet e robërisë kanë qenë robërit e luftës. Kur'ani ka urdhëruar që të lirohen robërit apo të kërkohet fidja, shpengimi për robërit: "...ose i lironi me zemërgjerësi ose me kompensim..." (Muhammed: 4). Për sa i përket robërve të cilët janë hasur në prona me rastin e ardhjes së Islamit, sipas Kur'anit është dashur që ata gradualisht të lirohen. Kur'ani për kefaret (shpengim) nga mëkatet pikërisht ka caktuar që robi të lirohet nga robëria:. "E ai nuk mundi ta kapërcejë këtë pengesë. E, ç'mendon ti, ç'është pengesa? - të lirohet robi nga robëria." (El-Beled: 11-13).

Në këtë mënyrë Kur'ani i ka mbyllur dyert e robërisë. Ajo që ka ndodhur gjatë kohës së dinastisë së emevive, për këtë Kur'ani nuk është fajtor, por sistemi dhe jeta në pallate, i cili është shndërruar në skenë për kënaqësitë trupore në mënyrë persiane. Kur'ani konfirmon barazinë e të gjithë njerëzve pa marrë parasysh ngjyrën dhe kombin.

"O njerëz, frikësohuni Zotit tuaj, i Cili ju krijoi prej një njeriu, nga i cili krijoi edhe bashkëshorten e tij, e prej atyre dyve krijoi shumë mashkuj e femra..." (En-Nisa: 1).

"O njerëz! Ne u krijojmë juve prej një mashkulli dhe një femre dhe u ndajmë në popuj dhe në fise për t'u njohur (në mes veti). Më i lavdërueshmi te All-llahu është ai, i cili i druan më së shumti Atij..." (El-Huxhurat: 13).

"...që njëri-tjetrin mos ta konsiderojmë për zot, në vend të All-llahut..." (Ali Imran: 64).

Kur'ani, nëse e krahasojmë me atë që rreth kësaj çështjeje gjendet në Ungjill dhe në Teurat, paraqet dokumet çlirimtar për robërit. Shën Petri u rekomandon robërve të jenë të dëgjueshëm ndaj zotërinjve të tyre dhe thotë se robëria është shpengim i njeriut për mëkatet që i ka bërë ndaj

Zotit, ndërsa Shën Pavli në Letrën dërguar Efezhanëve thotë: *"O robër, nënshtrojuni zotërinjve tuaj të kësaj bote me frikërespekt dhe me sinqeritetin e zemrave tuaja sikurse edhe Krishtit."* (Letra dërguar Efezhanëve-6, 5-6). I njëjti rast është edhe me Teurat. Kur'ani është i padyshimtë (jo i dykuptimshëm) kur është fjala për robërit dhe lirimin e tyre. Njeriu nuk mund të jetë rob i njeriut, e as që mund ta konsiderojë veten hyjni. Të gjithë njerëzit i takojnë një familjeje dhe kanë të drejta dhe obligime të barabarta. Askush nuk ka përparësi ndaj tjetrit pos në devotshmëri. Kur'ani çështjen kryesore e hedhë në etikë dhe në doktrinën etike. Që nga faqja e parë e gjer tek faqja e fundit hasim në ajete, të cilët urdhërojnë këtë.

"All-llahu ju urdhëron që detyrat e besueshme t'ua besoni atyre që janë të denjë për to dhe kur të gjykoni mes njerëzve - gjykoni drejt..." (En-Nisa: 58)

"O besimtarë, kryeni obligimet ndaj All-llahut, dhe dëshmoni drejt! Le të mos u nxisë juve urrejtja që keni ndaj disa njerëzve të bëheni të padrejtë. Bëhuni të drejtë, ajo është më së afërti shpirtdëlirësisë." (El-Maide: 8).

"Dhe mos iu qasni kurvërisë, sepse ajo është zvetnim dhe rrugë e shëmtuar." (El-Isra: 32).

"...Dhe mos u grindni mes veti, se do të demoralizoheni dhe do t'ju lë fryma luftarake. Kini durim, se All-llahu, me të vërtetë, është me durimtarët." (El-Enfal: 46).

"Thirr në rrugën e Zotit tënd me urtësi dhe me këshilla të bukura dhe diskuto me ta si është më së miri!..." (En-Nahël: 125).

"O besimtarë! Nëse ndonjë njeri i pandershëm ju sjell ndonjë lajm, analizoni mirë, që të mos i bëni dëm ndokujt nga mosdija, e të pendoheni pastaj për atë që keni punuar. (El-Huxhurat: 6).

"Ata të cilët bëjnë shpifje për besimtaret e ndershme dhe të padjallëzuara, le të jenë të mallkuar në këtë botë dhe në botën tjetër. (En-Nur: 23).

"O besimtarë! Mos të tallen burrat njëri me tjetrin, mbase ata janë më të mirë se këta; por as gratë njëra me tjetrën, ndoshta ato janë më të mira se këto. Mos e qortoni njëri-tjetrin dhe mos i ngjitni njëri-tjetrit llagape (të këqija)! O, sa e shëmtuar është që besimtarët të përmenden me llagape tallëse! (El-Huxhurat: 11).

"O besimtarë! Mos hyni në shtëpitë e huaja pa marrë leje dhe pa i përshëndetur njerëzit e saj." (En-Nur: 27).

"Dhe përmbushni obligimet, sepse për obligime me të vërtetë do të ketë përgjegjësi." (El-Isra: 34).

"O besimtarë! Shmanguni prej shumë dyshimeve, meqë disa dyshime janë me të vertetë mëkat. Dhe mos spiunoni njëri-tjetrin e as mos e përqeshni njëri-tjetrin! Mos vallë dëshiron ndokush prej jush të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur?..." (El-Huxhurat: 12).

"Nëse dikush nga idhujtarët të lutë për mbrojtje, ti mbroje atë që t'i dëgjojë fjalët e All-llahut, e pastaj përcjelle në një vend të sigurt për të..." (Et-Teube: 6).

Ndërsa për luftën dhe etikën luftarake Kur'ani thotë:

"O besimtarë! Kur të ndesheni me mosbesimtarët, e ata janë shumë, mos ua ktheni shpinën! (El-Enfal: 15).

"All-llahu me të vërtetë i don ata që luftojnë në rrugën e tij, në radhë sikur t'ishin beden i fortë." (Es-Saff: 4).

"...Nëse në mesin tuaj gjenden njëzet të qëndrueshëm, do t'i mundin dyqind, e nëse janë njëqind, do t'i mundin një mijë nga ata që nuk besojnë, për shkak se ata janë njerëz që nuk kuptojnë." (El-Enfal: 65).

"Thuaj: "Nëse ikni nga vdekja apo që të mos vriteni, ikja nuk do t'ju ndihmojë, prapë vetëm pak do të kënaqeni." (El-Ahzab: 16).

"Thuaj: "Kush është ai që do t'ju mbrojë nga All-llahu, nëse Ai don që t'ju godas e keqja, ose, kush mund t'ju dëmtoj nëse Ai don t'ju mëshirojë?..." (El-Ahzab: 17).

"Thuaj: "Vdekja nga e cila ikni me të vërtetë do t'ju arrijë. Pastaj do t'i ktheheni Atij që e di botën e padukshme dhe të dukshme, dhe Ai do t'ju informojë se çka keni punuar." (El-Xhumu'a: 8).

Për shpabesim Kur'ani fletë në këtë ajet:

"All-llahu u sjell si shembull atyre që nuk besojnë - gruan e Nuhit dhe gruan e Lutit: ato kanë qenë të martuara me dy rob të ndershëm nga robërit Tanë, por ato ndaj tyre kanë qenë tradhtare dhe ata dy nuk do të mund t'u ndihmojnë atyre dyjave - te All-llahu (për t'i shpëtuar nga dënimi), e do t'u thuhet: "Hyni ju të dyja në zjarr me ata (të gjithë) që po hyjnë." (Et-Tahrim: 10).

Ndërsa për hipokrizi Kur'ani thotë:

"O besimtarë! Përse flisni atë që nuk e punoni? O, sa e urrejtur është tek All-llahu kur i flisni fjalët të cilat veprat nuk i përcjellin!" (Es-Saff: 2-3).

"Hipokritët dhe hipokritet janë të ngjashëm me njeri tjetrin: kërkojnë që të bëhen vepra të këqija, dhe pengojnë të mirat, dhe janë duarshtrënguar, e harrojnë All-llahun, andaj edhe Ai i ka harruar ata. Hipokritët më të vërtetë janë mosbesimtarë të vërtetë." (Et-Teube: 67).

Për koprraci dhe dorëdhënësi Kur'ani thotë:

"Nuk do ta meritoni shpërblimin përderisa nuk e ndani një pjesë të asaj që e keni më të dashur..." (Ali Imran: 92).

"Dhe më tepër duan t'u bëjnë mirë atyre se sa vetes, edhe pse madje vetë janë nevojtarë." (El-Hashër: 90).

"Mos e mbajë dorën tënde të shtrënguar, e as tërësisht të hapur, që të mos meritosh qortimin (për shkak të koprracisë) dhe të mbetesh pa asgjë (për shkak të dorëlëshuarsisë)." (El-Isra: 29).

Kurse për mendjemadhësinë, përulësinë dhe mëshirën thotë:

"...Se All-llahu, me të vërtetë, nuk i do ata, të cilët krenohen dhe lavdërohen." (En-Nisa: 36.)

"Bëhu ndaj tyre i kujdesshëm dhe i përulshëm dhe thuaj: "O Zoti im, ki mëshirë ndaj tyre, siç kanë pasur ata kujdes ndaj meje në vegjëli." (El-Isra: 24).

Për faljen thotë:

"...Le t'ua falin dhe mos t'ua zënë për gabim. Vallë, a nuk do t'ju vinte mirë që edhe All-llahu t'ju falë juve?..." (En-Nur: 22).

"Ti ktheje të keqen me të mirë..." (El-Mu'minun: 96).

"Por kush duron dhe falë ajo është nga punët e mençura." (Esh-Shura: 43).

Në ajetet të lidhura fort Kur'ani përmbledh mësimet etike dhe thotë:

"Nuk është bamirësi të ktheni fytyrat tuaja kah lindja dhe kah perëndimi, por bamirësit janë ata, të cilët i besojnë All-llahut dhe asaj bote, edhe engjëjt, edhe Librat, edhe Pejgamberët, dhe të cilët nga pasuria, edhe pse e donë atë, u japin të afërmve dhe bonjakëve, edhe të varfërve, edhe udhëtarëve, edhe lypësve, edhe për lirimin e robërve, edhe që kryejnë faljen dhe japin zekatin, edhe që obligimin e vet kur e marrin e zbatojnë, sidomos ata, të cilët janë të durueshëm në skamje, edhe në sëmundje, edhe në luftë të ashpër. Ata janë besimtarë të sinqertë, dhe ata i frikësohen All-llahut dhe shmangen nga punët e këqija." (El-Bekare: 177).

Shembuj ka shumë. Kur'ani, në tërësi, është dokumenti më i madh etik.

Rruga e drejtë për të cilën flet Kur'ani është njohja e vetvetes, pastaj të drejtuarit kah Krijuesi. Kjo është rrugë e dyndjes, hixhretit, përkatësisht kthimi nga brendia e tokës kah drita dhe e vërteta, e Kur'ani është udhërrëfyesi më i mirë në këtë rrugë të rëndë jetësore.

NUK KA ZOT TJETËR PËRVEÇ ALL-LLAHUT

Nuk ka zot tjetër përveç All-llahut. Kurrgjë nuk ekziston pa vullnetin e Tij. Unë, ti dhe të gjithë ne jemi vetëm fotografi, të cilat shfaqen dhe zhduken në ekranin ekzistencial, siç është rasti me fotografinë në ekranin e televizorit e cila shfaqet, pastaj zhduket, pastaj përsëri shfaqet kur vjen

rryma elektrike dhe përsëri zhduket, dhe kështu me radhë. Në të njëjtën mënyrë ndërrohen epokat si dhe gjethet, në vjeshtë ato bien, grumbullohen nën lis, të vdekura, sikurse edhe njerëzit që kanë vdekur dhe janë të grumbulluar njëri mbi tjetrin në brendinë e tokës. Në kohët e gjata e të pafundme shumë varre janë bërë varre shumë herë. Të vdekurit janë varrosur në mbeturinat e të vdekurve. Kështu që toka, pas një milion vjetësh, është bërë si gjyshërit tanë. Ec ngadal, sepse kjo tokë është e përbërë nga këto kufoma.

Shkencëtarët, duke gërmuar, nga toka nxjerrin një surmedan, e vëzhgojnë atë dhe vijnë në përfundim se i kishte takuar motrës së Hakim bi-Emrilahut dhe vlerësojnë vjetërsinë e tij në 900 vjet, e në surmedan hasin edhe mbeturinat e surmes.

Ku është motra e këtij sundimtari? Kur ka qenë koha e saj? Të duket sikur dëgjon hapat e shërbëtorëve. I sheh floktaret dhe zonjat e pallatit. Nga largësia dëgjon tringëllimën e shpatave të rojtarëve të tij. Ngritet zëri i muezinit. Kali hingëllon. Agai i pallatit thërret emisarin i cili kthehet nga Qadeshi. Hakimi hyn me suitën dhe shërbëtorët e vet. Ku është e tërë kjo? Nën tokë. Është bërë dhe. Ka qenë kjo ëndërr në imagjinatën e kohës. Nesër edhe unë edhe ti gjithashtu do të jemi nën tokë. Kjo do të jetë një rresht i librit dhe një ëndërr në imagjinatën e historianëve. Arkeologët hasin në pakon e cigareve tuja, dhe shkruajnë rrëfimin për emirin i cili ka vdekur nga helmimi me nikotin. Zhduken faktet ashtu siç janë zhdukur edhe pronarët e tyre. Çdo gjë bëhet dhe, edhe artisti, edhe publiku edhe kritiku, e mbetet vetëm Një i Vetmi, i Gjalli, i Cili nuk vdes kurrë.

"Ti je i vdekur, e edhe ata janë të vdekur." (Ez-Zumer: 30).

Shikoje vetën dhe do të shohësh se nuk ekziston. Ti je hije sikur edhe çdo hije tjetër, e cila në tokë ekziston derisa ka diell në qiell. Kur perëndon Dielli zhduket edhe hija. Me zhdukjen tënde zhduken edhe të gjitha hijet e tjera që i ke pasur afër vetes.

Ekzistenca jote ka qenë e mbështetur në diçka jashtë teje. Ekzistimi yt nuk është ekzistim real. Ajo ndien nevojën për një tjetër ekzistim. Ti ekziston me ndihmën Zotit. Ai e furnizon ekzistimin tënd dhe kur Ai e ndalë ndihmën e Vet, jeta jote mbaron.

Zoti ekziston nga vetvetiu dhe nuk ka nevojë për askënd. Ai me të vërtetë është vetekzistues. Asgjë nuk ekziston përveç Tij. Nga Ai çdo gjë emanon (rezulton) dhe Atij të gjitha i kthehen. Ai është gjithnjë i amshueshëm, e çdo gjë tjetër është gjithnjë e përkohshme.

Ai ia dërgon Muhammedit alejhis-selam Shpalljen dhe e informon:

"Dije se nuk ka zot tjetër përveç All-llahut! Kërko falje për mëkatet tua..." (Muhammed: 19).

Kurse në suren En-Nahl qëndron:

"Ai dërgon engjëjt me Shpallje, me dëshirën e Vet, kujt të dojë prej robërve të Tij: "Paralajmëroni se s'ka zot tjetër përveç Meje, pra frikësohmuni!" (En-Nahël: 2)

Ky është lajmi i parë dhe më i rëndësishmi i cili ka ardhur nga qielli. "Nuk ka zot tjetër përveç All-llahut". Kjo është zemra e Kur'anit, zemra e Islamit dhe e të gjitha Librave të shpallura. Nga këtu ka rezultuar edhe hadithi i Muhammedit alejhis-selam, në të cilin thotë: *"Gjëja më e mirë me çka kam ardhur unë dhe Pejgamberët e tjerë para meje është maksima: nuk ka zot tjetër përveç All-llahut."*

Kjo është devotshmëri.

"All-llahu lëshoi qetësinë e Vet në Pejgamberin e Vet dhe në besimtarët dhe i obligoi ata me fjalën e takvasë (shehadetit) e ata gjithsesi kanë pasur më shumë të drejtë në të dhe kanë qenë më të denjë për të. All-llahu me të vërtetë i di të gjitha. (El-Fet'h: 26).

Fjala takva (devotshmëri) do të thotë nuk ka zot tjetër përveç All-llahut. Kjo është lutja e engjëjve në tubimet qiellore. Ky është shehadet (dëshmi) të cilin ai që falet e shqipton dhjetë herë për çdo ditë në namazet e tij. Kjo është fjala e shpëtimit, të cilën çdo fatlum e shqipton në grahmën vdekjes para se t'i dal shpirti. Kjo është fjalë e të përkujtuarit se çdo gjë është e përkohshme. Kjo fjalë, po qe se do të bëhej ligj jetësor, është në gjendje ta bëjë jetën më të mirë dhe më të bukur, jetë në të cilën ekzistojnë vetëm vlera të përhershme. Vetëm All-llahu është Zot. Pra s'ka tjetër hyjni pos Tij.

Nuk do ta adhurojmë njëri-tjetrin, e as që do të mbytemi për ndonjë send, sepse e kuptojmë se këtu nuk ka asgjë. Nuk do të na kaplojë xhelozia, pasi që e dimë se jemi vetëm hije, të cilat zhduken në sipërfaqen e ujit. Nuk do t'i gëzohemi pasurisë, e as që do të rënkojmë për shkak të varfërisë. Nuk do të jemi të pavendosur para flijimit, e as që do të pikëllohemi tek fatkeqësia, sepse kuptojmë se këto janë vetëm gjendje kaluese.

Ky fakt mund të na inspirojë për durim edhe pranë dhembjeve më të mëdha, sepse ato janë kaluese, të përkohshme sikurse edhe çdo gjë tjetër. Nuk do t'i frikësohemi njëri-tjetrit; si mund të frikësohet i vdekuri prej të vdekurit? Nuk do të frikësohemi, sepse çdonjëri prej nesh e di se është vetëm hije, dhe kurrgjë tjetër. Do të dashurojmë dhe do të ndihmojmë me modesti. Do të kundërshtojmë dhe do të luftojmë trimërisht. Dekoratat më të larta do t'i pranojmë me turp. Të turpëruar do t'i dëgjojmë lavdithurjet. Do t'i durojmë të gjitha pa kufi. Do t'i flijojmë të gjitha pa

kufi. Nuk do t'i frikësohemi luftës, mikrobeve, sëmundjeve, sepse e kuptojmë Njësinë e Subjektit. Subjekti është Zoti, e të gjitha tjerat janë shkaqe. Mikrobi nuk bën dëm. Zoti është Ai i cili jep edhe dëmin edhe dobinë. Ai sundon dhe mbretëron me shkaqet.

Ai ka e krijuar akrepin, helmin dhe trëndafilin. Ai është i cili shpërndanë aroma dhe zgjeron helmin në gjak. Ai është vendi i suksesit dhe fatkeqësisë. Askush nuk mund t'i kundërshtojë përcaktimit të Tij, e as që mund ta shtyjë urdhërin e Tij. Ai është i vetmi faktor aktiv, e ne të gjithë jemi vetëm mjete të Tij.

Zemrat tona do të mbushen me qetësi, me besim dhe me siguri, sepse kuptojnë se kanë ndihmë nga i Gjalli i cili nuk vdes. Kush beson se fuqia dhe pushteti i takon vetëm All-llahut dhe se të gjitha janë në dorë të All-llahut, do të jetë mutewekkil, d.m.th. ai i cili në punët e veta i mbështetet vetëm All-llahut.

Tewekkul nuk është njësoj sikurse Tewakul.

Tewekkuli kërkon energji, vendosmëri, përpjekje, e krahas të gjitha këtyre, në fund çdo gjë ia lë vullnetit të Zotit. Suksesi dhe mossuksesi atëherë do të jenë të paradestinuar sikurse përpjekja personale.

"...E kur të vendosish, atëherë mbështetu tek All-llahu... (Ali Imran: 159).

Mutewekkili dallon nga njeriu mendjemadh dhe të mërzitshëm, sepse heq dorë nga fuqia dhe pushteti... punon dhe suksesin në punë ia përshkruan Zotit, e jo vetes. Suksesin e vet e quan ndihmë të All-llahut, e jo sukses të cilin e ka arritur me vullnetin e vet. Veprën e duarve të veta e

konsideron si njërin nga shkaqet që i ka siguruar Zoti, në mënyrë që të ketë sukses në punën e vet.

Njeriu kryelartë mendon se çdo gjë që bën në jetë është produkt i mendjemprehtësisë, aktivitetit dhe zgjuarësisë së vet, duke mos pranuar vullnetin e tjetërkujt pos vullnetin e vet i cili influencon në botë dhe në kozmos.

Mutewakkili është njeriu i tretë, e ky dallon prej dy të parëve: pensionist, përtac, i pavendosur, papuntor i cili dëshiron që çdo gjë t'i vijë vet nga Zoti. Ai është i ngjashëm me ata të cilët, kur i ka thirrë Musai alejhis-selam të luftojnë, janë përgjigjur: "Shko ti dhe Zoti yt e luftoni, ne do të rrimë këtu!" (El-Maide: 24).

Mutewekkili është i sigurt në vete dhe në Zotin e vet. Ky nuk është rasti tek Mutewakili, i cili nuk beson në sistemin të cilin e ka vendosur Zoti dhe në të cilin çdo gjë është e lidhur me zinxhirin e kauzalitetit (shkaktueshmërisë), kurse vendosmërinë e ka bërë shkak të domosdoshëm që të arrihet diçka.

Mutewekkili i ngjan udhëtarit i cili mendon për udhëtimin e vet, e rezervon biletën e trenit, përgatitë valixhen dhe me kohë shkon në stacion. Kur hyn në tren dhe ulet, i mbështet drejtuesit të trenit duke besuar në aftësitë e tij dhe në ligjet sipas të cilëve zhvillohet lëvizja. Aq është i sigurt, saqë rehatohet dhe e zë gjumi në ulëse si fëmijën. Mirëpo, po t'ishte i shqetësuar do të shkonte afër drejtuesit, do të përzihej në drejtimin e lokomotivës, e atëherë secili do ta konsideronte si ahmak i cili i hyn punëve që nuk i di. Ne në këtë botë jemi porsi ky udhëtar. Përpiqemi t'i sigurojmë vetit vendin më të mirë në lundër, të cilën e quajmë botë dhe njëkohësisht i dorëzohemi, tërësisht të sigurt lundërtarit i cili udhëheqë me këtë botë duke besuar në ligjet e tij.

Zemra jonë është e përmbushur me siguri, punojmë dhe luftojmë, andaj na kaplon qetësia, besimi dhe të besuarit se secili prej nesh fiton atë që meriton. Atëherë nuk pikëllohemi për shkak të mossuksesit, e as që dalldisemi për suksesin që kemi arritur. Nëse na robëron shqetësimi për shkak të kësmetit që na ka goditur, atëherë kjo është shenjë e besimit të dobët dhe mungesës së mbështetjes tek Zoti.

Për sa i përket mutewakilit ai është udhëtar i një lloji tjetër. Ai mendon për udhëtim e nuk përgatitet për rrugë. Rezervimin nuk e ka bërë, e as që e ka përgatitur valixhen. Thotë se e beson Zotin dhe se mbështetet tek Ai. Zoti do t'ia dërgojë biletën nga qielli, e edhe dikë që ta vozitë gjer në stacion pa pagesë.

Duke menduar në këtë mënyrë ai ka mbetur aty ku ka qenë. Për mossuksesin e vet e fajson Zotin dhe thotë se është vullneti i Zotit, të cilin ai e ka pranuar pa vërejtje, sepse e ndien veten si besimtar. Mirëpo, është fakt se sjellja e tij nuk tregon se është besimtar. Kush e beson Zotin, duhet të besojë edhe në ligjshmëritë e Tij, të cilat i ka vënë në këtë botë dhe me të cilët i ka ndërlidhë shkaqet me pasojat. Në këtë mënyrë Ai e ka bërë punën si kusht të domosdoshëm për t'u arritur diç. Aq më tepër, punën e ka caktuar me imperativ:

"Dhe thuaj: "Punoni se All-llahu do ta shohë punën tuaj..." (Et-Teube: 105).

Tewekkul, mbështetja tek Zoti, është gjë e madhe. Këtë mund ta arrijë vetëm sufisti, mistiku, besimtari i cili sinqerisht beson se nuk ka zot tjetër përveç All-llahut. Ai mbështetet tek All-llahu, e don Atë, e don rendin dhe rregullimin e Tij, është i kënaqur me urdhërat e Tij, punon dhe përpiqet, e njëkohësisht mbështetet tek Zoti. Nuk brengoset për atë se a do të ketë sukses apo jo, në të dy rastet ai është i sigurt se do t'i ndodhë ajo që ka merituar. All-llahu është i drejtë. Ai

askujt nuk i ka bërë zullum. Kush ia arrinë, ai i lanë duart nga mendjemadhësia, mohon efektin e vet dhe thotë me modesti: "Këtë që e kam arritur, e kam arritur duke i fakënderuar Zotit. Kjo që ka ndodhur, nuk do të ndodhte nëse kështu nuk do të dëshironte Zoti. Unë dhe vepra ime janë një nga shkaqet që i ka përgatitur Zoti. Atij i falënderohem në fillim dhe në mbarim." Nëse i ndodhë ndonjë fatkeqësi , nuk ndryshohet, e as që pikëllohet, por thotë: "Zoti më ka përgatitur çdo të mirë."

"...Mund të urreni një gjë, por ajo mund të jetë e mirë për ju; mund të doni një gjë, por ajo mund të jetë e dëmshme për ju..." (El-Bekare: 216).

Besimtari i vërtetë përherë e përkujton veten se nuk din asgjë dhe se Zoti është i vetmi i Cili din çdo gjë. Nuk është e lejuar kundërvënia vullnetit të Zotit. Besimtari gjithnjë i kthehet Zotit, mbështetet tek Ai, lufton dhe beson se të gjitha ligjet e Zotit i përkasin krijesave të Tij. Maksima "nuk ka zot tjetër përveç All-llahut" për të nuk është fjalë boshe, por program i jetës dhe ligj i zemrës; ajo është udhërrëfyesja e tij në jetë dhe dritë e cila ia ndriçon rrugën. Prandaj ai heq dorë nga fuqia dhe pushteti, sepse beson se nuk ka as fuqi as pushtet. Fuqi dhe pushtet posedon vetëm All-llahu. Vetëm Ai është i fuqishëm. Vetëm ai përnjëmend ekziston. Kjo është ajo që ne e quajmë me termin "takva" (devotshmëri, përshpirtje). Për këtë shkak maksima "nuk ka zot tjetër përveç All-llahut" në Kur'an është adekuate me fjalën "takva". Kush e shqipton dhe domethënien saj e mishëron në zemër dhe në mendje dhe kujt ajo i bëhet fener deti i jetës, ai ka besuar, ai ka besim.

Për të, në një hadith kudsij, All-llahu xhel-le shanuhu thotë: *"Nuk ka zot tjetër përveç All-llahut" është fortifikata Ime. Kush e shqipton - ka hyrë në fortifikatë, e kush hyn në fortifikatën Time, ai është i mbrojtur nga*

ndëshkimi Im." Ajo është fillim i çdo lutjeje. Me të çdo sufij e fillon dhikrin e vet, afrimin e vet tek Zoti dhe lutjen e vet. Ajo është definicion i Zotit, njohuri se asgjë nuk ekziston pos Tij. Çdo gjë tjetër që ekziston është sa për dukje, paraqet përhitjen, gjegjësisht iluzionin e shqisave toNe. Ai është i Gjalli dhe i Amshueshmi, i Cili i jep jetë çdokujt, e jetën e Vet nuk e thithë prej askujt. Ai është dritë. Me ndihmën e Tij i shohim gjërat. Është dritë e syrit, e mendjes dhe e zemrës. Ai është e vërteta, e çdo gjë tjetër është e pavërtetë. Ai është i Lartësuari, i Cili plotëson qiejt dhe Tokën, Nuk është i kufizuar as me kohë as me hapësirë. Ai është i fortë pamasë. Ai ekziston pa fillim. Ai është një dhe e vetmja shpresë, tjetër shpresë përveç Tij nuk ekziston . Qoftë i Lavdëruar Ai. Nuk ka zot tjetër përveç All-llahut. Qenia e Tij është e Shenjtë. Ai është i pastër nga çdo e metë. Asgjë në qiell dhe e as Tokë Atij nuk i ngjan. Ai të gjitha i përfshinë më shikim, e shikimi nuk arrijë tek Ai. Nuk është i lindur, e as që ka lindur . Ai është i pasuri, Ai i Cili jepë pasuri, Ai i Cili ngadhënjen, i Cili të gjitha i përcjellë dhe për të gjitha kujdeset në të dy botët. Krijon dhe përsëri e kthen më një fjalë, Detet do të thahen, e fjalët e Tij jo. Nga ne është i fshehur për shkak të iluminizmit, përhershmërisë dhe shfaqjes tejet të madhe të Tij.

Nga ai çdo gjë fillon dhe Atij çdo gjë i kthehet. Nuk do të kemi rehati përderisa nuk gjendemi në afërsi të Tij. Ai është Zoti ynë. Gjithçka që ekziston Ai i ka përfshirë me mëshirën e Vet dhe me diturinë e Vet. Nuk e madhërojmë proporcionalisht me fuqinë e Tij. Nuk do të mundnim edhe nëse do të donim. E si do Te madhërojmë kur nuk i kemi përfshirë veprat dhe diturinë e Tij? Nuk kemi fuqi që T'i falënderohemi. Prandaj ai Vetvetes i ka falënderuar në fillim të *Fatihasë*: "Çdo lavdërim i përket All-llahut, Zotit të botëve!" Ai është i Cili lavdëron dhe meriton çdo lavdërim, sepse Ai i Vetmi në realitet ekziston. Ne jemi vetëm emanacion i bujarisë së Tij. Vetëm

Ai është i aftë për të lavdëruar, sepse Ai është Vetmi që i di fshehtësitë e veprave të Veta. Ne jemi dëshmitarë të një thërrmie nga thërrmiat e Tij të Tokës dhe qiejve të pakufishëm.

Ai është i Miri dhe Bujari. Neve na ka zgjedhur formën e Vet që T'i falënderohemi dhe ne themi: "Çdo lavdërim i përket All-llahut, Zotit të botëve!" në fillim të çdo namazi. Ai na ka informuar se botën e ka krijuar në emër të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit, e jo në emër të Fuqishmit, i Cili ngadhënjen. Ai ka krijuar nga mëshira, nga mëshira absolute (*"Er-Rahman"* është Ai i cili përfshinë me mëshirën absolute të tëra që i ka krijuar, edhe ata që e meritojnë edhe ata që nuk e meritojnë). Në fillim të çdo pune themi: "Në emër të All-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!", sepse Ai në emër të gjithëmëshirës dhe mëshirëplotësisë së Vet ka filluar krijimin. Të gjitha i ka krijuar nga mëshira, e jo nga dëshira për nështrim. Ai Vetes ia ka caktuar mëshirën. Në një hadith kudsij thotë: *"Mëshira Ime është para zemërimit Tim"*.

Në Fatiha Ai është së pari i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti e pastaj Sundues i Ditës së gjykimit. Dita e gjykimit është Ditë zemërimi dhe e dhënies së llogarisë, Ditë në të cilën njeriu jep llogaritë e veta.

"Nuk ka zot tjetër përveç All-llahut". Kjo maksimë në brendinë e vet përfshinë unitetin absolut. Ajetet e Fatihasë përqëndrojnë vëmendjen dhe e drejtojnë njeriun kah Një i Vetmi.

Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm nga Ti ndihmë kërkojmë. Drejtona në rrugën e drejtë!

Ti je i Vetmi të Cilin e Adhurojmë. Ti je i Vetmi i Cili drejton ne rrugë të drejtë. Rruga e drejtë është ajo që shpien kah Zoti, kah e Vërteta dhe kah shpëtimi. Prandaj *Fatiha* është definimi i Zotit, rruga kah Ai. Ajo është përmbledhje e tërë përmbajtjes së Kur'anit në shtatë ajete. Në

esencë e tërë përmbajtja e Kur'anit është definim i Zotit dhe rrugë që shpie tek Ai. Zoti në Kur'an është qenie, emra, atribute dhe vepra. Vepra e Zotit është Gjithësia: me qiejt dhe Tokën, me krijesa dhe me botën e padukshme (botën e gajbit). Xhenneti, Xhehennemi dhe bota tjetër janë vetëm një pjesë e asaj që ka krijuar Ai. Rruga kah Zoti, sipas Kur'anit, shpien përmes ibadetit, sheriatit dhe dashurisë. Kjo është rruga e drejte, rruga e shpëtimit.

Fatiha në mënyrë të thukët flet për këto fakte. Prandaj Pejgamberi i Zotit, Muhammedi alejhis-selam ka thënë se Fatiha është pjesa më e mirë e Kur'anit gjersa për Jasinin-sherif ka thënë se është zemra e Kur'anit. Kush e lexon Kur'anin me kujdes, do ta ndie se ai ka mugulluar prej një thelbi, prej maksimës "La ilahe il-lall-llah" (nuk ka zot tjetër përveç All-llahut), e cila është degëzuar, gjethuar dhe ka sjellur frutet e tërë pemës së Kur'anit. Prej këtu kanë lindur të gjitha shkencat dhe dituritë. Kjo shihet qartë në Ajetul-kursij, i cili fillon me Unitetin (Njësinë) e Zotit, pastaj gjurmëve të pandërprera arrinë tek atributi Një i Vetmi i Cili mirëmbanë të gjitha.

"All-llahu është - nuk ka zot tjetër përveç Tij - i Gjalli dhe i Përjetshmi! Nuk e kaplon kotja as gjumi! E Tij është çka ka në qiej dhe çka ka në Tokë! Kush është ai që mund të angazhohet për dikë te Ai pa lejimin e Tij? Ai di çdo gjë që ka ndodhur para tyre dhe çdo gjë që do të ndodhë pas tyre, dhe prej asaj që di Ai - të tjerët dinë vetëm aq sa dëshiron Ai. Kursija e Tij ngërthen edhe qiejt edhe Tokën dhe Atij nuk i vjen rëndë t'i ruajë ato. Ai është Shumë i Larti, i Madhërishmi!" (El-Bekare: 255).

Shumë sure dhe shumica e ajeteve fillojnë me Unitetin (Njësinë) e Zotit, apo me të përfundojnë. Çdo gjë fillon nga Një i Vetmi dhe ne fund çdo gjë i kthehet Atij. Nga matematika e dimë se numri një pjesëtohet në pafundësi dhe se i jep të gjitha numrat, thyesat dhe pjesëzat. Zoti është

Një. Ai i jep të gjitha numrat, por është i papjestueshëm. Prandaj për Vete ka thënë se është i Vetmi.

I vetmi është një i cili nuk pjesëtohet dhe nuk mund të ndahet në pjesë. Ai është Një. I plotë në qenien e Vet. Është e pamundur të ketë pjesë. Ai përherë është tërësi. Duke qenë se është një, është e pamundur të jetë dy me pjesëtim apo me shumëzim. Ai është i pastër nga të metat. Përleshjet dhe luftërat tek Ai nuk ekzistojnë, sepse lufta shpërthen mes dy palëve, e Ai gjithnjë është Një. Njëri nga emrat e Tij të bukur është "Es-Selam" (Paqja). Për të arritur paqen duhet të bashkohemi si shtete, si popuj dhe si kombe. Askush prej nesh nuk mund të realizojë paqen e vet të brendshme, pos me bashkimin e tekeve dhe arsyes, dëshirave dhe qëllimit. Kjo është e mundur të realizohet me zhytjen në qenien e Zotit në kuptimin mistik.

Numrat dhe shkronjat tek sufistët kanë domethënien e vet. Çdo numër e ka shenjën e vet. Çdo shkronjë e ka numrin e vet gjegjës.

Disa numra e kanë edhe shenjtërinë e vet, si për shembull numri shtatë: shtatë qiej, shtatë tokë, shtatë ngjyra të spektrit, shtatë notat e muzikës, shtatë ditët e javës, plotësimi i zhvillimit të foshnjës në muajin e shtatë, shtatë dyert e Xhehennemit, shtatë ajetet e Fatihasë...

Po ashtu edhe shkronjat e kanë fshehtësinë e vet. Shkronja "haun" të themi, hyn në çdo fjalë që sillet në sferën e domethënies "suhunet" (nxehtë), si p.sh. "hubbun" - dashuria, "harbun" - lufta, "harikun" - zjarri i madh që bie e djeg ndonjë objekt etj., "hararetun" - temperatura e të tjera, që do të thotë se çdo shkronjë në esencën e vet ka specifikën, domethënien dhe kuptimin e vet. Kjo tregon se shkronjat, që gjenden në fillim të disa sureve të Kur'anit: elif, lam, mim, ta, sin, mim, ha,

mim, kaf, nun, sad etj. kanë kuptimin e vet dhe domethënien e vet, të cilat tani për tani nuk mund t'i kuptojmë, por në të ardhmen, me siguri, do t'i kuptojmë edhe ato.

Në Kur'an nuk ekziston asnjë shkronjë tepër, asnjë shkronjë mangu, as shkronjë që nuk është në vendin e vet. Zoti është mësuesi i parë..."i Cili ia mësoi njeriut pendën (të shkruaj) dhe i Cili ia mësoi njeriut atë që nuk e diti." (El-Alak: 4-5). Ai është i Cili na ka frymëzuar, na ka mësuar shkronjat dhe disa fshehtësi të tyre. Kur'ani, për shkruesin e ndonjë dokumenti, thotë: "...e të mos ngurrojë shkruesi të shkruajë ashtu siç e ka mësuar All-llahu..." (El-Bekare: 282). Në të njëjtën sure dhe në të njëjtin ajet qëndron: "...frikësohuni All-llahut, All-llahu ju mëson..."

All-llahu është mësues, fakultet, shkollë, bibliotekë - librat janë vetëm shkaqe dhe mjete. All-llahu është Dhurues i vërtetë. Ai na ka dhuruar shpirtin dhe arsyen. na ka mësuar gjërat dhe fjalët dhe kështu na ka dhënë mundësinë t'i përvetësojmë arritjet shkencore. Një fjalë, si për shembull "nëna", mjaft ngjashëm shqiptohet në shumë gjuhë: në arabishte, anglishte, frëngjishte, madje edhe në gjuhën nijam nijam hasim në konstruksion të ngjashëm: ummun, mama, mami, moma. E njëjta gjë është edhe më fjalën "babë": ebun, baba, babi, dhe boba. Kjo ngjashmëri, pa marrë parasysh vendet dhe rajonet, tregon në unitetin e burimit, si dhe atë se shkronjat e para i kemi pranuar me anë të frymëzimit. Disa domethënie të shkronjave dhe përdorimin e tyre e kemi kuptuar nga burimi i njëjtë. Kyçja e shkronjës "baun" në fjalët: ebun, baba, babi dhe boba zbulon fshehtësinë e kësaj shkronje. E njëjta gjë është edhe me shkronjën "mim" në fjalën "ummun". Çdo shkronjë posedon specifikën shprehëse dhe fshehtësitë e veta. Nga e tërë kjo ne dimë shumë pak. Kur Kur'ani na informon për ato shkronja në fillim të disa sureve, si p.sh. ta-si-mim, kaf-ha-ja-ajn-sad, ha-mim, ta-sin, ai me të vërtetë na komunikon fshehtësitë. Nuk janë ato shkronja vetëm të radhitura njëra pranë tjetrës. Kjo është nxitje shpjegimin e të cilës mund ta presim në

ditët e fundit. Ky fenomen është komentuar nga shumë komentues të Kur'anit në mënyra të ndryshme. Disa thonë se All-llahu është betuar me këto shkronja, disa thonë se prej tyre përbëhet emri i Zotit, fshehtësinë e të cilit e ka ruajtur vetëm për Vete. Disa të tjerë thonë se këtu është në pyetje vetëm terminologjia, e disa thonë se janë emra të bukur të Zotit (nga elif-lamra, ha-mim, nun, është i përbërë emri i Zotit "Er-Rahman" - i Gjithëmëshirshmi).

Ibni Arabi thotë se kjo është gjuha e Zotit, me ndihmën e së cilës Zoti përmes engjëjve dhe të zgjedhurve të Tij udhëheqë me kozmos. Në veprën "Fatuhat El-Mekkije" thotë se Asafi, veziri i Sulejmanit alejhis-selam duke u shërbyer me këto shkronja për një qast e ka bartë fronin e mbretëreshës Belkise. Me ndihmën e tyre të zgjedhurit mund ta shndërrojnë materien në energji, dhe anasjelltas.

Të gjitha këto janë vetëm supozime të thata, ndërsa domethënien e vërtetë të këtyre shkronjave e di vetëm All-llahu xhel-le shanuhu. Ne nuk mund të depërtojmë në Kur'an gjatë një brezi apo më shumë brezash. Kur'ani është shpallur për të gjitha kohët në mënyrë që t'i zbulojë fshehtësitë e veta sa të jetë jeta.

Kur'ani gjithnjë i zbulohet atij që dëshiron ta kuptojë dhe i cili e studion atë. Ai ia hap zemrën çdonjërit i cili atij ia hap zemrën e vet.

MU'XHIZJA E KUR'ANIT, Ç'ËSHTË KJO?

Kur'ani është Libër i cili shumë gjëra e ka parashikuar që më parë. Disa prej atyre gjërave kanë ndodhur në kohën e kaluar, e disa presin kohën e vet.

Mu para betejës së Bedrit ndërmjet myslimanëve numerikisht të vogël dhe mushrikëve të shumënumërt, All-llahu xhel-le shanuhu zbret Shpalljen e thotë:

"Dhe kur All-llahu ju premtoi se njëri nga dy grupet do të jetë i juaji... (El-Enfal: 7).

"Grupi së shpejti do të jetë i mundur dhe ata do të ikin." (El-Kamer: 45).

Kjo me të vërtetë edhe ka ndodhur.

Para hyrjes në Mekë, kur vizita e Ka'bes për myslimanët në mërgim ishte vetëm ëndërr, zbret Shpallja që t'ia vërteton Pejgamberit alejhis-selam ëndrrën e tij:

"All-llahu do të njëmendëson ëndrrën e Pejgamberit të Vet se ju me të vërtetë do të hyni në tempullin e Shenjtë të sigurt - nëse dëshiron All-llahu - disa kokërruar e disa flokëshkurtuar pa kurrfarë frike..." (El-Fet'h: 27).

Për fitoren e bizantinëve, pas humbjes së tyre, Kur'ani thotë:

"Bizantinët u mundën në tokën më të afërt, por ata pas humbjes së tyre me siguri do të ngadhënjejnë brenda disa vjetëve..." (Er-Rum: 2-4).

Fjala bid'un në gjuhën arabe përdoret për diç që është më pak se dhjetë e më shumë se tri vjet. Dhe me të vërtetë, ka ndodhur që bizantinët të ngadhënjejnë shtatë vjet pas humbjes së tyre.

Pos këtyre, aty janë edhe parashikimet që kanë të bëjnë me Ditën e gjykimit, ndarjen, përkatësisht çarjen e Hënës, paraqitjen e tymit etj., për çka kemi shkruar më heret.

Kur polemizon Kur'ani, atëherë polemizon shkencërisht duke u bazuar në argumente. Për ata që nuk besojnë në ringjallje pas vdekjes Kur'ani thotë:

"Dhe ai na sjell shembull, dhe harron se si është krijuar, e thotë: "Kush do t'i ngjallë eshtrat duke qenë ato të kalbura (shkapërderdhura)?"Thuaj: "Do t'i ngjallë Ai që i krijoi herën e parë; Ai i di të gjitha ato që i ka krijuar." (Ja Sin: 78-79).

"E, vallë, mos jemi lodhur Ne gjatë krijimit të parë? Jo, por ata dyshojnë në krijimin e sërishëm." (Kaf: 15).

Ekzistimin e Krijuesit Kur'ani nuk e argumenton me faqe të teksteve filozofike, por vetëm me një pyetje e cila i lë në dilemë ata që mohojnë Zotin:

"A mos vallë, ata janë krijuar pa Krijues, apo mos janë ata krijues të vetvetes?!" (Et-Tur: 35).

Pyetja është e hapur edhe më tej, madje edhe pas pesë mijë vitesh të zhvillimit filozofik. Dhe përsëri është pa përgjigjje. Kur njerëzve dëshiron t'u sqaron faktin themelor filozofik: se çdo gjë ka formën e vet e cila është kaluese, e përkohshme dhe esencën e cila është e përhershme, Kur'ani nuk shërbehet me logjikë apo me argumente siç bëjnë zakonisht filozofët, por për faktet merr shembull më të thjeshtë:

"...Për sa i përket mbeturinave ato hudhen, gjersa ajo që u shërben njerëzve mbetet në tokë. Ja, kështu, All-llahu ju shpjegon shembujt." (Er-Ra'd: 17).

Kur dëshiron ta heshtë dikë apo ta frenojë, atëherë sjellë shembull tjetër:

"O njerëz, ja një shembull, e dëgjojeni atë: "Ata, të cilëve ju, në vend të All-llahut, u luteni nuk munden kurrsesi të krijojnë mushkonjën po edhe sikur të tubohen për këtë (krijimin e mushkonjës). E, nëse mushkonja, u rrëmben atyre diçka, nuk do të mund ta shpëtojnë prej saj. I dobët është adhuruesi (i tjetërkujt pos All-llahut), por edhe i adhuruari (pos All-llahut)." (El-Haxhxh: 73).

Ky shembull ende është fshehtësi si për shkencën ashtu edhe për shkencëtarët, madje edhe pas zhvillimit njëmijëvjeçar të shkencës dhe teknologjisë. Kush është ai që është në gjendje të krijon mushkonjën aq të vogël dhe të parëndësishme? Nëse mushkonja me anë të infektimit ta rrëmben jetën kush është ai që do ta kthejë jetën; nëse e merr madje vetëm një pjesëz të amidonit nga gjella jote, kimistët, të gjithë të tubuar nuk do të mundnin ta kthenin atë, sepse amidoni nën ndikimin e fermenteve të ndryshme tretëse shndërrohet në sheqer. I pafuqishëm është ai që kërkon, si dhe ajo që kërkohet, në këtë botë të pakufishme, të cilën e ka krijuar Krijuesi duke ngërthyer të gjitha me diturinë e Vet. Me këtë thjeshtësi Kur'ani i shpjegon problemet tejet të komplikuara, të kuptueshëm për çdo arsye (mendje).

Shpirti, sipas Kur'anit, është i vdekshëm siç është i vdekshëm edhe trupi. Në Kur'an All-llahu xhel-le shanuhu thotë:

"Çdo shpirt do ta shijojë vdekjen..." (Ali Imran: 185).

"Shpirti vdes me vullnetin e All-llahut në çastin e caktuar..." (Ali Imran: 145).

"...Mos e vritni personin, vrasjen e të cilit e ka ndaluar All-llahu, përveç kur e kërkon drejtësia..." (El-En'am: 151).

Nefsi - shpirti është nocion i përgjithshëm. Kjo fjalë është përdorur në Kur'an së pari për t'u caktuar dëshira, instinkti dhe pasioni. Nefsu-l-emmare, shpirti impulsiv:

"Unë nuk e shfajsoj veten, meqë shpirti (i njeriut) është fort i prirur për të keqe..." (Jusuf: 53).

"...Dhe ja kështu në shpirtin tim lindi mendimi i keq." (Ta Ha: 96).

Ndonjëherë është përdorur në kuptimin nefsul-lev-vame - shpirti kritik:

"Betohem në Ditën e kiametit dhe betohem në shpirtin e atij që e qorton vetveten." (Kijameh: 12).

E ndonjëherë është emëruar me nocionin ruh:

"All-llahu ua merr shpirtin në çastin e vdekjes së tyre."

Shpirti është fshehtësi, të cilin Zoti e merr në çastin e vdekjes, sepse ai nuk është i nënshtruar ligjeve të vdekjes së kësaj bote.

"Të pyesin për shpirtin. Thuaj: "Ç'është shpirti - vetëm Zoti im e di, e juve u është dhënë vetëm pak dijeni." (El-Isra: 85).

Në filozofi shpirti është fshehtësi. Ai nuk mund të dëshmohet me argumente shqisore, ndijore, e as që mund të mohohet. Ai mbetet problem para të cilit dijenia e jonë e kufizuar pushon së ekzistuari. Ky është problem shumë më i vështirë për t'u argumentuar sesa ekzistimi i Krijuesit.

Atë që ka thënë Kur'ani për historinë e krijimit, për qiejt dhe Tokën, për botën e padukshme (botën e gajbit), për etikën, drejtësinë, politikën, lirinë, përgjegjësinë dhe ceremonialet fetare, tanimë i kemi parashtruar detajisht dhe nuk ka nevojë që këtu t'i përsërisim.

Shumica të cilët shkruajnë për mu'xhizen e Kur'anit në radhë të parë tregojnë sheshit puthitjen e ajeteve kur'anore me shkencën bashkëkohore, në gjithmbarshmërinë e tij e cila ka të bëj me pushtetin, etikën, dispozitat juridike dhe metafizikën. Ata gjithashtu theksojnë edhe parashikimet kur'anore se çka do të ndodhë në të ardhmen, si dhe rrëfimet e tij që i përkasin të kaluarës, për ne të panjohura.

Mirëpo, unë konsideroj se mu'xhizja në rend të parë prehet në muzikën e tij, e cila posa arrinë te veshi i njeriut ia ngazëllen zemrën. Kjo është muzikë e cila nuk njeh instrumente, metrin poetik dhe rimën poetike.

Dëgjoni fjalët e Zekerijas alejhis-selam të drejtuara Zotit xhel-le shanuhu në suren Merjem: "Tha: "Zoti im! Eshtrat më janë dobësuar e koka më është thinjur, por kur Të jam drejtuar me lutje Ty, asnjëherë, o Zot im, nuk kam mbetur i pafat."(Merjem: 4)

Apo të dëgjojmë se ç'thotë Isai alejhis-selam në djepin e tij:

"Unë jam robi i All-llahut" - tha ai - "Ai do të ma jep Librin dhe do të më bëjë Pejgamber, do të më bëjë të lavdëruar kudo që të jem, dhe to të më urdhërojë që deri sa jam gjallë të bëj namaz dhe të jap zekat. (Merjem: 30-31).

Apo fjalinë muzikale, e cila flet për përkorësinë e Pejgamberëve të Zotit:

"Kur t'u lexohen ajetet e Mëshiruesit, ata bien me fytyrë për toke dhe qajnë." (Merjem: 50).

Apo zërin kërcënues me të cilin është përshkruar takimi me Zotin në Ditën e gjykimit:

"Njerëzit do t'i përulen të Gjallit, të Amshueshmit, e ai që i ka bërë shok Atij do të humbë çdo shpresë." (Ta Ha: 111).

Apo harmoninë hyjnore, me të cilën Ai e inkurajon Pejgamberin e Vet, Muhammedin alejhis-selam, muzikë kjo që robëron zemrën:

"Ta Ha, Ne, nuk ta shpallim ty Kur'anin që të mundohesh, por që të jetë këshillë për atë që frikësohet, - atë e shpallë Krijuesi i Tokës dhe i qiejve të lartë, i Gjithëmëshirshmi, që qëndron mbi Arshin *(i Cili udhëheqë me Gjithësinë e tërë)*. E Tij është çka ka në qiej e çka ka në Tokë dhe çka ka mes tyre e çka ka nën tokë! E, nëse ti lutesh me zë të lartë - Ai e di edhe atë çka i thua dikujt në fshehtësi dhe atë që ti vetëm e mendon. All-llahu, nuk ka zot tjetër përveç Tij, ka emrat më të bukur." (Ta Ha: 1-8).

Kur Kur'ani flet për mëkatarët dhe për ndëshkimin që i pret ata, atëherë muzika e Kur'anit tingëllon në vesh. T'i dëgjojmë ajetet nga sureja *El-Kamer*:

"Një ditë të kobshme dërguam në ta një erë të akullt, që frynte pandërprerë dhe i ngriste njerëzit, sikur t'ishin trungje të shkulur të hurmave." (El-Kamer: 19-20).

Kur engjëjt e madhërojnë All-llahun duke e lutur që t'i falë besimtarët, fjalët rrjedhin thuajse janë të shkrira nga ari:

"...O Zoti ynë, Ti çdo gjë ngërthen me mëshirë dhe më dituri, andaj fali ata të cilët janë penduar dhe të cilët ndjekin rrugën Tënde, dhe ruaji ata nga vuajtjet e zjarrit." (El-Mu'min: 7).

E kur kërcënohet me Ditën e gjykimit, atëherë në fjalë dominon frika dhe tmerri:

"Dhe terhiqjau vërejtjen atyre për Ditën e afërt të gjykimit, kur zemrat do t'u vijnë deri në fyt e të gajasen, kur dhunuesit nuk do të kenë as mik të sinqert, e as ndërmjetës që përfillet." (El-Mu'min: 18).

Pastaj qortimi, e çka vlenë ky qortim:

"O njeri, përse të mashtron ty ajo që Zoti yt është i mëshirshëm, i Cili të ka krijuar - dhe ka bërë që të jesh i harmonishëm e të mbahesh drejt, dhe të ka dhënë çfarë forme ka dashur Vet?" (El-Infitar: 6-8).

Lajm i gëzueshëm, kur engjëjt e sihariqojnë Merjemen për lindjen e Isait alejhis-selam:

"Oj Merjeme, All-llahu të sihariqon ty, me një Fjalë nga Ai; emrin do ta ketë Mesih - Isa, i biri i Merjemes, do të bëhet i famshëm edhe në këtë edhe në botën tjetër dhe do të jetë njëri nga të afërmit e All-llahut." (Ali Imran: 45).

Pastaj thirrja shurdhuese në vesh me fjalët të cilat prejnë:

"E, kur të arrijë zëri i madh shurdhues - në Ditë kur njeriu ikën nga vëllai i tij dhe nga nëna e babai i tij dhe nga bashkëshortja e fëmijët e tij - atë Ditë çdo njeri do të jetë i preokupuar me vetën e vet." (Abese: 33-37).

Ky trajtëformim dhe struktuim i llojllojshëm i shkronjave dhe fjalëve, e bënë Kur'anin thjesht të pakrahasueshëm. Në të kaluarën kurrgjë nuk ka pasur të ngjashëm me të. Nuk do të ketë as në të ardhmen. Fjalët rrjedhin thjesht, arrijnë në zemër dhe e nxisin atë ndjenjë të paqartë përkorësie edhe para se arsyeja fillon të analizojë e të mendojë. Vetë gëlimi (vrulli) i fjalëve në vesh dhe kontaktimi i tyre me zemër nxitë ëndje të shumta dhe të papërshkrueshme.

Kjo veçori, krahas të gjitha veçorive të tjera të burimeve të të folurit që i njohim ne, e bënë Kur'anin fenomen për të cilin është i tepërt çdo komentim.

Më së shumti që mund të bëj një letrar është që t'i shprehë ndjenjat e tij, përkatësisht të na informojë për vetën, mjedisin dhe shoqërinë, pastaj të na rrëfejë ngjarjet historike të cilat i ka ruajtur historia, gjegjësisht të na parashikojë ardhmërinë në bazë argumenteve ekzistuese me këngë, poezi të rimuar, tregim apo me dramë.

Kur'ani ndryshon nga të të gjitha ato që i përmendëm më sipër. Ai është mu'xhize - mrekulli. Ai na informon për botën e padukshme, për njohuritë shkencore - për ne ende të panjohura, për të kaluarën e cila është e evidencuar dhe për të ardhmen e cila ende nuk ka ardhur. Ai çdonjërit i ofron urtësinë e stërlashtë, etikën, filozofinë, metafizikën, mënyrën e afarizmit, dispozitat që kanë të bëjnë për bashkëshortësi, për luftën, për paqen dhe për ceremonialet fetare - me stil të thjesht dhe shprehje të larta. Ai është godinë estetike dhe stilistike, unike dhe e pakrahasueshme. Nuk

është poezi e as prozë në poezi. Atij asgjë nuk ka përngjа në të kaluarën e as që mund të imitohet. Kjo është Shpallje që ka ardhur si sprovë për të gjitha kohët dhe të gjitha epokat:

"E në qoftë se ju dyshoni në atë që Ne i shpallim robit Tonë (Muhammedit), atëherë hartonije një sure të ngjashme si atë që ia kemi shpallur atij, e thirrni (në ndihmë) edhe dëshmitarët tuaj (zotat që i adhuroni), përveç All-llahut, nëse e flisni të vërtetën. Por nëse nuk mundeni, dhe kurrsesi nuk mundeni (me i bë shembull Kur'anit), atëherë ruajuni zjarrit të përgatitur për mosbesimtarët, lëndë djegëse e të cilit do të jenë njerëzit dhe gurët. (El-Bekare: 23-24).

Kur'ani, pra, na provokon që ta imitojmë atë: madje qoftë edhe në një sure më të vogël të tij, e atëherë na tërheq vërejtjen se sigurisht nuk do të mundemi ta bëjmë këtë. Kjo është e vërtetë. Këtë e vërtetojnë ditët dhe vjetët. Brenda 1.400 viteve të kaluara, përkundër numrit të shumtë të armiqve të tij, historia nuk ka shënuar asnjë tentim të imitimit të Kur'anit. Kjo sprovë është ende në fuqi.

Kur'ani gjithnjë na zbulon fshehtësitë e veta, të cilat e bëjnë mu'xhize edhe më të madhe.

"Ne do t'u ofrojmë argumentet Tona në hapësirat e Gjithësisë, por edhe në vetë ata, përderisa nuk u bëhet tërësisht e qartë se Kur'ani është e vërteta..." (Fussilet: 53).

Ky është provokim i dytë. Ardhmëria do të vërtetojë se ajetet kur'anore të cilat tani i mësojmë janë fshehtësi.

"E përse ata nuk mendojnë për Kur'anin? Të ishte ai prej tjetërkujt e jo prej All-llahu, me siguri, në të do të gjenin shumë kundërthënie." (En-Nisa: 82).

Kur'ani paraqet përkryeshmëri në çdo fjalë dhe në çdo shkronjë. Çdo fjalë e tij është përmendur me arsye më heret apo më vonë nga ndonjë fjalë tjetër. Si shembull marrim fjalën semun (të dëgjuarit), të cilën Kur'ani në shumë ajete e përmend para fjalës besarun (të pamurit). Kjo është fshehtësi të cilën e njohin mirë ata që mirren me anatomi dhe filozofi: duke ditur se shqisa e të dëgjuarit është më e zhvilluar, më e përbërë, më ekzakte dhe më e mprehtë se shqisa e të pamurit. Shqisa e të dëgjuarit shquhet mbi shqisën e të pamurit edhe me atë se ajo mund të kuptojë edhe gjërat abstrakte, për shembull muzikën. Shqisa e të dëgjuarit është në gjendje t'i dallojë edhe zërat e përziera, të themi rastin e nënës e cila e njeh zërin e fëmijës së vet në mesin e një mijë zërave fëmijësh. Shqisa e të pamurit nuk mund të orientohet në atë rrëmujë. Fëmija humb nga shikimi i nënës, por nuk mund të humbas nga të dëgjuarit e saj. Musai alejhis-selam ka dëgjuar të folmit e Zotit, por nuk ka mund ta shohë Zotin. Sot shkenca na ofron shumë argumente, të cilat flasin për epërsinë e shqisës të të dëgjuarit ndaj shqisës të të pamurit.

E tërë kjo nuk ka qenë e njohur në kohën kur është shpallur Kur'ani, por, megjithëkëtë shqisa e të dëgjuarit është përmendur në Kur'an para shqisës të të pamurit në më tepër se në shtatëdhjetë vende.

"...Ai u jep të dëgjuarit, të pamurit dhe arsyen (mendjen) për të qenë falënderues." (En-Nahël: 78).

"...Kush disponon me shqisën e të dëgjuarit dhe të pamurit?..." (Junus: 31).

"...Atyre u kemi dhënë edhe të dëgjuarit edhe të pamurit edhe arsyen (mendjen)..." (El-Ahkaf, 26).

"Dhe kur të vijnë tek ai (zjarri), kundër tyre do të dëshmojnë veshët e tyre, sytë e tyre dhe lëkura e tyre..." (Fussilet: 20).

"Sa mirë do të dëgjojnë dhe sa mirë do të shohin atë Ditë kur do të dalin para Nesh..." (Merjem: 38).

"Ai u jep të dëgjuarit, të pamurit dhe arsyen (mendjen)..." (El-Mu'minun: 78).

"...Me të vërtetë, të dëgjuarit, të pamurit dhe arsyeja (mendja), për të gjitha këto do të ketë përgjegjësi." (El-Isra: 36).

"Ju nuk jeni fshehur që kundër jush të mos dëshmojnë veshët tuaj, dhe sytë tuaj, dhe lëkura juaj..." (Fussilet: 22).

"Thuani: "Çka mendoni sikur t'jua merrte All-llahu të dëgjuarit, të pamurit..." (El-En'am: 46).

"...E sikur të donte All-llahu, do t'ua merrte edhe të dëgjuarit edhe të pamurit..." (El-Bekare: 20).

"...Ata janë të cilëve All-llahu ua ka vulosur zemrat, të dëgjuarit dhe të pamurit" (En-Nahël 100).

"...Por as të dëgjuarit e tyre, as të pamurit e tyre dhe as arsyeja (mendja) e tyre nuk u kanë sjellur kurrfarë dobie..." (El-Ahkaf, 26).

"Këta janë ata, të cilët i ka mallkuar All-llahu dhe i ka bërë të shurdhër e të verbër." (Muhammed: 23).

"Me të vërtetë, Ne e krijojmë njeriun nga një farë e përzier, për ta provuar atë, dhe bëjmë që ai të dëgjojë dhe të shohë. (El-Insan: 2).

"...Asgjë nuk i shëmbëllen Atij! Ai i dëgjon të gjitha dhe i sheh të gjitha." (Esh-Shura: 11).

"...All-llahu dëgjon bisedat tuaja, sepse All-llahu, me të vërtetë, i dëgjon dhe i sheh të gjitha." (El-Muxhadele: 1).

Me këtë përsëritje të qëllimshme Kur'ani përmend të dëgjuarit para të pamurit, pa marrë parasysh se populli i jep rëndësi më të madhe të pamurit dhe se anatomia dhe filozofia të cilat kanë provuar këtë fakt, nuk kanë qenë të njohura në atë kohë.

Kur'ani kur flet për vjedhje, më parë përmend vjedhësin e pastaj vjedhësen:

"Vjedhësit dhe vjedhëses këputjuani duart e tyre..." (El-Maide: 38).

Por tek amoraliteti situata është e kundërt. Këtu Kur'ani më parë përmend laviren e pastaj lavirin:

"Laviren dhe lavirin rrihne çdonjërin prej tyre me nga njëqind të rëna me kamxhik..." (En-Nur: 2).

Instruksioni është i qartë. Tek laviria gruaja është përherë ajo e cila fillon më së pari. Ajo me stolitë e veta dhe me sharmin e vet e ngashëron njeriun. Përsa i përket vjedhjes, ajo është më pak e guximshme, andaj është përmendur më vonë. Gjendemi para fjalëve të sakta, të përpikta, dhe të përdorura me vend. Kur'ani është "Libër, ajetet e të cilit janë të radhitur me kujdes." Kurrnjë fjalë nuk është përmendur para tjetrës pa qëllim të caktuar, dhe e kundërta, kurrnjë fjalë nuk është përmendur pas tjetrës pa qëllim të caktuar.

Zgjedhja ngandonjëherë bie në ndonjë fjalë për shkak të harmonizimit të shprehjes në mënyrë që zgjedhimi i ri i kuptimit të shkëlqejë me mu'xhize retorike. Si shembull mund të shërbej ajo që Kur'ani thotë për erën:

"Ne dërgojmë erërat për të frytëzuar, e nga qielli lëshojmë shiun që të keni çka të pini - ju më këtë nuk mund të dispononi." (El-Hixhër: 22).

Tek erërat që frytëzojnë nevojitet të ndalemi pak më gjatë. Era e ftohtë i shtyen retë e elektrizuara kah njëra-tjetra. Aty vie gjer tek bashkimi i eketricitetit negativ me atë pozitiv dhe kështu shkaktohet rrufeja, bubullima dhe shiu. Ky është frytëzimi ndërmjet reve. Shiu bie në tokë dhe kështu e bënë të pëlleshme. Ky është frytëzim i llojit të dytë, frytëzim ndërmjet ujit dhe tokës. Era shpërndan pluhurin e polenit prej një bime në tjetrën. Ky është frytëzim i llojit të tretë; frytëzim në kuptimin tekstual të fjalës.

Gjendemi para një dëshmie e cila është e vërtetë edhe në kuptimin figurativ edhe në atë tekstual. Sido që të merret, ajo është e saktë. Ajo është e re, e çuditshme dhe origjinale kur e përshkruan erën. Ajo është, për sa i përket bukurisë dhe harmonisë, apogje, ndërsa në shqiptim është tejet rjedhshëm. "Ne dërgojmë erërat për të frytëzuar".

Në shqiptim ajo thjesht tërheq të dëgjuarit dhe ngazëllen veshin.

Këto hollësi shkencore mbi elektricitetin e reve dhe frytëzimin e bimëve, natyrisht, nuk kanë qenë të njohura në kohën e shpalljes të këtij ajeti.

Shumë komentues të Kur'anit domethënien e këtyre fjalëve e kanë kuptuar në kuptimin figurativ. Sot shkenca na mundëson të depërtojmë edhe në domethënien e brendshme të këtyre fjalëve, e kjo është e vlefshme edhe në kuptimin tekstual edhe në kuptimin figurativ.

Shembulli i dytë është ajeti nga sureja "El-Ankebut":

"Shembulli i atyre që kanë marrë ndihmës, pos All-llahut, - është si shembulli i merimangës, e cila ka thurë për vete shtëpi, e shtëpia më e dobët, me të vërtetë, është ajo e merimangës. Sikur ta dinin *(këtë)* ata!" (El-Ankebut: 41).

Vëmendjen na tërheq dëshmia, në të cilën shtëpia e merimangës është përshkruar si shtëpia më e dobët. Kur'ani nuk ka thënë: fija e merimangës apo, rrjeti i merimangës, por ka thënë: "shtëpia e merimangës". Kjo gjithsesi ka shkakun e vet dhe argumentet e veta. Shkenca ka zbuluar se fija e merimangës është më e fortë se fija e ngjashme me të e çeliktë për tri herë. Është më e fortë dhe më elastik se edhe mëndepshi. Për merimangën rrjeta e saj është e përshtatshme. Ajo për të paraqet edhe fortifikatë edhe vendstrehim të sigurt. Përse atëherë Kur'ani ka thënë se shtëpia më e dobët është, në realitet, ajo e merimangës, duke përfunduar ajetin më fjalët "sikur ta dinin ata"? Këtu gjithsesi prehet ndonjë fshehtësi, dhe atë fshehtësi biologjike.

Kjo është zbuluar vetëm në kohën e fundit. Shtëpia e merimangës është shumë larg nga ky kualifikim. Femra e merimangës është ndërtuese e shtëpisë. Ajo e thurë rrjetën dhe mbretëron me hapësirën e saj. Pas frytëzimit ajo e mbytë merimangën mashkull, që pastaj ta hajë me oreks. Të vegjëlit posa dalin nga vezët, e hajnë njëri-tjetrin. Pas frytëzimit meshkulli ik menjëherë dhe nuk tenton që të ndalet në hapësirën e rrjetës.

Femra e thurë rrjetën për ta mbytur secilin insekt i cili tenton t'i afrohet. Çdo mysafir i cili haset në rrjetë ajo e mbytë dhe e hanë me oreks. Kjo, pra, është karamanjollë (gijotinë) e jo shtëpi.

Kjo është shtëpia më e dobët, më e ligë, për çdonjërin që tenton të strehohet në të.

Vehnun është fjalë arabe e cila, mes tjerash, do të thotë rraskapitje, molisje dhe ligështim. Në situatë të tillë gjendet secili që pos All-llahut kërkon mbrojtës tjetër: "Shembulli i atyre që kanë marrë ndihmës, pos All-llahut, - është si shembulli i merimangës, e cila ka thurë për vete shtëpi, e shtëpia më e dobët, me të vërtetë, është ajo e merimangës. Sikur ta dinin (këtë) ata!" (El-Ankebut: 41).

Pasuri ekspresive dhe saktësi shkencore, e panjohur në kohën e Pejgamberit alejhis-selam dhe e zbuluar një mijë vjet pas vdekjes së tij. Kjo, me të vërtetë është mu'xhize në të cilën nuk ka dyshim as iniciatori i arsyes gjatë përpjekjes së zbulimit të burimeve të tilla në suazat e vendshuarjes hyjnore të etjes.

Në suren Kehf lexojmë një shembull tjetër ku flitet për ëndrrat e banorëve të shpellës:

"E ata kanë qëndruar në shpellën e tyre - treqind vjet, duke shtuar nëntë (vjet)".(El-Kehf: 25)

Sot, me ndihmën e llogarive astronomike, e dimë se treqind vjet sipas kalendarit diellor vlejnë sa treqind e nëntë vjet sipas kalendarit hënor. Kalendari hënor ka qenë në përdorim e sipër në kohën kur ka zbritur ky ajet kur'anor, andaj ka qenë nevoja që Kur'ani t'u shton këtyre edhe nëntë vjet.

Ky është ndryshimi mes këtyre dy kalendarëve. Kjo është fshehtësi, e cila gjer në ditët tona ka qenë e panjohur.

Një shembull tjetër e marrim nga sureja El-Kijameh:

"A mendon njeriu se nuk do të mund t'ia mbledhim eshtrat e tij? Po si jo, Ne mundemi t'ia bëjmë përsëri majat (bulat) e gishtërinjve ashtu siç i ka pasur." (El-Kijameh: 3-4).

Kur'ani këtu, tërësisht qartë dhe me siguritet të plotë, tregon se mu'xhizja e krijimit të sërishëm të bulave (mollëzave) në majat e gishtërinjve dhe ringjallja e tyre në formën e mëparshme është më e madhe se edhe vet ringjallja e eshtrave të njeriut. Fshehtësia e bulave (mollëzave) është zbuluar një mijë vjet pas shpalljes së këtij ajeti, kur është dëshmuar se çdo njeri posedon vurrata (shenja) të veçanta, të shënuara në bulat (mollëzat) e gishtërinjve të tij.

Në asnjë rast dy njerëz nuk mund të kenë vurrata të njëjta, madje edhe nëse janë binjakë.

Pastaj shembulli në suren En-Naziat, ku All-llahu xhel-le shanuhu thotë:

"E pastaj Tokën e rrafshoi *(e ka bërë si vezë)*." (En-Naziat: 30).

Fjala arabe dehjun do të thotë të bëhet diç në formë të vezës. Kjo është në harmoni të plotë me mendimet më të reja të cilat kanë të bëjnë me formën e Tokës. Fjala dehjun gjthashtu do të thotë edhe rrepshim. Kjo është e vetmja fjalë araba e cila në vete përmbanë të dy këto kuptime.

Në suren *Et-Tarik* All-llahu xhel-le shanuhu thotë:

"Dhe pasha qiellin i cili kthen dhe Tokën e cila hapet (çelet)." (El-Tarik: 11-12).

Kur'ani përshkruan qiellin i cili kthen çka i ngjitet (p.sh. avullin e ujit e kthen në Tokë si shi). Tani e dimë se edhe radiovalët kur arrijnë në jonosferë dëbohen dhe kthehen në Tokë.

Duke i falënderuar kësaj ne mund t'i zëmë radiovalët e Londrës, Parisit dhe të gjitha radiostacioneve në Tokë. Qielli është ai i cili dëbon. Ai i dëbon edhe rrezet infrakuqe dhe i kthen

në Tokë për ngrohjen e saj. Toka gjthashtu hapet (çelet) që prej saj të mbijnë bimë të ndryshme, që të shpërthen gazi natyror, nafta, burimet termale e minerale dhe lava vullkanike. Ajo hapet edhe gjatë tërmeteve të saj.

Përsëri gjendemi pranë fjalëve tejet të sakta, me domethënie të gjithmbarshme, të zgjedhura me përpikëri dhe të radhitura edhe më me përpikëri. Ekzistojnë shembuj të shumtë, të cilët vërtetojnë se Kur'ani është Shpallje, se ka prejardhje hyjnore, e jo njerëzore. Kurdoherë që përpiqemi që ndonjë fjalë ta bartim në ndonjë vend tjetër, apo ta ndërrojmë me ndonjë fjalë tjetër, gjithnjë bindemi se kjo është e pamundur.

Çdo gjë është e pajisur me domosdoshmëri gjuhësore dhe strukturale saqë nxisin habitje. Gjendemi para të vërtetës absolute.

Disa prej këtyre fjalëve i kuptojmë, e disa edhe më tej mbesin fshetësira.

Sepse, Kur'ani është Libër, i cili assesi nuk i nënshtrohet ndryshimeve.

Nëse kësaj i shtojmë se Kur'ani i është shpallur njeriut analfabet nga fisi Kurejsh, beduinit, i cili ka jetuar në shkretëtirë i izoluar nga çdo kulturë dhe qytetërim, atëherë me të vërtetë gjendemi para mu'xhizes, të cilën tenton ta konteston vetëm ai që është mendjemadh, tekanjoz, me ndjenja të turbullta, i verbër, i cili vetveten e ndëshkon, i cili është izoluar nga e tërë ajo që na ofron ky Libër. O Zot, bëhu i mëshirshëm ndaj të tillëve dhe hapjau zemrën:

"Me të vërtetë, nuk janë sytë të verbëta, por zemrat në kraharor." (El-Haxhxh: 46)

PASTHËNIE

Tefsir[10] është shkencë e cila merret me komentimin e Kur'anit. Krahas tefsirit shpeshherë përdoret edhe fjala "te'vil" e cila, sipas Zemahsheriut, Ebu Ubejdit e të tjerëve, ka domethënie të njëjtë si dhe fjala tefsir. Disa komentues të Kur'anit, si për shembull Ibni Xherir Et-Taberiu, En-Nesefiu dhe El-Bejdaviu, madje edhe komentimet e veta, tefsiret, i kanë quajtur te'vil.[11]

Mirëpo, ulemaja e mëvonshme i ka dhënë tefsirit kuptim më të gjerë. I bazuar në rivajet tefsiri do të ishte, sipas tyre, ajo që ne sot e quajmë zakonisht komentimi tradicional i Kur'anit, ndërsa te'vili, që bazohet në dirajet, do të ishte komentimi i pavarur në bazë të mendimit të lirë.

Tefsiri, si çdo shkencë tjetër, kaloi nëpër disa etapa të zhvillimit të vet. Në ditët e para të Islamit Muhammedi alejhis-selam ishte i vetmi komentues i Kur'anit. Pas vdekjes së tij Kur'anin e komentonin shokët e tij, as'habët. Prej tyre, si mufessir më të dalluar kanë qenë kalifët nga grupi Hulefai-Rashidinë[12], pastaj Abdullah Ibni Mes'udi, Ubeje b. Ka'bi, Zejd b. Thabiti, Ebu Musa El-Esh'ariu, Zubejr b. Avvami dhe Abdullah Ibni Abbasi, i cili, sipas traditës, ka merita më të mëdha të bartë emrin e ndershëm mufessir. Muhammedi alejhis-selam shpeshherë e ka quajtur

---

[10] Nga fjala arabe "fesrun" - sqarim, shpjegim.

[11] Komentimi i Taberiut është botuar nën titullin: Xhemiul bejani fi te'vilil Kur'ani, i Nesefiut: Medariku Et-tenzili ve hakikatu Et-te'vil, e i Bejdaviut: Envaru Et-tenzili ve esrarut te'vili.

[12] Katër kalifët e parë të cilët qeverisën shtetin islam, menjëherë pas vdekjes së Muhamedit alejhis-selam quhen Hulefai-Rashidinë, e këta janë: Ebu Bekri, Umeri, Uthmani dhe Aliu r.a. (sh.p.).

terxhuman - përkthyes-komentues i Kur'anit, e shumë herë e ka lutur All-llahu xhel-le shanuhu me fjalët: *"O Zoti im, aftësoje atë në njohjen e fesë dhe mësoje atë të kumtojë Kur'anin."*[13]

Brezi i dytë i myslimanëve pas Muhammedit alejhis-selam është i njohur në terminologjinë islame me emrin Tabi'inë. Në kohën e tyre janë formuar tri shkolla të tefsirit: mekkase, medinase dhe irakiane, kurse përfaqësuesit më të njohur të këtyre shkollave kanë qenë: Muxhahidi, Ata' b. Ebi Rebbahu, Ikrime, Se'id b. Xhubejri dhe Tavus - nxënësit dhe shokët e Abdullah Ibni Abbasit, pastaj Zejd b. Eslemi, përfaqësues i shkollës medinase të tefsirit dhe shumë të tjerë në Mekë, Medinë dhe Bagdad.

Brezi i tretë i myslimanëve pas Muhammedit alejhis-selam, Tebei-tabi'inë, është brez që ka tubuar materiale nga tefsiri dhe ka shkruar koleksionet e para të tefsirit, të cilat më vonë kanë qenë burim i Ibni Xherir Et-Taberiut dhe i të tjerëve që kanë ardhur pas tij. Në këtë periudhë të tretë të zhvillimit të tefsirit mufessirët më të njohur kanë qenë: Sufjan b. Ajinete, Veki' b. Xherrah, Shu'ajb b. El-Haxhxhaxh, Jezid b. Haruni, Abd b. Hamidi etj. Materiali që e kanë tubuar këta kryesisht është bazuar në hadithe[14], ku Muhammedi alejhis-selam i ka shpjeguar disa dispozita sheriatike, ajetet e deroguara (anuluara) dhe deroguese (anuluese), dhe shkaqet e zbritjes së disa ajeteve kur'anore.

---

[13] Abdullah Ibni Abbasi është lindur tri vjet para hixhretit. Ka qenë pjesëmarrës në betejën e Hunejnit dhe të Taifit. Ka marrë pjesë edhe në çlirimin e Mekës dhe ka qenë në haxhxhin lamtumirës. Ka vdekur në moshën shtatëdhjetë e një vjeçare.

[14] Hadith: gjithçka që Muhammedi alejhis-selam ka thënë, ka porositur, ka punuar dhe ka pëlqyer (kur diçka kanë punuar të tjerët).(sh. p.)

Pas brezit të tretë të myslimanëve tefsiri kryesisht është zhvilluar në tri drejtime:

1. - Komentimi tradicional - et-tefsiru bil-me'thuri, i cili bazohet në komentimin e Muhammedit alejhis-selam dhe shokëve të tij, as'habëve;

2. - Komentimi racional - et-tefsiru birre'ji, i cili bazohet në arsyen dhe ku hasim metoda të ndryshme dhe mendime reciprokisht të përkundërta; dhe

3. - Komentimi shkencor - et-tefsiru bil-'ilmi, i cili si bazë të komentimit të Kur'anit përfshin të arriturat shkencore.

KOMENTIMET TRADICIONALE

Komentuesit e parë të Kur'anit kanë qenë rreptësisht të lidhur për traditë. Çdo komentim që nuk ka qenë i bazuar në traditë, hadith, është konsideruar si i rrezikshëm. Ka pasur edhe të tillë që kanë refuzuar të thonë çkado qoftë përkitazi me tefsir. Kufasi Abid b. Kajsi, ka vdekur në vitin 72. h., ka refuzuar të flasë për shkaqet e zbritjes së disa ajeteve. Qëndrimin e vetë e ka shpjeguar me fjalët: "Bëhu vetëm i devotshëm dhe i fuqishëm në besim. Kanë shkuar ata të cilët i kanë njohur shkaqet e zbritjes të ajeteve kur'anore." El-Asme, filologu (linguisti) i madh, ka qenë shumë i kujdesshëm kur ishte fjala për tefsirin e Kur'anit dhe sunnetit[15]. Kur kanë kërkuar prej tij

[15] Sunnet: traditë, zakon. Në terminologjinë islame sunnet është sinonim i fjalës hadith.

që të shpjegojë një ajet kur'anor ka thënë: "Arabët thonë se domethënia e kësaj është kjo. Nuk e di se a dëshirohet kështu edhe në Kur'an e në sunnet."[16] Shkaqet e këtyre refuzimeve duhet kërkuar në hadithe, ku thuhet: "Kush thotë diç për Kur'anin sipas mendimit të vet subjektiv, le të përgatit vendin në zjarr." "Kush e komenton Kur'anin sipas mendimit të vet subjektiv ka gabuar madje edhe nëse ka komentuar saktësisht."

Tefsiri i parë i cili ekskluzivisht është bazuar në traditë, është tefsiri i Jahja b. Selamit. Ky është tefsiri më i vjetër që ekziston sot. Është shkruar në Kajrevan, në shekullin e dytë mysliman, në tridhjetë pjesë të lidhura në tri vëllime. Dy ekzemplarë në dorëshkrim gjenden në bibliotekën Zejtun dhe Kajrevan në Tunis.

Gjurmët e njëjta i ka ndjekur edhe Muhammed b. Xherir Et-Taberiu.[17] Në pjesën hyrëse të tefsirit të vet, ai trajton dhe shpjegon hadithin "Kur'ani ka zbritur në shtatë harfe", duke i ngërthyer të gjitha mospajtimet në mendime të ulemasë islamike rreth komentimit të "shtatë harfeve" në shtatë të folme, dialekte arabe, të cilat i kanë përdorur fiset më të njohura arabe.

Pjesën më të madhe të hyrjes ia ka kushtuar gjuhës së Kur'anit. Është e njohur se gjuha e Kur'anit ka qënë lëndë e polemizimit mjaft të zhurmshëm në mjedisin e ulemasë islamike. Shumë dijetarë

---

[16] - Ahmed Muhammed El-Hufi: Et-Taberi, seria *"Ea'lamul areb"*, nr. 13, faqe 101, Kajro 1963. Në version diç të ndryshuar të dy shembujt i paraqet edhe Nerkez Smailagiqi në "Hyrje në Kur'an", faqe 135 (tekstet).

[17] Taberiu është lindur në vendin Amulu - Taberistan në vitin 224. h., e ka vdekur në Bagdad në vitin 310. h. ku edhe është varrosur. Ka shkruar shumë vepra, prej të cilave i veçojmë: *tefsirin*, e botuar në Kajro më 1923 dhe 1963. *Tarihul umemi vel muluki*, është botuar në Lajden dhe Kajro, dhe shumë vepra të tjera.

islamik, duke u nisur nga ajetet kur'anore, ku janë përmendur fjalë persiane, abisinase, greke, aramene, hebraike dhe fjalë të tjera të huaja, theksojnë se Kur'ani nuk është shpallur në gjuhën e pastër arabe.

Taberiu, gjithashtu, duke u nisur nga ajetet kur'anore në të cilat thuhet se Shpallja ka zbritur në gjuhën e pastër arebe, konfirmon se fjalori i Kur'anit përbëhet vetëm nga fjalët arabe. Polemikën e vet me ata të cilët pohojnë se në Kur'an janë përdorë fjalë të huaja, Taberiu e ngërthen në ngjashmërinë e domethënies së këtyre fjalëve në gjuhën arabe dhe në gjuhët e tjera.

Është e qartë se Taberiu këtu nuk ka të drejt. Arabët para paraqitjes të Islamit kanë pasur lidhje tregtare dhe ekonomike me persianët, abisinasit, hindusët, grekët dhe me popuj të tjerë përreth. Është e natyrshme që përmes këtyre lidhjeve tregtare t'a kenë pasuruar edhe gjuhën e vet. Prej këtu në gjuhën e tyre gjenden edhe fjalë të huaja, të cila All-llahu xhel-le shanuhu i ka përdorë në Shpallje, në mënyrë që Shpallja të kuptohet dhe të vlerësohet në mënyrë të drejtë.

Tefsiri i Taberiut është i bazuar në traditë, hadith, në transmetimin e vërtetuar, i cili është kriter i vetëm i vlefshmërisë egzegjete. Kurrnjë mendim të pavarur, subjektiv dhe tekanjoz Taberiu nuk e ka marrë parasysh. Aq më tepër, ai në parathënien e tefsirit disa faqe ia ka kushtuar haditheve, të cilët flasin për ndalimin e komentimit të Kur'anit në mënyrën bir re'ji sipas mendimit subjektiv, apo bil heva, me vetëdashje. I vetmi komentim i drejt i Kur'anit është ai i bazuar në "ilm". Me fjalën ilm nënkuptohet vetëm ajo që mund të reduktohet në konstruksionet e vet Pejgamberit apo shokëve të tij, as'habëve.

Për këtë qëllim, me gjithë hadithet të cilët flasin për këtë ndalesë, Taberi e ka cituar edhe Ebu Bekrin, i cili me një rast pat thënë: "Cila tokë do të mund të më mbante, cili qiell do të mund të

më bënte hije, nëse për Kur'anin do të thosha diç sipas mendimit tim, bir re'ji ose për diç që nuk di asgjë, bi ma la a'lemu.[18]

Përveç në traditë, tek komentimi i teksteve të Kur'anit, Taberiu është mbështetur edhe në poezinë e vjetër arabe, duke përmendur nganjëherë emrin e poetit e nganjëherë vetëm citatet gjegjëse të vargjeve. Duke përdorë poezinë e vjetër arabe, Taberiu, në realitet, ka ndjekur praktikën e Ibni Abbasit, i cili kur e pyetnin për ndonjë fjalë më pak të njohur të Kur'anit, thoshte: "Kërkone atë në poezinë e vjetër arabe, sepse ajo është e pastër arabe." Sipas fjalëve të Se'id ibni Xhubejrit, Ibni Abbasi kurrënjëherë nuk e komentonte ndonjë tekst kur'anor e që gjatë kësaj të mos shërbehej me vargje nga poezia e vjetër arabe.[19]

Është e njohur se Taberiu ka qenë njohës i madh i gjuhës arabe dhe i poezisë së vjetër arabe. Ai, derisa ishte ende në Egjipt, i diktonte Ibni Serraxhit dhe filozofëve të tjerë arab poezinë e Turmahut, duke ua shpjeguar fjalët më pak të njohura. Prandaj edhe *Tefsiri* i tij është përplot me shqyrtime leksike, gramatikore dhe filologjike.

Ajo që është më kryesorja për *Tefsirin* e Taberiut, është qëndrimi kritik i tij ndaj isnadeve me anë të cilëve i ka njohur komentimet e shokëve të Muhammedit alejhis-selam, as'habëve. Ai në mënyrë kritike e prek edhe çështjen e transmetuesve të Ibni Abbasit. Për Muxhahidin, të cilin jashtëzakonisht e ka çmuar, me një rast ka thënë se mendimi i tij është i pavlefshëm dhe se qëndron në kundërthënie me mendimin e shumicës së ulemasë islame, të cilëve nuk mund t'u

[18] Tefsiri i Taberiut, 1/27.
[19] Tefsiri i Hamasiut nga Tibrizi 1/3.

përshkruhet gënjeshtra. Dëshmi e mjaftueshme për pavlefshmërinë e mendimit të Muxhahidit është pajtueshmëria e shumicës së ulemasë islame se ai ka gabuar.[20]

Tefsiri i Taberiut, sipas vlerësimit të hulumtuesve lindor dhe perëndimor, është vlerë tejet të madhe. Ebu Hamid el-Isfahani thotë: "Sikur dikush të udhëtonte gjer në Kinë që të vinte gjer tek kjo vepër nuk do të bënte diç të tepërt." Noldekes qysh në vitin 1860, në bazë të citateve dhe fragmenteve ka thënë: "Sikur ta kishim këtë vepër (atëbotë është konsideruar si e humbur), do të liroheshim nga gjitha komentimet e mëvonshme.[21]

Vepra është gjetur në vitin 1903, e diç më vonë është botuar. Në këtë mënyrë është plotësuar zbrazësira në shkencën e tefsirit.

Vepra e tretë sipas vlerës nga tefsiret tradicionale është *Tefsiri* i Ibni Kethirit.[22] Disa ajete kur'anore, Ibni Kethiri i ka komentuar ekskluzivisht sipas hadithеve të Pejgamberit alejhis-selam Tefsiri është i shkruar me stil tejet të thjeshtë, ku mendimi ka ardhur në shprehje të plotë. Shquhet, mes tjerash, me qëndrimin kritik të autorit ndaj transmetuesve së traditës.

---

[20] Tefsiri i Taberiut 1/264.

[21] N. Smailagiqi: Hyrje në Kur'an, faqe 141 (tekstet).

[22] Ibni Kethiri është lindur në vendin Busra, në vitin 700. h., e ka vdekur në Damask, në vitin 774. h. Është autor i shumë veprave nga historia islame, tefsiri, hadithi, i shumë jetëshkrimeve dhe kritikave të transmetuesve të hadithit. Shumë prej këtyre veprave janë botuar, e disa kanë përjetuar edhe ribotime të shumta.

Mbrojtës i madh i traditës ka qenë edhe Tekijjuddin Ahmed ibni Tejmije.[23] Metoda e tij e komentimit të Kur'anit është mbështetur në këto baza:

1.- Komentimi i Kur'anit me Kur'an. Kjo është mënyra më e mirë dhe më e lartësuar e egzegjezës së tekstit kur'anor. Ajo që është cekur shkurtimisht në një vend të Kur'anit, është shpjeguar dhe është komentuar hollësisht në një vend tjetër.

2.- Komentimi i Kur'anit me hadith. Nëse disa ajete në Kur'an nuk janë shpjeguar me ajete të tjera, atëherë si burim i dytë i tefsirit merret hadithi. Hadithi është komentar i Kur'anit dhe komentues i tij. All-llahu xhel-le shanuhu, duke iu drejtuar Muhammedit alejhis-selam, thotë: "Ne ta kemi shpallur ty Librin, vetëm që t'ju shpjegosh atyre atë për të cilën ata nuk pajtoheshin, dhe (që te jetë) udhërrëfyes dhe mëshirë për njerëzit që besojnë. (En-Nahël: 64). Në këtë kuptim ka thënë edhe Muhammedi alejhis-selam se Kur'ani është Libër i shpallur nga Zoti e hadithi është komentar i Kur'anit.

3.- Komentimi i Kur'anit sipas komentimeve të as'habëve. Pas komentimeve të sipërpërmendur vijnë komentimet e as'habëve si burim i tretë i tefsirit. Ata janë më meritorët për këtë, sepse kanë jetuar në kohën kur është shpallur Kur'ani, e posaçërisht katër kalifët e mëdhenj nga grupi Hulefai-Rashidin, pastaj Abdullah Ibni Mes'udi dhe Abdullah Ibni Abbasi.

---

[23] Ibni Tejmije është lindur në vitin 1264 në Harran të Sirisë, ndërsa ka vdekur në vitin 1323 në Damask, ku edhe është varrosur. Ka shkruajtur mbi 500. vepra, risale të shkurtëra apo të gjata, prej të cilave disa janë mbledhur dhe janë shtypur si përmbledhje e veçanta. I ka takuar medhhebit hanbelit, por nuk është mbyllur në zgjidhjet hambelite.

4.- Komentimi i Kur'anit sipas tabi'inëve. Në vendin e katërt vijnë komentimet e tabi'inëve: Muxhahidit, Se'id ibni Xhubejrit, Ikrimës etj. Mirëpo, te ky burim i katërt duhet të kihet kujdes, sepse tabi'inëve u është përshkruar shumëçka që nuk u takon.

Në fund mund të themi se e tërë ajo për çka ka shkruar Ibni Tejmije nuk është asgjë e re. Shumë komentues para tij, gjithashtu e kanë komentuar Kur'anin me Kur'an, pastaj me hadith dhe me shpjegimet e as'habëve e me komentimet e tabi'inëve, duke marrë prej tyre atë që, sipas kritereve të tyre, është e saktë. Introdukti i këtillë i Kur'anit është i njohur në terminologjinë e tefsirit si afrim tradicional i egzegjezës të tekstit kur'anor. Tradicionalistët, siç thekson Tejmije, por edhe Taberiu në tefsirin e vet, i kanë ikur komentimit të Kur'anit sipas mendimit të vet të pavarur, vetëdashës dhe subjektiv. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se Tejmije aftësitë e veta i ka reduktuar vetëm në traditë. Ai, gjithashtu e ka komentuar Kur'anin edhe në mënyrën racionale. Sado që gjatë komentimit të Kur'anit është mbështetur në arsyen, ai,gjithashtu ka ndërmarrë fushatë kundër komentimit të shi'injve dhe ekstremistëve të tjerë.

KOMENTIMET RACIONALE

Pranë introduktit tradicional të Kur'anit në tefsir, që nga shekulli i tretë hixhrij, hasim edhe në përpjekjet e komentimit racional të tekstit kur'anor. Disa dijetarë islam kanë marrë qëndrim se komentimi racional i Kur'anit është i ndaluar, e disa të tjerë mendojnë se kjo është e lejuar. Mospajtimin e tyre mund ta shpjegojmë me faktin se ata të cilët e ndalojnë, këtë e bëjnë vetëm

për shkak të atyre, të cilët ngandonjëherë, edhe pse kanë mbetur pa argumente, kategorikisht konfirmojnë se "Zoti ka dashur të thotë këtë", apo për shkak të atyre, të cilët tentojnë të komentojnë Kur'anin pa i njohur rregullat e gjuhës arabe dhe themelet e sheriatit, përndryshe, nëse mufessiri posedon konditat që kërkohen nga ai, atëherë nuk ekziston kurrfarë pengese që t'i afrohet Kur'anit në mënyrë racionale. Aq më tepër, edhe vet Kur'ani na thërret për këtë në shumë ajete të veta.[24]

Mirëpo, duhet të përmendim se përsiatja jonë për Kur'anin dhe ajetet e tij duhet të jetë e bazuar në burimet e Islamit. Kjo gjithashtu vlenë edhe për tefsirin "bir re'ji", i cili duhet të jetë në harmoni me egzegjezën tradicionale të bazuar në tekstin autentik. Nëse ky tefsir bie në kundërthënie me tekstin autentik, atëherë ai e humb edhe cilësinë e vlefshmërisë.

1. - KOMENTIMET E PRANUARA RACIONALE

Tefsiri më i njohur në mesin e tefsireve të vyeshëm racional është Tefsiri i Fahruddin Er-Raziut[25], i shkruar me titull "Mefatihul gajbi" (Çelësat e fshehtësisë), kurse më i njohur është me emrin "Et-tefsirul kebiru" (Tefsiri i madh).

---

[24] Kur'an: sureja Muhammed - ajeti 24, sureja Sad - ajeti 29.

[25] Fahruddin Er-Raziu (Ebu Abdullah Muhammed bin Umer bin Husein Er-Razi) U lind në qytetin e vjetër persian Rej-ju, në vitin 543. h., ndërsa vdiq në vitin 606. h në Herat. Ka shkruar një numër të

Në egzegjezën e tekstit kur'anor Fahruddin Er-Raziu është shërbyer me të gjitha mjetet që i kishte në disponim për t'i përgënjeshtruar qëndrimet e mu'etezilëve. Pesë tezat e mëdha të mu'etezilëve ai i ka reduktuar vetëm në dy:

1.- tevhid ose monoteizmi abstrakt, dhe

2.- adl ose drejtësia e Zotit.

Tevhidi, sipas ehli sunnetit, përmbanë të besuarit dhe të adhuruarit e Zotit, Një të Vetmit i Cili nuk ka shok. Ai është Një, e gjithçka tjetër Atij i drejtohet. Nuk është i lindur, e as që ka lindur kë, dhe askush nuk është i barabartë me Të.

Mu'etezilët, nën ndikimin e filozofisë greke, mohojnë ekzistimin e vërtetë të atributeve të Zotit. Fjalët e Zotit "Dhe Atij askush nuk i është i barabartë" i kuptojnë në mënyrë tejet të eksagjeruar. Në ajetin "Dhe Atij askush nuk i është i barabartë, Ai i sheh të gjitha dhe i dëgjon të gjitha" Zoti ia vërteton Vetit të dëgjuarit dhe të pamurit, kurse e mohon ngjashmërinë. Mu'etezilët pohojnë se Zoti dëgjon, por pa shqisën e të dëgjuarit, sheh, por pa shqisën e të pamurit, sepse kuptimi i kundërt i këtij ajeti shpien në politeizëm. Me këtë ndërlidhet edhe të pamurit e Zotit në Ditën e gjykimit dhe zhvillojnë teorinë mbi krijimin e Kur'anit, të cilën sunitët e konsiderojnë si bid'at, novatori, e cila nuk ka baza në Kur'an dhe në hadith.

---

madh veprash nga tefsiri, hadithi, filozofia, letërsia, mediciNe dhe lëmive të tjera. Një ekzemplar në dorëshkrim i sures El-Fatiha gjendet në bibliotekën Gazi Husrevbeg në Sarajevë. Në fillim të ekzemplarit është jetëshkrimi i shkurtër i Er-Raziut, marrë nga vepra *"Faslul hitabi fi ilmit tesavuf"* e Muhammed b. Muhammed El-Hafizit, të quajtur Parsa.

Zoti nuk është krijues i veprave të njeriut, pohojnë mu'etezilët, e në këtë mënyrë e mohojnë kaderin, predestinimin e Zotit, për çka edhe janë quajtur kaderijë, indeterministë. Në anën e kundërt qëndrojnë deterministët, xheberijët, të cilët flasin për shkakun e kushtëzuar të vullnetit të njeriut. Sunitët, tradicionalistë, kanë qëndrim mesatar. Duke i kundërshtuar mendimet e mu'etezilëve Er-Raziu është shërbyer me kelamin tradicional, i cili përdorë arsyen dhe synon afrimin e mendimit të Kur'anit dhe Sunnetit.

Përveç këtij Tefsiri, ku Er-Raziu qëndron fuqishëm në pozitat e Ehli-Sunnetit, shumë mirë janë të njohura edhe tefsiret e El-Bejdaviut[26], Ebu Es-Seudit[27], En-Nesefiut dhe i El-Hazinit[28]. Tefsiri i Bejdaviut nuk është i bazuar në hadithet autentike, posaçërisht ato pjesë të tefsirit, të cilat flasin për përparësitë e disa sureve të Kur'anit. Në këtë tefsir autori ka rekapituluar stilistikën, retorikën dhe tropikën arabe nga Keshshafi, filozofinë dhe apologjetikën nga Tefsiri i Madh i Raziut, dhe etimologjinë nga vepra-tefsiri "Mufredatul meani" i Ragib El-Isfahanit, komentuesit të famshëm

---

[26] Emri i tij i plotë është: Nasiruddin Ebu El-Hajr Abdullah b. Umer Esh-Sherazi El-Bejdavi. U lind në Bejda të rrethinës së Shirazit, ndërsa vdiq në Tibriz në vitin 685.h. ku edhe është varrosur. Përveç tefsirit, veprave nga fusha e apologjetikës dhe sintaksës arabe, ka shkruar edhe një tefsir për veprën hadithore *"Mesabihus-sunneti"* të Begaviut, dorëshkrimi i të cilit gjendet në bibliotekën Gazi Husrevbeg në Sarajevë.

[27] Ebu Es-Seudi (Ahmed b. Muhammed El-Imadi El-Hanefi) u lind në vitin 898. h. në një katund afër Stambollit, ndërsa vdiq në vitin 982. h. në Stamboll. Ka qenë njohës i madh i gjuhës arabe, turke dhe persiane. Ka marrë pjesë në ekspeditat ushtarake të Sulejman Ligjëdhënësit.

[28] En-Nesefiu (Ebu Berekat Hafizudin Abdullah b. Ahmed) ka vdekur në vitin 710. h. në Bagdad, kurse El-Hazini në vitin 741, po ashtu në Bagdad.

tradicional të Kur'anit nga shekulli i katërt islamik. I bazuar në Keshshaf dhe në tefsirin e Er-Raziut, tefsiri i Bejdaviut mbanë renome të madhe duke i falënderuar Shehabuddin El-Hafaxhit. Në mesin e mufessirëve tanë më të njohur, të cilët këtë tefsir e kanë shkruar në glose[29] dhe kanë ligjëruar në shkollat e mesme është Muhammed b. Musa El-Bosnevi, i quajtur Allamek. Pas Allamekut, tefsirin e Bejdaviut e ka glosuar dhe e ka ligjëruar në medresen Karagjozbeg të Mostarit, Ibrahim Opijaçi, i quajtur Mostaras. Gloseja e parë gjendet në dorëshkrim në Darul kutubi (bibliotekën e qytetit) në Kajro, e disa kaptina në bibliotekën e Universitetit "Svetozar Markoviq" në Beograd, gjersa e dyta gjendet në dorëshkrim në bibliotekën Gazi Husrevbeg në Sarajevë.

Tefsiri i Ebu Seudit *"Irshadu el-aklis es-selim ila mezaje el-kitab el-kerim"*, i cili nuk është larg tefsirit të Bejdaviut, më së tepërmi i shqyrton mu'xhizet e Kur'anit si për kah gjuha ashtu edhe për kah stili, ndërsa ai i En-Nesefiut shqyrton stilistikën dhe kiraetet[30], e i El-Hazinit kujdes të veçantë i ka dhënë traditës, duke mënjanuar ngandonjëherë transmetuesit.

[29] Glose - komentues i fjalëve të vjetra, të pakuptueshme dhe të panjohura.
[30] Kiraet: leximi dhe këndimi i Kur'anit në mënyrë të drejtë.

2. - KOMENTIMET E QORTUARA RACIONALE

Tefsiret tendencioze dhe sektare, siç janë tefsiret e mu'etezilëve, mistikëve dhe të atyre që hulumtojnë për domethëniet e brendshme të Kur'anit, i takojnë komentimeve të qortuara racionale të egzegjezës së tekstit kur'anor.

Tefsiret e mu'etezilëve janë komentime të qortuara racionale. Në tefsiret e tyre tradita, hadithi, ka rëndësi të dorës së dytë në raport me arsyen. Keshshafi i Zemahsheriut, i cili është ndërtuar në momentet retorike, paraqet vepër apogjetike (kulminante) të egzegjezës mu'etezile. Ky është njëkohësisht edhe vepra e vetme e mu'etezilëve e ruajtur në tërësi gjer më sot nga fusha e egzegjezës së tekstit kur'anor. Shumë vepra të tyre nga fusha e tefsirit janë shkatërruar në tërësi në luftën e madhe ndërmjet tyre dhe sunitëve. Mbi tridhjetë tefsire të tyre janë shkatërruar duke filluar nga egzegjeti i tyre i parë Vasil ibni Ata' e gjer tek Zemahsheriu.

Si pikënisje në egzegjezën e tekstit kur'anor Zemahsheriu ka marrë ajetin kur'anor: "Ai ta ka shpallur Librin ty *(Kur'anin)*. Disa ajete të tij janë të qartë *(dhe me kuptim konkret e të hapët sheshazi)*. Ato janë themelet e Librit, e për disa të tjera nevojitet komentimi *(pasi që shprehin shumë kuptime të thella)*..." (Ali Imran: 7).

Nën muhkemat - ajetet e qarta mendohet ne ato ajete të cilat me siguri mund të kuptohen dhe të cilat nuk mund të komentohen ndryshe nga ajo që kërkon kuptimi i jashtëm i tyre. Të kundërtat nga këto - ajetet muteshabih mundësojnë komentime të shumëfishta. Duke aplikuar metodën filologjike dhe metodën e analizës gramatikore Zemahsheriu ajetet muteshabih i vënë në harmoni me doktrinën mu'etezile e cila përbëhet prej pesë tezave të mëdha:

1.- *Tevhidi* apo monoteizmi abstrakt është teza e parë themelore e mu'etezilëve. Kjo tezë ka të bëjë me mohimin e antropomorfizmit. Atributet e Zotit, sipas mu'etezilëve, nuk kanë ekzistencën e tyre të vërtetë. Në këtë ndërlidhet edhe çështja e të pamurit të Zotit në botën tjetër dhe çështja e krijimit të Kur'anit. *Tefsiri* i Zemahsheriut në tërësi është i gërshetuar nga këto çështje. Flitet se Zemahsheriu e ka filluar këtë tefsir me fjalët: "Falënderimi i qoftë Zotit i Cili e ka krijuar Kur'anin", të cilat më vonë përshkruesit i kanë përmirësuar në: "Falënderimi i qoftë Zotit i Cili e ka shpallur Kur'anin".

2.- *Adl* apo drejtësia e Zotit është teza e dytë e mu'etezilëve. Shpeshherë mu'etezilët e kanë quajtur veten "njerëz të drejtësisë dhe të monoteizmit" (ehlul 'adli vet tevhidi). Drejtësia e Zotit, sipas tyre, e parasheh lirinë e veprimit të njerëzve.

3.- *V'ad* dhe *va'id* apo premtimi dhe kërcënimi është teza e tretë e mu'etezilëve, krahas së cilës mund të përmendim edhe të katërtën duke qenë se janë të lidhura ngusht njëra me tjetrën, e kjo është gjendja ndërmjet besimit dhe mosbesimit (el menziletu bejnel menziletejni). Edhe njëra edhe tjetra tezë janë pasojë e doktrinës mu'etezile mbi fenë dhe drejtësinë e Zotit.

Njeriu mund të jetë besimtar (mu'min), mëkatar (fasik) dhe jobesimtar (kafir). Bëhet pyetja se, ai i cili bën mëkat të madh (murtekibul kebire) a është besimtar, jobesimtar apo vetëm mëkatar Murxhinjtë pohojnë se është mu'min, havarixjinjtë se është kafir, e mu'etezilët se është fasik. Kjo është në lidhje me ajetet kur'anore të cilat flasin për ndëshkimin e asaj bote për ata që bëjnë mëkate të mëdha.

5.- *El emru bil me'arufi ven nehju 'anil munkeri* ose mbi urdhërin e Zotit me të cilin urdhërohen veprat e mira, ndërsa ndalohen veprat e këqija është teza e pestë e mu'etezilëve.[31]

Zemahsheriu tek komentimi i tekstit kur'anor është kujdesur rreptësisht për këto teza. Nëse mësimet e tyre kanë ardhur në kundërshtim me tekstin kur'anor, Zemahsheriu, duke përdorur të gjitha mjetet e disponuara, është angazhuar që tekstin kur'anor ta bie në harmoni me tezat e sipërpërmendura. Si shembull do të marrim ajetet kur'anore në të cilët thuhet: "Atë ditë - disa fytyra do të shkëlqejnë, në Zotin e tyre do të shikojnë." (El-Kijameh: 22-23), "...Kush shpreson takimin me Zotin e vet..." (El-Kehf: 110) Zemahsheriu i sjell në harmoni me ajetet "...Asgjë nuk i shëmbëllen Atij..." (Esh-Shura: 11), "Dhe Atij askush nuk i është i barabartë." (El-Ihlas, 4), "Shikimet nuk mund ta përfshijnë Atë..." (El-En'am: 103) në atë mënyrë që të pamurit dhe takimin me Zotin e shndërron në të pamurit dhe takimin me shpërblimin e Tij.

Ajetet kur'anore: "Nuk ndodh kurrfarë fatkeqësie pa lejen e All-llahut..." (Et-Tegabun: 11), "- pa lejen e Zotit nuk mund t'i bënin dëm askujt..." (El-Bekare: 102) të cilat deterministët i marrin si argument për paradestinimin e veprimeve të njeriut, mu'etezilët, e së bashku me ta edhe Zemahsheriu, termin "idhn", leje, e komentojnë si "dijeninë e Zotit", e cila nuk eliminon mundësinë e vullnetit të lirë dhe lirinë e njeriut në veprimet e tija.

Tefsiri i Zemahsheriut ka hasur në kritika të ashpra. Bejdaviu i ka përjashtuar nga ai të gjitha kuptimet e mu'etezilëve, Er-Raziu po ashtu. Mirëpo, duhet të pranojmë se ka pasur edhe sish, të cilët i kanë shprehur lavdata Zemahsheriut dhe tefsirit të tij. Se sa ka qenë Keshshafi lëndë

[31] Më gjerësisht mbi këto teza të shikohet: N. Smailagiqi, Kultura klasike islame I, faqe 150-155).

diskutimi shihet edhe prej gloseve dhe supergloseve të shumënumërta të shkruara përkitazi me këtë tefsir. Dr. Mustafa Eth-Thavi El-Xhuvejni në veprën "Metoda e Zemahsheriut në komentimin e Kur'anit" paraqet mbi pesëdhjetë recensime të shkurtëra, glose dhe superglose të shkruara përkitazi me tefsirin e Zemahsheriut.[32]

Komentimet mistike të Kur'anit nuk përputhen me komponimin dhe harmoninë e Kur'anit. Komentimet e tyre i kupton vetëm një rreth i ngushtë njerëzish, të cilët mirren ekskluzivisht me një meditim më të thellë shpirtëror. Përfaqësues i introduktit mistik të Kur'anit është Muhjjiddin Ibni Arabiu[33], i cili si pikënisje për komentimin e ajeteve kur'anore ka marrë panteizmin, doktrinë kjo filozofike e cila Zotin e identifikon (njëjtëson) me natyrën, ndërsa natyrën e shqyrton si manifestim të hyjnisë.

Shumë afër komentimit mistik të Kur'anit është edhe tefsiri i El-Alusiut[34], i cili përpiqet t'i shpjegojë ajetet kur'anore në bazë të kuptimit të dukshëm të fjalëve duke treguar edhe në

---

[32] Mustafa Eth-Thavi El-Xhuvejni: *"Menhexhuz Zemahsheri fi tefsiril Kur'ani"*, Kajro 1959, faqe 72. Punim magjistrature i përpunuar në fakultetin filozofik në Kajro.

[33] Muhjjiddin Ibni Arabiu, mistik i madh islam, u lind në Andaluzi, në vendin Mursiji në vitin 560. h.. kurse vdiq në Damask në vitin 638. h. Ka shkruar shumë vepra, mes të cilave i shquajmë: *"El-Futuhatul Mekkije", "Fususul hikem", "Trexhumanul eshvaki"* etj. Nga tefsiri i shkroi dy vepra. Njëri është më i madh, i shkruar në stilin alegorik, ku ka arritur gjer tek sureja *El-Kehf*, e tjetri shumë më i shkurtër i shkruar në stilin joalegorik.

[34] Ebus-SeNe Shihabuddin Muhammed El-Alusi El-Bagdadi lind në vitin 1217. h. në Bagdad, ndërsa vdiq në vitin 1270. h. po ashtu në Bagdad ku edhe është varrosur. Ka shkruar shumë vepra në mesin e të

kuptimin e tyre të fshehtë e më të thellë. Ky është pretendim i bashkimit të kuptimit të dukshëm (dhahir) me atë më të thellë (batin) të fjalëve.

Pos mu'etezilëve dhe mistikëve këtij lloji të tefsirit i takojnë edhe komentime të tjera ezoterike të batinijëve. Të udhëhequr nga ajeti kur'anor: "Në mes tyre do të vëhet një mur, në të do të ketë një derë, në anën e brendshme të të cilit është mëshira e Zotit, kurse nga ana e jashtme kah ai është ndëshkimi." (El-Hadid: 13) Batinijët gjurmojnë kuptimin e brendshëm të Fjalës së Zotit. Tefsiret e tyre janë në kundërshtim me bazat e islamit dhe gjuhës arabe.

KOMENTIMET SHKENCORE

Përveç komentimit tradicional dhe racional të Kur'anit, qysh nga koha e renesansës shkencore, nga periudha Abaside, hasim edhe në përpjekjet e komentimeve shkencore të tekstit kur'anor.

Në periudhën klasike dhe pasklasike të zhvillimit të shkencës së tefsirit, ideja e komentimit shkencor të Kur'anit ka gjetur përfaqësuesit e vet në personalitetet e Ebu Hamid El-Gazaliut, Xhelaludin Es-Sujutiut, El-Mursiut e të tjerë, ndërsa në kohët më të reja përfaqësuesit më të dalluar të qasjes së këtillë janë: Tantavi Xhevheri, Muhammed Abduhu, Reshid Rida, Mahmud Sheltut, Mustafa Mahmud e të tjerë.

---

cilave tefsiri i tij është më i njohur. U botua në Kajro 1301/1883 në titullin *"Ruhul meani fi tefsiril Kur'anil' vesseb-il mesani"*.

Muhammed Abduhui në tefsirin e vet ka futur edhe një aspekt të ri në Kur'an. Ai komentimin e ajetit 249 të sures El-Bekare "Kem min fietin kaliletin galebet fieten kethireten..." e ka përfunduar me darvinizëm mbi zgjedhjen natyrale dhe luftën për ekzistencë. Pas ajeteve 18. dhe 19. të sures El-Bekare, në të cilat flitet për bubullimën, vetëtimën dhe dukuri të tjera natyrore, Muhammed Abduhui shqyrton teorinë e elektricitetit dhe flet për telegrafin, telefonin dhe tramvajin elektrik. Në fund të komentimit të këtyre ajeteve ai thotë: "Të shfaqurit dhe ndikimi i këtyre dukurive natyrore, të cilat përmenden në këto ajete, duhet të kuptohen ashtu siç ka konfirmuar shkenca e sotme. Përkitazi me këtë nuk guxojnë të jenë kompetente mendimet e mufessirëve, të cilët i kanë shkruar veprat e veta para qinda vitesh, sepse prej asaj kohe shkenca ka përparuar dhe ka ardhur gjer tek rezultatet të cilat janë në kontradiktë diametrale me kuptimet e gjeneratave të mëparshme."

Në suren El-Fil All-llahu xhel-le shanuhu i ka ndëshkuar abisinasit, që ishin nisur për ta rrënuar Ka'ben, në atë mënyrë që ka dërguar tufa shpesësh të gjuajnë në ta copa argjili të pjekur. Ajetet të cilat flasin për këtë Muhammed Abduhui i komenton në mënyrë shumë të afërt me hulumtimet shkencore të historianëve perëndimor. Ai konsideron se abisinasit janë ndalur me epidemi të lisë së madhe e të vogël, shkaktarët e së cilës janë gjendur në copa që i kanë hedhur shpesët mbi ushtrinë, e si argument merr rivajetin e Ikrimes dhe Jakub b. Utbes, të cilët transmetojnë se kjo epidemi është shënuar në arabi për të parën herë në vitin që ata e quajtën 'Amul-fili.[35]

[35] Muhammed Abduhu: Komentimi i xhuzit Amme, faqe 157-158.

Karakteristikë e përgjithshme e kësaj shkolle është theksimi i atyre ajeteve kur'anore ku flitet mbi ligjshmëritë e natyrës, mbi botën bimore dhe shtazore, mbi lëvizjen e trupave qiellor, mbi të vërtetat shkencore të cilat Kur'ani i ka nxjerr në dritë, e shkenca shumë më vonë i ka vërtetuar.

Përkitazi me këtë Mustafa Mahmudi[36], mes tjerash thotë:

"Në Kur'an ekzistojnë shumë ajete të cilat tregojnë se islami është religjion shkencor. Dituria bashkëkohore ofron gjasa jashtëzakonisht të volitshme për komentimin e tyre. Disa ajete kur'anore është e mundur të komentohen vetëm me ndihmën e të arriturave shkencore. Kur'ani nuk është vetëm libër sheriatik, e as që është krijuar vetëm për shkak të stilistikës, retorikës dhe gramatikës. Kur'ani është enciklopedi e cila në vete përmbanë etikë, politikë, psikologji, sociologji, histori, mjekësi, filozofi, madje edhe etapat e zhvillimit të embrionit në mitrën e nënës...

Kur jam përpjekur që në mënyrë racionale-shkencore t'i afrohem egzegjezës së tekstit kur'anor, kam qenë i sulmuar. Prej meje kanë kërkuar ahmedinë dhe diplomën e el-Az'harit, sikur Kur'ani t'ishte krijuar ta komentojnë vetëm ata që posedojnë këto diploma."

---

[36] Mustafa Mahmudi u lind në vitin 1921 në Egjipt ku edhe sot jeton. (Përkthimi i këtij libri në boshnjakishte është botuar në vitin 1981. sh.p.). Ka shkruar shumë vepra prej të cilave tek ne janë përkthyer: *"Nga dyshimi gjer në besim", "Dialog me mikun", "All-llahu"* dhe *"Muhammedi alejhis-selam"*. Tani, ja, paraqitet edhe vepra e tij e pestë e përkthyer në gjuhën tonë. Kjo është përpjekje e tij për kuptimin bashkëkohor të Kur'anit, të cilin ia ofrojmë lexuesve tanë. Më gjerësisht për autorin dhe veprat e tij të shikohet në pjesën hyrëse të veprës "Dialog me mikun", në përkthim të dr. Ahmed Smailoviqit, Sarajevë, 1981, ndërsa në gjuhën shqipe Nexhat Ibrahimi, Miftar Ajdini dhe Muhidin Ahmeti, të botuar nga KSHU së Kosovës në vitin 1990.

Ndër të parët që e kanë përkrahur Mustafa Mahmudin në përpjekjen e tij për ta kuptuar Kur'anin në mënyrë bashkëkohore është Osman Emini, profesor i filozofisë islame në fakultetin filozofik në Kajro, i cili mes tjerash ka thënë:

"Mendoj se Kur'ani nuk u është shpallur vetëm atyre të cilët posedojnë kualifikime profesionale, por edhe atyre që nuk i posedojnë këto. Ibni Abbasi, i cili në kohën e vet është njohur si autoritet në egzegjezën e tekstit kur'anor, nuk ka vijuar kurrfarë shkolle, e as që ka studiuar religjionin. Prej kualifikimeve ai ka pasur vetëm prirjen natyrale. All-llahu xhel-le shanuhu sipas Kur'anit "i jep dituri kujt të dojë Vet". Mustafa Mahmudi posedon, e këtë mund ta shohë çdo lexues objektiv, me prirje dhe aftësi natyrale për këtë punë. Nëse gabon do të jetë i shpërblyer me shpërblimin e muxhtehidit, e nëse vjen tek zgjidhja e drejtë, atëherë shpërblimi i tij do të jetë i dyfishuar."[37]

Kur'ani ka qenë dhe ka mbetur preokupim kryesor i Mustafa Mahmudit. Ai të kuptuarit e vet të Kur'anit nuk e shpien në kufijtë e mendimit filozofik, sepse filozofia është teori. Përpjekja e tij nuk është përpjekje e pastër shkencore e komentimit të Kur'anit, nga shkaku i thjeshtë se ai beson që faktet shkencore janë "supozime", që janë të nënshtruara ndërrimit, ndërsa të vërtetat fetare, parimet nuk durojnë ndërrime.

Përpjekja e tij është përpjekje e komentimit të Kur'anit në përshtatshmëri me kuptimin e tij të brendshëm dhe të jashtëm. Kuptimi i brendshëm i Kur'anit nuk guxon të jetë në kundërshti me kuptimin e jashtëm. Komentimi i brendshëm është i pranuar vetëm atëherë kur është në shërbim

[37] Dr. Aisha Abdurrahman: *El-Kur'an vet-tefsirul aserijju"* (Kur'ani dhe tefsiri bashkëkohor), Kajro 1970, faqe 68.

të kuptimit të jashtëm të Kur'anit dhe kur vjen si vërtetim i domethënies së jashtme të fjalës së Kur'anit.

Mirëpo, duhet të përmendim se Mustafa Mahmudi nuk i ka shqyrtuar gjithnjë ajetet kur'anore në kontekst me ajete të tjera, të cilët gjenden para dhe pas ajetit përkatës. Po ashtu disa ajete i ka amputuar e pastaj i ka shqyrtuar në fragmente, si për shembull një pjesë të ajetit të sures Ali Imran, i cili bën pjesë në ajetet muteshabih, ajetet dykuptimore, komentimin e të cilëve e di vetëm All-llahu xhel-le shanuhu, e jo edhe ajetet muhkemat, ajetet e qarta, ashtu siçi i ka kuptuar Mustafa Mahmudi.

Vepra e Mustafa Mahmudit "Kur'ani - përpjekja për të kuptuarit bashkëkohor" është botuar në vitin 1970, në formë të artikujve në revistën *"Sabahul hajr"*, e diç më vonë edhe si libër i veçant, i cili ka përjetuar më tepër ribotime.

Botimi i parë është paraqitur në vitin 1970, botimi i dytë në vitin 1977 në Kajro në edicionin *Darul me'arif*, e ekziston edhe botimi i tretë bejrutas. Ne gjatë përkthimit jemi shërbyer me botimin e dytë, paksa të zgjeruar, në të cilin gjendet edhe një kapitull, i cili nuk është në botimin e parë të librit.

Tek përkthimi i ajeteve kur'anore jemi shërbyer me përkthimin e Kur'anit nga Besim Korkuti, i cili këtë duhet theksuar, disa ajete i ka përkthyer gabimisht psh. ajetin 72 nga sureja El-Ahzab; ajetin 197 nga sureja El-Bekare; ajetin 40 nga sureja Et-Tevbe, dhe disa të tjera. Përveç kësaj përkthimi i Korkutit nuk është i unifikuar për sa i përket dialektit si për shembull përzierja e ekavishtes dhe ijekavishtes gjatë përkthimit të disa ajeteve dhe shumë gjëra të tjera që kanë të bëjnë me terminologjinë e të toçiturit nga një kulturë në tjetrën.